

MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

# PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR

**Për klasën X të shkollës së mesme të lartë**

Prishtinë, gusht 2003

Kryredaktor

*Isuf Zeneli*

Redaktorë:

*Xhavit Rexhaj*

*Ramush Lekaj*

*Ilaz Zogaj*

*Arbër Salihu*

*Bajram Shatri*

Lektura dhe korrektura:

*Afërdita Kryeziu*

*Arif Demolli*

*Sylejman Dërmaku*

*Miranda Kasneci*



UNMIK



---

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA**

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË  
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, AND TECHNOLOGY  
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**

**LËNDA: ZBATIMI I PLANIT DHE PROGRAMIT PËR KLASËN E DHJETË**

**NR: MASHT 53/01B/2003**

**Datë: 15 gusht 2003**

Në bazë të nenit 6.1 paragrafi (d) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm dhe në përputhje me Rregulloren numër 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi degen e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

**Neni 1**

1.1. Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i Planit dhe programit mësimor për klasën e dhjetë, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit fillor dhe të mesëm.

**Neni 2**

2.1. Plani dhe programi i ri për klasën e dhjetë i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.


### **Neni 3**

3.1. Ky Plan dhe program për klasën e dhjetë zbatohet nga viti shkollor 2003/2004.

3.2. Me zbatimin e Planit dhe të programit të klasës së dhjetë shfuqizohen planet dhe programet e deritashme të klasës së dytë të shkollës së mesme.

### **Neni 4**

4.1. Ky udhëzim hyn në fuqi më 15 gusht 2003.

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Rexhep Osmani', with a horizontal line extending from the end of the signature.

Mr. Rexhep Osmani, Ministër

## **PËRMBAJTJA**

Udhëzim administrativ, **3**

**UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE, 7**

I. Hyrje, **7**

II. Qëllimet, **8**

III. Objektivat e përgjithshëm, **10**

IV. Vlerësimi, **11**

V. Udhëzime metodologjike, **14**

VI. Burimet dhe mjetet mësimore, **15**

VII. Plani mësimor i lëndës, **15**

VIII. Organizimi i procesit mësimor, **16**

## **GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI, **21**

ENGLISH LANGUAGE, **36**

GJUHË FRËNGE, **47**

GJUHË GJERMANE, **61**

GJUHË LATINE, **80**

**MATEMATIKË, 89**

## **SHKENCAT E NATYRËS**

BIOLOGJI, **131**

FIZIKË, **172**

KIMI, **219**

GJEOGRAFI, **253**

## **SHKENCAT SHOQËRORE**

EDUKATË QYTETARE, **287**

HISTORI, **298**

## **ARTET**

ARTI MUZIKOR, **337**

ARTI FIGURATIV, **351**

## **TEKNOLOGJI**

TEKNOLOGJI ME TIK, **361**

## **EDUKATË FIZIKE**

EDUKATË FIZIKE DHE SPORT, **375**

## UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT

### I. HYRJE

Arsimi përfaqëson fushëveprimtarinë prirëse të zhvillimeve shoqërore, politike dhe ekonomike të Kosovës.

Vizionin për krijimin e një shkolle bashkëkohore sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare, që filloi pas përfundimit të luftës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) po e realizon duke ndërmarrë hapa të gjithanshëm dhe praktikë në të gjitha fushat e veprimit.

Në këtë ndërmarrje me rëndësi historike për zhvillimin dhe për përparimin e shoqërisë kosovare, MASHT synon të ndryshojë pikëpamjet në procesin e ndërtimit të individit me një vizion të qartë për të ardhmen e tij dhe të vendit të tij.

Kjo krijon parakushtet e nevojshme për integrimin e individit dhe të shoqërisë kosovare në lëvizjet politike, në zhvillimet ekonomike, intelektuale, shkencore e teknologjike, si dhe në zhvillimet social-kulturore të vendeve të përparuara evropiane dhe botërore.

Zhvillimi i Planit dhe programit mësimor mbështet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtimi i rezultateve të të nxënit, mjetet mësimore, metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit.

Grupet punuese profesionale për zhvillimin e planeve dhe programeve ishin vazhdimisht në rrjedhë të zhvillimeve të reja në arsim dhe në konsultim me ekspertët ndërkombëtarë. Në këtë proces të zhvillimit të planprogrameve, i cili qëndron mbi bazën e strategjisë afatgjate të MASHT-së, ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë UNICEF-i, agjencitë dhe qeveritë e disa shteteve.

Procesi do të kryhet në faza të caktuara në të tri nivelet e shkollimit (nivele të parë I-V, nivele të dytë VI-IX dhe nivele të tretë X-XII ose XIII). Në fazën e parë (2003) është bërë zhvillimi i planeve dhe i programeve lëndore për klasën X.

Vëmendje e veçantë gjatë zhvillimit të planeve dhe programeve mësimore në klasën X i është kushtuar kultivimit të qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit, inkurajimit të nxënësve që të angazhohen në mënyrë të arsyeshme në përmbushjen e kërkesave shkollore, zhvillimit të shkathtësive në jetën e përditshme, vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve. Ata në klasën e dhjetë dhe gjatë tërë shkollimit të mesëm të lartë vihen përballë njohurive akademike, bazave shkencore dhe sferave të ndryshme kulturore.

## II. QËLLIMET

Plani dhe programi lëndor për klasën e dhjetë ka për qëllim:

- të sigurojë kushte të përshtatshme për zhvillimin intelektual, estetik, fizik, shoqëror, moral dhe shpirtëror të nxënësve;
- të sigurojë për nxënësit orientim të drejtë profesional dhe kompatibil me realizimin e intereseve të tyre personale për plotësimin e aspiratave përmes nxënies.
- konsolidimin e diturive, ngritjen, orientimin e prirjeve dhe të shkathtësive në ndërtimin e të ardhmes së tyre;
- që t'iu mundësojë nxënësve shfrytëzimin e burimeve të shumta për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve si dhe për zhvillimin e një qasjeje kritike ndaj informacioneve dhe fakteve që u ofrohen;
- që t'iu mundësojë nxënësve në mënyrë të pavarur të marrin iniciativë dhe veprim, gjithnjë duke pasur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grup, varësisht prej llojeve të ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë;
- që nxënësit me prirje dhe talentë për profesionin të përgatiten dhe të orientohen me kujdes përmes mënyrave të ndryshme të nxënies, duke përfillur interesimet dhe nevojat e tyre për tregun e punës si dhe zhvillim akademik e profesional.

Grupet punuese për zhvillimin e planeve dhe të programeve në përshtatshmëri me përmbajtjen i kanë zgjedhur objektivat e përgjithshëm dhe specifike për sendërtimin e qëllimeve të lartëshënuara nga të cilat në mënyrë të qartë janë përcaktuar edhe rezultatet e pritura në përfundim të klasës së dhjetë.





### III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Për të jetësuar qëllimet e këtij Plani dhe programi nevojiten shumë rezultate të të nxënit që mund të jenë të shkallës së përgjithshme dhe specifike. Gjithë herë vendosen paraprakisht rezultatet e përgjithshme të të nxënit, të cilat duhet të jenë të shkallës së nevojshme të së përgjithshmes dhe të dallohen qartë në aspektin e shkallës së ndërlikueshmërisë apo tërësisë që synojmë të arrihet.

Në bazë të qëllimit të Plani dhe programit mësimor të klasës së nëntë (9) MASHT synon që në fund të vitit mësimor nxënësi t'i arrijë këto objektiva të përgjithshme:

#### ***A. Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat***

- Të jetë kritik ndaj lëndës;
- Të jetë i hapur;
- Të jetë tolerant;
- Të gëzojë respekt;
- Të jetë i vullnetshëm.

#### ***B. Të njohë***

- Fjalorin (terminologjinë);
- Faktet;
- Konceptet;
- Parimet;
- Procedurat dhe metodat.

#### ***C. Të kuptojë***

- Faktet dhe parimet (të zbatojë në situata të thjeshta);
- Përmbajtjen e materialeve;
- Relacionin shkak-efekt;
- Arsyetimin e metodave dhe të procedurave.

#### ***Ç. Të zbatojë në situata të reja***

- Faktet dhe parimet.
- Procedurat dhe metodat;
- Zgjidhjen e problemeve .

#### ***D. Të analizojë***

- Zbërthimin e informatave;
- Krahasimin e fakteve;
- Marrëdhënien ndërmjet shkakut dhe efektit;
- Raportin e ngjarjeve në një tekst.

#### ***DH. Të sintetizojë (të menduarit kritik- kompleks)***

- Njohjen e informatës relevante dhe jo relevante;
- Dallimin ndërmjet faktit dhe mendimit;
- Zbatimin e parimeve në zgjidhjen e problemeve;
- Interpretimin e materialit ilustrues;
- Njohjen e supozimeve.

Për të vlerësuar arritjen e këtyre objektivave duhet të zhvillojmë procedurë dhe mjete adekuate të matjes (shih vlerësimi).

### **IV. VLERËSIMI**

Vlerësimi është proces i vrojtimit, i mbledhjes sistematike, i analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzuese. Ai duhet të mbështetet në rezultatet e pritura të programit të lëndës përkatëse dhe të nivelit përkatës.

Ky proces mbështetet në disa parime themelore siç janë:

- përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- zbatimi i instrumenteve adekuate të matjes në përputhje me qëllimin në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- zbatimi i teknikave të vlerësimit me anë të së cilave bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

#### **IV. 1. Instrumentet e vlerësimit**

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- vrojtimi;
- pyetëtori (vetëvlerësimi);
- raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- testi i bazuar në kritere dhe objektiva;
- testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje):
  - me përgjigje alternative të shumta;
  - me përgjigje të hapuar të shkurtra;
  - me përgjigje të hapura të zgjëruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

*Çdo shkollë vendos standardet apo kriteret me anën e së cilave përcaktohet shkalla e arritshmërisë në fund të procesit mësimor për klasën e dhjetë.*

#### **IV. 2. Shkalla e përfitimit**

Në fund të vitit mësimor çdo nxënës duhet të arrijë njërin prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumë mirë (arritje e lartë);
- mirë (arritje mesatare);
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme).

Shkalla e përfitimit të arritshmërisë varet drejtpërdrejt nga standardet e arritshmërisë (shiko tabelën më poshtë) të cilat bazohen në:

<b>Objektivat e përgjithshëm</b>	<b>Arritje shumë e lartë 90%</b>	<b>Arritje e lartë 80%</b>	<b>Arritje e kënaqshme 60%</b>	<b>Arritje e kufizuar 40%</b>	<b>Arritje e pamjaftueshme</b>
<i><b>Njohja e lëndës</b></i>	Aftësi shumë e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi mesatare në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e kufizuar në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi jo e mjaftueshme në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.
<i><b>Të kuptuarit e proceseve shkencore</b></i>	Aftësi shumë e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të iformacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të iformacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kënaqshme e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të iformacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kufizuar e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore	Aftësi e pamjaftueshme e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore
<i><b>Të menduarit kritik</b></i>	Aftësi e lartë e të menduarit kritik në situata komplekse si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e të menduarit kritik në situata komplekse, si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e kufizuar e të menduarit kritik në situata komplekse s : njohja me informacione relevante, zgjedhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.		
<i><b>Shkathtësitë manovruese</b></i>	Shkallë e kënaqshme e përfitimit në shkathtësitë manovruese.			Shkallë e ulët e përfitimit (disa) në shkathtësitë manovruese.	

## V. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përzgjedhja e metodave mësimore është në kompetencë të mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me veçoritë e përmbajtjes së temave mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet kombinuar, të jenë sa më të larmishme, ngase nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat dhe teknikat e mësimitdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë llojet e mësimitnxënies. Mësimitdhënësi mund të përdorë disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara për të arritur rezultate sa më të larta gjatë procesit mësimor.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda dhe teknika të ndryshme:

- shpjegimi dhe sqarimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- të mësuarit problemor;
- diskutimi (debati);
- puna në grupe;
- demonstrimi dhe interpretimi;
- teknika e të menduarit kritik;
- shtrim idesh (brainstorming);
- vetëhulumtimi (kërkimi).

Për tema të caktuara që karakterizohen me informacione të bollshme gjejn zbatim edhe ligjërata ndërvepruese e kombinuar me veprimtari praktike.

Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses mësimi në natyrë, eskursione të ndryshme studimore, vizita institucioneve të ndryshme etj.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

## VI. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive e këtij plani dhe programi, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi. Deri tash burim kryesor informimi ishte teksti shkollor i lëndës përkatëse.

Krahas teksteve të ndryshme shkollore sugjerojmë të përdoren edhe materiale të tjera informimi:

- doracakë, atlasë, broshura;
- gazeta, revista profesionale dhe shkencore;
- fotografi, posterë, afishe, skema, diagrame, harta, tabela;
- modele, figura, makete;
- fotoslajde, filma, videokaseta;
- programe të kopjuterëve, interneti, CD-të etj.

Është kompetencë e arsimtarit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon, shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

## VII. PLANI MËSIMOR I LËNDËS

	Lëndët mësimore	Gjinnazi i përgjith shëm	Gjinnazi matematikë& informatikë	Gjinnazi i shkencave natyrore	Gjinnazi i shkencave shoqërore	Gjinnazi i gjuhëve
		Numri vjetor i orëve mësimore				
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	148	148	111	148	148
2	Gjuhë angleze	111	111	74	111	111
3	Gjuhë e dytë e huaj	74			74	111

4	<b>Gjuhë latine</b>			74		
5	<b>Matematikë</b>	111	296	111	74	74
6	<b>Biologji</b>	74	74	111	74	74
7	<b>Fizikë</b>	74	74	111	74	74
8	<b>Kimi</b>	74	74	74	74	74
9	<b>Gjeografi</b>		74	74	74	
10	<b>Edukatë qytetare</b>	74			74	74
11	<b>Histori</b>	74	74	74	74	74
12	<b>Art muzikor</b>	37		37		37
13	<b>Art figurativ</b>	37		37	37	37
14	<b>TIK (Teknologjia e informacionit dhe komunikimit)</b>	74	74	74	74	74
15	<b>Edukatë fizike dhe sportive</b>	74	74	74	74	74
16	<b>Pjesa sipas zgjedhjes:</b> a) Orë plotësuese nga lëndët e obligueshme b)Gjuhë e dytë e huaj, gjuhë e tretë e huaj c) Studime kulturore kombëtare, Studime Europiane ç) Matematika aplikative d) Edukimi qytetar,etika, artet e interpretimit, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, arsimimi për ndërmarrës, TIK. e)Mjedisi jetësor f) Kohë e dedikuar për ekskurzione/shetitje dhe veprimtari për zhvillimin individual	74	37	74	74	74
	<b>Gjithsej</b>	<b>1110</b>	<b>1110</b>	<b>1110</b>	<b>1110</b>	<b>1110</b>

## VIII. ORGANIZIMI I PROCESIT MËSIMOR

### Mësimi i rregullt

Plani dhe programi mësimor i klasës së dhjetë duhet të realizohet për jo më pak se 37 javë të obliguara me Ligj, ose 185 ditë të përcaktuara me kalendarin shkollor në vitin kalendarik shkollor 2003 / 04.



Pesëmbëdhjetë lëndë mësimore të para janë të obligueshme, për të cilat është përcaktuar edhe Plani i shpërndarjes së orëve mësimore.

### **Mësimi zgjedhor**

Pjesa sipas zgjedhjes në Plan dhe program i mbetet shkollës në dispozicion, ajo ka të bëjë me autonominë e shkollës.

Vendimi për pjesën e Planit dhe të programit sipas zgjedhjes duhet të merret mbi bazë të këshillave, ku do të përfshihen nxënësit, mësuesit, prindërit dhe faktorët e tjerë të interesuar. Ky vendim duhet të merret në organet profesionale të shkollës më së largu deri më 15 shtator.

Shkolla e bën zgjedhjen, duke përfillur nevojat dhe kërkesat individuale të nxënësve. Këto orientime lejojnë hapësirë për një veprimtari më të individualizuar në shkollë, njëkohësisht ofrojnë standarde për një proces arsimor më cilësor dhe të barabartë, pavarësisht nga dallimet midis nxënësve.

Kurset dhe veprimtaritë sipas zgjedhjes mund të sugjerohen nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, ose mund t'i propozojë shkolla. Zgjedhja mund të bëhet në:

- a) orë plotësuese nga lëndët e obligueshme (p.sh. 1 ose 2 orë mësimi në gjuhën amtare, gjuhë të huaj, matematikë ose për ndonjë lëndë tjetër mësimore);
- b) gjuhë e huaj (nxënësit dhe shkolla mund të përcaktohen cila nga gjuhët e huaja mund të merret si gjuhë e dytë apo edhe gjuhë e tretë e huaj: gjuha gjermane, gjuha frenge, gjuha spanjolle, gjuha italiane apo një gjuhë tjetër europiane);
- c) Mund të zgjedhet edhe ndonjë lëndë e re mësimore (si p.sh. Studime kulturore kombëtare, Studime europiane, Matematika aplikative etj)
- ç) futjen e lëndëve/kurseve të reja (p.sh.edukimi qytetar, etika, artet e interpretimit, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, arsimimi për ndërmarrës, teknologjia e informimit dhe e komunikimit etj.);
- d) tema nga jeta (si p.sh. mbrojtjen e mjedisit jetësor, tema të integruara etj.)
- e) kohë e dedikuar për ekskursionë/shëtitje dhe veprimtari për zhvillimin individual.

Në bazë të kësaj shkolla ka mundësinë e angazhimit më me përgjegjësi në hartimin e programeve të nevojshme për lëndët/kurset e ofruara, gjithnjë duke pasur për bazë planin dhe programin nga lëndët e obliguara dhe në përmbushjen e nevojave dhe të kërkesave themelore të nxënësve, që të sigurohen mundësi të barabarta për të gjithë. Nga MASHT mund të kërkohej ndihmë për materialet e nevojshme për kurset e zgjedhura nga shkolla.

Pasi shkolla të vendosë për pjesën zgjedhore të planit dhe të programit (orë plotësuese nga lëndët e obligueshme apo lëndëve/kurseve të tjera), zgjidhet kuadri adekuat për udhëheqjen e mësimit në këto lëndë/kurse gjatë zbatimit.

Kur shkolla vendos sipas kërkesave dhe nevojave të nxënësve për një zgjedhje të tillë, udhëheqja e mësimit bëhet e obligueshme, siç bëhet edhe informimi i zyrës rajonale të arsimit dhe drejtorisë komunale të arsimit.

Kohëzgjatja e mësimit zgjedhor në kurset e ofruara përcaktohet nga organet profesionale të shkollës, varësisht nga plotësimet e kërkesave dhe të përmbushjes së nevojave të nxënësve.

---

## GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

---

*Hyrja, qëllimet, objektivat, rezultatet e pritura, shkathësitë e komunikimit, lidhja ndërlëndore, metodologjia, vlerësimi, si dhe literatura janë të përbashkëta për të gjitha llojet e gjimnazeve.*

### HYRJJE

Shkolla e mesme e lartë është vazhdim i shkollës së mesme të ulët dhe ky nivel shkollimi synon t'i pavarësojë nxënësit dhe të kultivojë tek ata frymën kritike.

Synimet themelore të mësimin në klasën e dhjetë janë: përvetësimi i dijeve, formimi gjuhësor, formimi kulturor, formimi si individ dhe si qytetar. Si synime të lidhura drejtpërdrejt me shkollën e mesme të lartë, do të veçonim zotërimin e gjuhës amtare, njohjen e letërsisë dhe përvetësimin e një kulture.

Shkolla e mesme e lartë kontribuon për formimin kulturor të nxënësve nëpërmjet leximit të teksteve të të gjitha llojeve, po kryesisht të veprave letrare më të njohura. Kjo u bën të mundur nxënësve të krijojnë perspektivën historike të hapësirës kulturore të cilës ata i përkasin. Ato, në të njëjtën kohë, janë edhe realizimet gjuhësor më të mira.

Ajo favorizon formimin e nxënësve si individë përmes aftësimin të tyre në përdorimin e gjuhës amtare, përmes mundësive që u jep nxënësve të strukturojnë gjithnjë e më mirë mendimet, gjykimet dhe imagjinatën e tyre. Si rezultat i punës së bërë në këtë nivel shkollimi, nxënësit arrijnë të organizojnë mendimet e tyre dhe të bëjnë me gojë dhe me shkrim paraqitje që i trajtojnë problemet e trajtuara nga disa pikëpamje.

Përmes njohurive që u ofron nxënësve nga trashëgimia kulturore kombëtare dhe botërore dhe përmes analizës së ideve dhe argumenteve përkatëse ajo kontribuon në formimin e tyre si qytetarë.

### QËLLIMET

Në klasën e dhjetë synohet:

- përforcimi i arritjeve të mëparshme
- zotërimi në rritje i përdorimit të gjuhës

- rritja e nivelit të komunikimit me diskurset orale, letrare dhe joletrare
- arritja e kulturës së mendimit të pavarur

## **OBJEKTIVAT**

- Nxënësi do të lexojë, të shkruajë, të dëgjojë dhe të flasë, me qëllim të përvetësimit të informatave dhe zhvillimit të shkathtësisë së të kuptuarit
- Nxënësi do të lexojë, të shkruajë, të dëgjojë dhe të flasë, që të pasurojë të shprehurit dhe të dëshmojë dije për gjuhën, letërsinë dhe kulturën
- Nxënësi do të lexojë, të shkruajë, të dëgjojë dhe të flasë, që të mund të zhvillojë shkathtësitë për mendim kritik dhe vlerësim
- Nxënësi do të lexojë, të shkruajë, të dëgjojë dhe të flasë, me qëllim të krijimit të individualitetit të pavarur dhe të një bote të pasur shpirtërore

## **REZULTATET E PRITURA**

Nxënësi do të zhvillojë shkathtësi të veçanta individuale, njohëse dhe komunikative, duke punuar në grupe po edhe individualisht. Në fund të klasës, ai do të bëjë dallimin në mes diskurseve dhe në mes formave të ndryshme letrare e joletrare. Do të njohë format dhe idetë themelore të letërsisë antike, të Mesjetës dhe të letërsisë së vjetër shqipe. Do të njohë esencat e kulturës tradicionale shqiptare. Do të zhvillojë aftësitë argumentuese dhe vlerësuese për përmbajtjet e zhvilluara. Do të lexojë, të analizojë e të interpretojë krijime letrare të kohëve të ndryshme - të zgjedhura, brenda konteksteve kulturore të caktuara. Do të zhvillojë dijet gjuhësore, kryesisht në aspekt të krijimit dhe analizës së sentencës, të stilistikës gjuhësore etj. Do të kultivojë shijen për letërsinë dhe për gjuhën shqipe dhe do të rrisë interesimin dhe dijen për kulturat e tjera, nëpërmjet krahasimeve dhe shembujve.

Standardet dhe përmbajtjet nga kjo lëndë dhe për këtë klasë, do të realizohen duke u mbështetur në zhvillimin e **shkathtësive të komunikimit** dhe në ngritjen e **vetëdijes së komunikimit**:

## I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

## II. TË LEXUARIT

## III. TË SHKRUARIT

Përmbushja e standardeve që iu referohen këtyre shkathtësive synon pasurimin e një tipari shumë të rëndësishëm për këtë nivel: mendimin e pavarur, reflektimet personale për përmbajtje të caktuara.

## I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nëpërmjet të dëgjuarit do të zhvillohet:

- aftësia për të parafrazuar
- identifikimi i formave letrare dhe diskurseve letrare e joletrare
- ndjenja për kulturë gjuhësore
- identifikimi i qëllimit të folësit dhe karakterit të informatës
- identifikimi i diskursit (tipit të ligjëratës) dhe i funksionit të tij
- parashikimi e pikave të folësit dhe ngritja e supozimit për vlerat për të cilat flitet
- definimi i qartësive dhe paqartësive
- sinteza e informatave nga burime të ndryshme, ngjeshja, kombini-mi dhe kategorizimi i të dhënave, fakteve dhe ideve
- njohja e përdorimit efektiv të gjuhës
- njohja e përmbajtjes, fjalorit ose të folmeve të caktuara (dialektet e ndryshme, të folmet: prishtinase, tiranase etj.)
- lidhja e përmbajtjeve të tekstit letrar me dijet kulturore, me përvojat paraprake dhe me situatat e përditshme
- nxitja e mendimit të pavarur
- marrja e informative dhe mendimeve, si dhe klasifikimi i tyre
- formimi i drejtë i pyetjeve
- përdorimi i trajtave të ndryshme foljore

Nëpërmjet të folurit do të zhvillohet:

- dhënia e informatave dhe mendimeve
- zhvillimi i të folurit ndërveprues (dialogu, debati etj.), në të folur për tekste të ndryshme
- shkathtësia para të tjerëve dhe me të tjerët
- analiza me gojë e teksteve letrare
- rritja e shkathtësive të përdorimit të gjuhës

- zhvillimi i analizave kritike më gojë, në grup dhe individualisht
- zhvillimi i aftësive vlerësuese
- krahasimi i kulturës shqiptare me të tjerat
- pjesëmarrja në grupe për përgatitjen e projekteve ose vlerësimeve
- marrja e përgjegjësisë për detyra të ndryshme
- përfshirja e të gjithë nxënësve në paraqitje gojore
- zhvillimi i aftësisë për analizë të teksteve letrare
- vlerësimi i efektivitetit të punës në grupe
- organizimi i informacionit nga burime të ndryshme, për qëllime hulumtuese

## II. TË LEXUARIT

Nëpërmjet të lexuarit do të zhvillohet:

- të kuptuarit e teksteve të ndryshme
- njohja e letërsisë dhe kulturës kombëtare në raport me kulturat e tjera dhe me historinë
- analiza dhe vlerësimi i teksteve letrare të kohëve dhe kulturave të ndryshme
- analiza dhe dallimi i diskurseve të ndryshme
- hetimi i ngjashmërive dhe dallimeve të strukturave të ndryshme letrare e kulturore në letërsitë dhe kulturat e ndryshme
- identifikimi i temave universale dhe atyre nacionale
- njohja e esencave kulturore shqiptare: kultura gojore dhe ajo me shkrim; kultura tradicionale, format dhe ndikimet
- njohja e letërsisë së vjetër shqipe; kontekstit historik, letrar dhe gjuhësor; letërsia dhe shoqëria; letërsia dhe religjioni
- përshkrimi i arketipave letrare e kulturore në tekste të ndryshme
- trajtimi i teksteve letrare nga disa perspektiva kritike
- njohja e letërsisë antike, e kontekstit kulturor përkatës dhe e diskurseve; drama dhe teatri, regjizura
- parafrazimi dhe interpretimi i teksteve të zgjedhura
- verifikimi i formave të drejta gramatikore
- përdorimi i saktë i informatave nga burime të ndryshme dhe verifikimi i tyre
- përdorimi i teknologjisë moderne për qëllime hulumti
- leximi i fragmenteve të teksteve

### III. TË SHKRUARIT

Nëpërmjet të shkruarit do të realizohet:

- eseja e llojeve të ndryshme për qëllime përkatëse
- shkrimi funksional, zhvillimi dhe organizimi i idesë dhe strukturës së një shkrimi
- shkrimi individual; dhënia e tiparit individual shkrimit; stilistika gjuhësore
- konstruktimi i teksteve (në shembullin e formave të identifikuara - në trajta të reduktuara)
- zhvillimi i formave të ndryshme të shkrimeve dhe të paraqitjeve;
- analiza e qartë e ideve dhe teksteve përmes shkrimit
- organizimi i idesë brenda një sekuence logjike
- përdorimi korrekt i gjuhës, pikësimit dhe drejtshkrimit
- analiza e shkrimit të tjerëve
- shkrimi argumentues
- sugjerimi për përmirësimin e një shkrimi
- analiza kritike ndaj një shkrimi të caktuar
- shkrimi si mjet analize, interpretimi dhe vlerësimi
- zbërthimi i koncepteve në terme më të thjeshta dhe më të kuptueshme
- mbledhja dhe seleksionimi i informatave; klasifikimi i tyre sipas rëndësisë
- eseja personale, narrative dhe refleksive

**Gjimnazi i Përgjithshëm,  
Gjimnazi i Gjuhëve,  
Gjimnazi i Shkencave Shoqërore dhe  
Gjimnazi Matematikë-Informatikë**

## **STRUKTURA E PËRMBAJTJES**

### **Argument:**

- Mësimi i diskurseve (ligjërimeve) në planin praktik, qoftë si diskurse të aplikueshme ose pragmatike, qoftë si diskurse letrare, gojore e të shkruara, mundëson një qasje të re ndaj letërsisë: diskurset (mënyrat dhe ngjyrimet e ligjërimit) si sisteme komunikimi dhe si shenjë e modelit kulturor. Në këtë frymë, dija letrare nuk jepet vetëm si qëllim në vete, por në funksion të modeleve kulturore e sociokulturore dhe në funksion të zhvillimi më të mirë të shkathtësive gjuhësore. Edhe dijet teorike vihen në funksion të njohjes praktike dhe të ilustrimit të modeleve të nënvizuara. Po ashtu, ruhen shenjat e ecjes në rrjedhën historike, por jo të tipit të Historisë së letërsisë si metodë sa të tipit të Historisë së modeleve letrare e kulturore. Për shembull, Letërsia e Vjetër shihet kryesisht përbrenda kulturës retorike, duke iu referuar varianteve të shfaqjeve konkrete. Kjo mundëson njohjen e saj në planin e destinimit e të funksionit, si dhe në planin e shfaqjeve zhanrore, pa e përfshirë dimensionin e saj kulturor.
- Mësimi i gjuhës dhe letërsisë në këtë mënyrë e kushtëzon metodën aplikative, e cila bashkërendon njohuritë e dhëna në një sistem, i cili do të duhej të kulmonte me atë që quhet kulturë shkrimi. Shkrimi do të zhvillohet në zhanrin e esesë, në forma të tjera, pastaj si analizë e si koment letrar e joletrar për tekste të caktuara.
- **Vërejtje:** Autorët janë vënë si pika orientuese dhe si ilustrime e jo si qëllim në vete



### **Tërësitë tematike dhe numri i orëve:**

(Kategoritë dhe nënkategoritë)

- *Kulturë tradicionale* - 15 orë
- *Letërsi klasike dhe e Mesjetës* - 45 orë
- *Letërsi e vjetër shqiptare* - 60 orë
- *Kulturë gjuhe* - 28 orë

Synimet themelore në kuadër të tërësive tematike:

- Zhvillimi i diskurseve letrare dhe joletrare
- Njohja e modeleve kulturore

### **KULTURË TRADICIONALE**

- *Kultura gojore / Kultura e shkruar* (esencat, me një përqendrim të dallimet dhe relacionet ndërmjet diskurseve - interdiskursiviteti)
- *Kanuni*: diskursi kodifikues, diskursi etnik - lexim dhe analizë (edhe gjuhësore)
- *Eposi për Mujin dhe Halilin*; diskursi epik, tema heroike, eposi dhe mitologjia shqiptare
- *Balada dhe përralla shqiptare*; diskursi baladik, diskursi përrallor; esencat tematike dhe strukturore

### **LETËRSIA KLASIKE DHE E MESJETËS**

- *Epi i Gilgameshit*: diskursi fantastik; tema e pavdekësisë; hyjnorja, njerëzorja, shtazorja - koment i pjesëve/këngëve të zgjedhura
- *Letërsia klasike greke* - dimensionimi sociokulturor
- *Homeri*  
Esenca e epopesë: diskursi heroik, tema e luftës (*Iliada*), e kthimit (*Odiseja*); mitologjia dhe historia, kultura dhe historia; miti
- *Eskili*  
Esenca e tragjedisë, diskursi tragjik
- *Aristofani*  
Esenca e komedisë, diskursi komik
- *Ditirambi, oda, himni; Safo etj.*, diskursi poetike-përkushtuese dhe personale
- *Aristoteli*  
Poetika, retorika; esencat teorike: mënyrat, kategoritë letrare – nocionet themelore

- Letërsia e Mesjetës - esencat kulturore
- *Kënga e Rolandit*: relacioni me eposin shqiptar - pjesë/këngë për ilustrim
- Dante Aligieri  
Fillimi i letërsive nacionale; diskursi/teksti alegorik - pjesë të zgjedhura për komentim nga *Ferri*

## LETËRSI E VJETËR SHQIPTARE

- Latiniteti - koncepti kulturor; Humanizmi dhe nacionalja
- M. Barleti  
Diskursi historik / diskursi fiksional / diskursi retorik-heroik; Përpunimi i *Parathënies*, komentimi i së paku një Libri nga *Historia e Skënderbeut*
- Kultura e krishterë / Kultura shqiptare
- Kultura retorike
- Letërsia kishtare, diskursi biblik; Letërsia e vjetër
- Konteksti historik dhe kulturor i shkrimit të vjetër shqip
- Shkrimi si dokument / Shkrimi si kulturë letrare
- Letërsia si Retorikë - dimensionin teorik (çështja e zhanrit)
- Librat liturgjikë
- Kodet tematike
- Diskurset kulturore dhe diskurset letrare (retorike)
- Planet poetike (p.sh. te poema e J. Varibobës)
- Statuset autoriale (tipi i autorësisë së tekstit të vjetër)
- Gjon Buzuku  
*Meshari*: dimensionin kulturor dhe linguistik; Parathënia, parabolat, himnet religjioze, diskursi i përkushtimit shpirtëror - analizë dhe komente letrare, sociokulturore dhe filologjike
- Pjetër Budi  
Veprat në kontekstin kulturor, destinimi, letrarja dhe joletrarja, motivi biblik dhe ai nacional, poezia religjioze - analizë dhe komentim (tekste ilustrative - me zgjedhje)
- Frang Bardhi  
Diskursi apologjik-retorik (*Apologjia e Skënderbeut*) - një copë tekst me zgjedhje; fjalët e urta
- Pjetër Bogdani  
Konteksti i shfaqjes së veprës *Cuneus prophetarum*; *Të primit përpara letërarit*, *Krijimi i rruzullimit*, *Këngët e sibilave*, *Ligjë-*

*rata* (me zgjedhje) - analizë në planin e diskurseve dhe të figurave retorike

- Jul Variboba  
Konteksti kulturor arbëresh; *Gjella e Shën Mërisë Virgjër*, struktura e ndërliqshme letrare, diskurset - ilustrime, komente me analizë teksti e gjuhe  
Bejtexhinjtë - dimensionin kulturor; strukturat, diskurset dhe temat letrare
- Nezim Frakulla  
Divani; Poetika: vargu dhe ritmika e poezisë; diskursi personal.
- Hasan Zyko Kamberi  
Poezia: kodet tematike, diskursi social dhe ai satirik
- Muhamet Kyçyku-Çami  
*Erveheja*, poema - struktura, diskursi, tema dashurisë dhe e besnikërisë

## KULTURË GJUHE

Orët e kulturës së gjuhës të zhvillohen në lidhje me përmbajtjet nga orët e letërsisë.

- gjuha letrare dhe gjuha e letërsisë, distinkcione të nxjerra nga shembujt
- kthim i tekstit të vjetër shqip në shqipe standarde, p.sh.: te Buzuku
- rikapitulim i mbiemrit, punë praktike, tekst kreativ
- ushtrime drejtshkrimi; pikësimi dhe efektet letrare
- sforcime të niveleve gramatikore sipas nivelit të nxënësve
- analiza e teksteve letrare dhe eseja e zhvilluar nga nxënësit në klasë dhe në shtëpi, të mbikëqyret dhe të kontrollohet vazhdimisht në planin gjuhësor, drejtshkrim e gramatikë
- shkrimi i përjetuar i sentencave efektive
- shkrimi i sentencave të kombinuara
- shkrimi i një historie (rrëfimi)
- rishikim kohë pas kohe i pjesëve të ligjëratës
- sprovimi i modeli të ri të sentencës
- domeni stilistik i kombinimit të fjalive, përdorimi dhe teknikat
- rishikimi i modeleve të sentencave bazike dhe hyrje në modelet e sentencave të reja
- udhëheqja e nxënësve në procesin e mendimit dhe të shkrimit

- mësimi i strategjive të shkrimit, si zgjerimi apo reduktimi i sentencës
- shkrimi i sentencave me bashkërenditje dhe me nënrenditje; sentencat e kombinuara qëllimshëm
- zhvillimi i projekteve me shkrim, që përfshijnë të folurit bindës, editorialin, reportin dëshmuës (për gjërat e para me sy), esenë hulumtuese, esenë autobiografike, shkrimin eseistik në logjikën shkak-pasojë, rrëfime personale etj.
- ndryshimet historike (fonetike) të tingujve të shqipes, shembuj nga letërsia e vjetër; ndryshime të tjera
- gjuha letrare dhe gjuha e folur
- ushtrimi i përdorimit të drejtë të shkathësive gramatikore në shkrim; trajtat e pashtjelluara të foljes
- ndajshtimi dhe sentencat me fjali ndajshuese
- eseja (lloje të ndryshme) si shkrim mbizotërues dhe pasues; pas zhvillimit të njësisë mësimore

**Gjimnazi i Shkencave të Natyrës****STRUKTURA E PËRMBAJTJES****Argument:**

- Mësimi i diskurseve (ligjërimeve) në planin praktik, qoftë si diskurse të aplikueshme ose pragmatike, qoftë si diskurse letrare, gojore e të shkruara, mundëson një qasje të re ndaj letërsisë: diskurset (mënyrat dhe ngjyrimet e ligjërimit) si sisteme komunikimi dhe si shenjë e modelit kulturor. Në këtë frymë, dija letrare nuk jepet vetëm si qëllim në vete, por në funksion të modeleve kulturore e sociokulturore dhe në funksion të zhvillimi më të mirë të shkathtësive gjuhësore. Edhe dijet teorike vihen në funksion të njohjes praktike dhe të ilustrimit të modeleve të nënvizuara. Po ashtu, ruhen shenjat e ecjes në rrjedhën historike, por jo të tipit të Historisë së letërsisë si metodë sa të tipit të Historisë së modeleve letrare e kulturore. Për shembull, Letërsia e Vjetër shihet kryesisht përbrenda kulturës retorike, duke iu referuar varianteve të shfaqjeve konkrete. Kjo mundëson njohjen e saj në planin e destinimit e të funksionit, si dhe në planin e shfaqjeve zhanrore, pa e përjashtuar dimensionin e saj kulturor.
- Mësimi i gjuhës dhe letërsisë në këtë mënyrë e kushtëzon metodën aplikative, e cila bashkërendon njohuritë e dhëna në një sistem, i cili do të duhej të kulmonte me atë që quhet kulturë shkrimi. Shkrimi do të zhvillohet në zhanrin e esesë, në forma të tjera, pastaj si analizë e si koment letrar e joletrar për tekste të caktuara.
- **Vërejtje:** Autorët janë vënë si pika orientuese dhe si ilustrime e jo si qëllim në vete

**Tërësitë tematike dhe numri i orëve:**  
(Kategoritë dhe nënkategoritë)

- *Kulturë tradicionale - 13 orë*

- *Letërsi klasike dhe e Mesjetës - 35 orë*

-Letërsi e vjetër shqiptare - 45 orë

-Kulturë gjuhe - 18 orë

Synimet themelore në kuadër të tërësive tematike:

- Zhvillimi i diskurseve letrare dhe joletrare

- Njohja e modeleve kulturore

## KULTURË TRADICIONALE

- Kultura gojore / Kultura e shkruar (esencat, me një përqendrim te dallimet dhe relacionet ndërmjet diskurseve - interdiskursiviteti)
- *Kanuni*: diskursi kodifikues, diskursi etnik - lexim dhe analizë (edhe gjuhësore)
- Eposi për Mujin dhe Halilin; diskursi epik, tema heroike, eposi dhe mitologjia shqiptare
- Balada dhe përralla shqiptare; diskursi baladik, diskursi përrallor; esencat tematike dhe strukturore

## LETËRSIA KLASIKE DHE E MESJETËS

- Letërsia klasike greke - dimension i sociokulturor
- Homeri - Esenca e epopesë: diskursi heroik, tema e luftës (*Iliada*), e kthimit (*Odiseja*); mitologjia dhe historia, kultura dhe historia; miti
- Eskili - Esenca e tragjedisë, diskursi tragjik
- Aristofani - Esenca e komedisë, diskursi komik
- Letërsia e Mesjetës - esencat kulturore
- Dante Aligieri

Fillimi i letërsive nacionale; diskursi/teksti alegorik - pjesë të zgjedhura për komentim nga *Ferri*

## LETËRSI E VJETËR SHQIPTARE

- Latiniteti - koncepti kulturor; Humanizmi dhe nacionalja
- M. Barleti
- Diskursi historik / diskursi fiksional / diskursi retorik-heroik; Përpunimi i *Parathënies*, komentimi i së paku një Libri nga *Historia e Skënderbeut*
- Kultura e krishterë / Kultura dhe letërsia shqiptare
- Shkrimi si dokument / Shkrimi si kulturë letrare

- Statuset autoriale (tipi i autorësisë së tekstit të vjetër)

- Gjon Buzuku

*Meshari*: dimensionimi kulturor dhe lingvistik; Parathënia, parabolat, himnet religjioze, diskursi i përkushtimit shpirtëror - analizë dhe komente letrare, sociokulturore dhe filologjike

- Pjetër Budi

Veprat në kontekstin kulturor, destinimi, letrarja dhe joletrarja, motivi biblik dhe ai nacional, poezia religjioze - analizë dhe komentim (tekste ilustrative - me zgjedhje)

- Frang Bardhi

Diskursi apologjik-retorik (*Apologjia e Skënderbeut*) - një copë tekst me zgjedhje; fjalët e urta

- Pjetër Bogdani

Konteksti i shfaqjes së veprës *Cuneus prophetarum; Të primit përpara letërsisë, Krijimi i rruzullimit, Këngët e sibilave, Ligjërata* (me zgjedhje) - analizë në planin e diskurseve dhe të figurave retorike

- Jul Variboba

Konteksti kulturor arbëresh; *Gjella e Shën Mërisë Virgjër*, struktura e ndërliqshme letrare, diskurset - ilustrime, komente me analizë teksti e gjuhe

Bejtexhinjtë - dimensionimi kulturor; strukturat, diskurset dhe temat letrare

- Nezim Frakulla

Divani; Poetika: vargu dhe ritmika e poezisë; diskursi personal.

- Hasan Zyko Kamberi

Poezia: kodet tematike, diskursi social dhe ai satirik

- Muhamet Kyçyku-Çami

*Erveheja*, poema - struktura, diskursi, tema dashurisë dhe e besnikërisë

## KULTURË GJUHE

Orët e kulturës së gjuhës të zhvillohen në lidhje me përmbajtjet nga orët e letërsisë.

- gjuha letrare, gjuha e folur dhe gjuha e letërsisë
- kthim i tekstit të vjetër shqip në shqipe standarde, p.sh.: te Buzuku
- ushtrime drejtshkrimi; pikësimi dhe efektet letrare
- sforcime të niveleve gramatikore sipas nivelit të nxënësve

- analiza e teksteve letrare dhe eseja e zhvilluar nga nxënësit në klasë dhe në shtëpi, të mbikëqyret dhe të kontrollohet vazhdimisht në planin gjuhësor, drejtshkrim e gramatikë
- shkrimi i një historie (rrëfimi)
- rishikim kohë pas kohe i pjesëve të ligjëratës
- domeni stilistik i kombinimit të fjalive, përdorimi dhe teknikat
- udhëheqja e nxënësve në procesin e mendimit dhe të shkrimit
- ndyshimet historike (fonetike) të tingujve të shqipes, shembuj nga letërsia e vjetër; ndryshime të tjera
- ndajshtimi dhe sentencat me fjali ndajshuese
- eseja (lloje të ndryshme) - pas zhvillimit të njësisë mësimore

## **LIDHJA NDËRLËNDORE**

Gjuha shqipe, si gjuhë amtare, është mjete për krijimin e aftësive të nevojshme komunikative në të gjitha lëndët. Lidhje të drejtpërdrejta vihen me historiografinë (veçanërisht me historinë e kulturës), me edukatën qytetare, me artet etj.

## **METODOLOGJIA**

Mësimdhënësi duhet t'i zbatojë me këmbëngulje metodat që vënë nxënësin në qendër të vëmendjes. Kjo hap rrugë për mësim aplikativ. Mësimi duhet të organizohet në seanca që bashkojnë të folurit, shkrimin dhe leximin. Seanca ndryshon në vartësi të synimeve të mësimdhënësit dhe të reagimit të nxënësve.

Do të aplikohen dy mënyra leximi: leximi analitik dhe leximi i shpejtë. Leximi analitik ka si qëllim analiza të hollësishme të objekteve të caktuara dhe mund të aplikohet në tekste të gjatësive të ndryshme. Leximi i shpejtë nënkupton leximin e zakonshëm. Me të nxitet pavarësimi i nxënësve në leximin e teksteve të ndryshme. Raporti ndërmjet këtyre dy tipave të leximit gjatë vitit duhet të jetë i ekuilibruar.

Lidhja ndërmjet leximit e shkrimit duhet të jetë e përhershme, qoftë edhe kur aplikohen shkrime kreative, imituese ose transformuese. Derisa studimi i aplikativ i gjuhës është një element i përbashkët i të gjitha aktiviteteve të parashtruara.



## VLERËSIMI

Vlerësimi, që duhet të bëhet gjatë klasës së dhjetë dhe në fund të saj, lidhet me veprimtarinë dhe mjetet me të cilat gjykohet puna dhe arritjet e nxënësve për klasën përkatëse. Meqë klasa e dhjetë paraqet fazën e parë të shkollës së mesme të lartë, edhe parimet, kushtet, metodat dhe mjetet e vlerësimit realizohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit për këtë nivel. Kjo nënkupton praktikimin e tipave të ndryshme të vlerësimit, varësisht nga nevoja dhe situatat, siç janë: vlerësimi përca-ktues, normativ, i përditshëm, i vazhdueshëm, i brendshëm, i jashtëm, përmbledhës etj.

## LITERATURA DHE MJETET NDIHMËSE

1. **Sabri Hamiti:** *Letërsia e vjetër shqipe*
2. **Bahri Beci:** *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*

Tekste dhe mjete të zgjedhura nga mësimdhënësit, përmes të cilave ata mendojnë se mund të realizojnë programin

---

## **ENGLISH LANGUAGE**

---

### **INTRODUCTION**

Learning is a complex process of discovery, collaboration, and inquiry facilitated by language. Composed of interrelated and rule/governed symbol systems, language is a social and uniquely human way of representing, exploring, and communicating meaning. Language is essential for forming interpersonal relationship, understanding social situations, extending experiences, and reflecting on thought and action. Language is the primary basis of all communication and the primary instrument of thought.

### **PHILOSOPHY**

The program for English language will emphasize the importance of experiencing language in context. Students' background knowledge, skills and attitudes will be used as a means of developing communicating abilities: interpreting, expressing and negotiating meaning through oral and written texts. As the students develop communication skills, they also increase their linguistic accuracy and develop language learning strategies.

In the English language program students will acquire various kinds of knowledge, skills and attitudes about:

- interpreting, expressing and negotiating meaning (communication).
- patterns of ideas, behaviours, manifestations, cultural artifacts and symbols (culture).
- sounds, written symbols, vocabulary, grammar and discourse (language).
- cognitive, socio-affective and meta-cognitive process (general language education).

Students will learn to communicate in English through the process of ‘comprehension’, ‘production’ and ‘negotiation’. **Comprehension** involves deriving meaning or significance from an oral or written text. **Production** is expressing meaning by creating oral and written texts to suit different participants, topics, purposes and reasons for communication. **Negotiation** is the *interaction process*: participants in the communication process must adjust to the needs and intentions of others. Integral to all three processes are the communicative intents or functions of communication, reporting or describing and so on, which are developed in the experience / communication component. Students will also learn about the language and how to use it : the sound – symbol system, vocabulary, grammar and discourse elements that are needed to convey ideas and enhance communication in an oral or written context.

## GOALS

The long – term goals in the study of English language are cultural understanding and effective communication. The development of cultural understanding and linguistic proficiency is a complex process involving a variety of language experiences and exposure to the culture of the people whose language is being studied.

- Learners should reinforce, develop and deepen their language and language skills, gained at previous level, and should broaden them gradually, aiming at increasing language awareness and broadening their communicative ability.
- They should deepen the level of understanding of their own culture and other cultures, where English is spoken as a first, second, or an international language.

## GENERAL AND SPECIFIC OBJECTIVES

- ◆ Enable learners to communicate with some degree of fluency in both oral and written language:
  - Understand the main points of clear standard input of familiar matters regularly encountered in, school, leisure, etc.;
  - Be able to communicate in situations likely to arise whilst travelling in an area where the target language is spoken;
  - Produce simple connective texts on familiar topics, or of personal interest.

- ◆ Deepen language awareness and develop meta-cognitive skills:
  - Identify language which conveys mood and feeling e.g. selection of vocabulary, imagery and metaphor;
  - Read texts containing extensive vocabulary confidently, including subject specific texts;
  - Use monolingual and bilingual dictionaries.
- ◆ Apply knowledge of cross-curricular issues:
  - Understand the main message of written text using resources (dictionaries, Internet, etc.);
  - Recognise and select relevant information;
  - Draw conclusions
- ◆ Develop and deepen cultural awareness:
  - Gain background knowledge concerning cultural events and celebrations;
  - Recognize customs and manners of other people;
  - Become familiar with main aspects of everyday life in family, school, and community in the countries where English is spoken as first or second language.

## **GRADE TEN - TOPICS**

### **1. Residence**

- Home and school
- Rooms and furniture
- Living **outdoors**

### **2. Daily routine**

- Activities at home
- Office
- School life

### **3. Leisure and pleasure**

- **Leisure and lifestyle**
- Media (TV, radio, cinema, theatre. Exhibitions)
- Sports pastime **activities**

### **4. Travel**

- Countries and places
- Entering and leaving a country
- Travel documents

**5. People and places**

- Family and relatives
- People of the world
- Friendship

**6. A matter of life and death**

- Physical state
- Visiting a doctor
- Health maintenance

**7. Education and career**

- Plans and ambitions
- Life in school
- The best way to learn

**8. Shopping**

- Money and prices
- Different types of stores
- Fashion

**9. Eating**

- Healthy food
- Shopping at the grocery store
- Eating and drinking out

**10. Public services**

- At the post office
- Hospital, surgery
- Police

**11. Going places**

- Capital cities
- How to find your way
- Excursions

**Weather conditions**

- Places and climate
- Weather forecast
- Going on a picnic

## **GRADE 10 ATTAINMENT TARGETS**

### **◆ Listening**

#### **At the end of this grade learners can:**

- Understand and extract the essential information from short, recorded passages;
- Understand and respond to everyday expressions related to simple and concrete need delivered in normal speed speech;
- Understand the main points of broadcast on familiar topics and topics of personal interest;
- Understand the gist of TV news, interviews, announcements, and films without too much effort.

### **◆ Speaking**

#### **At the end of this grade learners can:**

- Introduce him/herself, and other people;
- Ask and answer questions about personal details;
- Express opinions, likes, dislikes, preferences, and feelings without much effort searching for expressions;
- Interact fairly spontaneously with others, provided they speak at normal speed;
- Describe people, places, and events.

### **◆ Reading**

#### **At the end of this grade learners can:**

- Identify specific information in announcements, extracts from newspaper articles, brochures;
- Understand and identify content and relevance of new items, articles and reports related to everyday problems;
- Understand the content of more complex texts by use of dictionaries;
- Understand fairy tales, poetry, and short stories.

### **◆ Writing**

#### **At the end of this grade learners can:**

- Write personal letters describing experiences, impressions, feelings, and events in detail;
- Write short reports and /or articles with occasional use of dictionary;
- Use a variety of linking words to mark clearly the relationship between ideas;
- Write with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation.

**Note:** In order to achieve the targeted aims and objectives, and cover the topical content of the grade ten syllabus, teachers should select teaching materials from coursebook(s) of **pre-intermediate level**. These materials and aids should primarily be age-appropriate, which means that they should be dedicated to teenagers and/or young adults. In different vocational schools, it again remains in the teacher's domain to select teaching materials that may be profile-appropriate, which s/he may use either as alternative or supplementary material in English language teaching.

## **METHODOLOGY**

### **The Communicating Approach and Task - Based Learning**

The overall aim of the English Language Curriculum is to enable learners to communicate successfully. Successful communication means getting our message across to others effectively. The Communicative Approach to language learning aims at facilitating genuine interaction with others, whether they live in the neighbourhood, in a distant place, or on another continent.

In language learning, the attention of the learners may be focused on particular segments, or on the language as a whole. In cases when we want to focus learners' attention on particular segments, then a segment may be a grammatical structure (a tense), a language function (expressing gratitude), a vocabulary area (food and drinks), or a phonological feature (stress or particular sounds).

Since communication basically means sending and receiving messages, learners should develop the four language skills, which are the core of communication. Development of *receptive skills*, that is *listening* and *reading* skills, will enable learners to receive messages and, depending on tasks they are expected to fulfil, select essential information. However, since language skills do not occur in isolation, but are normally integrated for communicative purposes, after having received a message, learners should be able to make decisions, and respond appropriately. In a situation which involves language, their response is a communicative function, which is performed by one of the *productive skills*—either by *speaking* or by *writing*.

## **The Learning – Centred Classroom**

The objective of learning centred teaching is to make teachers aware of the importance of learner autonomy in the classroom. The teacher has a role, to support and help learners. The learners learn more actively and with enjoyment. The environment requires a learning centred approach that relies on participant's share in the learning, and responsibility for furthering discussion. In all cases learners need clear guidelines and preparation for effective discussion participation.

The major aim, or set of aims will relate to the development of learning skills. Such aims may include the following:

- To provide learners with efficient learning strategies;
- To assist learners identify their own preferred ways of learning;
- To develop skills to negotiate the curriculum;
- To encourage learners to adopt realistic goals and a timetable to achieve these goals;
- To develop learners' skills in self-evaluation.

## **The use of the mother tongue in the classroom**

Contrary to the principles of the direct method and natural approach in language learning, which favour exclusive use of the target language, excluding the mother tongue completely from the classroom, most recent approaches today suggest that the use of the mother tongue at particular stages of foreign language learning may prove useful.

While there is clearly a place for the mother tongue in the classroom, teachers should make efforts to keep the use of the mother tongue to a minimum. Instead of translating words and/or asking learners to translate, they should demonstrate, act, use simple drawings and/or pictures, explain, give simple definitions. If teachers readily intervene with translation, as soon as learners are provided with an 'equivalent' word or expression, as soon as their curiosity is satisfied, they may lose interest in that particular item. In consequence, the English word or expression is easily forgotten and cannot be easily recalled. This method is easiest for teacher and learner, but may be the least memorable.



## Vocabulary

Vocabulary teaching and learning is central to learning English. Words have a central place in culture, and learning words is seen by many as the main task in learning another language.

At level 3 learners know how to express themselves using a range of vocabulary and expressions.

L 3	Teacher's role	Learner's role	Possible activities
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ to set the task, to give explanations and monitor the learner.</li> <li>▪ to encourage the use of bilingual and English-English dictionaries.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ in pairs or small groups to cooperate and take the right decision with the help of dictionaries if need be .</li> <li>▪ to store new words through diagrams, write word lists, produce word-cards and so on.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Using given words to complete a specific task .</li> <li>▪ classifying items into lists;</li> <li>▪ matching words to other words e.g. collocations, synonyms, opposites.</li> </ul>

## The Role of Grammar

If we see language as a building, the words as building blocks or bricks, and grammar as the architect's plan, than we must admit that without a plan, even a million bricks do not make a building. Similarly, one may know a million English words, but if s/he does not know how to put them together, s/he cannot speak English ( Sesnan, 1997).

In the light of this statement, the question is not whether to teach grammar or not, but *how* to teach it. We should consider which approach to adopt in teaching grammar, whether to teach form before meaning, or meaning before form, and what strategies and techniques to use in order to enable learners to put their knowledge of grammar into use and communicate effectively. It is the teacher's responsibility to estimate which approach would yield best effects at a particular stage of learning, or with a particular class.

L 3	Teacher's role	Learner's role	Possible activities
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ To set and monitor the development of activities;</li> <li>▪ To focus on meaning, form and context;</li> <li>▪ To raise learners' awareness as to what they have learned.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ To solve problems, and puzzles, fulfil tasks, and take part in activities;</li> <li>▪ To make conscious efforts to work out the rules independently;</li> <li>▪ To increase their awareness and keep record of their own learning.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Solving problems and puzzles ;</li> <li>▪ Discussions, and debates;</li> <li>▪ Guided and free writing.</li> </ul>

At this level of education, learners should be ready not only to notice the regularities in language, but also to make a conscious effort to work out the rules. They should be ready to deal with more complex sentences, including coordinated and subordinated clauses. Therefore, teachers should increase the learners' awareness about their progress in learning, as well as to encourage them to work independently and keep record of their own learning.

Teachers should always bear in mind that grammar is not an aim on its own, but is closely connected with communication. It should not be used as a driving force, but should arise out of other classroom activities.

### ASSESSMENT AND EVALUATION

There are many reasons for assessing learners. Some of them are:

- to compare learners with each other;
- to see if learners have reached a particular standard;
- to help the learners' learning;
- to check if the teaching programme is successful.

Teaching means changing the learner. Teachers will always want to know how effective their teaching has been- that is, how much their pupils have changed.

This change can be in:

- The amount of English learners know;
- The quality of the English they use;
- Their ability to use English.

The general word for measuring the change is assessment. Naturally if we want to assess how much pupils have changed, we have to know exactly what they already **know** and what they can already **do**.

There are different types of assessment (or evaluation).

- Self assessment (self - evaluation)
- Group assessment (group - evaluation)
- Individual assessment (evaluation)
- Combination of group and individual assessment
- The use of work samples, portfolios and projects.

If teachers want to find out how effective their teaching has been, or if they want to evaluate the learners' progress, then **tests** are used. Tests are conducted in class by the teacher. They measure the results of learners' performance. Teaching and testing always go hand-in-hand. Questions are often asked to check if the learners have understood what has been said. Equally, they may be asked to find out whether a particular point needs to be taught. We instinctively know why we ask a question: whether it is to teach or to test something.

Some major reasons for testing are:

- To diagnose learners' standard on arrival;
- To measure learners' progress;
- To find out how much pupils have learned;
- To find out the quality of learning;
- To find out how many of the class have learned what they were supposed to learn;
- To motivate pupils;
- To show the teacher what to teach next.

There are different kinds of tests, such as:

- Proficiency tests
- Achievement tests
- Placement tests
- Diagnostic tests use proficiency or achievement tests

We see **evaluation** as wider than testing. Testing may be a successful tool in evaluation, but we also think there are other criteria for assessing someone's performance.

Evaluation is not limited to numbers or just giving learners marks. Instead of trying to count or measure learner's ability to make useful contribution to the class, we can simply judge whether s/he makes a

contribution or not, and sometimes we will have to justify, negotiate, and possibly modify our opinions.

With the evaluation we are trying to help the learner to learn, so it is not an assessment, in fact it is aid to learning. In other words, we can use assessment procedure to develop and improve, not only the learner, but also the teaching programme and even the school.

**For methodological guidelines  
see the English Language Curriculum document.**

## **HYRJE**

Mësimi i gjuhës frënge deri në vitet e shtatëdhjeta, është mësuar në shumicën e shkollave të Kosovës. Pastaj ky raport ka ndryshuar në favor të gjuhës angleze.

Gjuha frënge, edhe sot, është njëra nga gjuhët më të rëndësishme botërore dhe paraqet një gjuhë me interes për t'u mësuar edhe më tutje në Kosovë. Ajo njihet si gjuhë zyrtare e OKB, si gjuhë e diplomacisë, e kulturës, e artit, e modës, e mirësjelljes, etj. Si e tillë, ajo mbetet një gjuhë me interes për gjeneratat tona të tanishme dhe të ardhme.

Sipas Kurrikulit të ri të Kosovës mësimi i gjuhëve të huaja mundëson **formimin e qytetarit aktiv e të ndërgjegjshëm në një shoqëri demokratike dhe multikulturore.**

Gjuha frënge, tani e tutje, do të mësohet vetëm si gjuhë e dytë e huaj – në **shkollën e mesme të ulët dhe në shkollën e mesme të lartë** ajo do të mësohet me **dy orë në javë – si lëndë e detyrueshme.** Ajo do të mësohet në **tri tipe të gjimnazeve: në gjimnazin e përgjithshëm; në gjimnazin e shkencave shoqërore dhe në gjimnazin e gjuhëve.**

Nxënësit e klasës së 10, marrë në përgjithësi, do të jenë fillestarë dhe mësimi i gjuhës frënge në këtë klasë nuk do të dallojë shumë nga mësimi i saj në klasën e 6.

Programi i klasës së 10 përfshinë: **Hyrjen, Qëllimet** e mësimit të gjuhës frënge; **Objektivat** (e përgjithshme dhe specifike); **Përmbajtjet programore, Lidhjet ndërprogramore, Udhëzimet metodologjike dhe Vlerësimin.**

## **QËLLIMET KRYESORE TË MËSIMIT TË GJUHËS FRËNGE (për nxënës fillestarë në mësimin e kësaj gjuhe të huaj)**

### **Mësimi i gjuhës frënge ka këto qëllime kryesore:**

- Forcimi (i mëtejshëm) i kompetencave të përgjithshme të fituara në mësimin e gjuhës amtare dhe gjuhës së parë (dhe i gjuhës së dytë) të huaj,
- Zhvillimi i aftësisë për të komunikuar në gjuhën e huaj,
- Zotërimi i komunikimit themelor në situata të jetës së përditshme,
- Pasurimi i përvojës kulturore të nxënësit,
- Pranimi i kulturave tjera dhe zhvillimi i qëndrimit kritik ndaj vlerave të tyre,
- Vetëdijesimi për ruajtjen e llojllojshmërisë kulturore,
- Zhvillimi i empatisë dhe simpatisë ndaj kulturës franceze,
- Zhvillimi i njohës dhe psikoafektiv i nxënësit,
- Formimi i përgjithshëm i personalitetit të nxënësit,
- Formimi i shprehive për punë të pavarur, njohja e teknikave të të mësuarit,
- Zhvillimi i aktiviteteve ndërdisiplinare dhe ndërkulturore,
- Përgatitja e nxënësit për jetë profesionale dhe që të mësojë gjatë tërë jetës
- Pranimi i tjetrit dhe luftimi i stereotipave të ndryshme, etj.

## OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITURA

Kl.	Kategoritë	Objektivat e përgjithshme	Objektivat specifike	Rezultatet e pritura
X	<b>1.0. KOMUNIKIMI</b>	Zgjerim dhe pasurim i fjalësit të gjuhës frënge	Përvetësimi: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ i fjalësit</li> <li>▪ i shprehjeve gjuhësore</li> <li>▪ i strukturave gjuhësore</li> </ul>	Nxënësi është në gjendje të përdorë: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ një fjalës fillestar</li> <li>▪ shprehjet fillestare</li> <li>▪ mekanizmat fillestarë të gjuhës</li> </ul>
		Zhvillimi dhe zgjerimi i shkathtësive dhe i shprehive për punë individuale dhe në grupe	Aftësimi i nxënësve për të dëgjuar / kuptuar Aftësimi i nxënësve për t'u shprehur në gjuhën frënge Aftësimi i nxënësve për të shkruar në gjuhën frënge  Zhvillimi i shkathtësive dhe i shprehive për punë (mësim)	Nxënësi ka fituar shprehitë dhe shkathtësitë fillestare për punë
		Shqiptimi i drejtë i tingujve të gj. frënge	Perceptimi dhe dallimi i tingujve dhe riprodhimi i tyre	Nxënësi dallon dhe riprodhon drejt tingujt themelorë
		Të kuptuarit e fjalësit themelor të gj. frënge	Të kuptuarit e mekanizmave gjuhësorë dhe funksioni i tyre	Nxënësi kupton mekanizmat themelorë dhe funksionimin e tyre
<b>2.0. TË KUPTUARIT DHE PËRDORIMI I GJUHËS</b>	Renditja e fjalëve në fjali	Njohja e funksioneve bazë të fjalëve në fjali	Nxënësi njih funksionet bazë të fjalëve në fjali	
	Zgjerimi i njohurive ndërprogramore	Zgjerimi i njohurive nga shkencat shoqërore Zgjerimi i njohurive nga shkencat natyrore Zgjerimi i njohurive nga artet	Nxënësi zbaton lidhjet ndërprogramore (shfrytëzon njohuritë e tij nga fushat tjera dhe anasjelltas)	
<b>3.0. LIDHJET NDËRPROGRAMORE</b>	Njohja e nxënësit me kulturën frënge	Përforcimi i aftësive të përgjithshme kulturore Vetëdijesimi për të qenë i hapur ndaj të tjerë. Përforcimi i kompetencave ndërkulturore	Nxënësi njih aspekte themelore nga kultura frënge Nxënësi përforcon kompet. ndërkulturore	
	Rëndësia e vendeve frankofone në botë	Zbulimi një kulture tjetër Kahet e zhvillimit të frankofonisë në botë	Nxënësi has / zbulon një kulturë tjetër Nxënësi kupton vendin e frëngjishtes në botë dhe rëndësinë e njohjes së saj	
<b>4.0. KULTURA</b>				

## **PROGRAMI PËR KLASËN E 10 (për nxënës fillestarë)**

### **1.0. SHKATHTËSITË KOMUNIKATIVE (SAVOIR-FAIRES COMMUNICATIFS)**

#### **1.1. Përshëndetjet dhe marrëdhëniet shoqërore (saluer et entretenir des relations sociales)**

- 1.1.1. Kontaktet (entrer en contact)
- 1.1.2. Kërkoj informata për dikë / përgjigjem (demander des nouvelles de quelqu'un / répondre)
- 1.1.3. Ndarje (se quitter)
- 1.1.4. Falënderoj (remercier)
- 1.1.5. Shpreh urime (exprimer des vœux)
- 1.1.6. Kërkoj ndjesë (s'excuser)
- 1.1.7. Kërkoj me mirësjellje (demander poliment)

#### **1.2. Paraqitem dhe paraqes dikë (se présenter et présenter quelqu'un)**

- 1.2.1. Paraqitem (se présenter)
- 1.2.2. Paraqes dikë (présenter quelqu'un)
- 1.2.3. Kërkoj informata / përgjigjem në pyetje në lidhje me identitetin: mbiemri, emri, shtetësia, adresa, mosha, klasa, shkollla, profesioni i prindërve (demander des informations / répondre à des questions portant sur l'identité : nom, prénom, nationalité, adresse, âge, classe, école, profession des parents)
- 1.2.4. Kërkoj informata / përgjigjem në pyetje që kanë të bëjnë me familjen: numri i vëllezërve, mosha, emri, mësimet (demander des informations / répondre à des questions portant sur la famille: nombre de frères et de soeurs, âge, prénom, études)

#### **1.3. Çmoj, vlerësoj (apprécier)**

- 1.3.1. Tregoj ç'më pëlqen dhe çka nuk më pëlqen (dire ce qu'on aime et ce qu'on n'aime pas)
- 1.3.2. Pyes dikë për shijet e tij (demander à quelqu'un ses goûts)
- 1.3.3. Shpreh vlerësimin për veprimtari të ndryshme, për personalitete, për vende (exprimer une appréciation sur des activités, des personnes, des lieux)



#### **1.4. Karakterizoj (caractériser)**

- 1.4.1. Përshkruaj dikë, përshkruaj një personazh fiksoni (décrire quelqu'un, décrire un personnage de fiction)
- 1.4.2. Përshkruaj një objekt, një vend (décrire un objet, un lieu)
- 1.4.3. Përshkruaj motin (décrire le temps qu'il fait)
- 1.4.4. Krahasoj (comparer)

#### **1.5. Shpreh sasinë (quantifier)**

- 1.5.1. Shpreh një numër (exprimer un nombre)
- 1.5.2. Shpreh sasinë (exprimer une quantité)
- 1.5.3. Shpreh masën : peshën, gjatësinë, madhësinë (indiquer une mesure : le poids, la longueur, la taille)
- 1.5.4. Shpreh madhësinë, numrin (indiquer la taille, la pointure)
- 1.5.5. Tregoj, pyes për çmimin (indiquer, demander un prix)
- 1.5.6. Përcaktoj shkallën, sasinë: shumë, pak, mjaft (indiquer un degré: beaucoup, trop, assez)

#### **1.6. Këshilloj / jap udhëzime (conseiller / donner des consignes)**

- 1.6.1. Shpreh një urdhër, them ç'nuk duhet bërë (exprimer un ordre, dire de ne pas faire)
- 1.6.2. Paralajmëroj (avertir)
- 1.6.3. Jap / kërkoj këshilla (donner / demander des conseils)

#### **1.7. Përcaktimi në hapësirë (se situer dans l'espace)**

- 1.7.1. Jap udhëzime orientimi / shtroj pyetje për pozicionin (donner des indications / poser des questions sur la situation)
- 1.7.2. Jap udhëzime, shtroj pyetje për një drejtim / vend (donner des indications / poser des questions sur une direction)

#### **1.8. Përcaktoj kohën (se situer dans le temps)**

- 1.8.1. Tregoj / shpreh momentet e orës gjatë ditës (indiquer des indications sur les moments de la journée)
- 1.8.2. Tregoj / pyes për ditët e javës, për muajt, për stinët (indiquer / demander des indications sur les jours de la semaine, les mois, les saisons)
- 1.8.3. Tregoj / pyes për orën (dire / demander l'heure)
- 1.8.4. Flas për aktivitetet e mia gjatë ditës (parler de ses activités à différents moments de la journée)

**1.9. Marrëdhëniet e përditshme shoqërore (les relations sociales courantes)**

- 1.9.1. Përshëndetje / ndarje (saluer / prendre congé)
- 1.9.2. Takohem me dikë (prendre contact avec quelqu'un)
- 1.9.3. Falënderoj (remercier)
- 1.9.4. Kërkoj ndjesë (s'excuser)
- 1.9.5. Kërkoj me mirësjellje (demander poliment)
- 1.9.6. Shpreh urime, ditëlindje, festa (exprimer des souhaits: anniversaire, fêtes)
- 1.9.7. Ftoj, propozoj (inviter, faire des propositions)

**1.10. Identiteti: jap / kërkoj informata (l'identité: donner / demander des informations)**

- 1.10.1. Emri dhe mbiemri / njoftimi (prénom et nom / faire la connaissance)
- 1.10.2. Shtetësia (la nationalité)
- 1.10.3. Vendbanimi / adresa (le lieu où l'on habite / l'adresse)

**1.11. Veprime nga jeta e përditshme (les activités quotidiennes)**

- 1.11.1. Shkolla (l'école)
  - 1.11.1.1. Tregoj shkollën (indiquer l'école)
  - 1.11.1.2. Tregoj lëndët mësimore (indiquer les disciplines étudiées)
  - 1.11.1.3. Pjesëmarrja në ritualin e klasës (participer au rituel de la classe)
  - 1.11.1.4. Jap / kërkoj informata për një ditë shkollë (donner / demander des informations sur une journée de l'école)
  - 1.11.1.5. Jap / kërkoj informata për mjetet shkollë (donner / demander des informations sur le matériel de l'école)
  - 1.11.1.6. Jap kërkoj informata për etapat e vitit shkollor (donner / demander des informations sur les étapes de l'année scolaire)
- 1.11.2. Familja (la famille)
  - 1.11.2.1. Emërtimi i anëtarëve të familjes së ngushtë (nommer les membres de la famille proche)
  - 1.11.2.2. Tregoj sa vëllezër sa motra kam (dire combien on a des frères et des soeurs)
  - 1.11.2.3. Tregoj moshën / emrat e vëllezërve / motrave (indiquer l'âge et le prénom des frères et des soeurs)

### 1.11.3. Shijet (les goûts)

1.11.3.1. Tregoj çka (nuk) më pëlqen: këngëtari, kënga, muzika, sporti, ushqimi, (dire ce qu'on aime / ce qu'on n'aime pas: chanteur, chanson, musique, sport, aliments)

1.11.3.2. Shpreh një parapëlqim (indiquer une préférence)

## 2.0. GRAMATIKA (LA GRAMMAIRE)

### 2.1. Emri (le nom)

2.1.1. Gjinia e emrit (le genre du nom)

2.1.2. Numri (le nombre)

### 2.2. Përcaktuesit (les déterminants)

2.2.1. Nyja shquese (l'article défini)

2.2.2. Nyja shquese e rrëgjuar (l'article défini contracté)

2.2.3. Nyja joshquese (l'article indéfini)

### 2.3. Mbiemrat (les adjectifs)

2.3.1. Mbiemrat dëftorë (les adjectifs démonstratifs)

2.3.2. Mbiemrat pronorë (les adjectifs possessifs)

2.3.3. Mbiemrat cilësues (les adjectifs qualificatifs)

2.3.4. Numërorët (les adjectifs numériques)

### 2.4. Përemrat (les pronoms)

2.4.1. Përemrat vetorë (les pronoms personnels)

### 2.5. Foljet (les verbes)

2.5.1. Grupet e foljeve (les groupes des verbes)

2.5.2. Kohët e foljes (les temps du verbe)

2.5.3. Mënyrat e foljes (les modes)

## 3.0. SINTAKSË (LA SYNTAXE)

### Llojet e fjalisë:

3.1. Llojet e fjalive (les types de phrases)

3.2. Fjalja pohore (la phrase affirmative)

3.3. Fjalja pyetëse (la phrase interrogative)

3.4. Fjalja mohore (la phrase négative)

#### 4.0. FONETIKË (LA PHONÉTIQUE)

##### 4.1. Zanoret (les voyelles)

###### 4.1.1. Zanoret hundore (les voyelles nasales)

##### 4.2. Bashkëtingëlloret (les consonnes)

#### 5.0. LIDHJA E FJALËVE (LA LIAISON)

#### 6.0. ORTOEPI (L'ORTHOÉPIE)

##### 6.1. Intonacioni (l'intonation)

#### 7.0. DREJTSHKRIMI (L'ORTHOGRAPHE)

#### 8.0. KULTURA (LA CULTURE)

##### 8.1. Marrëdhëniet e përditshme (les relations courantes)

##### 8.2. Identiteti (l'identité)

##### 8.3. Mjedisi; hapësira e përditshme (le milieu; l'espace courant)

##### 8.4. Familja (la famille)

##### 8.5. Frankofonia (frëngjishtja në botë)

### UDHËZIME METODOLOGJIKE

#### 1.0. PARIMET METODIKO-DIDAKTIKE

**Të mësosh një gjuhë do të thotë të mësosh për të komunikuar në atë mënyrë që të mund të përdorësh gjuhën në situata të jetës reale.** Shkathtësitë zënë vend parësor në mësimin e gjuhëve.

**1.1. Parimi i parë:** përqendrimi në komunikim, dhe jo si deri më tani përqendrim në gjuhë;

**1.2. Parimi i dytë:** përqendrimi në nxënësin dhe në nxënien e tij.

#### 2.0. FORMA KOMUNIKATIVE E MËSIMDHËNIES

Se mësimdhënia më e mirë është në formë komunikative është e ditur sepse tanimë është e pranuar ndërkombëtarisht. Prandaj në një mësimdhënie bashkëkohore komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme. Kjo

formë ju mundëson nxënësve arritjen e mjeteve gjuhësore që atyre u nevojiten për t'u shprehur në gjuhën frënge, në situata të caktuara gjuhësore e shoqërore.

Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja e një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo anasjelltas.

### 3.0. METODAT E MËSIMDHËNIES

#### **3.1. Metodatat që nxisin komunikimin**

- Puna në grupe, në qifte
- Debatet,
- Lojrat në role
- Intervistat e thjeshta

#### **3.2. Metodatat që nxisin punën e pavarur**

- Tekste me vende të zbrazta
- Lojëra mësimi (si Memorie)
- Kontrolli i partnerit
- Përpunimi i pavarur i të dhënave (nga biblioteka, kompjuteri, etj.)
- Nxënia gjatë mësimdhënies (nxënësi merr rolin e mësuesit)
- Letërkëmbime me Francën (partnerizimi i shkollave, letërkëmbime mes nxënësve tanë dhe francezë, etj).

#### **3.3. Metodatat që nxitin prodhimin**

- Punimi i gazetave të murit, i pikturave, posterëve, teksteve (p.sh. për ekspozita, gara të shkollës apo interne, etj.)
- Shkrimi kreativ i poezive, i tregimeve të shkurtra, i nxitur përmes aktivizimit të njohurive paraprake.

### 4.0. PËRDORIMI I MEDIAVE

#### **4.1. Televizioni**

Televizioni është një mjet i dobishëm dhe i përhershëm që duhet të shfrytëzohet si nga arsimtari ashtu edhe nga nxënësit. Emisionet shkollore kushtuar gjuhës ose kulturës frënge të ne, programet e filmit dhe ato

te dramës dhe emisionet e ndryshme te televizioneve te jashtme ne gjuhen frënge janë një mjet i fuqishëm qe do te ndihmoje dhe shpejtoje përvetësimin e kësaj gjuhe te huaj nga nxënësit tanë.

#### **4.2. Filmi, teatri, muzika**

Filmi, teatri dhe muzika, poashtu, përbejnë mjete motivuese te rëndësishme për rritjen e rezultateve ne përvetësimin e gjuhës frënge, edhe pse te ne ato nuk janë shfrytëzuar aq sa ka pasur mundësi. Kinemaja dhe teatri, bashke me Televizionin, tani e tutje do te luajnë një rol me te rendesishem ne këtë aspekt.

#### **4.3. Fotografitë**

Fotografitë ndihmojnë për të sajuar tekste kreative, dhe përshkruese.

- Nxënësit përshkruajnë gjërat e njohura dhe ato të pazakonshme që shohin në fotografi.
- Ata tregojnë një ngjarje, fillimin ose mbarimin e së cilës e përshkruan fotografia.

#### **4.4. Videoprojektori**

Përdorimi i projektorit rrit interesimin e nxënësve për mësim. Kjo arrihet me:

- prezentimin e fotografive, vizatimeve, tregimeve të ilustruara, etj. dhe të teksteve përmes folive dhe projektorit,
- mbulimin dhe zbulimin e pjesërishëm të fotografisë,
- paraqitjen me fotografi të një ngjarjeje pa renditjen kronologjike,
- pararaqitjen e një teksti të ndarë në pjesë dhe të radhitur në mënyrë jo të rregullt dhe rregullimi i tij.

#### **4.5. Materiali auditiv**

Ky material mundëson ballafaqimin me frëngjishten standarde dhe nxit të kuptuarit përmes dëgjimit.

- Nxënësit gjejnë fillimin ose mbarimin e një teksti të shkurtër të dëgjuar më parë,
- Ata personifikohen me personazhet e një pjese teatrore të dëgjuar dhe diskutojnë për sjelljet e tyre.

#### **4.6. Videomateriali**

Përdorimi i videomaterialit u jep nxënësve mundësi të shumta për sajimin e teksteve me shkrim dhe me gojë:

- Paraqitja e një filmi të punuar mbi bazën e një tregimi ose një përralle, i cili nxit krahasimin me tregimin apo me përrallën e lexuar ose të dëgjuar më parë.

#### **5.0. RENDITJA E VEPRIMEVE**

Për mësimi të efektshëm të frëngjishtes është e nevojshme të respektohet kjo renditje:

##### **të dëgjuarit/ të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit.**

Kjo është një renditje logjike, respektimi i se cilës mundëson një mësimdhënie me te shpejte, me te lehte dhe me cilësore te gjuhës se huaj.

#### **5.1. Puna aktive dhe konkrete**

Gjatë mësimi të gjuhës frënge në shkollat tona mësimdhënësit duhet të kenë parasysh kushtet dhe rrethanat tona (si një mes jofrankofon) që dallohen nga ato të Francës (si mes frankofon).

#### **5.2. Për ushtrime dhe zbatim**

Rëndësi e veçantë duhet t'u kushtohet ushtrimeve, varësisht nga llojet e tyre. Ato mund të bazohen në të dëgjuar, në të shikuar dhe në të shkruar.

#### **6. 0. KORRIGJIMI I GABIMEVE TË NXËNËSVE**

Mënyrat e korrigjimit diskutohen shpesh dhe në mënyrë kundërtë-nëse në rrethin e mësimdhënësve. Disa i shohin gabimet si pengesë në procesin e mësimdhënies, të tjerët i shohin si ndihmesë në përvetësimin e gjuhës së huaj. Ndërsa disa prej tyre mendojnë se ato duhet të korrigjohen menjëherë që të mos përvidhen, të tjerët mendojnë se nuk duhet të korrigjohet, me çdo kusht, çdo gabim. Sido që të jetë, në fazën e komunikimit gjuhësor, gjatë përshkrimit të një fotografie, mësimdhënësit praktikojnë të shprehur të lirë të nxënësve të tyre. Gjatë korrigjimit të gabimeve, nxënësit nuk duhet ndëshkuar, qortuar apo kritikuar për gabimet e bëra.

## 7.0. MËSIMDHËNIA / NXËNIA E DIFERENCUAR

Asnjë klasë nuk ka përbërje homogjene nxënësish sa u përket njohurive të tyre paraprake. Këtë duhet ta ketë parasysh çdo mësimitdhënës dhe të organizojë orën në bazë të kësaj. Kjo nënkupton që nxënësit që kanë aftësi për nxënie më të shpejtë të trajtohen ndryshe nga të tjerët në mënyrë që mësimi i gjuhës frënge të jetë në përputhje me mundësitë dhe aftësitë individuale të secilit nxënës.

## 8.0. TEKNIKAT E PUNËS

Një ndër detyrat e mësimitdhënies në gjuhën e huaj është edhe aftësimi i nxënësve që të marrin përgjegjësinë për të mësuarit individual. Nxënësit të cilët kanë mundësi për të menduar për proceset e nxënies dhe të organizojnë procesin e mësimitdhënies dhe të të mësuarit në grup, zakonisht arrijnë sukses më të mirë. Në këtë mënyrë ata, përveç tjerash, mund të përgatiten që të reagojnë në mënyrë të pavarur në situatat jashtëshkollore si dhe të vazhdojnë proceset e mësimit të gjuhës.

## LIDHJET NDËRPROGRAMORE

Mësimi i një gjuhe të huaj sidomos në klasat e larta, ofron mundësi të shumta për lidhje ndërprogramore, në të gjitha nivelet. Këto lidhje do të përfshijnë shumë lëmi (lëndë mësimore), sidomos ato të gjuhëve (gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj të parë); të shkencave shoqërore (edukatën qytetare, historinë, gjeografinë, etj.); të arteve të llojeve të ndryshme; por edhe të shkencave të natyrës. Në këtë mënyrë, nxënësit, përmes njohurive nga lëndët tjera, në një rën anë do të ndihmohen në përvetësimin më të suksesshëm të gjuhës frënge, në anën tjetër, përmes njohurive nga gjuha frënge, ata do të zgjerojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre paraprake nga lëndët tjera.

## VLERËSIMI

### 1.0. LLOJET E VLERËSIMIT NË ORËN E GJUHËS FRËNGE

#### 1.1. Vlerësimi diagnostik:

- të identifikojë vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit dhe të ndërmjetësojë në tejkalimin e tyre;
- të kontrollojë njohuritë e nxënësve;



## **1.2. Vlerësimi i jashtëm**

- të vlerësojë njohuritë e nxënësve, të vërtetohet se njohuritë e fituara mjaftojnë që nxënësi mund të kalojë në klasën më të lartë;
- të vlerësojë përparimin e nxënësit;
- të identifikojë anët pozitive dhe negative të nxënësit;

## **1.3. Vlerësimi formativ:**

- t'i mundësojë nxënësit të identifikojë anët e tij pozitive dhe negative dhe të angazhohet në përmirësimin e anëve negative.

## **2.0. ÇFARË DUHET TË VLERËSOHET?**

### **2.1. Të kontrollohen njohuritë e fituara:**

### **2.2. Të kontrollohet përparimi i nxënësit:**

- Vlerësimi i zhvillimit të nxënies;
- Shkalla e zotërimit:

### **2.3. Integrimi i njohurive të fituara:**

- Vlerësohet projekti ose aktivitetet jashtëshkollore.

## **3.0. SI DUHET TË VLERËSOJMË?**

### **3.1. Mënyrat e vlerësimit nga mësuesi: kontrolli i vazhdueshëm:**

#### **Vlerësimi i drejtpërdrejtë:**

(Mësuesi vlerëson rezultatet e nxënësit)

#### **Vlerësimi i tërthortë:**

(Teste me shkrim)

### **3.2. Vlerësimi bëhet:**

- Me ndihmën e një table (vlerësimi objektiv)
- Pa tabelë (vlerësimi subjektiv)

**3.3. Vlerësimi nga nxënësit (vlerësim i njëri-tjetrit):** në grupe nxënësish, brenda klase, me ndihmën e një table. Ky është një vlerësim i drejtpërdrejtë.

**3.4. Vetëvlerësimi i nxënësve:** vlerësimi bëhet nga vetë nxënësit: secili nxënës vlerëson vetveten.

#### 4.0. KRITERET E VLERËSIMIT

##### 4.1. Aktivitetet e receptivit (të kuptuarit gojor dhe të kuptuarit me shkrim)

- Të dëgjuarit
- Të lexuarit

##### 4.2. Aktivitetet e të shprehurit:

- Të shprehurit gojor dhe
- Të shprehurit me shkrim.

##### 4.3. Mjetet pedagogjike për vlerësimin e nxënësve:

- Për një vlerësim të drejtpërdrejtë: një tabelë
- Për një vlerësim të tërthortë: testet:
- për një vlerësim në të shprehur me gojë dhe me shkrim:
  - tabela me kritere dhe me shpjegime për nxënës (tabela përpilohet nga vetë ata).

##### Skedë për të drejtuar të mësuarit e nxënësit

Notat	Të dëgjuarit	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit
5	x	x		
4			x	
3				x
2				
1				

	Shkalla e të përvetësuarit	Duhet të përmirësojë...	Për të përmirësuar unë kam...
Dëgjoj	Mirë / përafërsisht		
Flas			
Lexoj			
Shkruaj			
Pjesëmarrja në aktivitete të klasës			
Mirëmbajtja e fletores			

**HYRJJE**

Sipas Planit dhe Programit të ri gjuha gjermane mësohet si gjuhë e huaj e dytë (sipas zgjedhjes) për herë të parë në shkollën e mesme të lartë.

**QËLLIMET**

- Të zhvillohen katër shkathtësitë gjuhësore;
- të aftësohen nxënësit të komunikojnë, brenda dhe jashtë shkollës, me njerëz që i përkasin kulturës dhe gjuhës gjermane;
- të aftësohen nxënësit të krahasojnë në mënyrë krijuese kulturën gjermane me kulturën dhe traditën vetjake, si dhe të shfrytëzojnë këto pikëpamje për flakjen e paragjytimeve dhe për zgjerimin e njohurive për botën dhe për veten;
- të aftësohen nxënësit të shfrytëzojnë strukturat dhe rregullsitë e gjuhës gjermane për përdorimin më të vetëdijshëm të gjuhës amtare, që t'i zhvillojnë në mënyrë të pavarur më tutje aftësitë e fituara në gjuhën gjermane si dhe mbi këtë bazë të mësojnë gjuhë të tjera të huaja.

Një ndër qëllimet kryesore të mësimdhënies së gjuhës gjermane në Kosovë është edhe vazhdimi i projektit të filluar para dy vjetësh në gjimnazin e filologjisë “Eqrem Çabej” të Prishtinës, projekt ky i cili ka për qëllim aftësimin e nxënësve për kryerjen e provimit dhe marrjen e Diplomës së Gjuhës Gjermane I dhe II, e lëshuar nga Ministria Gjermane e Kulturës. Me këtë diplomë nxënësit i jepet mundësia që të regjistrohet në cilindo universitet në Gjermani pa provim pranues gjuhësor.

	<b>Viti i parë i mësimi të gjuhës gjermane</b>
<b>Objektivi 1</b>	Krijimi i kontakteve të thjeshta gjuhësore
<b>Objektivi 2</b>	Emërtimi dhe përshkrimi i gjësendeve dhe veprimeve
<b>Objektivi 3</b>	Kuptimi i udhëzimeve dhe përgjigja e pyetjeve

<b>Objektivi 4</b>	Orientimi në kohë dhe hapësirë
<b>Objektivi 5</b>	Krijimi i kontakteve gjuhësore
<b>Objektivi 6</b>	Dhënia dhe marrja e informatave gjuhësore

Plan-programi mund të lexohet edhe *horizontalisht*, pra prej të majtës në të djathtë .

	<b>Klasa X</b>	<b>Klasa XI</b>	<b>Klasa XII</b>	<b>Klasa XIII</b>
Objektivi 1	Krijimi i kontakteve të thjeshta gjuhësore	Biseda me njëri tjetrin	Dhënia e informatave personale gjatë kontakteve gjuhësore	Raportimi mbi ngjarjet

Tek mënyra horizontale e të lexuarit vërehet një gjë: Objektivi 1. nga viti i parë zgjerohet më tutje në vitin e dytë, po ashtu në të tretin e pastaj edhe në të katërtin, sepse në secilin prej tyre kemi të bëjmë me “kontaktet gjuhësore”. Do të thotë se mbetet te tema e njëjtë, por në një nivel më të lartë e më të vështirë. Pra të gjitha objektivat me radhë përsëriten në vitin vijues, por me struktura gjithnjë e më të vështira dhe natyrisht me më shumë leksik (fjalës).

### **Shkathtësitë gjuhësore, inventari gramatikor, fushat tematike**

Përderisa me “shkathtësi gjuhësore” janë dhënë mostra të fjalive, me “inventar gramatikor” janë dhënë fushat, të cilat përcillen me anë të objektivave specifike (shkathtësitë gjuhësore).

Fjalësi(leksiku) në fjalitë mostra shërben si shembull dhe zgjerohet sistematikisht nga mësuesi.

Përmbajtja programore duhet të jetë e shkruar sipas rregullave më të reja të drejtshkrimit.

Pasi që nxënësit e kanë mësuar qysh moti alfabetin e gjuhës amtare, mospërputhja e pjesërishme e fonemave dhe grafemave në gjuhën shqipe e gjermane, nuk do të duhej të jetë ndonjë problem i madh.

Objektivat *gramatikore* të paraqitura në këtë plan-program janë të detyrueshme dhe duhet të shikohen si program minimal. E detyrueshme është edhe *radhitja e objektivave*, pasi që një objektivi ndërtohet mbi bazën e objektivit të mëparshëm.

Fushat tematike me qëllim janë të përgjithsuara, sepse siç u përmend më herët, sipas këtij plan-programi do të krijohen tekste shkollore. Sikur

të caktoheshin qysh tash temat konkrete, në bazë të të cilave do të arriheshin objektivat specifike dhe gramatika, do të ishte kufizim për autorin e teksteve shkollore.

Këshillohet që temat të zgjedhen nga fushat që propozohen nga “Korniza programore për gjuhën gjermane si gjuhë e huaj” e Konferencës së Ministrisë Gjermane të Kulturës, e cila përsëri orientohet në Kornizën e Rekomanduar Europiane:

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Grundlegende Existenzenerfahrungen</li> <li>- Die persönliche Identität</li> <li>- Partnerbeziehungen</li> <li>- Alltag und Familie</li> <li>- Individuum und Gesellschaft</li> <li>- Wohnen</li> <li>- Erziehung</li> <li>- Arbeit</li> <li>- Versorgung</li> <li>- Gesundheitsfürsorge</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Freizeitgestaltung</li> <li>- Sport</li> <li>- Mensch und Natur</li> <li>- Mobilität und Verkehr</li> <li>- Kommunikation</li> <li>- Wissenschaft und Technik</li> <li>- Kunst und Kreativität</li> <li>- Norm- und Wertorientierung</li> <li>- Zeitlich-historische Erfahrungen</li> <li>- Geistige und seelische Dimensionen</li> </ul>
--	--

## PËRMBAJTJA PROGRAMORE

### PASQYRË E OBJEKTIVAVE TË PËRGJITHSHME

1. LERNJAHR	
Lernziel 1	Lerninhalte
<b>Einfache sprachliche Kontakte herstellen</b>	<b>Sprechfertigkeiten</b> <i>Jemanden begrüßen</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Guten Tag!</li> <li>• Guten Morgen!</li> <li>• Guten Abend!</li> <li>• Hallo!</li> </ul> <i>Sich verabschieden</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Auf Wiedersehen!</li> <li>• Gute Nacht!</li> </ul> <i>Reagieren</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ja, bitte.</li> <li>• Nein, danke.</li> </ul> <i>Sich vorstellen</i>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ich heiße ...</li> <li>• Mein Vorname ist ...</li> <li>• Mein Nachname ist ...</li> <li>• Dein Vorname ist ...</li> <li>• Dein Nachname ist ...</li> <li>• Ich wohne in ...</li> <li>• Ich bin Schüler.</li> </ul> <p><b>Fragen</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• wie heißt du?</li> <li>• wo wohnst du?</li> <li>• was bist du?</li> </ul> <p><b>Grammatik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aussagesätze</li> <li>• Verben in der 1. und 2. Person Singular</li> <li>• Personalpronomen in der 1. und 2. Person Singular im Nominativ</li> <li>• Einfache Fragesätze</li> <li>• Sein als Vollverb in der 1. und 2. Person Singular</li> </ul>
<b>1. LERNJAHR</b>	
<b>Lernziel 2</b>	<b>Lerninhalte</b>
<p><b>Gegenstände und Tätigkeiten benennen und beschreiben, nach Gegenständen fragen</b></p>	<p><b>Sprechfertigkeiten</b></p> <p><b>Fragen</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Was ist das?</li> <li>• Ist das ein/eine/ein ...?</li> <li>• Ist das dein/deine/dein ...?</li> <li>• Was machst du?</li> </ul> <p><b>Benennen</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Das ist der/die/das ...</li> <li>• Das sind die ...</li> <li>• Das ist ein/eine/ein ...</li> <li>• Das sind ...</li> </ul> <p><b>Beschreiben</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Der/Die/Das ... ist ...</li> <li>• Die ... sind ...</li> <li>• Das ist mein/meine/mein/...</li> <li>• Das ist dein/deine/dein ...</li> <li>• Ich lerne ...</li> <li>• Wir lernen ...</li> </ul> <p><b>Verneinen</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nein.</li> <li>• Das ist kein/keine/kein ...</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Das ist nicht mein/meine/mein ...</li> <li>• Das ist nicht dein/deine/dein ...</li> </ul> <p><b>Grammatik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Einfache Fragesätze</li> <li>• Bestimmter Artikel im Nominativ Singular und Plural</li> <li>• Unbestimmter Artikel im Nominativ Singular und Plural</li> <li>• Possessivpronomen in der 1. und 2. Person im Nominativ Singular</li> <li>• Nomen im Nominativ Singular und Plural</li> <li>• Adjektive in prädikativer Stellung</li> <li>• Sein als Vollverb in der 3. Person Singular und Plural</li> <li>• Verben in der 1. Person Singular und Plural</li> <li>• Personalpronomen in der 1. Person Plural</li> <li>• Negation mit nein</li> <li>• Negation mit kein/keine/kein</li> <li>• Negation mit nicht</li> <li>• Kardinalzahlen von 1 – 10</li> </ul>
<b>1. LERNJAHR</b>	
<b>Lernziel 3</b>	<b>Lerninhalte</b>
<b>Anweisungen verstehen und Fragen beantworten</b>	<p><b>Sprechfertigkeiten</b> <i>Anweisungen verstehen und danach handeln</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Schreibe ab.</li> <li>• Male aus.</li> <li>• Sprich laut.</li> <li>• Unterstreiche.</li> <li>• Schreibe ab.</li> <li>• Malt aus.</li> <li>• Sprecht im Chor.</li> <li>• Unterstreicht.</li> </ul> <p><b>Fragen beantworten</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Er/Sie schreibt.</li> <li>• Er/Sie schreibt nicht.</li> <li>• Er/Sie malt aus.</li> <li>• Er/Sie malt nicht aus.</li> <li>• Sie schreiben.</li> <li>• Sie schreiben nicht.</li> <li>• Sie malen aus.</li> <li>• Sie malen nicht aus.</li> </ul> <p><b>Grammatik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Imperativ mit nicht trennbaren und trennbaren Verben im Singular und Plural</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personalpronomen in der 3. Person Singular und Plural, maskulin/feminin im Nominativ</li> <li>• Verben in der 3. Person Singular und Plural</li> <li>• Negation mit nicht</li> </ul>
<b>1. LERNJAHR</b>	
<b>Lernziel 4</b>	<b>Lerninhalte</b>
<b>Sich orientieren und verständigen</b>	<p><b>Sprechfertigkeiten</b>  <i>Räumliche Angaben erfragen und geben</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Wo ist/bist/sind/seid ...?</li> <li>• Dort/hier/Oben/Unten.</li> <li>• Er/Sie ist ...</li> <li>• Wir sind ...</li> <li>• Ihr seid ...</li> <li>• Sie sind ...</li> </ul> <p><i>Zeitliche Angaben erfragen und geben</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Wann haben wir Deutschunterricht?</li> <li>• Am ...</li> <li>• Heute.</li> <li>• Morgen.</li> </ul> <p><b>Grammatik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fragen mit wo</li> <li>• Fragen mit wann</li> <li>• sein als Vollverb in allen Personen</li> <li>• Personalpronomen in allen Personen</li> <li>• haben als Vollverb in der 1. Person Plural</li> <li>• Adverbiale des Ortes und der Zeit</li> <li>• Kardinalzahlen von 11 – 12</li> </ul>
<b>1. LERNJAHR</b>	
<b>Lernziel 5</b>	<b>Lerninhalte</b>
<b>Sprachliche Kontakte knüpfen</b>	<p><b>Sprechfertigkeiten</b>  <i>Auffordern und Aufforderungen beantworten</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Machst du mit?/Macht ihr mit?</li> <li>• Ich kann/Wir können leider nicht.</li> <li>• Tut mir/uns leid, ich muss/wir müssen die Hausaufgaben machen.</li> <li>• Willst du/Wollt ihr mitkommen?</li> <li>• Ja, gerne.</li> <li>• Spielst du/Spielt ihr gern ...?</li> <li>• Ja/Nein.</li> <li>• Nicht so besonders.</li> <li>• Eigentlich nicht.</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ja, natürlich!</li> <li><b>Fragen stellen und Fragen beantworten</b></li> <li>• Was machst du/Was macht ihr?</li> <li>• Darf ich/Dürfen wir mitkommen?</li> <li>• Ich möchte/Wir möchten auch gerne mitkommen.</li> <li>• Komm, wir gehen/Wir wollen gehen.</li> <li>• Gehen wir?</li> <li>• Kannst du/Könnt ihr schwimmen?</li> <li>• Kannst du/Könnt ihr Fußball spielen?</li> <li>• Na klar!</li> <li>• Toll!</li> <li>• Nein, zeigst du/zeigt ihr es mir?</li> <li><b>Erklären</b></li> <li>• Jetzt musst/kannst/darfst du ...</li> <li>• Jetzt müsst/könnt/dürft ihr ...</li> <li><b>Grammatik</b></li> <li>• Frage- und Aussagesätze mit Modalverben</li> <li>• Modalverben <i>mögen, können, dürfen, wollen, müssen</i> in der 1. und 2. Person Singular und Plural</li> <li>• Adverbiale der Art und Weise</li> </ul>
<b>1. LERNJAHR</b>	
<b>Lernziel 6</b>	<b>Lerninhalte</b>
<b>Einfache Auskünfte einholen und erteilen</b>	<p><b>Sprechfertigkeiten</b></p> <p><b>Fragen nach dem Befinden stellen und beantworten</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Wie geht es dir/Ihnen? <ul style="list-style-type: none"> <li>- Danke, gut.</li> <li>- Nicht gut/Schlecht/Es geht.</li> </ul> </li> <li>• Was fehlt dir/Ihnen? <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mein Hals tut weh/Ich habe Halsschmerzen.</li> </ul> </li> <li>• Bist du/Sind Sie krank? <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ja/Nein.</li> </ul> </li> </ul> <p><b>Vorhaben angeben</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ich möchte spielen/nicht spielen.</li> <li>• Er/Sie besucht den/die/das ...</li> <li>• Er/Sie braucht einen/eine/ein ...</li> <li>• Er/Sie hat/möchte/braucht keinen/kein/kein ...</li> <li>• Ich gehe in den Park/in die Schule/ins Geschäft.</li> </ul> <p><b>Zeitangaben</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Wie spät ist es?</li> <li>• Es ist ... (nur volle Stunden!)</li> </ul> <p><b>Grammatik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nomen im Akkusativ mit bestimmtem und unbestimmtem</li> </ul>

	Artikel <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fragesätze mit wie</li> <li>• Modalverben in allen Personen</li> <li>• Präposition in mit Akkusativ</li> <li>• Kardinalzahlen von 13 – 31</li> </ul>
--	---

Realizimi i objektivave të sipërshënuara bëhet përmes këtyre temave:

### Pasqyrë e fushave tematike

<b>KLASA E GJASHTË</b>
<b>1. Grundlegende Existenzerfahrungen</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dasein in der Welt</li> <li>• Elementare Gefühle: Liebe zu den Eltern und Geschwistern</li> </ul>
<b>2. Die persönliche Identität</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Ich” – Erfahrung</li> <li>• Einige persönliche Eigenschaften</li> </ul>
<b>3. Partnerbeziehungen</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Du” – Erfahrung</li> <li>• einige Eigenschaften des anderen</li> <li>• mit Freunden spielen</li> <li>• Erlebnisse mit Freunden</li> </ul>
<b>4. Alltag und Familie</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Wir” – Erfahrung</li> <li>• die private Gemeinschaft der Familie: Eltern, Geschwister</li> <li>• Der Alltag einer Familie</li> </ul>
<b>5. Individuum und Gesellschaft</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Sie” – Erfahrung</li> <li>• Nachbarschaft</li> <li>• Erlebnisse in der Schule</li> </ul>
<b>6. Wohnen</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Das eigene Heim</li> <li>• Haus, Wohnung, Siedlung</li> <li>• Kinderzimmer, Gemeinschaftszimmer</li> <li>• Die Schule als Lebensbereich</li> </ul>
<b>7. Erziehung</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• In der Familie</li> <li>• In der Schule ( z.B. Stundenplan, Hausaufgaben, u.a.)</li> <li>• Vorbilder</li> <li>• Verkehrserziehung</li> </ul>
<b>8. Arbeit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Beruf der Mutter/des Vaters</li> </ul>

<b>9. Versorgung</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nahrung, typische Speisen</li> </ul>
<b>10. Gesundheitsfürsorge</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hygiene</li> <li>• Im Badezimmer</li> <li>• Zähneputzen, usw.</li> <li>• Zahnarzt</li> </ul>
<b>11. Freizeitgestaltung ( der Kinder)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hobbys</li> <li>• Lesegewohnheiten</li> <li>• Haustiere halten</li> </ul>
<b>12. Kommunikation</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Das Telefon nutzen</li> <li>• Fernsehen</li> </ul>
<b>13. Kunst und Kreativität</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lieder singen</li> <li>• Bilder malen</li> <li>• Etwas selbst schreiben, lesen, malen, gestalten</li> <li>• Einfache Gedichte kennen lernen</li> </ul>
<b>14. Zeitlich-historische Erfahrung</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Uhrzeiten</li> <li>• Tageszeiten</li> <li>• Jahreszeiten</li> <li>• Persönliche Vergangenheit-Gegenwart</li> </ul>

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

### Forma komunikative e mësimdhënies

Në një mësimdhënie bashkëkohore komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme, kjo do të thotë: Cilat mjete gjuhësore ju duhen nxënësve që në situata të caktuara gjuhësore të shprehin dhe të sillen në mënyrë të duhur?

Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja për një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregullë gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo e kundërta.

## **Metodat e mësimdhënies**

### *Metodat që nxisin komunikimin*

- Puna në grupe, në çifte
- Debatet, debat në podium
- Lojrat në role
- Intervistat

### *Metodat që nxisin punën e pavarur*

- Stacione(materiali i përgatitur me detyra të shtruara në mënyra të ndryshme lihet në vende të caktuara, ashtu që nxënset/ sit në një rrugë të zgjedhur vet i mbledhin dhe përpunojnë ato pa ndihmen e mësuesit)
- Lojra mësimi (si Memori, Bingo)
- Kontrollimi i partnerit
- Përpunimi i pavarur i temave ( mbledhja e informatave në bibliotekë, kompjuter etj; përpunimi i pavarur i informatave rreth një ligjerate, referati, ditari pune, kollazheve etj; përcjellja e mëtutjeshme e informatave tek grupi)
- Nxënia gjatë mësimdhënies( nxënësi merr rolin e mësuesit)
- Mbledhja e materialeve dhe burimeve
- Letërkëmbime me Gjermaninë( partnerizimi i shkollave, letërkëmbime mes nxënësve, etj)

### *Metodat që nxisin prodhimin*

- Punimi i gazetave të murit , pikturave, posterëve, kollazheve, teksteve (p.sh. për ekspozita, gara të shkollës apo interne, etj.)
- Shkrimi kreativ (i poezive, eseve, tregimeve, skenarëve për teatër) i nxitur përmes aktivizimit të njohurive paraprake (me asociograme, clustering, Brainstorming etj.)

## **Përdorimi i mediave**

### *Fotografitë*

Ndihmojnë në prodhimin ( shkruarjen) e teksteve kreative përshkruese dhe komentuese.

- Nxënësit përshkruajnë gjërat e njohura dhe ato të pazakonshme që shohin në fotografi dhe tregojnë si ndikon në ta ajo që shohin në foto;

- Ata tregojnë një ngjarje, fillimin ose mbarimin e së cilës e përshkruan fotografia

### *Videoprojektori*

Prezentimi i materialeve (fotografive, vizatimeve, tregimeve të ilustruara, etj) dhe teksteve përmes folieve dhe projektorit, rrit interesimin e nxënësve për mësim

- Prezentimi i fotografive të veçanta ose të një sërë fotografish
- Mbulimi dhe zbulimi i pjesërishëm i fotografisë
- Një ngjarje e paraqitur me fotografi jepet me foto të radhitura gabimisht
- Paraqitja e një teksti të ndarë në pjesë dhe të radhitur në mënyrë jo të rregullt dhe rregullimi i tij

### *Materiali auditiv*

Ky material mundëson ballafaqimin me variantet gjuhësore individuale dhe regjionale të gjermanishtes dhe nxit të kuptuarit përmes dëgjimit.

- Nxënësit gjejnë fillimin ose mbarimin e një teksti të shkurtër të dëgjuar më parë
- Ata karakterizojnë personat e një pjese teatrale të dëgjuar dhe diskutojnë për sjelljet e tyre.

### *Videomateriali*

Përdorimi i videomaterialit u jep nxënësve mundësi të shumta për krijimin e teksteve me shkrim dhe me gojë:

- Paraqitja e një filmi të punuar mbi bazën e një tregimi ose një përralle, i cili nxit krahasimin me tregim a përrallen e lexuar ose dëgjuar më parë.
- Puna me video sekuenca mund të bëhet në tri faza:
  - paraqitja e materialit filmik pa zë, ku nxënësit identifikojnë vendet dhe personat e njohur, përshkruajnë personat, vendet, veprimet ose gjësendet etj.
  - paraqitja e materialit filmik pa fotografi ku nxënësit diskutojnë mbi objektet dhe aktivitetet e ndryshme, shënojnë informacione nga ajo që dëgjojnë (numrat, emrat e vendeve, të personave, të dhënave kohore), emërtojnë temat, vizatojnë një pikturë.

- paraqitja e materialit filmik me zë dhe fotografi më që rast bëhet krahasimi në mes të supozimit të mëhershëm dhe sekucencës që shihet dhe dëgjohet.

## **Objektivat**

Përcaktimi i qartë i objektivave, është lehtësim për punën e mësuesit dhe e ndihmon atë vet në përcaktimin e objektivave më specifike. Kur të arrihet objektivi - kjo do të thotë se nxënësit e zotërojnë materien e përpunuar - atëherë mesimdhësi do të duhej të jetë i kënaqur me këtë. Nëse ende nuk ka përfunduar ora mësimore nuk ka logjikë që të futen edhe përmbajtje të tjera në orë. Në këtë rast më e logjikshme do të ishte që të përforcohet ajo që është mësuar me anë të ushtrimeve të llojllojshme, të përpunohet një këngë gjatë orës së mësimit ose të futet ndonjë lojë mësimore më qëllim të arritjes së objektivit.

## **Kufizimi i objektivave**

Duke i njohur nxënësit dhe duke i pasur të qarta objektivat e përcaktuara më parë mësuesi nuk do të duhej të bëjë gabim e të përcaktojë shumë objektiva për një orë mësimi e të habitet pastaj pse nuk është arritur objektivi. Për këtë arsye mësuesi duhet të caktojë një objektiv specifik, të cilin tenton ta arrijë brenda një ore mësimi. Përcaktimi i shumë objektivave për një orë ka për pasojë këtë:

Mbetet pak kohë për ushtrime dhe zbatim, për këtë arsye nxënëset/sit nuk mund ta bëjnë zotërimin e mjaftueshëm të materies. Në orën e ardhshme duhet të përsëritet dhe sqarohet materia edhe një herë, sepse mund të ndodhë që të jenë përvjedhur gabime, të cilat pastaj me mund mund të korrigjohen, arsye kjo për t'u dëshpruar arsimtari dhe nxënësi.

Llogaria është e thjeshtë: një orë e stërngarkuar dhe një orë për përsëritje bëjnë dy. Në këtë rast do të ishte më e logjikshme që materia qysh nga fillimi të ndahet në dy orë.

Sipas hulumtimeve nxënëset/sit mesatarë janë në gjendje që për një orë mësimi të mbajnë mend rreth dhjetë shprehje të reja. Ky fakt nuk duhet të lihet anash.

### **Radhitja: të dëgjuarit/ të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit**

Posaçërisht në mësimin fillestar do të duhej të ruhet radha e katër shkathtësive, që d.m.th.:

- Nxënësit nuk do të duhej të flasin asgjë që nuk e kanë dëgjuar më parë,
- Ata nuk do të duhej të lexojnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar dhe folur më parë,
- Ata nuk do të duhej të shkruajnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar, folur dhe lexuar më parë.

Për t'iu përmbajtur kësaj radhitjeje posaçërisht te fillestarët, flet kjo arsye:

Nëse do të mësohet një fjalë, logjikisht ajo do të duhej të dëgjohej më parë. Në anën tjetër leximi i një fjale të re është më i lehtë kur ajo më parë është dëgjuar ose folur. Edhe të shkruarit do të duhej të ishte më i lehtë, kur ajo fjalë është dëgjuar, folur apo lexuar më parë.

### **Puna aktive dhe konkrete**

Një dallim në mes të mësimit të gjuhës gjermane në Gjermani- pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gjermanishten si gjuhë amtare ose për gjermanishten si gjuhë e dytë ose e huaj- dhe në Kosovë është ndër tjera se mjedisi-kosovar mund të japë pak ose aspak informacione për RFGJ-në dhe përveç orës së mësimit pothuajse nuk ekziston ndonjë mundësi për t'iu zbatuar ajo që është mësuar. Kështu që bie mundësia që ajo që është mësuar në shkollë të thellohet jashtë orëve të mësimit si përmes ekskursioneve, zhvillimit të intervistave etj. Në këtë kontekst nuk duhet mbiçmuar apo nënçmuar televisionin.

Prodhimi(krijimi) i pllakatave, mozaiqeve dhe posterëve, prodhimi i punëdoreve të vogla janë gjithashtu të rëndësishme.

Një arsye tjetër për aktivitete të këtilla, janë njohuritë nga psikologjia e të mësuarit: sipas saj rezultati (arritja) është më i madh, sa më shumë që të mbështeten veprimet gjuhësore nga veprimet konkrete.

### **Kohë e mjaftushme për ushtrime dhe zbatim**

Për nxënien dhe zotërimin e sigurtë të një gjuhë nevojiten në përgjithësi tri gjëra: kohë, kohë dhe prapë kohë.

Ne e dimë se ekzistojnë 3 tipa të ndryshëm të nxënësve:

**Tipat akustik** (ata e nxënë- mësojnë gjuhën më shpejt përmes dëgjimit - veshit);

**Tipat vizuel-** (pamor) (ata e nxënë gjuhën në radhë të parë përmes syrit);

**Tipat motorik** (ata nxënë gjuhën më se shpejti përmes të shkruarit).

Për këtë arsye është e rëndësishme, që ushtrimi të zgjedhet gjithashtu edhe përmes këtij këndvështrimi; që gjuha të mësohet njëkohësisht përmes kanaleve të shumta, pasi që te shumica e atyre që mësojnë gjuhën bëhet fjalë për tipa të ashtuquajtur të përzier.

### **Llojlojshmëria në fazat e ushtrimeve**

Secili mësues dhe mësuese e di saktësisht se në orën e gjuhës, të ushtruarit monoton të strukturës së fjalisë ndikon më parë në të kundërtën e asaj që është synuar.

Nxënësit dhe nxënset do ta humbin interesimin për mësim dhe nuk do të marrin pjesë aktivisht në të. Në anën tjetër ne e dimë se motivimi i synuar dhe dhënia e detyrave interesante mund ta ngrisin në mënyrë të ndjeshme dëshirën për mësim dhe gatishmërinë për punë (rezultate).

Si rezultat mund të jetë jo vetëm ndërrimi i formave të punës (puna e veçantë, puna në çifte ose në grupe), por posaçërisht edhe lojrat në mësim, këngët dhe poezitë si dhe tregimet do bëhen pjesë përbërse e mësimit.

### **Korrigjimi i shprehjeve të nxënësve**

Pothuajse asnjë çështje nuk diskutohet aq shpesh dhe në mënyrë kundërtënëse në rrethin e mësimeve se sa mënyra e korrigjimit.

Derisa korrigjimin disa e vështrojnë si pengesë të rrjedhjes gjuhësore, të tjerët mbështeten në atë se gabimet duhet korrigjohen menjëherë që të mos përvihen..

Ndoshta mund të bëhet një kompromis i arsyshëm gjatë korrigjimit dhe ai do të dukej kështu:

Në fazën e kontaktit gjuhësor, si për shembull: gjatë përshkrimit të një fotografie, mësueset dhe mësuesit presin një të shprehur të lirë të nxënësve të tyre.

Po të bëjnë korrigjimin masiv gjatë kësaj faze të mësimit, nxënësit ndoshta do të tërhiqeshin menjëherë dhe në fund do të heshtin plotësisht.



Në këtë fazë është e drejtë që korrigjimet ndër të tjera të parashtrohen në atë mënyrë, për shembull, një fjalë e thënë gabimisht të përsëritet nga mësuesi edhe një herë, por natyrisht në mënyrë të drejtë. Nuk duhet të bëhet kurrfarë diskutimi: që do t'i turpëronte nxënësit në këtë rast para klasës, por të tregohet takt pedagogjik.

### **Diferencimi**

Asnjë klasë nuk ka përbërje të njëtrajtshme. Këtë duhet ta ketë parasysh çdo mësues dhe të organizojë orën në bazë të kësaj. Kjo nënkupton që nxënësit, të cilët kanë aftësi të nxënies më të shpejtë të trajtohen ndryshe nga të tjerët në mënyrë që mësuesi i gjuhës të jetë përafërsisht i njëjtë për të gjithë.

### **Teknikat e punës**

Një ndër detyrat e mësuesit në gjuhën e huaj është edhe aftësimi i nxënësve që të marrin përgjegjësinë për të mësuarit e vet. Nxënësit, të cilët janë mësuar që t'i reflektojnë proceset e tyre të mësuarit dhe që të organizojnë në grup procesin e mësimit dhe procesin e të mësuarit, zakonisht mësojnë me sukses dhe në mënyrë efektive. Në këtë mënyrë ata, përveç tjerash, mund të përgatiten që të reagojnë në mënyrë të pavarur në situatat jashtëshkollore si dhe të vazhdojnë proceset e mësimit të gjuhës.

### **LIDHJA NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE**

Duke pasur parasysh udhëzimet nga MASHT-i jemi kujdesur që zgjedhja e temave (më të përgjithësuara-orientuese, sepse temat specifike i zgjedhin hartuesit e librave shkollor) të bëhet ashtu që të ketë ndërlidhje programore.

Lidhja do të jetë me tri fusha kryesore:

Shkencat natyrore

Shkencat shoqërore

Artet

Me shkencat shoqërore do të jenë të lidhura kryesisht me: Edukatën qytetare, Historinë etj. gjatë trajtimit të temave si:

1. E kaluara dhe e tashmja
2. Tradita dhe religjioni
3. Skena dhe kultura rinore
4. Përditshmëria dhe familja
5. Bota e të rinjve dhe të rriturve
6. Shkolla dhe shkollimi
7. Individidi dhe shoqëria
8. Jeta politike dhe çështja sociale
9. E drejta dhe drejtësia

Lidhja me shkencat natyrore do të jetë si:

1. Gjeografia
2. Biologjia
3. Matematika
4. Teknologjia

Dhe atë gjatë trajtimit të temave si:

1. Natyra dhe ambienti
2. Teknika dhe zhvillimi
3. Koha
4. Bota fantastike
5. Kultura dhe shkenca
6. Ekonomia dhe tregu i punës

Pasi që ora e mësimit do të bëhet kryesisht përmes komunikimit, lojës, këngës e mënyrave tjera kreative, atëherë lidhja me artet e sportin do të bëhet kryesisht gjatë zhvillimit të orës së mësimit dhe trajtimit të temave.

Gjatë punimit të plan-programit për gjuhë gjermane është menduar mjaft edhe për barazinë gjinore dhe personat me nevoja të veçanta. Tërë kohën thuhet “ajo/ai” ose “ata/ato”. Gjatë hartimit të librave do të definohen edhe gjërat tjera si personazhet do të jenë edhe femra të barabarta me meshkuj (nëna shkon në punë, vajzat bëjnë atë që bëjnë djemtë), ka fëmijë të racave të ndryshme etj.

## **VLERËSIMI**

Janë tri aftësi që kontrollohen (vlerësohen):

1. Riprodhimi (reprodukimi) - nënkupton riprodhimin nga nxënësi e asaj që është mësuar më parë.

2. Riorganizimi- nënkupton bartjen e të mësuarës në situata të ngjashme( p.sh. nëse nxënësit i mësohet vendi i foljes në fjali të varur, duhet të jetë i aftë të aplikojë foljen në fjali të varur).
3. Transferi- nënkupton bartjen e të së mësuarës në situata plotësisht të reja.

### Teknikat e të vlerësuarit

Teknikat e poshtëshënuara vlejné për mëyrën e vlerësimit me shkrim, pasiqë mendohet se kjo është mënyra më objektive dhe më e zbatuar në shkolla:

#### Përgjigjet seleksionuese

##### 1. Përgjigjet alternative

###### Shembull:

Prishtinë ist die Hauptstadt von Kosova.	richtig <input type="radio"/>
	falsch <input type="radio"/>

##### 2. Përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes

###### Shembull:

Kreuze die richtige Lösung an.

Das Auto steht	<input type="radio"/> unter der Straße.
	<input type="radio"/> über der Straße.
	<input type="radio"/> in der Straße.
	<input type="radio"/> auf der Straße.

#### Përgjegjet rregulluese

##### 1. Përgjigjet kategorizuese

###### Shembull:

Ordne zu.

1. Peter	a) Griechenland
2. Armend	b) Deutschland
3. Giuseppe	c) Spanien
	d) Kosova
	e) Türkei
	f) Italien

## 2. Përgjigjet radhitëse

### Shembull:

Schreibe die richtige Reihenfolge auf.

1. Es ist acht Uhr.
2. Liridon geht bei Rot über die Kreuzung.
3. Der Wecker klingelt.
4. Liridon kommt zu spät zur Schule.
5. Liridon hat verschlafen.
6. Der Autofahrer bremst scharf.
7. Er springt aus dem Bett.
8. Der Fahrer schimpft Lukas.
9. Er läuft schnell weiter.

## Përgjigjet e lira

### 1. Përgjigjet plotësuese

#### Shembuj:

Viele Dinge sind schneller, schöner usw. als andere. Setze die richtige Form ein.

(langsam)	Ein Fahrrad ist ... als ein Auto.
(schwer)	Fünf Kilo sind ... als ein Kilo.
(teuer)	Fleisch ist ... als Brot.

Trage das Gegenteil in die Lücke ein.

Dieses Buch ist spannend. Es ist nicht ...
Anna ist groß. Sie ist nicht...
Emira ist ein Mädchen. Sie ist kein ...

Setze die richtige Zeit in die Lücke ein.

Heute Nachmittag ... (gehen) ich auf den Spielplatz.
Morgen ... (spielen) ich Tennis.
Gestern ... (sein) ich im Kino.

### 2. Përgjigjet e shkurtëra hartuese

#### Shembull:

Bilde aus den folgenden zwei Sätzen einen Satz.

Andreas weint. Eine Wespe hat ihn gestochen.
--

Librat mësimore, të cilat i preferojmë për klasën e gjashtë, derisa nuk botohen libra të bazuara në këtë plan-program janë:

- **B. Weisgerber, H. Böhm, R. Urbanek:** “*Hallo, Peter - wir lernen Deutsch I*”, Dürr + Kessler Verlag, 1998, Köln ose
- **S. Büttner, G. Kopp, J. Alberti:** “*Tamburin I*”, Hueber Verlag, 2002, Ismaning

Po ashtu preferohon edhe libra tjera shkollore që përdoren për mësimin e gjuhës gjermane për të huaj:

Libri i punës

Libri i ushtrimeve

Kaseta dhe CD

---

## **GJUHË LATINE**

---

### ***STRUKTURA PROGRAMORE PËR GJUHËN LATINE*** ***Standardet e arritshmërisë***

#### **NIVELI 3: Për gjimnazin e shkencave të natyrës**

##### **I. NJOHURITË ELEMENTARE HISTORIKO-GJUHËSORE**

- 1. Formimi i gjuhës latine**
- 2. Vlera historike e shkrimit latin**
- 3. Fonetika dhe fonologjia latine**

##### **II. LIDHMËRITË ME TERMINOLOGJINË GRAMATIKORE DHE LEKSIKORE**

- 1. Trajtëformimi i pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës**
- 2. Trajtëformimi i pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës**
- 3. Vlera historike e terminologjisë gramatikore dhe leksikore latine**

##### **III. SHPREHITË DHE KULTURA**

- 1. Fjalë kryesore dhe e varur**
- 2. Fjalët e urta dhe sentencat latine**
- 3. Shkurtesat më të zakonshme latine**

## **PROGRAMI PËR KLASËN E DHJETË**

### **1.0. NJOHURITË ELEMENTARE HISTORIKO-GJUHËSORE**

#### **1.1. Njohuri për shkrimin (alfabetik) dhe gjuhën latine**

- 1.1.1. Vendi dhe koha e formimit të gjuhës (letrare) latine;
- 1.1.2. Shkrimi alfabetik latin (në krahasim me alfabetin shqip);
- 1.1.3. Tingujt: zanoret, diftongjet dhe bashkëtingëlloret;
- 1.1.4. Leximi antik (klasik) dhe tradicional;
- 1.1.5. Dallimi në mes leximit antik dhe tradicional ( ke/ki; ce/ci);
- 1.1.6. Gjatësia e rrokjeve (ndarja e fjalëve në rrokje: con-cor-di-a - bashkimi);
- 1.1.7. Theksi (rëndom theksohet rrokja e parafundit: natura, si në gjuhën shqipe: natyra)

### **2.0. LIDHMËRITË ME TERMINOLOGJINË GRAMATIKORE DHE LEKSIKORE**

#### **2.1. Morfologjia latine (dhe shqipe)**

- 2.1.1. Veçoritë morfologjike: rrënja, tema dhe mbaresa;
- 2.1.2 Pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës;
- 2.1.3. Emrat dhe mbiemrat;
- 2.1.4. Mbaresa si formë dalluese e trajtave morfologjike;
- 2.1.5. Gjinia, numri dhe rasa e emrit (pyetjet e rasave);

#### **2.2. Lakimi i emrave**

- 2.2.1. Lakimi i emrave dhe i mbiemrave (Declinatio);
- 2.2.2. Lakimi i parë me *-a* dhe veçoritë e lak. të parë;
- 2.2.3. Lakimi i dytë me *-o* dhe veçoritë e lak. të dytë;
- 2.2.4. Lakimi i tretë me bashkëtingëllore
- 2.2.5. Lakimi i tretë me zanoren *-i* dhe veçoritë e lak. të tretë;
- 2.2.6. Lakimi i katërt me *-u* dhe veçoritë e lak. të katërt;
- 2.2.7. Lakimi i pestë me *-e* dhe veçoritë e lak. të pestë;
- 2.2.8. Lakimi i emrave grekë;

#### **2.3. Lakimi (dhe shkallëzimi) i mbiemrave**

- 2.3.1. Mbiemrat e grupit të parë dhe të dytë (Mbiemrat me *-us*, *-a*, *-um*; *er*, *-a*, *-um*, dhe mbiemrat e lak. të tretë me tri mbaresa, me dy mbaresa dhe me një mbaresë);

- 2.3.2. Shkallëzimi i mbiemrave (shkalla pohore, krahasore dhe sipërore);
- 2.3.3. Shkallëzimi i zhdrejtë, përshkrues dhe pa pohore;
- 2.3.4. Ndajfoljet dhe shkallëzimi i tyre;
- 2.3.5. Përemrat (vetorë dhe vetvetorë, pronorë, dëftorë, lidhorë, pyetës, mbiemërorë, të pacaktuar dhe korelativë);
- 2.3.6. Numërorët (themelorë, rreshtorë, ndasorë, mbiemërorë);

#### **2.4. Folja (Verba)**

- 2.4.1. Foljet e rregullta dhe zgjedhimi i tyre
- 2.4.2. Veta, numri, koha, mënyra dhe diateza e foljes;
- 2.4.3. Katër zgjedhimet e foljes dhe dallimi i tyre sipas temës;
- 2.4.4. Zgjedhimi i parë *–are dhe* zgjedhimi i dytë *–ere*;
- 2.4.5. Zgjedhimi i tretë me bashkëtingëllore (dhe i përzier) dhe zgjedhimi i katërt *–ire*;
- 2.4.6. Kohët e temës të së tashmes (koha e tashme, e pakryer, e ardhme);
- 2.4.7. Kohët e temës të së kryerës (koha e kryer, më së e kryer, e ardhme e e përparme);
- 2.4.8. Mënyrat e foljes (dëftore, lidhore dhe urdhërore);
- 2.4.9. Diatazmat e foljes (veprore, pësore);

#### **2.5. Foljet e parregullta**

- 2.5.1. Foljet deponente dhe semideponente;
- 2.5.2. Folja e parregullt *esse* dhe ato të përbëra prej saj;
- 2.5.3. Folja e parregullt *ire* dhe ato të përbëra prej saj;
- 2.5.4. Folja e parregullt *ferre* dhe ato të përbëra prej saj;
- 2.5.5. Foljet: *volo, nolo, malo, fio, edo, queo*;
- 2.5.6. Foljet mungesore (*inquam, aio, memini, odi, coepi*);
- 2.5.7. Foljet pavetore dhe fjalët përshendetëse;

#### **2.6. Trajtat e pashtjelluara të foljes**

- 2.6.1. Emrat dhe mbiemrat prejfoljorë;
- 2.6.2. Pjesorja e së tashmes,
- 2.6.3. Gjerundi dhe Gjerundivi (dhe shkëmbimi i tyre);
- 2.6.4. Supini i parë dhe supini i dytë;
- 2.6.5. Zgjedhimi përshkrues vepror dhe pësor;

#### **2.7. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës**

- 2.7.1. Parafjalët me kallëzoren dhe me rrjedhoren;
- 2.7.2. Lidhëzat dhe pasthirrat;



### 3.0. SHPREHITË DHE KULTURA

#### 3.1. Sintaksa

- 3.1.1. Rendi i fjalëve në fjali;
- 3.1.2. Kryefjala, kallëzuesi dhe cilësori;
- 3.1.3. Sintaksa e rasave;
- 3.1.4. Rasa rrjedhore;
- 3.1.5. Përdorimi i emrave të vendeve me parafjalën *-in* dhe pa parafjalë;
- 3.1.6. Kuptimi i pjesëve të ligjëratës;
- 3.1.7. Kuptimi i ndërtimeve gramatikore;
- 3.1.8. Kallëzorja me paskajoren;
- 3.1.9. Emërorja me paskajoren;
- 3.1.10. Rrjedhorja e lirë (Ablativus absolutus);

#### 3.2. Sintaksa e fjalisë

- 3.2.1. Fjalitë kryesore dhe të varura dhe pëlqimi i kohëve;
- 3.2.2. Fjalitë (e varura) pyetëse;
- 3.2.3. Fjalitë (e varura) qëllimore;
- 3.2.4. Fjalitë (e varura) kohore;
- 3.2.5. Fjalitë (e varura) shkakore;
- 3.2.6. Fjalitë (e varura) kushtore,
- 3.2.7. Fjalitë (e varura) krahasore;
- 3.2.8. Fjalitë (e varura) rrjedhimore;
- 3.2.9. Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë.

#### 3.3. Drejtshkrimi, pikësimi, kultura gjuhësore

- 3.3.1. Fjalët e urta dhe sentencat;
- 3.3.2. Shkurtesat më të zakonshme në gjuhën shqipe;
- 3.3.3. Sinonimet latine dhe përdorimi i fjalorit.

### FORMAT DHE METODAT E REALIZIMIT TË PROGRAMIT

Ligjërata, ushtrime, përkthime fjalish (dhe tekstesh të shkurtëra) nga teksti i hartuar sipas këtij planprogrami.

Vlerësimi i njohurive të nxënësve bëhet sipas kontrollit njëmuji në përkthimin e fjalive (dhe të fjalëve të urta ose sentencave latine). Hartimi me shkrim dy herë në vit ka për qëllim vlerësimin (notimin) e nxënësve në përvetësimin e shkrimit -leximit të drejtë, që do të thotë, të fonetikës dhe fonologjinë, pastaj të përvetësimit të morfologjisë dhe të sintaksës, si dhe të (jo më pak se 1000) fjalëve latine.

**STRUKTURA PROGRAMORE PËR GJUHËN LATINE**  
*Standardet e arritshmërisë*

**Për gjimnazin e gjuhëve (gjimnazin e filologjisë)**  
**(Vetëm për ata nxënës që mësojnë gjuhën latine katër vjet)**

---

**I. NJOHURITË ELEMENTARE HISTORIKO-GJUHËSORE**

1. Formimi i gjuhës latine
2. Vlera historike e shkrimit latin
3. Fonetika dhe fonologjia latine

**II. LIDHMËRITË ME TERMINOLOGJINË GRAMATIKORE  
DHE LEKSIKORE**

1. Trajtëformimi i pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës
2. Struktura gramatikore latine dhe shqipe
3. Vlera historike e terminologjisë gramatikore dhe leksikore latine

**III. SHPREHITË DHE KULTURA**

1. Fjalët e urta dhe sentencat latine
2. Përdorimi i fjalorit

## **PROGRAMI PËR KLASËN E DHJETË**

### **1.0. NJOHURITË ELEMENTARE HISTORIKO-GJUHËSORE**

#### **1.1. Njohuri për gjuhën latine**

- 1.1.1. Vendi dhe koha e formimit të gjuhës (letrare) latine;
- 1.1.2. Shpjegimi i koncepteve *latin* dhe *romak* (*gjuha latine-populli romak*);
- 1.1.3. Aktualiteti i mësimi të gjuhës latine;

#### **1.2. Njohuri për shkrimin alfabetik latin dhe për fonetikën**

- 1.2.1. Shkrimi alfabetik latin (në krahasim me alfabetin shqip);
- 1.2.2. Tingujt: zanoret dhe diftongjet;
- 1.2.3. Bashkëtingëlloret;
- 1.2.4. Leximi antik (klasik) dhe tradicional;
- 1.2.5. Dallimi në mes leximit antik dhe tradicional ( *ke/ki; ce/ci*);
- 1.2.6. Gjatësia e rrokjeve (ndarja e fjalëve në rrokje: *con-cor-di-a* - bashkimi);
- 1.2.7. Theksi (rëndom theksohet rrokja e parafundit: *natura*, si në gjuhën shqipe: *natyra*).

### **2.0. LIDHMËRITË ME TERMINOLOGJINË GRAMATIKORE DHE LEKSIKORE**

#### **2.1. Morfologjia latine (dhe shqipe)**

- 2.1.1. Veçoritë morfologjike: rrënja, tema dhe mbaresa;
- 2.1.2 Pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës;
- 2.1.3. Emrat dhe mbiemrat;
- 2.1.4. Mbaresa si formë dalluese e trajtave morfologjike;
- 2.1.5. Gjinia, numri dhe rasa e emrit (formave pyetëse të rasave);

#### **2.2. Lakimi i emrave**

- 2.2.1. Lakimi i emrave dhe i mbiemrave (*Declinatio*);
- 2.2.2. Lakimi i parë me *-a* dhe veçoritë e lak. të parë;
- 2.2.3. Lakimi i dytë me *-o* dhe veçoritë e lak. të dytë;
- 2.2.4. Lakimi i tretë me bashkëtingëllore;
- 2.2.5. Lakimi i tretë me zanoren *-i* dhe veçoritë e lak. të tretë;
- 2.2.6. Lakimi i katërt me *-u* dhe veçoritë e lak. të katërt;
- 2.2.7. Lakimi i pestë me *-e* dhe veçoritë e lak. të pestë;
- 2.2.8. Lakimi i emrave grekë;

#### **2.3. Lakimi (dhe shkallëzimi) i mbiemrave**

- 2.3.1. Mbiemrat e grupit të parë dhe të dytë (Mbiemrat me *-us, -a, -um; er, -a, -um*, dhe mbiemrat e lak. të tretë me tri mbaresa, me dy mbaresa dhe me një mbaresë);

- 2.3.2. Shkallëzimi i mbiemrave (shkalla pohore, krahasore dhe sipërore);
- 2.3.3. Shkallëzimi i zhdrejtë, përshkrues dhe pa pohore;
- 2.3.4. Mbiemrat pa krahasore dhe mbiemrat pa sipërore;
- 2.3.5. Ndajfoljet dhe shkallëzimi i tyre;
- 2.3.6. Përemrat (vetorë dhe vetvetorë, pronorë, dëftorë, lidhorë, pyetës, mbiemërorë, të pacaktuar dhe korelativë);
- 2.3.7. Numërorët (themelorë, rreshtorë, ndasorë, mbiemërorë);

## **2.4. Folja (Verba)**

- 2.4.1. Foljet e rregullta dhe zgjedhimi i tyre;
- 2.4.2. Veta, numri, koha, mënyra dhe diateza e foljes;
- 2.4.3. Katër zgjedhimet e foljes dhe dallimi i tyre sipas temës;
- 2.4.4. Zgjedhimi i parë – *are dhe* zgjedhimi i dytë – *ere*;
- 2.4.5. Zgjedhimi i tretë me bashkëtingëllore (dhe i përzier) dhe zgjedhimi i katërt – *ire*;
- 2.4.6. Kohët e temës të së tashmes (koha e tashme, e pakryer, e ardhme);
- 2.4.7. Mënyrat e foljes (dëftore, lidhore dhe urdhërore);
- 2.4.8. Diatazetat e foljes (veprore, pësore);
- 2.4.9. Folja *esse* dhe zgjedhimi i saj.

## **3.0. SHPREHITË DHE KULTURA**

### **3.1. Drejtshkrimi, pikësimi, kultura gjuhësore**

- 3.1.1. Fjalët e urta dhe sentencat;
- 3.1.2. Shkurtesat më të zakonshme në gjuhën latine;
- 3.1.3. Përdorimi i fjalorit.

## **FORMAT DHE METODAT E REALIZIMIT TË PROGRAMIT**

Ligjëratat, ushtrime, përkthime fjalish (dhe tekstesh të shkurtra) nga teksti i hartuar sipas këtij planprogrami.

Vlerësimi i njohurive të nxënësve bëhet sipas kontrollit (më së paku) njëmuji në përkthimin e fjalive (dhe të fjalëve të urta ose sentencave latine). Hartimi me shkrim katër herë në vit ka për qëllim vlerësimin (notimin) e nxënësve në përvetësimin e shkrim-leximit të drejtë, që do të thotë, të fonetikës dhe fonologjisë, pastaj të përvetësimin të trajtave të fjalëformimit, të kulturës gjuhësore, si dhe të (jo më pak se 1000) fjalëve latine.

---

## MATEMATIKË

---

Për klasen e dhjetë kemi pesë plane dhe programe të ndryshme (varësisht nga lloji i gjimnazeve dhe diciplinat matematikore që mësohen)

**1. Gjinnazi : Matematikë- Informatikë**

*a) Analizë më teori të gjasës*

*b) Algjebër më gjeometri*

**2. Gjinnazi i Përgjithshem dhe Gjinnazi i Shkencave të Natyrës**

**3. Gjinnazi i Shkencave Shoqërore**

**4. Gjinnazi i Gjuhëve**

Pjesa e përbashkët për këto pesë (5) plane dhe programe

### HYRJE

Matematika për klasën e dhjetë është vazhdimësi, rimarrje aktive dhe zgjerim i njohurive paraprake. Edukata matematikore u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri e shkathtësi për të zhvilluar të kuptuarit e botës fizike dhe asaj shoqërore. Me anë të matematikës nxënësit aftësohen të analizojnë, të përshkruajnë dhe të sqarojnë, të ngrisin hipoteza dhe të zgjidhin probleme.

Krahas lëndëve të tjera mësimi i matematikës synon::

- zhvillimin e personalitetit të nxënësit;
- edukimin e shprehive për punë të pavarur e sistematike;
- kultivimin e aftësive e shkathtësive për të menduar në mënyrë krijuese e kritike;
- nxitjen e kureshtjes dhe inkurajimin e nxënësit për kërkim në përgjedhje të informacionit të nevojshëm;

Në veçanti, nëpërmjet gjuhës karakteristike – simboleve e diagrameve, matematika synon të kultivojë aftësitë për t'u shprehur saktë, për

të organizuar e përmbledhur mendimet dhe për komunikim në përgjithësi.

Zbatimi gjithnjë e më shumë i matematikës së sotisfikuar në fusha të gjëra të ekonomisë, teknologjisë e shkencës, e rrit mundësinë e ndikimit të thellë të saj në zhvillimin e një shoqërie bashkëkohore.

## **QËLLIMET**

Qëllimet kryesore të mësimit të matematikës tek nxënësit janë:

1. Aktivizimi i kureshtjes, kreativitetit dhe zhvillimit i të menduarit logjik;
2. Përshkrimi i drejtë i koncepteve matematikore, dallimi i relacioneve të ndryshme sasiore si dhe kryerja me korrektësi e veprimeve logjike, si dhe veprimeve matematike në përgjithësi gjatë zgjidhjes së detyrave;
3. Zhvillimi i aftësive krijuese dhe shkathtësive të domosdoshme për përvetësimin e përmbajtjes së lëndës si: marrja e informatave me ndihmën e pyetjeve të njëpasnjëshme, komunikimi i vazhdueshëm me nxënës e arsimtarë, vetëbesimi, arsyeshmëria si dhe argumentimi;
4. Zotërimi i dijeve të reja me qëllim që t'i zbatojnë ato në zgjidhjen e situatave problemore nga jeta e përditshme dhe nga lëndët tjera shkollore;
5. Krijimi i një baze solide për të shtruar dhe kuptuar drejt problemet;
6. Ndërtimi i një qëndrimi të drejtë për rëndësinë e matematikës në zhvillimin e personalitetit të tyre si dhe krijimi i një vizioni të qartë për jetën në përgjithësi;
7. Përvetësimi i njohurive të domosdoshme që paraqesin bazë për studimin e suksesshëm në drejtime të ndryshme të shkollimit universitar.

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Si në çdo lëndë, edhe në lëndën e matematikës, detyra kryesore e arsimtarit është udhëheqja e veprimtarive arsimore të cilat përmbushin arritjen e rezultateve të të nxënësve që parashikohen në objektiva.

Praktika ka treguar se teknikat, metodat e strategjitë të cilat sigurojnë një mësimdhënie produktive, janë ato të cilat i mundësojnë nxënësit të përfshihen aktivisht në ndërtimin e të kuptuarit, në zhvillimin e strategjive matematikore për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e aftësive për të zbatuar njohuritë në jetën e përditshme.

Në vendimet që merr mësimdhënësi për zgjedhjen e metodave mësimore, krahas shumë faktorëve, duhet të ketë parasysh edhe:

- natyrën e materialit mësimor;
- tipin e të nxënësve;
- nivelin dhe kërkesat e nxënësve.

Për këtë qëllim, metodat dhe teknikat e mësimdhënies duhet të jenë të larmishme që të përshtaten me stilet e ndryshme të të nxënësve të nxënësve. Ato duhet të nxisin punën bashkëpunuese të nxënësve me qëllim të përfundimit të dimensionit shoqëror në procesin e të nxënësve.

Mësimdhënia ndërvepruese i angazhon nxënësit në marrjen e përgjegjësisë për zgjerimin e njohurive por edhe vlerëshmërinë e tyre.

Ky model përcaktohet nga këto faza:

1. Përcaktohet tema apo çështja që është me interes për nxënës, që ka kuptim dhe që është e lidhur ngushtë me aspektet jetësore. Kështu matematika nga një lëndë abstrakte dhe mjaft teorike shndërrohet në një lëndë të kuptimshme, e lidhur ngushtë me jetën;
2. Arsimtari inkurajon dhe nxitë nxënësit të mendojnë rreth çështjeve që trajtohen në tekst apo rreth një problemi të caktuar. Në këtë fazë, ata përfshihen në hulumtime të ndryshme: vëzhgojnë, mbajnë shënime, evidentojnë probleme, marrin informacione;
3. Në këtë fazë jepen shumë pyetje për sqarim të cilave duhet dhënë përgjigje. Është e rëndësishme që pyetjet të jenë të kuptueshme për nxënësit;
4. Nxënësit zhvillojnë planet e tyre për të ndërmarrë kërkime apo hulumtime të thjeshta dhe u japin përgjigje më precize pyetjeve të shtruar në fazën e mësipërme;
5. Në këtë fazë nxënësit së bashku me arsimtarin diskutojnë rreth praktikës së tyre- rezultateve të nxjerra nga hulumtimi apo zgjidh-

ja e problemit. Arsimtari u ndihmon atyre të marrin në konsideratë alternativa të tjera për rezultatet dhe të planifikojnë kërkime ose hulumtime të mëtejme. Është e rëndësishme që nxënësit të perceptojnë vlerësimin e ideve të tyre, zgjidhjeve që ata japin dhe të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që ata marrin.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për të nxënëit e efektshëm, sugjerohen metodat bashkëkohore të mësimdhënies sipas metodologjisë së projektit "Të mësuarit kritik gjatë leximit dhe shkrimit", "Mësimdhënia me nxënësin në qendër" si dhe projektit "Të nxënëit ndërveprues".

Në vazhdim po i vëmë në dukje disa metoda të punës.

## **METODAT E PUNËS**

Shkolla duhet të shërbejë për ruajtjen e interesimit të fëmijëve për matematikën dhe gradualisht ta zhvillojë atë.

- Mësimi i matematikës nuk guxon të jetë abstrakt dhe verbal, sepse matematika në esencë edhe ashtu vepron me kuptime dhe relacione abstrakte. Duhet që sa më shumë të ofrohet duke u shërbyer me eksperimente, paraqitje grafike dhe situata reale nga jeta e përditshme;
- Mënyra e të nxënëit të dijes duhet të zhvillohet në formë të një spiraleje, sepse veprimet dhe strukturat matematike nuk është e mundur që për një herë dhe në tërësi të kuptohen. Do të ishte mirë që çdo herë të lidhen tërësitë e vogla të përmbajtjeve në tërësi më të mëdha, në atë mënyrë që duke futur përmbajtjen e re të përvetësohen sa më shumë përmbajtjet e vjetra.
- Motivimi është çelës në të mësuarit e matematikës, sepse aty buron edhe mjeshtëria e mësimdhënësit. Motivimi i nxënësve që të punojnë në mënyrë të vazhdueshme, sa më shumë të jetë e mundur të pavarur dhe sistematike është i një rëndësie fundamentale. Është me rëndësi zgjedhja e përmbajtjeve për ushtrime të cilat nxisin vazhdimisht të menduarit, me ç'rast shkallë - shkallë paraqiten pyetje të reja. Ushtrimet e këtilla produktive orientojnë në drejtim të një pune hulumtuese dhe ngrisin tema të reja për diskutime dhe qasje të reja.
- Dallimet e nxënësve në aftësitë numerike mund të jenë shumë të mëdha. Prandaj mësimdhënësit duhet të gjejnë mënyrën që të gji-



thë nxënësit të përparojnë. Është e preferueshme që gjatë ushtrimeve të zbatohet metoda e mendimit kritik, duke ndarë nxënësit në grupe të vogla me nga dy, katër nxënës etj.

- Duhet pasë kujdes që gjatë ushtrimeve, nxënësit të stimulohen të zgjidhin detyrat edhe në ndonjë mënyrë të veten (originale).
- Qëllimi i të mësuarit të matematikës nuk është në arritjet rutinore, të mësuarit mekanik të fakteve ose të veprimeve por përvetësimi me themel i materies. Duhet të kihet parasysh që fondi i njohurive dhe shkathtësive të arritura gjithmonë të jetë në dispozicion të nxënësit.
- Që në vitin e parë arsimtari nuk guxon të udhëheqë orët mësimore me metodën stereotipe të mësimdhënies -me mësimdhënësin në qendër, duke lënë anash aktivitetin e nxënësit në të rezonuarit matematik. Duhet të zgjidhen ushtrime të përshtatshme që të zhvillohet intuita në shkallën e mjaftueshme për të lëvizur gjithmonë një hap përpara.

## VLERËSIMI

Vlerësimi i rregullt i përparimit të nxënësve është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve të matematikës dhe pashmangshmërisht i lidhur me to. Përmes këtij procesi konstatohet jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësve por edhe vlerëshmëria e programit dhe e metodologjisë mësimore në përgjithësi.

Vlerësimi mundëson diagnostifikimin e përparimit të nxënësve, planifikimin e drejtë të mësimdhënies, motivimin e nxënësve dhe përcaktimet përfundimtare të rezultateve. Ai duhet të fokusohet në identifikimin e njohurive ekzistuese të nxënësve, në konceptimet e gabuara dhe strategjitë e të nxënësve. Po ashtu përmes tij sigurohet informacion i vlefshëm, të cilin arsimtari i matematikës e shfrytëzon për të shqyrtuar aftësitë e ndryshme të nxënësve, njohuritë paraprake të tyre dhe mënyrat që shmangin të nxënësve mekanik të fakteve e procedurave matematike.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore dhe standardet e arritshmërisë të precizuara me program.

## 1. Nivelet e arritshmërisë

Shkalla e arritshmërisë të nxënësve vlerësohet duke u bazuar kryesisht në tri nivele:

**Niveli I.** Përfshinë arritshmërinë minimale, që d.m.th. paraqet minimumin e domosdoshëm, të cilin duhet ta arrijnë të gjithë nxënësit. Pra, ai paraqet kufirin e poshtëm (të lejueshëm) të përvetësimit të përmbajtjes programore e që në përqindje do të shprehej me 40% të materialit të zhvilluar. Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit, të cilët i zgjidhin problemet me ndihmën e mësimit të nxënësve me anë të një numri të kufizuar metodash, i arsyetojnë faktet e thjeshta matematike me ndihmën e mësimit si dhe komunikojnë për njohuritë matematike duke pasur gjithmonë këtë ndihmë.

**Niveli II.** Paraqitet me kufijtë e rezultateve të shprehur në përqindje (50%-80%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit, të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike me ndihmën e kufizuar të mësimit të nxënësve, me anë të një numri jo të madh të strategjive dhe metodave, me disa gabime apo me mangësi të vogla.

**Niveli III.** Është niveli më i lartë apo niveli i avancuar (maksimal) i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (mbi 80%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit, të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, në mënyrë të pavarur. Zgjidhin probleme matematikore me metoda të ndryshme, analizojnë dhe komentojnë rezultatet e fituara në mënyrë të pavarur dhe saktë, me gjuhë të qartë dhe rrjedhshmëri logjike.

## 2. Procedura e vlerësimit

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me standardet e vendosura. Është e kuptueshme se vlerësimi duhet të ndjekë qëllimet arsimore, objektivat mësimore, objektivat e vlerësimit. Vlerësimi duhet të mbështetet në një sasi të konsiderueshme të dhënash në të cilat duhet të përfshihen këto elemente. Tipat e vlerësimit janë të shumta. Ato duhet të përdoren në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës së matematikës, strategjitë e të nxënësve dhe moshën e kërkesat e nxënësve. Për matematikë konsiderojmë se vlerësimi mund të bëhet duke marrë parasysh:

- përgjigjet me gojë;
- aktivitetin e nxënësit nga vendi;
- aktivitetin gjatë punës në grupe;
- detyrat e shtëpisë;
- testet për grup temash;
- testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;
- testet në fund të semestrit;

Në fund të vitit duhet të nxirret nota përfundimtare e cila fitohet duke marrë mesataren e vlerësimeve:

- |                                    |       |
|------------------------------------|-------|
| • vlerësimi me gojë                | 25 %  |
| • testet                           | 50 %  |
| • vlerësimi i punës në klasë       | 15 %  |
| • vlerësimi i detyrave të shtëpisë | 10 %. |

### Gjinnazi matematikë dhe informatikë

#### OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Objektivat e përgjithshme të mësimit të analizës me teori të gjasës tek nxënësit janë:

- Të kuptojë bashkësinë e numrave realë si union i bashkësisë së numrave racionalë dhe bashkësisë së numrave irracionalë dhe vetitë e numrave realë;
- Të bëjë dallimin në mes të bashkësisë së numërueshme nga ajo e panumërueshme;
- Të zbatojë vlerën absolute në zgjidhjen e detyrave të ndryshme si dhe në formësimin e kuptimit të  $\varepsilon$  – rrethinës së pikës;
- Të zbatojë induksionin matematik për të vërtetuar pohime dhe formula të ndryshme matematike;
- Të zbatojë teknologjitë për llogaritje më të ndërlikuara;
- Të thellojë kuptimet e fuqisë dhe të rrënjës;
- Të zbatojë vetitë e fuqisë e të rrënjës për faktorizimin e thjeshtimin e shprehjeve të ndryshme algjebrike e racionale algjebrike;
- Të njohë nocionin e njësisë imagjinare „ $i$ “ si dhe nocionin e numrit kompleks si dyshe e renditur numrash realë;
- Të përvetësojë paraqitjen gjeometrike të numrit kompleks;
- Të kuptojë veprimet me numra kompleksë si dhe rrënjëzimin e numrit kompleks;
- Të zbatojë numrat kompleksë në zgjidhjen e ekuacioneve të ndryshme si dhe në faktorizimin e polinomit të shkallës  $n$ ;
- Të njohë ekuacionin kuadratik dhe rastet e tij të veçanta;
- Të njohë ekuacionin bikuadratik;
- Të njohë nocionin e dallorit (diskriminantës);
- Të zbatojë rregullat e Viet-it për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në lidhje me ekuacionet kuadratike;

- Të zbatojë ekuacionet kuadratike në zgjidhje të problemeve praktike;
- Të njohë nocionin e ekuacionit dhe inekuacionit eksponencial;
- Të njohë funksionet trigonometrike  $\sin \alpha, \cos \alpha, \operatorname{tg} \alpha, \operatorname{ctg} \alpha$ ; në trekëndëshin kënddrejtë;
- Të dijë si gjenden funksionet trigonometrike të këndeve 45, 60 dhe 300;
- Të njohë trigonometrinë në trekëndëshin kënddrejtë;
- Të dijë të zbatojë njohuritë e fituara për detyra praktike;
- Të njohë kuptimin e ngjarjeve dhe hapësirën e të gjitha ngjarjeve të mundshme;
- Të kuptojë përkufizimin e probabilitetit tek ngjarjet elementare dhe ato të përbëra. Të njohë ngjarjet e varura dhe ato të pavarura;
- Të njohë nocionin e variablave të rastit, shpërndarjes, pritjes matematike (vlerës së pritur), variancës dhe devijimit standard;
- Të dijë lidhjen dhe zbatimin e statistikës me (në) lëmit tjera;
- Të kuptojë metodat dhe ecurit e hulumtimit statistikor.

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Ndërtimi i përmbajtjes është organizuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës. Kategoritë e përmbajtjes së lëndës janë dhënë në tabelën nr. 1.

**Tabela 1.**

Lënda	Kategoritë e përmbajtjes	Orët	Gjithës. orë	%	Gjithës. %
Analizë me teori të gjasës	I. Analizë	140	185	76	100
	II. Teori e gjasës me statistikë	45		24	

**PËRMBAJTJA, OBJEKTIVAT SPECIFIKE, REZULTATET E PRITURA, LIDHJA NDËRLËNDORE**

**Tabela 2.**

ANALIZË ME TEORI TË GJASËS						
Nr.	Kategoritë e përmbajtjes	Nënkategoritë e përmbajtjes	Përmbajtja	Objektivat specifike	Rezultatet e pritura	Lidhja ndërlëndore
1	Analizë	<p><b>1. Bashkësitë</b></p> <p><b>2. Pasqyrimi</b></p>	<p><b>1.1. Bashkësia:</b> bashkësia e numrave natyralë, të plotë, racionalë, irracionalë dhe realë; intervali; vlera absolute; <math>\mathcal{E}</math> -rrethina.</p> <p><b>2.1. Pasqyrimi:</b> përkufizimi dhe shembuj ilustrativ; llojet e pasqyrimeve; kompozimi i pasqyrimeve; pasqyrimi invers; numri kardinal, bashkësitë e numërueshme dhe të panumërueshme; bashkësitë ekuivalente; fuqia e kontinuumit dhe raste paradoksale.</p>	<p>1. Të përdorë pa vështirësi veprimet me bashkësi (unionin, prerjen, diferencën e prodhimin kartezian);</p> <p>2. Të kryejë pa vështirësi të gjitha veprimet me numra realë;</p> <p>3. Të zgjidhë jobarazime të ndryshme me vlerë absolute;</p> <p>4. Të gjejë funksionin invers të funksionit</p>	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë nocionin e nënbashkësisë, unionit, prerjes, ndryshimit, dhe prodhimit kartezian të bashkësive;</li> <li>- të njohë dallimin në mes të bashkësive të fundme dhe të pafundme;</li> <li>- të njohë bashkësinë e numrave realë si union i bashkësisë së numrave racional dhe bashkësisë së numrave irracional;</li> <li>- të njohë vetitë themelore të numrave realë;</li> <li>- të njohë kuptimin e vlerës absolute;</li> <li>- të kuptojë dhe zbatojë ekuivalencën e bashkësisë së</li> </ul>	<p>Kimi – llogaritja e përqindjes.</p> <p>Fizikë – llogaritja e gabimit relativ dhe atij absolut.</p> <p>Fizikë – lëvizja drejtvizore, shpejtësia.</p>

		<p><b>3. Fuqizimi dhe rrënjëzimi</b></p>	<p><b>3.1. Fuqia:</b> fuqia me eksponent numër të plotë; vetitë e fuqive.</p> <p><b>3.2. Rrënjëzimi:</b> rrënjëzimi; veprimet me rrënjë përdorimi i kalkulatorit për llogaritjen e fuqive dhe rrënjëve të numrave.</p>	<p>të dhënë si dhe të gjejë kompozimin e dy e më shumë funksioneve;</p> <p>5. Të formojë shembuj të bashkësive ekuivalente;</p> <p>6. Të dijë të thjeshtojë shprehje të ndryshme duke përdorur vetitë e fuqive dhe të rrënjëve;</p> <p>7. Të thellojë dijen për zgjidhjen e ekuacioneve dhe inekuacioneve në të cilat paraqiten shprehje me vlerë absolute;</p> <p>8. Të përdorë pa vështirësi veprimet me numra kompleksë;</p> <p>9. Të zgjidhë</p>	<p>numrave realë me boshtin numerik;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë nocionin e bashkësisë së numërueshme dhe asaj të panumërueshme;</li> <li>- të kuptojë relacionin e përfshirjes ndërmjet bashkësive të numrave;</li> <li>- të zbatojë veprimet mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim, fuqizim e rrënjëzim për zgjidhjen e ekuacioneve;</li> <li>- të zbatojë nocionin e bashkësive ekuivalente në disa shembuj karakteristik;</li> <li>- të përvetësojë vlerën absolute në zgjidhjen e detyrave të ndryshme si dhe në formësimin e kuptimit të <math>\varepsilon</math> – rrethinës së pikës;</li> <li>- të aplikojë induksionin matematik për të vërtetuar pohime dhe formula të ndryshme matematike;</li> <li>- të njohë kuptimet e fuqisë dhe të rrënjës;</li> <li>- të përvetësojnë vetitë e fuqisë e të rrënjës;</li> <li>- të lidhin kuptimin e rrënjës</li> </ul>	
		<p><b>4. Numrat kompleksë</b></p>	<p><b>4.1. Numrat kompleksë</b> Përkufizimi i numrit kompleks në formë algjebrike; Interpretimi gjeometrik i numrave kompleksë; Veprimet me numra kompleksë (mbledhja, zbritja, shumëzimi, pjesëtimi).</p>			
		<p><b>5. Ekuacionet dhe funksionet kuadratike</b></p>	<p><b>5.1. Ekuacionet kuadratike:</b> zgjidhja e ekuacionit kuadratik; diskriminanta (dallori); zgjidhja e</p>			

			<p>ekuacionit kuadratik në varëshmëri të shenjës së diskriminantës; formulat e Vietit; ekuacionet bikuadratike.</p> <p><b>5.2. Funkzioni kuadratik:</b> shqyrtimi i funksionit kuadratik <math>y = ax^2 + bx + c</math>; zerot e funksionit kuadratik; monotonia; vlerat ekstreme; shenja; grafiku varësisht nga <math>a</math>; zgjidhja e jobarizimeve të shkallës së dytë me ndihmën e shenjës së funksionit kuadratik.</p> <p><b>5.3. Ekuacionet irracionale</b></p> <p><b>6.1. Funkzioni eksponencial:</b> fuqia me eksponent irracional; funksioni eksponencial, shqyrtimi i tij (kuptimi, vetitë, grafiku); ekuacionet</p>	<p>ekuacionin kuadratik, sistemet e ekuacioneve me një ekuacion linear dhe një kuadratik si dhe sistemet e ekuacioneve kuadratike;</p> <p>10. Të paraqesë grafikisht funksionin kuadratik dhe nga grafiku të vërejë monotoninë, zerot, shenjën dhe vlerat ekstreme dhe anasjelltas;</p> <p>11. Të zgjidhë ekuacione</p>	<p>me eksponent çift dhe numrit kompleks;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbatojë vetitë e fuqisë e të rrënjës për faktorizimin e thjeshtimin e shprehjeve të ndryshme algjebrike e racionale algjebrike;</li> <li>- të njohë nocionin e njësisë imagjinare „i“;</li> <li>- të njohë nocionin e numrit kompleks si dyshe e renditur numrash realë;</li> <li>- të paraqesë gjeometrikisht numrin kompleks;</li> <li>- të njohë veprimet me numra kompleksë si dhe rrënjëzimin e numrit kompleks;</li> <li>- të zbatojë numrat kompleksë në zgjidhjen e ekuacioneve të ndryshme si dhe në faktorizimin e polinomit të shkallës <math>n</math>;</li> <li>- të njohë ekuacionin kuadratik;</li> <li>- të njohë ekuacionin bikuadratik;</li> <li>- të zbatojë nocionin e dallorit (diskriminantës);</li> <li>- të kuptojë nocionin e</li> </ul>	<p>Fizikë - hedhja e pjerrët.</p>
--	--	--	---	---	--	-----------------------------------



			eksponenciale.	irracionale;	zgjdhjes së ekuacionit kuadratik;	
			<p><b>6.2. Funkzioni logaritmik:</b> përkufizimi i logaritmit dhe vetitë ; funksioni logaritmik dhe shqyrtimi i tij (vetitë dhe grafiku); ekuacionet logaritmike; përdorimi i kalkulatorit për llogaritjen e logaritmit të numrave.</p>	<p>12. Të zgjidhë ekuacione logaritmike dhe eksponenciale;</p> <p>13. Të zbatojë funksionin eksponencial dhe atë logaritmik për interpretimin e fenomeneve nga jeta e përditshme (nataliteti, kamatat, koha e gjysmëzbërthimit të elementeve radioaktive);</p> <p>14. Të zbatojë të gjitha shkathtësitë e sipërsënuara në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga matematika dhe fushat tjera (fizikë, kimi, etj.).</p>	<p>- të kuptojë si zgjidhet ekuacioni kuadratik dhe format e tij jo të plota;</p> <p>- të kuptojë si zgjidhet ekuacioni bikuadratik;</p> <p>- të njohë zgjidhjet e ekuacionit kuadratik në varëshmëri nga diskriminanta;</p> <p>- të zbatojë rregullat e Viet-it për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në lidhje me ekuacionet kuadratike;</p> <p>- të zbatojë ekuacionet kuadratike në zgjidhje të problemeve praktike;</p> <p>- të njohë nocionin e ekuacionit dhe inekuacionit eksponencial;</p> <p>- të përvetësojë kuptimin e logaritmit, vetitë e tij dhe ekuacionet logaritmike;</p> <p>- të kuptojë zgjidhjen e ekuacionit eksponencial dhe atij logaritmik;</p> <p>- të njohë funksionet trigonometrike në trekëndëshin kënddrejtë;</p>	<p>Kimi, Fizikë – logaritmi, funksioni eksponencial;</p> <p>Biologjia – lidhja me ligjet natyrore (shumimi- rritja eksponenciale e gjallesave).</p> <p>Fizikë - lëvizjet harmonike. Astronomi - përkufizimi i pralaksës së</p>
		<p><b>7. Funksionet trigonometrike</b></p>	<p><b>7.1. Funksionet trigonometrike në trekëndëshin kënddrejtë:</b> përkufizimi i funksioneve trigonometrike: <math>\sin \alpha, \cos \alpha, \operatorname{tg} \alpha, \operatorname{ctg} \alpha</math>; identitetet themelore trigonometrike.</p>			
		<p><b>1. Kuptimet themelore të statistikës</b></p>	<p><b>1.1. Historiku i statistikës:</b> rëndësia e statistikës dhe lidhmëria me lëmit tjera; objekti i studimit; metodat statistikore dhe hulumtimi statistikor.</p>			

2	Teori e gjasës me statistikë	<p><b>2. Provat dhe vrojtimi statistikor</b></p> <p><b>3. Analiza e të dhënave</b></p>	<p><b>2.1. Përgatitja dhe programi i vrojtimit:</b> qëllimi dhe rëndësia e vrojtimit statistikor; burimet, mënyrat, mjetet dhe llojet e vrojtimit; grumbullimi dhe grupimi i të dhënave statistikore; paraqitja e të dhënave statistikore.</p> <p><b>3.1. Analiza e të dhënave me një ndryshore:</b> kuptimi, rëndësia dhe llojet; masat e tendencës qendrore (meset, mediana, modi); përkufizimi i hapësirës së ngjarjeve elementare; aksiomat e probabilitetit (gjasës); shpërndarja e probabiliteti (gjasës): shpërndarja diskrete e probabilitetit; shpërndarja uniforme e prob.; shpërndarja uniforme dhe e vazhdueshme e prob; probabiliteti i kushtëzuar; teorema e Bayes-it;</p>	<p>15. Të zbatojë funksionet trigonometrike <math>\sin \alpha</math>, <math>\cos \alpha</math>, <math>\operatorname{tg} \alpha</math>, <math>\operatorname{ctg} \alpha</math> në vërtetimin e identiteteve të ndryshme trigonometrike;</p> <p>16. Të zbatojë funksionet trigonometrike për llogaritjen e elementeve të figurave e trupave gjeometrik si dhe syprinën përkatësisht vëllimin e tyre;</p> <p>17. Të zbatojë teorinë e gjasës në zgjidhjen e problemeve praktike në matematikë, informatikë, teori të lojërave, teknikë, etj;</p> <p>18. T'i klasifikojë ngjarjet shumë pak të mundshme dhe ato realisht të</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbatojë funksionet trigonometrike për vërtetimin e identiteteve të ndryshme trigonometrike si dhe për llogaritjen e elementeve të figurave e trupave gjeometrike si dhe syprinën, përkatësisht vëllimin e tyre.</li> <li>- të njohë kuptimin e ngjarjeve dhe llojet e tyre;</li> <li>- të kuptojë përkufizimin klasik të probabilitetit me anë të frekuencës relative;</li> <li>- të kuptojë nocionin e variablave të rastit, disa karakteristika numerike të tyre si dhe nocionin e shpërndarjes.</li> <li>- të kuptojë paraqitjen grafike të shpërndarjes;</li> <li>- të njohë disa shpërndarje të rëndësishme;</li> <li>- të kuptojë ngjarjet e pavarura dhe ngjarjet e kushtëzuara;</li> <li>- të kuptojë dhe zbatojë prirjen matematike;</li> <li>- të njohë nocionet: variancë, devijim standard dhe korrelacion ;</li> <li>- të dijë lidhjen e statistikës me lëmit tjera;</li> <li>- kuptojë metodat dhe ecurit e hulumtimeve statistikore</li> <li>- të njohë ecurinë e grumbullimit</li> </ul>	<p>një trupi në hapësirë dhe njehsimi i distancave të trupave në hapësirë nga Toka</p> <p>Mjekësi, biologji, ekonomi, gjeografi, kimi, edukate fizike, shkenca shoqërore, shkenca kompjuterike, teknikë etj.</p>
---	------------------------------	--	--	---	--	--

			ndryshoret diskrete dhe ato të rastit; vlera e pritur (pritja matematike) e ndryshoreve të rastit; varianca dhe devijimi standard.	mundshme; 19. Të zbatojë statistikën për grumbullimin, përpunimin dhe aranzhimin e të dhënave nga problemet praktike; 20. Të dhënat t'i paraqesë në trajtë tabelare dhe grafike; 21. T'i lexojë pa vështirësi të dhënat nga grafikone të ndryshëm.	të të dhënave; - të njohë mënyrën e dizajnit dhe përdorimit të fletëve të mbajtjes së shënimeve; - të njohë grupimin e shënimeve dhe grumbullimin e tyre duke përdorë metoda të ndryshme; - të kuptojë dizajnimin dhe përdorimin e tabelave të ndryshme për shënimet e grupuara; - të jetë në gjendje të llogarisë dhe rangojë të dhënat; - të jetë në gjendje të prezentojë të dhënat në vizatime dhe diagrame; - të jetë në gjendje të bëjë interpretimin dhe diskutimin e shënimeve; - të afrojë shënimet e përmbledhura ndaj pyetjeve të inkuara ; - të nxjerrë përfundime nga paraqitja e diagrameve; - të përdorë fjalorin statistikor (terminologjinë); - të jetë në gjendje të krahasojë shënimet eksperimentale me ato teorike; - të dijë të diskutojë implikimin dhe gjetshmerinë në kontekst të problemit.	
--	--	--	--	---	--	--

**Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë****OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME**

Objektivat e përgjithshme të mësimit të algjebërës me gjeometri tek nxënësit janë:

- Të thellojë kuptimet: gjykim, bashkësi, relacion, pasqyrim dhe veprim binar si dhe të përvetësojë operacionet me bashkësi dhe veprime logjike;
- Të njihet me kuptimin e grupit si strukturë algjebrike;
- Të kuptojë bashkësinë e numrave realë si union i bashkësisë së numrave racional dhe bashkësisë së numrave irracional dhe vetitë e numrave realë;
- Të kuptojë nocionet themelore gjeometrike dhe grupet e aksioma-ve;
- Të kuptojë pozitën reciproke të objekteve gjeometrike në hapësirë;
- Të zbatojë praktikisht kuptimet dhe pohimet themelore të gjeometrisë në vërtetimin e teoremave dhe në detyra konstruktive;
- Të njohë kuptimin e izometrisë;
- Të zbatojë izometrinë si metodë në detyra konstruktive;
- Të njohë trigonometrinë në trekëndëshin kënddrejtë;
- Të njohë poliedrat dhe trupat rrotullues;
- Të dijë si gjenden formulat për syprinë dhe vëllim dhe t'i zbatojë ato;
- Të zbatojë njohuritë gjeometrike (teorema e Pitagorës, formulat e ndryshme trigonometrike, etj) në zgjidhjen e detyrave më të ndërlikuara;
- Të dijë të zbatojë njohuritë e fituara për detyra praktike.

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Ndërtimi i përmbajtjes është organizuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës. Kategoritë e përmbajtjes së lëndës janë dhënë në tabelën nr. 1.

**Tabela 1.**

Lëndët	Kategoritë e përmbajtjes	Orët	Gjithës. orë	%	Gjithës. %
Algjebër me gjeometri	I. Algjebër	51	111	46	100
	II. Gjeometri	60		54	

**PËRMBAJTJA, OBJEKTIVAT SPECIFIKE, REZULTATET E PRITURA, LIDHJA NDËRLËNDORE**

**Tabela 2.**

<b>ALGJEBËR ME GJEOMETRI</b>						
<b>Nr.</b>	<b>Kategoritë e përmbajtjes</b>	<b>Nënkategoritë e përmbajtjes</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Objektivat specifike</b>	<b>Rezultatet e pritura</b>	<b>Lidhja ndërlëndore</b>
<b>1.</b>	<b>Algjebër</b>	<b>1. Logjika matematike dhe bashkësitë</b>	<p><b>1.1. Gjykimet:</b> veprimet me gjykime; formulat e gjykimeve; tautologjitë dhe formulat identikisht të sakta; kuantifikatorët.</p> <p><b>1.2. Bashkësitë:</b> bashkësia dhe nënbashkësia; veprimet me bashkësi; bashkësia partitive; bashkësitë e fundme dhe bashkësitë e pafundme; induksioni matematik; kombinatorika; formula e binomit – caktimi i koeficientëve me trekëndëshin e Paskalit. bashkësitë e numrueshme dhe bashkësitë e panumrueshme.</p> <p><b>1.3. Relacionet:</b> përkufizimi i relacionit; vetitë</p>	<p>1. Të përdorë pa vështirësi veprimet logjike dhe veprimet me bashkësi;</p> <p>2. Të zbatojë në detyra të ndryshme elementet e kombinatorikës;</p> <p>3. Të përdorë pa vështirësi vetitë e relacioneve;</p> <p>4. Të aplikojë teorinë e grupeve për zgjidhjen e detyrave të ndryshme.</p> <p>5. Të përdorë</p>	<p>Zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive të nxënësit për të njohur, përvetësuar, thelluar dhe zbatuar: - kuptimet: gjykim, bashkësi, relacion, pasqyrim, veprim binar; -veprimet logjike „dhe”, „ose”, „në qoftë se, atëherë”, „atëherë dhe vetëm atëherë“, „jo”, dhe kuantifikatorët „ekziston” dhe „për çdo“; -vetitë e veprimeve binare dhe kuptimin e grupit si strukturë algjebrike; - përdorimin e simboleve logjike;  - kuptimet themelore gjeometrike;</p>	<p>Informatikë – llogaritja e shumës së numrave të dhënë në sistemin binar</p>

	2. Gjeometria dhe matja	1. Kuptimet themelore dhe pesë grupet e aksiomave	<p>e relacioneve; relacioni i ekuivalencës dhe relacioni i renditjes.</p> <p><b>1.4. Veprimet binare:</b> vetitë e veprimeve binare; kuptimi i elementit njësi; kuptimi i elementit inverz; kuptimi i grupit.</p> <p><b>1.1. Aksiomat e incidencës dhe rrjedhimet themelore të tyre</b></p> <p><b>1.2. Aksiomat e renditjes. Segmenti</b></p> <p><b>1.3. Aksiomat e vazhdueshmërisë dhe kongruencës. Rregullat e kongruencës së dy trekëndëshave</b></p> <p><b>1.4. Aksioma e paraleleve dhe disa rrjedhime të saj</b></p> <p><b>1.5. Segmenti i orientuar, kuptimi i vektorit dhe veprimet: mbledhje, zbritje dhe shumëzim i vektorit me skalar</b></p>	<p>drejtë veglat gjeometrike për vizatimin e figurave gjeometrike;</p> <p>6. Të zbatojë ndërtimin aksiomatik të gjeometrisë për vërtetimin e rezultateve në gjeometri;</p> <p>7. Të zbatojë aksiomat dhe rezultatet në zgjidhjen e detyrave konstruktive;</p> <p>8. Të përdorë izometritë për zgjidhjen e detyrave të ndryshme konstruktive dhe atyre me zbatim;</p> <p>9. Të përdorë</p>	<p>- izometritë dhe llojet e tyre;</p> <p>-konstruktimin e figurave plane kur jepen elementet e nevojshme (trekëndësh, katërkëndësh, rreth, etj.);</p> <p>- të dalloj elementet e tepërta ose të varura në</p> <p>- pozitën reciproke të figurave gjeometrike në rrafsh dhe hapësirë;</p> <p>- poliedrat dhe trupat rrotullues;</p> <p>- llogaritjen e syprinës së sipërfaqeve dhe vëllimit të trupave.</p>	
--	-------------------------	---	--	---	---	--

		<p><b>2.Transformimet gjeometrike</b></p> <p><b>3.Stereometria.</b></p>	<p><b>2.1. Simetria boshtore</b></p> <p><b>2.2. Rotacioni</b></p> <p><b>2.3. Translacioni</b></p> <p><b>2.4. Simetria qendrore</b></p> <p><b>2.5. Zbatimi i transformimeve izometrike</b></p> <p><b>2.7. Transformimet e ngjashmërisë. Homotetia</b></p> <p><b>3.1. Poliedrat:</b> diedri; qoshja; prizmi (parimi i Kavalierit, syprina dhe vëllimi); piramida (syprina dhe vëllimi); trangu i piramidës (piramida e cinguar) (syprina dhe vëllimi);</p> <p><b>3.2. Trupat rrotullues:</b> sipërfaqet cilindrike dhe konike; cilindri (syprina dhe vëllimi); koni (syprina dhe vëllimi); trangu i konit (koni i cinguar) (syprina dhe vëllimi); sfera (syprina dhe vëllimi i rruzullit dhe i pjesëve të tij)</p>	<p>formulat për llogaritjen e vëllimit të disa trupave si dhe syprinën e kontureve (sipërfaqeve kufizuese) të tyre;</p> <p>10. Të përdorë teoremën e Pitagores dhe formula të ndryshme trigonometrike për zgjidhjen e detyrave numerike;</p>		<p>Fizikë- madhësitë vektoriale (rruga, shpejtësia, nxitimi, forca, momenti i forcës, etj.).</p> <p>Astronomi-llogaritja e laresave të ndryshme.</p> <p>Fizikë-kondenzatorët pllakëzorë, cilindrik dhe ata sferik.</p> <p>Kimi -molekulat, kristalet</p>
--	--	---	--	--	--	--



**Gjimnazi i Përgjithshëm  
Gjimnazi Shkencat e Natyrës****OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME**

Objektivat e përgjithshme të mësimit të matematikës tek nxënësit janë:

- Të thellojë kuptimet: gjykim, bashkësi, relacion, pasqyrim dhe veprim binar si dhe të përvetësojë operacionet me bashkësi dhe veprime logjike;
- Të kuptojë dallimin në mes të bashkësive të fundme dhe të pafundme;
- Të kuptojë bashkësinë e numrave realë si union i bashkësisë së numrave racionalë dhe bashkësisë së numrave irracionalë dhe vetitë e numrave realë;
- Të zbatojë vlerën absolute në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;
- Të zbatojë induksionin matematik për të vërtetuar pohime dhe formula të ndryshme matematike;
- Të thellojë kuptimet e fuqisë dhe të rrënjës;
- Të zbatojë vetitë e fuqisë e të rrënjës për faktorizimin e thjeshtimin e shprehjeve të ndryshme algjebrike e racionale algjebrike;
- Të njohë nocionin e njësisë imagjinare „ $i$ “ si dhe nocionin e numrit kompleks si dyshe e renditur numrash realë;
- Të kuptojë veprimet me numra kompleks si dhe rrënjëzimin e numrit kompleks;
- Të zbatojë numrat kompleks në zgjidhjen e ekuacioneve të ndryshme si dhe në faktorizimin e polinomit të shkallës  $n$ ;
- Të njohë ekuacionin kuadratik dhe rastet e tij të veçanta;
- Të njohë ekuacionin bikuadratik;
- Të njohë nocionin e dallorit (diskriminantës);
- Të zbatojë rregullat e Viet-it për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në lidhje me ekuacionet kuadratike;
- Të zbatojë ekuacionet kuadratike në zgjidhje të problemeve praktike;

- Të njohë trigonometrinë në trekëndëshin kënddrejtë;
- Të njohë poliedrat dhe trupat rrotullues;
- Të përdorë formulat për syprinë e vëllim dhe t'i zbatojë ato;
- Të zbatojë njohuritë gjeometrike (teorema e Pitagorës, formulat e ndryshme trigonometrike, etj) në zgjidhjen e detyrave më të ndërlikuara;
- Të dijë t'i zbatojë njohuritë e fituara për zgjidhjen e detyrave praktike;
- Të dijë lidhjen dhe zbatimin e statistikës me (në) lëmit tjera;
- Të kuptojë metodat dhe ecurit e hulumtimit statistikor.

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Ndërtimi i përmbajtjes është organizuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës. Ai përfshin tri kategori mësimore kryesore të paraqitura në tabelën në vijim:

**Tabela 1. Organizimi i përmbajtjes së lëndës**

Nr.	Kategoritë mësimore	Orë mësimore	%
1	ARITMETIKA DHE ALGJEBRA	87	78.37 %
2	GJEOMETRIA DHE MATJET	8	7.21 %
3	STATISTIKA DHE PROBABILITETI	16	14.42 %
	Numri i përgjithshëm i orëve	111	100 %

Këto tërësi edhe pse të paraqitura si të ndara, nuk janë të izoluar. Ato duhet parë dhe mësuar si njësi të ndërlidhura, ku të kuptuarit e një tërsie varet dhe mbështetet nga idetë dhe konceptet e tërësisë tjetër. Kështu, nxënësve iu nevojiten njohuritë për numrat për të kryer matjet, kurse konceptet gjeometrike u janë të domosdoshme për paraqitjen e të dhënave.

**PËRMBAJTJA, OBJEKTIVAT SPECIFIKE,  
REZULTATET E PRITURA DHE LIDHJA NDËRLËNDORE**

**Tabela 2.**

1. ARITMETIKA DHE ALGJEBRA					
Nr.	Nënkategoritë e përmbajtjes	Përmbajtja	Objektivat specifikë	Rezultatet e pritura	Lidhja ndërlëndore
1.	<b>Logjika matematike dhe bashkësitë</b>	<p><b>1.3. Gjykimet:</b> veprimet me gjykime; formulat e gjykimeve; tautologjitë dhe formulat identikisht të sakta; kuantifikatorët.</p> <p><b>1.4. Bashkësitë:</b> bashkësia dhe nënbashkësia; veprimet me bashkësi; prodhimi kartezian (direkt) i bashkësive; bashkësia partitive; kombinatorika (permutacionet, kombinacionet dhe variacionet).</p> <p><b>1.3. Relacionet:</b> përkufizimi i relacionit;veprimet me</p>	<p>1. Të përdorë pa vështirësi veprimet logjike dhe veprimet me bashkësi;</p> <p>2. Të kryejë pa vështirësi të gjitha veprimet me numra realë;</p> <p>3. Të thellojë dijen për zgjidhjen e ekuacioneve dhe inekuacioneve në të cilat paraqiten shprehje me vlerë absolute;</p> <p>4. Të kryejë pa vështirësi veprimet me polinome.</p> <p>5. Të gjejë shmvp dhe pmp të polinomeve.</p> <p>6. Të thjeshtojë shprehjet</p>	<p>Nxënësi duhet:</p> <p>-të njohë kuptimet: gjykim, bashkësi, relacion, pasqyrim,veprim binar;</p> <p>-të kuptojë veprimet logjike „dhe”, „ose”, „në qoftë se, atëherë”, „atëherë dhe vetëm atëherë“, „jo”,dhe kuantifikatorët „ ekziston” dhe „për çdo“;</p> <p>-të kuptojë nocionin e nënbashkësisë, unionit, prerjes, ndryshimit, prodhimit kartezian të bashkësive dhe bashkësisë partitive;</p> <p>-të kuptojë vetitë e veprimeve binare dhe kuptimin e grupit si strukturë algjebrike;</p> <p>-të zbatojë përdorimin e simboleve logjike;</p> <p>-të njohë bashkësinë e numrave realë, si union i bashkësisë së numrave racionalë dhe bashkësisë së numrave irracionale;</p>	<p>Informatikë - mbledhja e numrave në sistemin binarë.</p>

	<p>relacione; vetitë e relacioneve; relacioni i ekuivalencës dhe relacioni i renditjes.</p> <p><b>1.5. Pasqyrimi:</b> përkufizimi dhe shembuj ilustrativ; llojet e pasqyrimeve; kompozimi i pasqyrimeve; pasqyrimi invers.</p> <p><b>1.6. Veprimet binare:</b> vetitë e veprimeve binare; kuptimi i elementit njësi.</p> <p><b>1.6. Bashkësia e numrave realë:</b> bashkësia e numrave natyralë, të plotë, racionalë; bashkësia e numrave irracionalë; bashkësia e numrave realë (intervali, vlera absolute); induksioni matematik; formula e binomit – caktimi i koeficienteve me anë të trekëndëshit të Paskalit.</p>	<p>racionale algjebrike.</p> <p>7. Të paraqesë grafikisht funksionin kuadratik dhe nga grafiku të vërejtë monotoninë, zerot, shenjën dhe vlerat ekstreme dhe anasjelltas;</p> <p>8. Të zgjidhë ekuacionin kuadratik, sistemet e ekuacioneve me një ekuacion linear dhe një kuadratik si dhe sistemet e ekuacioneve kuadratike;</p> <p>9. Të zgjidhë ekuacione irracionale;</p> <p>10. Të zgjidhë ekuacione logaritmike dhe eksponenciale;</p> <p>11. Të zbatojë të gjitha shkathtësitë e sipërsënuara në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga matematika dhe fushat tjera (fizikë, kimi, astronomi, etj);</p>	<p>-të njohë vetitë themelore të numrave realë;</p> <p>-të njohë kuptimin e vlerës absolute;</p> <p>-të kuptojë relacionin e përfshirjes ndërmjet bashkësive të numrave;</p> <p>-të përvetësojë vlerën absolute në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;</p> <p>-të aplikojë induksionin matematik për të vërtetuar pohime dhe formula të ndryshme matematike;</p> <p>-të njohë kuptimin e fuqisë dhe të rrënjës;</p> <p>-të përvetësojnë vetitë e fuqisë e të rrënjës;</p> <p>-të lidhin kuptimin e rrënjës me eksponent çift dhe numrit kompleks;</p> <p>-të njohë nocionin e njësisë imagjinare „<math>i</math>“;</p> <p>-të njohë nocionin e numrit kompleks si dyshe e renditur numrash realë;</p> <p>-të paraqes gjeometrikisht numrin kompleks;</p> <p>-të njohë veprimet me numra kompleks;</p> <p>-të njohë ekuacionin kuadratik;</p> <p>-të njohë ekuacionin bikuadratik;</p> <p>-të zbatojë nocionin e dallorit (diskriminantës);</p> <p>-të kuptojë nocionin e zgjidhjes së</p>	<p>Fizikë – lëvizja drejtvizore, shpejtësia.</p> <p>Kimi – llogaritja e përqindjes.</p> <p>Fizikë – llogaritja e gabimit relativ dhe atij absolut.</p>
--	---	---	---	--

2.	<b>Fuqizimi dhe rrënjëzimi</b>	<p><b>2.1. Fuqia:</b> fuqia me eksponent numër të plotë; vetitë e fuqive;</p> <p><b>2.2. Rrënjëzimi:</b> rrënjëzimi; veprimet me rrënjë përdorimi i kalkulatorit për llogaritjen e fuqive dhe rrënjëve të numrave</p>	<p>12. Të zbatojë funksionet trigonometrike <math>\sin \alpha, \cos \alpha, \operatorname{tg} \alpha, \operatorname{ctg} \alpha</math>; në vërtetimin e identiteteve të ndryshme trigonometrike.</p> <p>13. Të zbatojë funksionet trigonometrike për llogaritjen e elementeve të figurave e trupave gjeometrik si dhe syprinën përkatësisht vëllimin e tyre.</p>	<p>ekuacionit kuadratik; -të kuptojë si zgjidhet ekuacioni kuadratik dhe format e tij jo të plota; -të kuptojë si zgjidhet ekuacioni bikuadratik; -të njohë zgjidhjet e ekuacionit kuadratik në varëshmëri nga diskriminanta; -të zbatojë rregullat e Viet-it për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në lidhje me ekuacionet kuadratike; -të zbatojë ekuacionet kuadratike në zgjidhje të problemeve praktike; -të njohë funksionet trigonometrike në trekëndëshin kënddrejtë.</p>	
3.	<b>Numrat kompleks</b>	<p><b>3.1. Numrat kompleks:</b> përkufizimi i numrit kompleks në formë algjebrike; interpretimi gjeometrik i numrave kompleksë; veprimet me numra kompleksë (mbledhja, zbritja, shumëzimi, pjesëtimi).</p>			
4.	<b>Ekuacionet dhe funksionet kuadratike</b>	<p><b>4.1. Ekuacionet kuadratike:</b> zgjidhja e ekuacionit kuadratik; diskriminanta; zgjidhja e ekuacionit kuadratik në varëshmëri shenjës së diskriminantës;</p>			Fizikë: hudhja e pjerrët.

5.	Funksionet trigonometrike	<p>formulat e Vietit; ekuacionet bikuadratike.</p> <p><b>4.2. Funksioni kuadratik:</b> shqyrtimi i funksionit kuadratik <math>y = ax^2 + bx + c</math> ; zerot e funksionit kuadratik ; monotonia; vlerat ekstreme; shenja; grafiku varësisht nga <math>a</math>; ekuacionet irracionale;</p> <p><b>5.1. Funksionet trigonometrike në trekëndëshin kënddrejtë:</b> përkufizimi i funksioneve trigonometrike: <math>\sin \alpha</math>, <math>\cos \alpha</math>, <math>\operatorname{tg} \alpha</math>, <math>\operatorname{ctg} \alpha</math> identitetet themelore trigonometrike.</p>			
<b>2. GJEOMETRIA DHE MATJA</b>					
1.	Matjet në gjeometri	1.2. Llogaritja e syprinave të disa figurave të rrafshëta (trekëndëshi, drejtkëndëshi, rrethi) dhe vëllimit të disa trupave gjeometrikë (prizmës, piramidës, cilindrit, konit dhe sferës).	1. Të përdorë formulat për llogaritjen e syprinave të disa figurave të rrafshëta dhe vëllimit të disa trupave gjeometrikë.	Zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive të nxënësit për të zbatuar formulat për syprinë dhe vëllim.	

3. STATISTIKA DHE PROBABILITETI					
1.	<b>Kuptimet themelore të statistikës</b>	<b>1.1. Historiku i statistikës:</b> rëndësia e statistikës dhe lidhshmëria me lëmit tjera; objekti i studimit; metodat statistikore dhe hulumtimi statistikor.	1. Të zbatojë statistikën për grumbullimin, përpunimin dhe sistematizimin e të dhënave nga problemet praktike. 2.. Të dhënat t'i paraqesë në trajtë tabelare dhe grafike.	-të kuptojë metodat dhe ecurit e hulumtimeve statistikore; -të njohë ecurinë e grumbullimit të të dhënave; -të njohë mënyrën e dizajnit dhe përdorimit të fletëve të mbajtjes së shënimeve; -të njohë grupimin e shënimeve dhe grumbullimin e tyre duke përdorur metoda të ndryshme; -të kuptojë dizajnimin dhe përdorimin e tabelave të ndryshme për shënimet e grupuara; -të jetë në gjendje të prezantojë të dhënat në vizatime dhe diagrame;	
2.	<b>Provat dhe vrojtimi statistikor</b>	<b>2.1. Përgatitja dhe programi i vrojtimit:</b> qëllimi dhe rëndësia e vrojtimit statistikor; burimet, mënyrat, mjetet dhe llojet e vrojtimit; grumbullimi dhe grupimi i të dhënave statistikore; paraqitja e të dhënave statistikore.	5. T'i lexojë të dhënat nga grafikonë të ndryshëm.	-të afrojë shënimet e përmbledhura ndaj pyetjeve të inicuar; -të nxjerrë përfundime nga paraqitja e diagrameve; -të përdorë fjalorin statistikor.	
3.	<b>Analiza e të dhënave</b>	<b>3.1. Analiza e të dhënave me një ndryshore:</b> kuptimi, rëndësia dhe llojet e analizave; masat e tendencës qendrore (mesi, mediana, moda).			

**Gjimnazi Shkencat Shoqërore****OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME**

Objektivat e përgjithshme të mësimit të matematikës tek nxënësit janë:

- Të thellojë kuptimet: gjykim, bashkësi si dhe të përvetësojë operacionet me bashkësi dhe veprime logjike;
- Të kuptojë bashkësinë e numrave realë si union i bashkësisë së numrave racionalë dhe bashkësisë së numrave irracionalë dhe vetitë e numrave realë;
- Të zbatojë vlerën absolute në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;
- Të thellojë kuptimet e fuqisë dhe të rrënjës;
- Të njohë nocionin e njësisë imagjinare „ $i$ “ si dhe nocionin e numrit kompleks;
- Të kuptojë veprimet me numra kompleks ;
- Të njohë ekuacionin kuadratik dhe rastet e tij të veçanta;
- Të njohë nocionin e dallorit (diskriminantës);
- Të zbatojë rregullat e Viet-it për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në lidhje me ekuacionet kuadratike;
- Të njohë funksionet trigonometrike në trekëndëshin kënddrejtë;
- Të dijë të zbatojë formulat për syprinë e vëllim;
- Të dijë lidhjen dhe zbatimin e statistikës me (në) lëmenjtë tjerë;
- Të kuptojë metodat dhe ecurit e hulumtimit statistikor.

**ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS**

Ndërtimi i përmbajtjes është organizuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës. Ai përfshinë tri kategori mësimore kryesore të paraqitura në tabelën në vijim:



**Tabela 1. Organizimi i përmbajtjes së lëndës**

<b>Nr.</b>	<b>Kategoritë mësimore</b>	<b>Orë mësimore</b>	<b>%</b>
1	ARITMETIKA DHE ALGJEBRA	50	67.56 %
2	GJEOMETRIA DHE MATJET	8	10.81 %
3	STATISTIKA DHE PROBABILITETI	16	21.63 %
	Numri i përgjithshëm i orëve	74	100 %

Këto tërësi edhe pse të paraqitura si të ndara, nuk janë të izoluara. Ato duhet parë dhe mësuar si njësi të ndërlidhura, ku të kuptuarit e një tërësie varet dhe mbështetet nga idetë dhe konceptet e tërësisë tjetër. Kështu, nxënësve u nevojiten njohuritë për numrat për të kryer matjet, kurse konceptet gjeometrike u janë të domosdoshme për paraqitjen e të dhënave.

**PËRMBAJTJA, OBJEKTIVAT SPECIFIKE,  
REZULTATET E PRITURA DHE LIDHJA NDËRLËNDORE**

<b>1. ARITMETIKA DHE ALGJEBRA</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Nënkategoritë e përmbajtjes</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Objektivat specifikë</b>	<b>Rezultatet e pritura</b>	<b>Lidhja ndërlëndore</b>
<b>1.</b>	<b>Logjika matematike dhe bashkësitë</b>	<p><b>1.1. Gjykimet:</b> veprimet me gjykime; formulat e gjykimeve; tautologjitë dhe formulat identikisht të sakta; kuantifikatorët.</p> <p><b>1.2. Bashkësitë:</b> bashkësia dhe nënbashkësia; veprimet me bashkësi; bashkësia partitive; bashkësia e numrave realë (veprimet dhe vetitë e tyre; intervalet, vlera absolute); kombinatorika (permutacionet, kombinacionet dhe variacionet).</p>	<p>1. Të përdorë veprimet logjike dhe veprimet me bashkësi;</p> <p>2. Të kryejë të gjitha veprimet me numra realë;</p> <p>3. Të kryejë veprimet me fuqi dhe rrënjë;</p>	<p>Nxënësi duhet: -të njohë kuptimet: gjykim, bashkësi; -të kuptojë veprimet logjike „dhe”, „ose”, „në qoftë se, atëherë”, „atëherë dhe vetëm atëherë”, „jo”, dhe kuantifikatorët „ ekziston” dhe „për çdo“;</p> <p>-të kuptojë nocionin e nënbashkësisë, unionit, prerjes, ndryshimit dhe bashkësisë partitive;</p> <p>-të zbatojë përdorimin e simboleve logjike;</p> <p>-të njohë bashkësinë e numrave realë, si union i bashkësisë së numrave racional dhe bashkësisë së numrave irracionale;</p> <p>-të njohë vetitë themelore të numrave realë;</p> <p>-të njohë kuptimin e vlerës absolute;</p>	Informatikë - mbledhja e numrave në sistemin binarë.
<b>2.</b>	<b>Fuqizimi dhe rrënjëzimi</b>	<p><b>2.1. Fuqia:</b> fuqia me eksponent numër të plotë; vetitë e fuqive.</p>	<p>4. Të kryejë veprimet (mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim) me numra kompleksë;</p>		

3.	<b>Numrat kompleks</b>	<p><b>2.2. Rrënjëzimi:</b> rrënjëzimi dhe veprimet me rrënjë.</p> <p><b>3.1. Numrat kompleksë:</b> përkufizimi i numrit kompleks në formë algebrike; interpretimi gjeometrik i numrave kompleksë; veprimet me numra kompleksë (mbledhja, zbritja, shumëzimi, pjesëtimi).</p>		<p>-të përvetësojë vlerën absolute në zgjidhjen e detyrave të ndryshme; -të njohë kuptimin e fuqisë dhe të rrënjës; -të përvetësojë vetitë e fuqisë e të rrënjës; -të njohë nocionin e njësisë imagjinare „i“; -të njohë nocionin e numrit kompleks; -të njohë veprimet me numra kompleksë; -të njohë ekuacionin kuadratik; -të kuptojë nocionin e zgjidhjes së ekuacionit kuadratik; -të zbatojë nocionin e dallorit (diskriminantës); -të dijë të zgjidhë ekuacionet kuadratike dhe format e tij jo të plota;</p>	<p>Fizikë – lëvizja drejtvizore, shpejtësia.</p>
4.	<b>Ekuacionet dhe funksionet kuadratike</b>	<p><b>4.1. Ekuacionet kuadratike:</b> zgjidhja e ekuacionit kuadratik; diskriminanta; zgjidhja e ekuacionit kuadratik në varshmëri të shenjës së diskriminantës; formulat e Vietit.</p> <p><b>4.2. Funksioni kuadratik:</b> shqyrtimi i funksionit kuadratik <math>y = ax^2 + bx + c</math> dhe për rastet e veçanta zero të funksionit kuadratik; monotonia; vlerat</p>	<p>5. Të paraqesë grafikisht funksionin kuadratik dhe nga grafiku të vërejë monotoninë, zerot, shenjën dhe vlerat ekstreme;</p> <p>Të zbatojë funksionet trigonometrike në vërtetimin e identiteteve</p>	<p>-të njohë dhe zbatojë funksionet trigonometrike në trekëndëshin kënddrejtë.</p>	<p>Kimi – llogaritja e përqindjes.</p> <p>Fizikë – llogaritja e gabimit relativ dhe atij absolut.</p> <p>Fizikë - hedhja e pjerrët.</p> <p>Biologji – lidhja me ligjet natyrore (shumimi eksponencial i gjallesave).</p>

5.	<b>Trigonometria</b>	ekstreme; shenja; grafiku varësisht nga $a$ .	themelore trigonometrike.		
<b>2. GJEOMETRIA DHE MATJA</b>					
1.	<b>Matjet në gjeometri</b>	1.2. Llogaritja e syprinave të disa figurave të rrafshëta (trekëndëshi, drejtkëndëshi, rrethi) dhe vëllimit të disa trupave gjeometrikë (prizmës, piramidës, cilindrit, konit dhe sferës).	1. Të përdorë formulat për llogaritjen e syprinave të disa figurave të rrafshëta dhe vëllimit të disa trupave gjeometrikë.	Zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive të nxënësit për të zbatuar formulat për syprinë dhe vëllim.	
<b>3. STATISTIKA DHE PROBABILITETI</b>					
1.	<b>Kuptimet themelore të statistikës</b>	<b>1.1. Historiku i statistikës:</b> rëndësia e statistikës dhe lidhmëria me lëmenjtë tjerë; objekti i studimit; metodat statistikore dhe hulumtimi statistikor.	1. Të zbatojë statistikën për grumbullimin, përpunimin dhe sistematizimin e të dhënave nga problemet praktike. 2.. Të dhënat t'i paraqesë në trajtë tabelare dhe grafike.	-të njohë kuptimin e ngjarjeve dhe llojet e tyre; -të kuptojë nocionin e variablave të rastit, -të dijë lidhjen e statistikës me lëmenjtë tjerë; -të kuptojë metodat dhe ecuritë e hulumtimeve statistikore; -të njohë ecurinë e grumbullimit të të dhënave; -të njohë mënyrën e dizajnit dhe përdorimit të fletëve të mbajtjes së shënimeve;	
2.	<b>Provat dhe vrojtimi statistikor</b>	<b>2.1. Përgatitja dhe programi i vrojtim:</b> qëllimi dhe rëndësia e vrojtimit statistikor;			

3.	<b>Analiza e të dhënave</b>	burimet, mënyrat , mjetet dhe llojet e vrojtimit; grumbullimi dhe grupimi i të dhënave statistikore; paraqitja e të dhënave statistikore.  <b>3.1. Analiza e të dhënave me një ndryshore:</b> kuptimi, rëndësia dhe llojet e analizave; masat e tendencës qendrore (mesi, mediana, moda).	5. T'i lexojë të dhënat nga grafikone të ndryshëm.	-të njohë grupimin e shënimeve dhe grumbullimin e tyre duke përdorur metoda të ndryshme; -të kuptojë dizajnimin dhe përdorimin e tabelave të ndryshme për shënimet e grupuara; -të jetë në gjendje të prezentojë të dhënat në vizatime dhe diagrame; -të jetë në gjendje të bëjë interpretimin dhe diskutimin e shënimeve; -të afrojë shënimet e përmbledhura ndaj pyetjeve të inicuar ; -të nxjerrë përfundime nga paraqitja e diagrameve; -të përdorë fjalorin statistikor.	
----	-----------------------------	---	--	---	--

**Gjimnazi i gjuhëve****OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME**

Objektivat e përgjithshme të mësimit të matematikës tek nxënësit janë:

- Të thellojë kuptimet: gjykim, bashkësi si dhe të përvetësojë operacionet me bashkësi dhe veprime logjike;
- Të kuptojë bashkësinë e numrave realë, si union i bashkësisë së numrave racionalë dhe bashkësisë së numrave irracionalë dhe vetitë e numrave realë;
- Të zbatojë vlerën absolute në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;
- Të thellojë kuptimet e fuqisë dhe të rrënjës;
- Të njohë nocionin e njësisë imagjinare „i“ si dhe nocionin e numrit kompleks;
- Të kuptojë veprimet me numra kompleks ;
- Të njohë ekuacionin kuadratik dhe rastet e tij të veçanta;
- Të njohë nocionin e dallorit (diskriminantës);
- Të zbatojë rregullat e Viet-it për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në lidhje me ekuacionet kuadratike;
- Të dijë të zbatojë formulat për syprinë e vëllim;
- Të dijë lidhjen dhe zbatimin e statistikës me (në) lëmit tjera;
- Të kuptojë metodat dhe ecuritë e hulumtimit statistikor.

**ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS**

Ndërtimi i përmbajtjes është organizuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës. Ai përfshinë tri kategori mësimore kryesore të paraqitura në tabelën në vijim:

**Tabela 1. Organizimi i përmbajtjes së lëndës**

<b>Nr.</b>	<b>Kategoritë mësimore</b>	<b>Orë mësimore</b>	<b>%</b>
1	ARITMETIKA DHE ALGJEBRA	50	67.56 %
2	GJEOMETRIA DHE MATJET	8	10.81 %
3	STATISTIKA DHE PROBABILITETI	16	21.63 %
	Numri i përgjithshëm i orëve	74	100 %

Këto tërësi edhe pse të paraqitura si të ndara, nuk janë të izoluara. Ato duhet parë dhe mësuar si njësi të ndërlidhura ku të kuptuarit e një tërësie varet dhe mbështetet nga idetë dhe konceptet e tërësisë tjetër. Kështu, nxënësve u nevojiten njohuritë për numrat për të kryer matjet, kurse konceptet gjeometrike u janë të domosdoshme për paraqitjen e të dhënave.

**PËRMBAJTJA, OBJEKTIVAT SPECIFIKE,  
REZULTATET E PRITURA DHE LIDHJA NDËRLËNDORE**

**Tabela 2**

1. ARITMETIKA DHE ALGJEBRA					
Nr.	Nënkategoritë e përmbajtjes	Përmbajtja	Objektivat specifike	Rezultatet e pritura	Lidhja ndërlëndore
1.	<b>Logjika matematike dhe bashkësitë</b>	<p><b>1.1. Gjykimet:</b> veprimet me gjykime; formulat e gjykimeve; tautologjitë dhe formulat identikisht të sakta; kuantifikatorët.</p> <p><b>1.2. Bashkësitë:</b> bashkësia dhe nënbashkësia; veprimet me bashkësi; bashkësia partitive; bashkësia e numrave realë(veprimet dhe vetitë e tyre; intervalet, vlera absolute); kombinatorika (permutacionet, kombinacionet dhe variacionet).</p>	<p>1. Të përdorë veprimet logjike dhe veprimet me bashkësi;</p> <p>2. Të kryejë të gjitha veprimet me numra realë;</p> <p>3. Të kryejë veprimet me fuqi dhe rrënjë;</p> <p>4. Të kryejë veprimet (mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim) me numra kompleksë;</p>	<p>Nxënësi duhet: -të njohë kuptimet: gjykim, bashkësi; -të kuptojë veprimet logjike „dhe”, „ose”, „në qoftë se, atëherë”, „atëherë dhe vetëm atëherë“, „jo”, dhe kuantifikatorët „ ekziston” dhe „për çdo“; -të kuptojë nocionin e nënbashkësisë, unionit, prerjes, ndryshimit dhe bashkësisë partitive; -të zbatojë përdorimin e simboleve logjike; -të njohë bashkësinë e numrave realë si union i bashkësisë së numrave racional dhe bashkësisë së numrave irracionalë;</p>	Informatikë - mbledhja e numrave në sistemin binarë.



2.	<b>Fuqizimi dhe rrënjëzimi</b>	<p><b>2.1. Fuqia:</b> fuqia me eksponent numër të plotë; vetitë e fuqive.</p> <p><b>2.2. Rrënjëzimi:</b> rrënjëzimi dhe veprimet me rrënjë.</p>		<p>-të njohë vetitë themelore të numrave realë; -të njohë kuptimin e vlerës absolute; -të përvetësojë vlerën absolute në zgjidhjen e detyrave të ndryshme; -të njohë kuptimin e fuqisë dhe të rrënjës; -të përvetësojë vetitë e fuqisë e të rrënjës;</p>	Fizikë – lëvizja drejtvizore, shpejtësia
3.	<b>Numrat kompleks</b>	<p><b>3.1. Numrat kompleksë:</b> përkufizimi i numrit kompleks në formë algjebrike; interpretimi gjeometrik i numrave kompleksë; veprimet me numra kompleksë (mbledhja, zbritja, shumëzimi, pjesëtimi).</p>		<p>-të njohë nocionin e njësisë imagjinare „<math>i</math>“; -të njohë nocionin e numrit kompleks; -të njohë veprimet me numra kompleksë; -të njohë ekuacionin kuadratik; -të kuptojë nocionin e zgjidhjes së ekuacionit kuadratik;</p>	Kimi – llogaritja e përqindjes
4.	<b>Ekuacionet dhe funksionet kuadratike</b>	<p><b>4.1. Ekuacionet kuadratike:</b> zgjidhja e ekuacionit kuadratik; diskriminanta; zgjidhja e ekuacionit kuadratik në varshmëri të shenjës së diskriminantës; formulat e Vietit.</p> <p><b>4.2. Funksioni kuadratik:</b> shqyrtimi i funksionit</p>	5. Të paraqesë grafikisht funksionin kuadratik dhe nga grafiku të vërejë monotoninë, zerot, shenjën dhe vlerat ekstreme;	<p>-të njohë nocionin e dallorit (diskriminantës); -të dijë të zgjidhë ekuacionet kuadratike dhe format e tij jo të plota; -të njohë dhe të zbatojë kuptimin e progresionit aritmetik dhe atij gjeometrik.</p>	Fizikë – llogaritja e gabimit relativ dhe atij absolut  Fizikë - hedhja e pjerrët  Biologji – lidhja me ligjet natyrore (shumimi eksponencial i gjallesave)

5.	Progresionet	kuadratik $y = ax^2 + bx + c$ dhe për rastet e veçanta zerot e funksionit kuadratik; monotonia; vlerat ekstreme; shenja; grafiku varësisht nga $a$ .  <b>5.1. Progresioni aritmetik</b> <b>5.2. Progresioni gjeometrik</b>			
<b>2. GJEOMETRIA DHE MATJA</b>					
1.	Matjet në gjeometri	<b>1.2. Llogaritja e syprinave të disa figurave të rrafshëta (trekëndëshi, drejtkën- dëshi, rrethi) dhe vëllimit të disa trupave gjeometrikë (prizmës, piramidës, cilindrit, konit dhe sferës).</b>	1. Të përdorë formulat për llogaritjen e syprinave të disa figurave të rrafshëta dhe vëllimit të disa trupave gjeometrikë.	Zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive të nxënësit për të zbatuar formulat për syprinë dhe vëllim.	
<b>3. STATISTIKA DHE PROBABILITETI</b>					
1.	<b>Kuptimet themelore të statistikës</b>	<b>1.1. Historiku i statistikës:</b> rëndësia e statistikës dhe lidhshmëria me lëmenjtë tjerë; objekti i studimit; metodat statistikore dhe hulumtimi statistikor.	1. Të zbatojë statistikën për grumbullimin, përpunimin dhe sistematizimin e të dhënave nga problemet praktike. 2.. Të dhënat t'i paraqesë	-të njohë kuptimin e ngjarjeve dhe llojet e tyre; -të kuptojë nocionin e variablave të rastit, -të dijë lidhjen e statistikës me lëmenjtë tjerë; -të kuptojë metodat dhe ecurit e hulumtimeve statistikore;	

2.	<b>Provat dhe vrojtimi statistikor</b>	<b>2.1. Përgatitja dhe programi i vrojtimit:</b> qëllimi dhe rëndësia e vrojtimit statistikor; burimet, mënyrat, mjetet dhe llojet e vrojtimit; grumbullimi dhe grupimi i të dhënave statistikore; paraqitja e të dhënave statistikore.	në trajtë tabelare dhe grafike.  5. T'i lexojë të dhënat nga grafikone të ndryshëm.	-të njohë ecurinë e grumbullimit të të dhënave; -të njohë mënyrën e dizajnit dhe përdorimit të fletëve të mbajtjes së shënimeve; -të njohë grupimin e shënimeve dhe grumbullimin e tyre duke përdorur metoda të ndryshme; -të kuptojë dizajnin dhe përdorimin e tabelave të ndryshme për shënimet e grupuara; -të jetë në gjendje të prezentojë të dhënat në vizatime dhe diagrame; -të jetë në gjendje të bëjë interpretimin dhe diskutimin e shënimeve; -të afrojë shënimet e përmbledhura ndaj pyetjeve të inicuar ; -të nxjerrë përfundime nga paraqitja e diagrameve; -të përdorë fjalorin statistikor	
3.	<b>Analiza e të dhënave</b>	<b>3.1. Analiza e të dhënave me një ndryshore:</b> kuptimi, rëndësia dhe llojet e analizave; masat e tendencës qendrore (mesi, mediana, moda).			

## LITERATURA

1. *Dr. Ejup Hamiti, dr. Emrush Gashi, dr. Eshref Ademaj*, **MATEMATIKA** me përmbledhje detyrash për klasën e parë gjimnaz;
2. *Dr. Muharrem Berisha, dr. Dervish Kamberi, dr. Rexhep Gjergji, dr. Ramadan Zejnullahu*, **PËRMBLEDHJE DETYRASH NGA MATEMATIKA**, për klasën e parë të shkollave të mesme;
3. *Dr. Muharrem Berisha, dr. Halil Turku, dr. Marjan Demaj*, **MATEMATIKA** për klasën e dytë gjimnaz;
4. *Dr. Islam Shehu, Sejdi Bilalli, Mustafë Kadriu*, **PËRMBLEDHJE DETYRASH TË ZGJIDHURA NGA MATEMATIKA 2**, për klasën e dytë të shkollave të mesme.
5. Përshtatur nga *Dr. Qamil Haxhibeqiri*, **PROBABILITETI DHE STATISTIKA MATEMATIKE**

---

## **BIOLOGJI**

---

Hyrja, qëllimet, objektiva e përgjithshëm, disa porosi për arsimtarin, metodologjia, tekstet dhe mjetet mësimore dhe vlerësimi janë të përbashkëta për të gjitha tipet e gjimnazeve.

### **HYRJE**

Zhvillimi i programit mësimor të lëndës së biologjisë është ndërtuar mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënësve, metodat dhe instrumentet e vlerësimit.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor kemi nisur nga parimi se nxënësia nuk d.m.th. të marrësh më shumë informata, por të zgjerosh aftësinë për të prodhuar më shumë rezultate që vërtet dëshirojmë.

Përmbajtja interesante e programit mësimor të biologjisë dhe qasja e propozuar e punës i kontribuon që të nxënësi të zhvillohen aftësitë kognitive, të menduarit kritik dhe abstrakt.

Puna në grupe, puna eksperimentale, brainstormingu, kërkimi shkencor etj., i ndihmojnë begatimit të botës emocionale të nxënësit dhe zhvillojnë tek ai prirje për aplikim dhe ndërlidhje të njohurive me botën reale, me çka hapen dyert për orientim të ardhshëm profesional në lëmin e mjekësisë, të veterinarisë, të bujqësisë, të pylltarisë etj.

Ky program është përqendruar më tepër në atë se çfarë dhe cilat lloje të rezultateve duhet t'i arrijë nxënësi dhe çka duhet të punojë mësimdhënësi, me nxënësin në qendër. Në vend të dhënies së informatave, të kultivohen shprehjet për gjetjen, kërkimin e pavarur të burimeve të informatave me punë të pavarur nga ana e vet nxënësit. Si agjent i ndryshimeve në mësim, arsimtari i udhëzon nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, të vrojtojnë, të masin, të klasifikojnë, të formojnë modele, të shtrojnë hipoteza, të zgjidhin probleme, të aftësohen për përdorim të drejtë dhe të

sigurt të veglërisë dhe instrumenteve në laboratorët biologjike, të dizajnojnë eksperimentin, të incizojnë dhe të paraqesin të dhënat etj.

Me fjalë tjera, mësimi i biologjisë duhet ta pajisë nxënësin me njohuri të cilat mund t'i zbatojë në mjedisin ku jeton, kështu ai transformon vetveten dhe shoqërinë.

## **QËLLIMET**

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën X është vazhdimësi e programit mësimor të kësaj lënde nga shkolla mesme e ulët dhe, si i tillë, konsiston në konsolidimin e njohurive paraprake, në thellimin e diturive të nxëna dhe në zhvillimin e shkathtësive, vlerave dhe të qëndrimeve. Andaj, mbi këtë bazë njohurish dhe pretendimesh, programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën X i siguron nxënësit synimin e zhvillimit të mëtejshëm:

- zhvillimi dhe thellimi i njohurive mbi nocionet dhe ligjësitë biologjike në tërësi dhe botën e gjallë në veçanti
- për aftësi dhe shprehje komunikimi duke përdorur gjuhë të thjeshtë shkencore për interpretim të ideve, fenomeneve dhe të proceseve jetësore
- për zhvillimin e shprehive për punë në grupe dhe në ekipe punuese, ndjenjës së shoqërizimit dhe të vetive të tjera pozitive të personalitetit të domosdoshme për bashkëpunim konstruktiv në zgjidhjen e detyrave të parashtruara
- që përmes mësimi eksperimental, vrojtues, matës dhe analizues të zhvillojnë aftësitë krijuese, të menduarit analitik, vlerësimin objektiv ndaj vetvetes dhe grupit gjatë punës ekipore
- që të jenë të aftë që me punën e tyre kreative të zbulojnë mënyrën e lidhjes së avancimeve teknologjike me idetë shkencore
- që përmes të punës së tyre kreative të marrin në konsideratë fuqinë e fakteve shkencore në aspekt të çështjes industriale, etike dhe ambientore
- për zotërim të punës në përdorimin e pajisjeve të nevojshme për vrojtim dhe matje si të domosdoshme për të ardhur deri të informatat shkencore
- për zotërim të evidencës përmes diagramit, tabelave, skicave etj.
- që përmes korrelacionit me shkencat e tjera t'u bëjë të mundur nxënësve formimin e parafytyrimeve të plota mbi natyrën, jetën

dhe dukuritë e ndërlidhura duke nënkuptuar unitetin në mes të botës organike dhe asaj joorganike

- që të kenë aftësi dhe shkathtësi për t'u përgjigjur në pyetjet që parashtrihen gjatë punës kërkimore: “Si?” , “Pse?” , “Çka do të ndodhte nëse ...?”

## **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

Në përputhje me qëllimet e Programit mësimor të klasës së dhjetë për lëndën e biologjisë, programi mësimor i kësaj lënde synon që në fund të vitit mësimor nxënësi t'i arrijë këta objektiva të përgjithshëm:

- që mësimet teorike të gërshetohen me metodat e vërtetimit direkt në laborator, eksperiment ose në terren
- që nxënësit të fitojnë aktivisht njohuri dhe në sajë të kërkimeve dhe zbulimeve të kuptojnë ndërlidhjen e jetës me natyrën sipas parimit spiral
- nga informacionet e shumta që marrin nxënësit zbulojnë thelbin e problemit, dhe zbatojnë të menduarit kritik në radhitjen e të dhënave dhe informacioneve
- mësohen të analizojnë, të përgjithësojnë të dhënat, ndërlidhin biologjinë me shkencat e tjera natyrore dhe shoqërore
- të zhvillojë njohuri për larminë e botës së gjallë
- të zhvillojë shkathtësi dhe motivojë nxënësit për mobilizim të inteligjencës psikomotorike për të manovruar me aparatet dhe instrumentet në laboratorin e biologjisë .
- të zhvillojë shkathtësi për të konsultuar literaturën përkatëse për të mbledhur informacione në mënyrë të pavarur.
- të vlerësojë ndërlidhshmërinë e fenomeneve dhe të proceseve jetësore
- të kuptojë varshmërinë reciproke ndërmjet qenieve të gjalla
- të njohë termat, kuptimet, veprimet dhe ligjshmëritë nga lëmi i biologjisë
- të zhvillojë aftësitë për vërtetim dhe shkathtësitë për hulumtim të sigurt
- të zhvillojë qëndrim përgjegjës ndaj natyrës dhe mjedisit dhe të zgjojë interes tek ai për mbrojtjen efektive të saj .

**Gjimnazi – Shkencat e Natyrës****ORGANIZMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS**

Përmbajtja e lëndës është organizuar në theksimet e tërësive kryesore apo thelbësore të lëndës së biologjisë, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përgjithshëm të lëndës së biologjisë për klasën X.

Organizmi i përmbajtjes përfshin: ndërtimin, balancimin dhe mbarështrimin.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin tetë tërësi - tema mësimore, me anë të të cilave përfshihet fundamenti i lëndës. Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara sipas tërësive mësimore, temave mësimore

<b>Nr.</b>	<b>Tërësitë mësimore</b>	<b>Orë mësimi</b>	<b>%</b>
1	Biologjia e qelizës	7	7.7
2	Biosistematika – kategoritë sistematike	5	5.5
3	Bakteriet, algat blu në të gelbër	10	11.0
4	Algat eukariote, kërpudhat, likenet, myshqet	13	14.4
5	Fiernat, bimët me lule – spermatofitet	29	32.1
6	Shtazët njëqelizore – parashitorët	4	4.4
7	Grupet më të rëndësishme të avvertebrorëve	25	27.7
8	Punë praktike në laborator dhe terren	15	16.6
9	Orë në dispozicion	3	3.3
10	Numri i përgjithshëm i orëve	111	100 %

Mbarështrimi i përmbajtjes së lëndës në klasë behët për jo më pak se 111 orë mësimi sipas kësaj forme:

- **Temat mësimore**
- **Përmbajtja programore**
- **Rezultatet e pritura**
- **Ndërlidhja**



Tërësia mësimore: BIOLOGJIA E QELIZËS

### **Objektivat specifikë**

#### **Nxënësi duhet:**

- të kuptojë kriteret që merren për klasifikimin e biologjisë në disiplinë
- të radhitë pozitën e biologjisë në sistemin e shkencave natyrore dhe shoqërore
- të përshkruajë metodat e kërkimit shkencor në citologji dhe të zbatojë në praktikë metodën e mikroskopisë, të fiksimit, të ngjyrosjes
- të hulumtojë ndërtimin dhe të përshkruajë funksionin e qelizës
- të analizoj si mirëmbahet mjedisi i brendshëm i qelizës (homeostaza)
- të parashikojë se çka ndodh me qelizën nëse çrregullohet apo humb funksioni i ndonjë organeli, p.sh. plastideve, mitokondrive
- të ketë qëndrim kritik për shkaqet, pasojat dhe manifestimet e ndryshimeve degjenerative në qelizë (kanceri, testi mikronukleus etj).

### **Përmbajtja programore**

- Qeniet e gjalla janë të ndërtuara nga njësia elementare e jetës – qeliza
- Për hulumtimin e qelizës përdoren metodat citologjike: mikroskopike (fiksimi, ngjyrosja), citokimike, citofiziologjike, mikrokirurgjike, e kulturës së qelizave dhe indeve etj.
- Përbërja kimike e qelizës (uji, mat. minerale, glucidet, lipoidet, proteinat, ac. nukleike) dhe veçoritë fiziko-kimike (osmoza, difuzioni, dializa) dhe roli i tyre në funksionin e qelizës.
- Strukturat qelizore (mitokondriet, ribosomet, plastidet, membrana plazmatike, bërthama etj.) kanë ndërtim të veçantë dhe kryejnë funksione të ndryshme.
- Ekzistojnë qeliza pa bërthamë të diferencuar dhe qeliza me bërthamë (prokariote dhe eukariote).
- Shkaqet e ndryshimeve më të shpeshta degjenerative në qelizë janë të shumta, kurse pasojat për organizëm të mëdha.

## **Rezultatet e pritura**

Nxënësit në fund të kl.X nga kjo tërësi mësimore:

- definojnë termin biologji dhe kuptojnë ndarjen e biologjisë sipas problemit dhe lëndës së studimit
- analizojnë pozitën e biologjisë në sistemin e shkencave natyrore dhe shoqërore
- njohin funksionin e infrastrukturave qelizore
- kuptojnë unitetin e botës së gjallë dhe jo të gjallë nëpërmjet njohjes së përbërjes kimike të qelizës dhe veçorive fiziko-kimike të saj,
- kuptojnë rëndësinë e biologjisë në jetën e përditshme
- dinë për disa filozofë natyralistë (Shëani, Shllajdeni etj)
- zbatojnë teknikat laboratorike në bazë të punës vetanake
- analizojnë formën dhe funksionin e qelizës,
- dallojnë qelizën prokariote prej asaj eukariote
- kuptojnë dallimin ndërmjet qelizës bimore dhe shtazore
- dallojnë membranën qelizore nga muri qelizor,
- dinë për ndërtimin e bërthamës, kuptojnë rolin e saj dhe funksionin e kromozomeve
- zbatojnë metodat për studimin e qelizës
- kuptojnë rëndësinë e ujit për qelizë
- analizojnë ndërtimin e membranës, kuptojnë transportin transmembranor, të materieve me osmozë, difuzion, transport aktiv, endo dhe ekzocitozë
- dallojnë plazmolizën nga deplazmoliza dhe kuptojnë rëndësinë e turgorit

## **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje:

- me kiminë; në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të qelizës
- me fizikën, në aspektin e njohjes së ligjshmërive fizike që manifestohen në qelizë

Tërësia mësimore:  
BIOSISTEMATIKA, KATEGORITË SISTEMATIKE

### **Objektivat specifikë**

#### **Nxënësit duhet :**

- të njohin parimet e biosistematikës
- të kuptojnë metodat që aplikohen në biosistematikë
- të përshkruajnë raportin e sistematikës me shkencat e tjera.
- të jenë në gjendje të dallojnë kategorinë sistematike (p.sh. mbretërinë) prej njësisë taksonomike (p.sh. llojin)
- të bëjnë klasifikim shkencor të gjallesave dhe të radhisin njësitë taksonomike nga poshtë lart, duke filluar nga njësia elementare – lloji,.
- të dinë për kontributin e Lineut në zhvillimin e sistematikës
- të zbatojnë udhëzimet për përdorimin e çelësave për determinim praktik, në shembullin e determinimit të kërpudhave, myshqeve, fiernave dhe të bimëve me farë.
- të dinë se bota e gjallë është ndarë në pesë mbretëri.

### **Përmbajtja programore**

- Biosistematika - definimi
- Metodat e biosistematikës, çelësat për determinim në biosistematikë
- Nomenklatura binominale e Lineut
- Kategoritë sistematike
- Klasifikimi i botës së gjallë në pesë mbretëri : 1.Monera.2.Protista. 3.Fungi 4.Plantae, 5. Animalia
- Biosistematika dhe shkencat aplikative

### **Rezultatet e pritura**

#### **Nxënësit në fund të klasës X:**

- njohin sistemin natyror të klasifikimit, përcaktojnë njësitë sistematike,
- emërtojnë kategoritë dhe njësitë sistematike, si: lloji, gjinia, familja, rendi, klasa, tipi, mbretëria,
- kuptojnë se krahas metodës analitike, morfologjike, paleontologjike, embriologjike, në sistematikë përdoren edhe metoda të tjera,

si metoda serologjike, biokimike, fiziologjike, hibridologjike, biomatematike etj.

- aftësohen të klasifikojnë disa lloje të kërpudhave, algjeve dhe bimëve me farë në mjedisin ku ato jetojnë, duke përdorur çelësa të thjeshtë të përcaktimit në klasifikim
- kuptojnë se të dhënat e biosistematikës i shfrytëzojnë shkencat aplikative, si mjekësia, veterina, farmacia, bujqësia, pylltaria etj. (p.sh. luftimi i sëmundjes me farmakopreparate është më efikas nëse dihet lloji i bakteries që e shkakton atë).
- zbatojnë njohuritë e biosistematikës në jetën e përditshme (dallojnë p.sh. kërpudhat helmuese në mjedisin ku jetojnë)
- dinë për kriteret e klasifikimit, kuptojnë domosdoshmërinë e klasifikimit të gjallesave me një gjuhë të vetme në sistematikë, gjuha latine

### **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje

- me anatominë, në aspektin e njohjes së ndërtimit të gjallesave
- me paleontologjinë, gjeologjinë, gjenetikën, biokiminë, ekologjinë, embriologjinë etj.

Tërësia mësimore: BAKTERET, ALGAT BLU NË TË GJELBËR

### **Objektivat specifikë**

**Nxënësit duhet:**

- të zhvillojnë njohuri për formën, ndërtimin, madhësinë, shumëzimin, larushinë dhe përhapjen e gjallesave pa bërthamë të diferencuar qelizore
- të analizojnë karakteristikat e përgjithshme të monereve dhe rëndësinë e baktereve në natyrë dhe ekonominë e njeriut
- të krahasojnë “ bërthamën” e viruseve me bërthamën e vërtetë të qelizës
- të kuptojnë pse viruset emërtohen si forma acelulare të jetës
- të përshkruajnë disa viroza bimore, shtazore dhe te njeriu
- të emërtojnë disa sëmundje që shkaktojnë bakteret te bimët, kafshët dhe njeriu.
- të kuptojnë se organizmat më të vjetër foto-autotrof janë algat blu në të gjelbër

### **Përmbajtja programore**

- Format acelulare të jetës - viruset dhe viroidet .Forma, madhësia, ndërtimi, shumëzimi, virozat
- Organizmat pa bërthamë qelizore të diferencuar .Bakteret, forma, madhësia, ndërtimi i qelizës, përhapja, shumimi dhe roli i tyre në natyrë
- Bakteret në shërbim të njeriut (bioteknologjia)
- Bakteret fotoautotrofe, kemotrofe, saprofite, parazite dhe simbiotike. Bakteret aerobe dhe anaerobe. Sëmundjet që shkaktojnë bakteret. Mykoplazmat.
- Organizmat më të vjetër fotoautotrofë pa bërthamë qelizore të diferencuar-algat blu në të gjelbër

### **Rezultatet e pritura**

#### **Në fund të klasës X nga kjo tërësi mësimore nxënësi:**

- **kupton** pse viruset emërtohen si forma acelulare të jetës dhe përshkruan disa viroza
- **di** për ndërtimin bimor dhe shtazor të “bërthamës së viruseve”
- **krahason** mënyrën e shumëzimit të qelizës dhe të virusit
- **kupton** si fitohet imuniteti në rast të përsëritjes së disa virozave
- **dallon** mykoplazmat prej viruseve
- **di** se bakteret dhe algjet Cyanophyceae grupohen në organizma prokariotë
- **kupton** se disa baktere jetojnë në kushte aerobe, kurse të tjerat në kushte anaerobe, analizon mënyrën e të ushqyerit të baktereve autotrofe dhe heterotrofe (saprofite, parazite, simbiotike)
- **vlerëson** rolin e baktereve në qarkullimin e materieve në natyrë dhe në ekonominë e njeriut (bioteknologjia)
- **emërton** disa sëmundje bakteriale të njeriut dhe kafshët.
- **sqaron shkaqet** e shfaqjes së “lulesës ujore”
- **kupton** dhe është në gjendje të përgatisë substratet ushqyese për baktere
- **zbaton** shkathtësitë në teknikën e vërtimit mikroskopik të baktereve të kultivuara në substrate ushqyese natyrore apo artificiale, ose baktereve të marra me rrëmojëse nga dhëmbët
- **zbaton** njohuritë nga mikrobiologjia për preventivë kundër sëmundjeve virale dhe bakteriale,
- **zhvillon** rrjetë mendimesh për dobitë dhe dëmet që mikroorganizmat i sjellin njeriut dhe ekonomisë së tij.

## **Ndërlidhja**

### **Përmbajtja e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje :**

- me sistematikën - në kuptim të njohjes dhe emërimit të llojeve të baktereve patogjene dhe dobiprurëse
- me bioteknologjinë - në kuptim të shfrytëzimit të baktereve në bujqësi, në industrinë ushqimore, në farmaci, në energjetikë, në mbrojtje të mjedisit
- me imunologjinë - në kuptim të njohjes së mekanizmave mbrojtës të organizmit ndaj mikrogjallesave patogjene.

Tërësia mësimore:

ALGAT EUKARIOTE, KËRPUDHAT, LIKENET, MYSHQET

### **Objektivat specifikë**

#### **Nxënësit duhet :**

- të njohin ndërtimin, mënyrën e të ushqyerit dhe përhapjen e algave eukariote, kërpudhave dhe likeneve në natyrë
- të përshkruajnë dhe të klasifikojnë disa lloje të algave
- të njohin kërpudhat dhe të dinë se ato paraqesin grup të veçante të bimëve, prandaj kategorizohen në mbretëri të veçantë
- të kuptojnë rolin e kërpudhave në natyrë dhe jetën e njeriut
- të aftësohen të klasifikojnë disa lloje kërpudhash dhe të identifikojnë kërpudhat helmuese dhe kërpudhat me vlerë ushqyese për njeriun
- të njohin dhe të përshkruajnë kërpudhat më të përhapura në mjedisin ku jetojnë
- të kuptojnë se likenet (Mycophycophyta) janë simbiozë e algave dhe e kërpudhave dhe se likenet janë të afërta me kërpudhat,
- të përdorin likenet si bioindikatore të ndotjes së mjedisit,
- të analizojnë ndërtimin e gametofitit dhe të sporofitit të myshqeve
- të kuptojnë ciklin e zhvillimit të bimëve jovasculare

### **Përmbajtja programore**

- Algat e kuqe, silikate, të murrme, algat e gjelbra, ndërtimi, shumëzimi, përhapja në natyrë
- Roli i algave në natyrë dhe në ekonominë e njeriut

- Kërpudhat, ndërtimi, mënyra e të ushqyerit, përhapja, shumëzimi, klasifikimi
- Roli i kërpudhave në natyrë dhe ekonominë e njeriut
- Bashkëjetesa midis kërpudhave dhe algave - likenet
- Myshqet, ndërtimi i gametofitit dhe sporofitit të myshqet

### **Rezultatet e pritura**

#### **Në fund të kësaj përmbajtjeje mësimore nxënësit:**

- kuptojnë ndërtimin e talusit të algave eukariote, kërpudhave, likeneve si dhe ndërtimin e gametofitit dhe sporofitit të myshqet
- dinë të përshkruajnë mënyrën e të ushqyerit dhe analizojnë variantet e shumëzimit të algave eukariote, kërpudhave, likeneve dhe myshqeve
- dinë si klasifikohen dhe në çka bazohet klasifikimi i algave, kërpudhave, likeneve dhe myshqeve
- kuptojnë se likenet janë simbiozë e kërpudhave dhe algave
- ndërlidhin rolin e bimëve jovaskulare në natyrë dhe ekonominë e njeriut
- dinë se trupi i kërpudhës është një micel i përbërë nga hifet
- kuptojnë pse kërpudhat numërohen si mbretëri e veçantë e botës së gjallë
- dinë për vështirësitë, por edhe përparësitë që u siguron bimëve jeta në tokë
- zbatojnë përdorimin e likeneve si biomonitorë të ndotjes së ajrit
- dallojnë hifet, michelet dhe sporanget (me mikroskop) të myku i bukës së mykur
- fitojnë shkathtësi e vlera dhe marrin qëndrim gjatë punës në laborator e terren në pajtim me standardet (serioziteti, kujdesi, saktësia, durimi, puna sistematike etj.)

### **Ndërlidhja**

Përmbajtja e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje:

- me ekologjinë - në kuptim të njohjes së përhapjes së bimëve jovaskulare në planet,
- me farmacinë - përdorimi i bimëve jovaskulare për prodhimin e antibiotikëve
- me paleontologjinë - në kuptim të njohjes së filogjenisë së bimëve jovaskulare.

- Me biosistematikën - në kuptim të klasifikimit dhe të emërimit shkencor të bimëve jovaskulare.

Tërësia mësimore:

FIERNAT, BIMËT ME LULE OSE FARË (SPERMATOPHYTA)

### **Objektivat specifikë**

**Nxënësit duhet:**

- të përcaktojnë karakteristikat e përgjithshme të grupeve të mëdha të bimëve vaskulare nëpërmjet përfaqësuesve tipikë
- të dallojnë përfaqësuesit e farëzhveshurave nga përfaqësuesit e farëveshurave,
- të dallojnë përfaqësuesit e bimëve njëthelbore nga bimët dythelbore
- të kuptojnë ndërtimin, përhapjen dhe ciklin e zhvillimit të fiernave dhe të spermatofiteve
- të njihen me ndërtimin, simetrinë dhe diagramin e lules,
- të dallojnë llojet e ndryshme të fryteve
- sqarojnë ndërlidhjen e shtazëve dhe bimëve gjatë përhapjes së frytave
- të kuptojnë shkaqet e ndarjes së farëveshurave në njëthelbore dhe dythelbore
- të dinë të determinojnë bimët vaskulare përmes çelësave të thjeshtë për determinim
- të ndërlidhin përvojat nga klasat e mëparshme në një tërësi

### **Përmbajtja programore**

- Fiernat si bimë të larta
- Ndërtimi, përhapja dhe cikli i zhvillimit të fiernave në shembullin e Polipodiun vulgare
- Fiernat izospore dhe heterospore
- Karakteristikat e përgjithshme bimëve spermatofite
- Farëzhveshurat (Coniferophytina dhe Cycadophytina. Fam. Pineaceae, Cupresaceae dhe Taxaceae)
- Farëfshehurat (Magnoliophytina).
- Dikotiledonet. Fam. Rosaceae, Prunoideae, Maloideae, Fabaceae Lamiaceae, Brasicaceae, Salanaceae, Asteraceae



- Monokotiledonet. Fam. Liliaceae. Fam. Poaceae-Graminae.
- Cikli i zhvillimit të farëzhveshurave në shembullin e pishës së bardhë (*Pinus silvestris*) dhe të farëveshurave në shembullin e...
- Lulja, ndërtimi, simetria, formula dhe diagrami i lules
- Polenizimi, frytnimi, fara, fryti, ndarja e fryteve
- Punë laboratorike. Ndërtimi anatomik i gjethit (i misrit, i vosh-trës), kërcellit (i blirit, i misrit), i rrënjës (i qepës, i kungullit), formula e lules dhe lulesat

## Rezultatet e pritura

### Nxënësit:

- kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet në ciklin e zhvillimit të myshqeve dhe të fiernave
- kuptojnë pse fiernat u përkasin bimëve të larta
- analizojnë ciklin e zhvillimit të fiernave, të farëzhveshurave dhe farëveshurave
- identifikojnë dallimet thelbësore sa i përket ndërtimit të lules së bimëve farëzhveshura dhe farëveshura.
- analizojnë veçoritë në bazë të së cilave dallohen bimët monokotiledone dhe dikotiledone dhe klasifikojnë disa prej tyre deri në nivel të familjes
- kuptojnë si formohet fryti dhe dallojnë llojet e fryteve
- përmendin disa lloje bimore sipas vlerave përdoruese
- kuptojnë rëndësinë e frytnimit artificial për fisnikërimin e bimëve
- dallojnë ndërtimin e organeve vegetative (p.sh. kërcellit) të bimëve njëthelbore dhe dythelbore
- kuptojnë se në ciklin e zhvillimit të spermatofiteve haset ndërrimi i gjeneratave, por me pak përjashtime uji nuk është i nevojshëm
- dinë se sporofiti i bimëve me farë është i ndarë në organe vegetative (kërcell, rrënjë dhe gjeth)
- definojnë termat polenizim, frytnim, farë, fryt
- krahasojnë se cilave qeliza të ciklit të zhvillimit të fiernave i përgjigjen kokërrzat e polenit,
- emërtojnë disa fierna të vdekur dhe kuptojnë shkaqet e zhdukjes së tyre

## **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje:

- me anatominë, morfologjinë, fiziologjinë, biokiminë, gjenetikën , në kuptim të ndihmës që i japin këto disiplina botanikës për të kuptuar proceset jetësore dhe për të klasifikuar llojet bimore
- me ekologjinë, në kuptim të njohjes së përhapjes së bimëve në Tokë në planin vertikal dhe horizontal
- me mjekësinë, pylltarinë, bujqësinë, në kuptim të njohjes së bimëve mjekësore, bimëve më rëndësi ushqimore, ekonomike etj.
- me bionikën, bioarkitekturën, aplikimi i modelit të organizimit trupor të bimës në ndërtimtari

Tërësia mësimore:

**SHTAZËT NJËQELIZORE - PARASHTAZORËT**

## **Objektivat specifikë**

Nxënësi duhet:

- të kuptojë specifitetin e organizimit qelizor të parashtazorëve
- të njohë funksionin e organeleve qelizore
- të analizojë format e shumëzimit të parashtazorëve
- të kuptojë mënyrën e jetës së parashtazorëve dhe larushinë e llojeve të tyre
- të emërtojë disa parashtazorë
- të dallojë llojet që shkaktojnë sëmundje te njeriu

## **Përmbajtja programore**

- Organizmi trupor i parashtazorëve - qeliza
- Krahasimi i funksionit të organeleve qelizore me organet e organizmave të lartë
- Mënyra e të ushqyerit; heterotrofe, autorofe
- Lëvizja e parashtazorëve; ciliet, kërbacet, pseudopodet
- Shumimi; seksual dhe aseksual
- Format parazite
- Klasifikimi

## Rezultatet e pritura

### Nxënësi:

- kupton se parashtazorët janë organizma njëqelizorë që jetojnë kryesisht në ujëra të ëmbla
- krahason funksionin e organeleve qelizore; citostomit me gojën, vakuolës kontraktile me veshkat, cilieve, flageleve dhe pseudopodeve me organet për lëvizje të kurrizorëve
- di se numri më i madh i parashtazorëve është heterotrof (ushqehen me baktere, alge njëqelizore), por ka edhe lloje autorofe
- di se krahas formave të lëvizshme, ekzistojnë edhe forma koloniale
- përshkruan se si kryhet shumëzimi aseksual dhe seksual i parashtazorëve
- emërton llojet që shkaktojnë sëmundje të njeriut (Triponosoma, Plasmodium)
- përshkruan si shfaqet sëmundja e malarisë
- di se parashtazorët përfshijnë një numër të madh të llojeve që janë grupuar në katër klasë: Sarcodina, Flagelata, Sporozoa dhe Ciliophora.

### Ndërlidhja

Kjo temë ndërlidhet me sistematikën, ekologjinë, citologjinë, parazitologjinë etj.

Tërësia mësimore:

GRUPET MË TË RËNDËSISHME TË AVERTEBRORËVE

### Objektivat specifikë

Nxënësi duhet:

- **të dijë** për karakteristikat e përgjithshme dhe organizimin trupor të grupeve kryesore të avertebrorëve
- **të kuptojë** format e shumëzimit të grupeve kryesore të avertebrorëve
- të njohë veçoritë e klasave kryesore të avertebrorëve
- **të zbatojë** parimet e biosistematikës në klasifikimin e insekteve

- të njohë grupet e dobishme dhe të dëmshme të avertebrorëve për njeriun dhe ekonominë e tij
- të ketë **qëndrim etik, përgjegjës dhe respekt** ndaj botës së gjallë

### **Përmbajtja programore**

- Pasqyrë e përgjithshme e organizmit trupor, përhapjes, shumëzimit, të klasifikimit të grupeve më të rëndësishme të avertebrorëve
- Shpuzorëve(Spongia)
- Krimbave të shtypur
- Skrrajave cilindrike
- Skrrajave unazore
- Nyjorëve
- Molusqeve
- Gjemborëve
- Grupet më pak të njohura të avertebrorëve (si Bryozoa, Rotatoria etj.)

### **Rezultatet e pritura**

#### **Nxënësi :**

- **di** për veçoritë themelore të organizimit trupor të shpuzorëve, grykorëve, krimbave të shtypur, skrrajave cilindrike dhe unazore, nyjorëve, molusqeve dhe gjemborëve
- **krahason** mënyrën e jetës dhe format e shumëzimit (seksual, aseksual) te klasat e ndryshme të pakurrizorëve nëpërmjet përfaqësuesve tipikë
- **kupton** zhvillimin direkt dhe indirekt (me metamorfozë) dhe di të emërtojë larvat te grupet e ndryshme të avertebrorëve (si zoea, nauplius, trohofora etj.)
- **definon** termat: gonohorist, hermafrodit, partenogjenezë
- **analizon** sistemin e organeve shqisore, frymëmarrëse, qarkullimit të lëngjeve trupore, ekskretimit, lëvizjes, sistemin nervor te klasat e ndryshme të avertebrorëve
- **kupton** termat mezogle, mezodermë, celom, pseudocel, kitin, kutikulë, polip meduzë etj.
- kupton rëndësinë e disa llojeve të avertebrorëve për ekonominë dhe jetën e njeriut (bletëve, krimbit të mëndafshit, guacave, kërminjve, ushunjëzave etj).

- di se nga disa avertebrorë (p.sh. morrat e bimëve, miza spanjolle etj.) fitohen preparate cilësore kozmetike dhe farmakologjike
- **emërton** llojet e avertebrorëve që shkaktojnë sëmundje (trematodet, cestodet, nematodet) ose bartin sëmundje te njeriu (insektet - mizat, morrat, rriqrat -ethet hemoragjike etj.)
- **dallon** grupet themelore të insekteve
- kupton se insektet bimëngrënëse i shkaktojnë dëme të mëdha: bujqësisë, pylltarisë, pemëtarisë, vreshtarisë, kopshtarisë etj.
- **zbaton** metodën apesticide(luftën biologjike) kundër insekteve dëmtuese
- di se kriter për klasifikimin e insekteve në kategori të ulëta merret: forma dhe ndërtimi i krahëve, ndërtimi i aparatit gojor, mënyra e shumëzimit
- kupton se insektet janë grupi më i përhapur me lloje në botën e gjallë që banojnë tri mediumet jetësore;ujin, tokën dhe ajrin

### **Ndërlidhja**

Kjo temë mësimore ka ndërlidhje me sistematikën, anatominë, filogjeninë, ekologjinë, parazitologjinë etj.

### **PUNËT PRAKTIKE**

Me punë praktike kuptojmë veprimtaritë që kryejnë nxënësit në natyrë dhe në laborator. Këto punë kryhen me qëllim të konkretizimit të pjesës teorike të lëndës.

Detyrat dhe ushtrimet për punë praktike (që duhet të kryhen në grupe ose individualisht) janë të lidhura me përmbajtjen e lëndës, prandaj për kryerjen e tyre nuk kërkohet njohuri jashtë përmbajtjes së lëndës për këtë vit. Ushtrimet janë relativisht të thjeshta dhe të realizueshme për një orë. Nuk është vështirë të udhëhiqet me veglërinë e paraparë për ushtrime.

Për kryerjen e ushtrimit kërkohet nga nxënësi seriozitet, kujdes, saktësi, durim dhe punë sistematike .Nëse ushtrimi nuk ka sukses herën e parë, nuk duhet humbur durimin, por duhet përsëritur ushtrimin më me shumë kujdes.

Nxënësi për të qenë i suksesshëm në punë praktike duhet të kuptojë metodat e punës praktike, zotërojë shkathhtësitë për manovrim me veglërinë (aparartet, instrumentet) laboratorike dhe të sillet në pajtim me udhëzimet për sjellje në laborator apo terren etj.

## PRAKTIKUMI

Në mësimin e biologjisë për klasën X nxënësi duhet :

- të njohë rregullat e sjelljes gjatë punës në laborator dhe në terren-ekskurzionet shkencore
- të demonstrojë ndërtimin e algave njëqelizore (algës së shiut) me mikroskop
- të zotërojë teknikën e përgatitjes së preparateve mikroskopike, të përkohshme dhe afatgjata
- të zbatojë teknikën për përpunim fizik dhe kimik të materialit për mikroskopim (ngjyrosja, fiksimi i mikropreparateve)
- të vrojttojë me mikroskop hifet, micelet dhe sporangjet te myku i përgatitur nga buka, molla apo dardha e mykur etj. Vizaton hifet, micelet, sporanget dhe krahason me vizatim
- të shohë me mikroskop tharmin e bukës. Vizaton qelizat e tharmit të bukës që vërehen në fushën vizive të mikroskopit dhe krahasohen me vizatim
- të shohë me mikroskop bakteret e marra me rrëmojëse nga dhëmbët e njeriut, apo nga substratet ushqyese (natyrore dhe artificiale) të përgaditura enkas për kultivim të baktereve
- në mikropreparate të gatshme të njihet me ndërtimin primar të rrënjës, të kërcellit dhe ndërtimin e ndërlikuar të gjethit të bimëve spermatofite, monokotiledone dhe dikotiledone
- të njohë ndërtimin e lules (me ndihmën e llupës) në material natyror (lulet e qershisë, të dredhëzës, të vjollcës, të kaçës, të kumbullës)
- të koleksionojë forma të ndryshme të fryteve dhe farave të bimëve që rriten afër shkollës dhe në bazë të dukjes gjykon si shpërndahen ato
- në material natyror të njihet me parimet themelore të klasifikimit të bimëve
- në bazë të luleve të mbledhura të qershisë, të mollës, të dardhës, të ftoit etj., të caktojë llojin, gjininë dhe familjen e këtyre bimëve. Në mungesë të materialit të freskët mund të përdorë edhe bimët e herbarit, e në instancë të fundit edhe fotografitë e luleve të këtyre bimëve
- arsimtari udhëzon nxënësit për përdorimin e çelësave për determinim të bazuar në karaktere diagnostiko .Nxënësi përdor çelësin e vogël për determinim të farëzhveshurave, familjes së halorëve.

- të determinojë farëveshurat. Cakton përkatësinë e disa familjeve të klasës së monokotiledoneve me ndihmën e çelësit të vogël.
- të determinojë dikotiledonet drunore me ndihmën e çelësit të vogël
- të determinojë disa llojeve të familjes së Fluturoreve me lule të bardha dhe të verdha me ndihmën e çelësit të vogël
- të determinojë kërpudhat. Përdor çelësin për determinimin e kërpudhave më të përhapura në natyrë,
- të vrojtojë (me llupë ose mikroskop) parashtazorët: parameciumin, amebën, (në infuzum të përgatitur nga sana, ose gjethi i ndonjë bime që një kohë të gjatë ka qëndruar në ujë moçali, kënete. Procedurën e mëtejme e sqaron arsimtari), ose kërbazorit të gjelbër në ujin e gjelbër ëndonjë moçali
- të bëjë diseksionin e skrajës së shiut, analizon ndërtimin e jashtëm dhe të brendshëm të saj
- të analizojë ndërtimin e jashtëm dhe të brendshëm të gaforreve (gaforres së lumenjve) dhe insekteve (bletës).

**Gjimnazi – Matematikë dhe Informatikë  
Gjimnazi i Përgjithshëm****ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES MËSIMORE**

<b>Nr.</b>	<b>TËRËSITË MËSIMORE</b>	<b>Orë mësimi</b>	<b>%</b>
1	Biologjia e qelizës	6	8.10
2	Metabilizmi qelizor	10	13.51
3	Indet, organet dhe sistemet organike	10	13.51
4	Trashëgimia-kuptimet themelore	18	24.32
5	Biologjia e zhvillimit-zhvillimi individual i njeriut	15	20.27
6	Punë praktike në laborator dhe terren	10	13.51
7	Orë në dispozicion	5	6.75
8	Numri i përgjithshëm i orëve	74	100

Tërësia mësimore: BIOLOGJIA E QELIZËS

**Objektivat specifikë**

Nxënësit duhet:

- të kuptojnë termin biologji dhe pozitën e biologjisë në sistemin e shkencave natyrore dhe shoqërore;
- të kuptojnë se gjallesat janë të ndërtuara nga qelizat;
- duke njohur përbërjen fiziko-kimike të qelizës, të kuptojnë kontinuitetin e botës së gjallë;
- të dinë për formën, madhësinë dhe arkitekturën e qelizës;
- të njihen me themeluesit e teorisë qelizore;
- të dallojnë qelizat prokaryote dhe eukaryote, pra të kuptojnë evolucionin e qelizës;
- të kuptojnë dallimin ndërmjet qelizave bimore dhe shtazore;
- të njihen me strukturën, infrastrukturën qelizore dhe funksionin e tyre.



## **Përmbajtja programore**

1. Qeniet e gjalla janë të ndërtuara nga njësia elementare strukturale e jetës-qeliza.
2. Për studimin e qelizës shfrytëzohen metodat përkatëse: mikroskopi, citofiziologjike, mikrokirurgjike, kulturat e qelizave etj.
3. Përbërja kimike e qelizës përfaqësohet nga komponenta inorganike (uji, kripërat minerale) dhe organike (proteinat, karbohidratet, yndyrat, acidet nukleike, vitaminat).
4. Organizimi dhe funksionimi i strukturave të qelizës (mitokondriet, ribosomet, plastidet, aparati i golgjit, centrozomi, mezozomi etj).
5. Tipat e organizimit qelizor: qelizat pa bërthamë të diferencuar dhe qelizat me bërthamë të diferencuar.
6. Ndryshimet degjenerative në qelizë-shkaqet dhe pasojat.

## **Rezultatet e pritura**

Në fund të klasës X nga kjo përmbajtje mësimore nxënësi:

- kupton definicionin dhe rëndësinë e biologjisë dhe pozitën e saj në sistemin e shkencave natyrore dhe shoqërore;
- përshkruan metodat citologjike të hulumtimit shkencor nga citologjia: citogjenetika, citokimia, citifiziologjia dhe mikrokirurgjia dhe njëkohësisht zbaton në praktikë mikroskopimin, fiksimin, ngjyrosjen;
- hulumton ndërtimin dhe përshkruan funksionin e qelizës;
- analizon mjedisin e brendshëm të qelizës në raport me mjedisin e jashtëm: difuzioni, osmoza, transporti aktiv;
- parashikon fatin e qelizës nëse dështon funksioni i ndonjë organeli.

## **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me kiminë (njohja e përbërjes kimike të qelizës) dhe me fizikën (ligjshmëritë fizike, qarkullimi i materieve, difuzioni, osmoza).

Tërësia mësimore: METABOLIZMI QELIZOR

### **Objektivat specifikë**

Nxënësit duhet:

- të njihen me metabolizmin dhe hallkat e tij-anabolizmin dhe katabolizmin;
- të kuptojnë se fotosinteza është proces tipik anabolik, kurse respiracioni është proces katabolik;
- të dinë se në kuadër të katabolizmit bëjnë pjesë fermentimet anaerobe dhe ato aerobe;
- të kuptojnë se enzimat janë ndërmjetësuese në proceset metabolike;
- të kuptojnë se cilat fermentime kryhen nën ndikimin e tharreve, cilat nën ndikimin e myshqeve, e cilat nën ndikimin e baktereve.

### **Përmbajtja programore**

1. Metabolizmi-defenicioni dhe karakteristikat themelore të tij.
2. Proceset endoenergjetike dhe ato ekzoenergjetike.
3. Organelet përgjegjëse për biosintezën e proteinave, karbohidrateve dhe të yndyrave.
4. Fotosinteza, kemosinteza, respiracioni dhe lëvizja e materies ushqyese nëpër mëmbrana (transporti aktiv, transporti pasiv etj.).
5. Komponimet e pasura me energji:makromolekulat energjetike.

### **Rezultatet e pritura**

Nxënësit në fund të klasës X nga kjo tërësi mësimore:

- kuptojnë shndërrimin e përhershëm të materies-metabolizmin;
- dinë për hallkat e zinxhirit të metabolizmit: anabolizmin dhe katabolizmin si procese të lidhura ngushtë njëra me tjetrën;
- dinë se anabolizmi dhe katabolizmi shoqërohen me energjinë, pra me lidhjen dhe lirimin e saj;
- kuptojnë se proceset anabolike dhe katabolike kryhen në organele të posaçme ose në citoplazmë;
- dinë të dallojnë fotosintezën nga kemosinteza;
- përshkruajnë përbërjen kimike, emërtojnë dhe (në bazë të mekanizmit të veprimit) klasifikojnë enzimet;
- dinë se oksidoreduktimet (fermentimet) mund të jenë të plota (fermentimi acido acetik) dhe jo të plota (fermentimi alkoolik).

## **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

- biokiminë-në aspektin e strukturës, aktivitetit dhe rolit të komponenteve kimike në metaboloizëm në përgjithësi;
- fizikën-në aspektin e madhësisë së molekulave, gjendjes agregate të përbërësve qelizor etj.

Tërësia mësimore:

**INDET, ORGANET DHE SISTEMET ORGANIKE**

## **Objektivat specifikë**

Nxënësit duhet:

- të zhvillojnë njohuri për specializimin e qelizave përnga funksioni;
- të definojnë termat ind, organ dhe sistem organesh dhe të njihen me grupet themelore të indeve, organeve dhe të] sistemeve organike të bimëve dhe të shtazëve;
- të krahasojnë funksionet e indeve, organeve dhe të sistemit të organeve të ndryshme të bimët dhe të shtazët;
- Të kuptojnë se harmonia e veprimit të organeve dhe të sistemit të organeve në organizëm rregullohet nëpërmjet sistemit nervor dhe sistemit humoral.

## **Përmbajtja programore**

1. Indet - formacione qelizash me formë, ndërtim e funksion të përbashkët dhe me origjinë të përbashkët.
2. Disa inde japin organin përkatës.
3. Sistemet e organeve paraqesin një harmoni strukturale dhe funksionale tek organizmat bimorë dhe shtazorë.
4. Organizmi struktural dhe funksional i indeve në organe dhe i organeve në sistem organesh është një ndërlidhje specifike.

## **Rezultatet e pritura**

Në fund të klasës X nga kjo njësi mësimore nxënësi:

- kupton pse indet janë të ndara sipas formës dhe funksionit;
- përshkruan dhe krahason indet bimorë dhe indet shtazore;
- dallon indet, organet dhe sistemet e organeve bimorë dhe shtazore;

- emërton indet, organet dhe sistemet organike themelore ndër bimët dhe shtazët;
- vlerëson rolin e indeve, organeve dhe të sistemeve organike;
- analizon varshmërinë ndërmjet indeve, organeve dhe sistemeve të organeve në organizmin si tërësi.

### **Ndërlidhja**

Përmbajtja e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

- anatominë - në kuptim të ndërtimit të indeve, organeve dhe sistemeve të organeve;
- fiziologjinë - në kuptim të funksionit të indeve, organeve dhe të sistemeve organike.

Tërësia mësimore: TRASHËGIMIA, KUPTIMET THEMELORE

### **Objektivat specifikë**

Nxënësit duhet:

- të definojnë termin gjentika;
- të kuptojnë se cila është baza molekulare e trashëgimisë;
- të shpjegojnë konceptet: gjen, gjenom, alel, homozigot, heterozigot, gjenotip, fenotip;
- të kuptojnë shifrën gjenetike dhe të dinë për vetëriprodhimin e acideve nukleike;
- të dinë për rregullat themelore të trashëgimisë (ligjet e Mendelit);
- të dinë për vetitë dominuse dhe recesive;
- të kuptojnë variabilitetin gjenetik të organizmave dhe shkaktarët e tyre: mutacionet e gjeneve, kromosomeve, gjenomeve etj.;
- të kuptojnë se mjedisi ndikon në shfaqjen e ndryshimeve trashëguese.

### **Përmbajtja programore**

1. Baza molekulare e trashëgimisë-acidet nukleike.
2. Mekanizmi i biosintezës së proteinave kontrollohet nga acidet nukleike.
3. Rregullat themelore të trashëgimisë: Ligjet e Mendelit (vetitë dominante dhe recesive: gjenet homologe, homozigotët, heterozigotët etj.).
4. Burimet e variabilitetit gjenetik: mutacionet.

## **Rezultatet e pritura**

Në fund të klasës X nga kjo përmbajtje mësimore nxënësi:

- kupton definicionin dhe rëndësinë e gjenetikës si shkencë e biologjisë molekulare;
- përqendrohet në strukturën kimike të acideve nukleike si baza molekulare e trashëgimisë;
- përshkruan biosintezën e proteinave, vetëriprodhimin e acideve nukleike dhe rregullimin gjentik;
- njeh, analizon dhe komenton ligjet e Gregor Mendelit;
- ndërgjegjësohet për pasojat e mjedisit në strukturën dhe në funksionin e bazës gjenetike;
- fut në përdorim proceset si: ngjyrosja dhe vrojtimi me mikroskop, observimi, analiza dhe komentimi i ndryshimeve gjenetike;
- parashikon pasojat e ndryshimeve gjenetike në organizëm duke pasur parasysh hartën gjenetike;
- vlerëson dobitë dhe dëmet e inxhinierisë gjenetike (klonimi, përfitimimi i mutantëve, bioteknologjia e aplikuar etj.).

## **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj teorie mësimore ka ndërlidhje me:

- biokiminë-në aspektin e njohjes së strukturës së acideve nukleike, kromozomeve, ribozomeve etj.;
- fiziologjinë-në aspektin e përcjelljes së vetive trashëguesë;
- fizikën-në aspektin e markimit, fragmentimit të gjeneve etj.;
- kiminë-në aspektin e përbërjes kimike të acideve nukleike.

Tërësia mësimore:

**BIOLOGJIA E ZHVILLIMIT**

- ZHVILLIMI INDIVIDUAL I NJERIUT

## **Objektivat specifikë**

Nxënësit duhet:

- të njohë ciklin e zhvillimit të organizmave në përgjithësi dhe të njeriut në veçanti;
- të kuptojë ciklin qelizor: mitozën, mejozën, gametogjenezën, frytënimin, krijimin e embrionit;

- të kuptojë se kategori të ndryshme organizmash shtazorë zhvillimin embrional e kryejnë në mjedise të ndryshme (në ujë, brendi të trupit etj);
- të njohë fazat kryesore të zhvillimit embrional;
- të kuptojë se zhvillimi embrional i anamniotëve bëhet jashtë trupit, ndërsa ai i amniotëve në trupin e nënës;
- të përshkruajë fazat kryesore të zhvillimit individual (ontogjenetik) të njeriut.

### **Përmbajtja programore**

1. Cikli i zhvillimit të gjallesave (shtazëve).
2. Shtazët anamniote dhe amniote-vendi i krijimit, liritimit dhe fekondimit të vezëve dhe zhvillimi embrional i tyre.
3. Zhvillimi embrional tek ujëtoksorët, shpendët dhe gjitarët.
4. Zhvillimi individual i njeriut.
5. Zhvillimi embrional dhe faktorët e mjedisit.

### **Rezultatet e pritura**

Në fund të klasës së X nga kjo njësi mësimore nxënësi:

- a) kupton rëndësinë e reprodukimit ndër shtazët dhe te njeriu;
- b) krahason kushtet dhe specifitetin e zhvillimit embrional ndër shtazët anamniote dhe amniote;
- c) përshkruan ganetigjenezën te njeriu, ciklin menstrual te femra, frytënimin dhe fazat e zhvillimit embrional te njeriu;
- d) kupton fazat e zhvillimit postnatal te njeriu dhe ndikimin e faktorëve të mjedisit në sjelljen e njeriut.

### **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me kiminë, citologjinë, anatominë, fiziologjinë, biokiminë, gjenetikën, sociologjinë, psikologjinë.

### **PUNËT PRAKTIKE**

Me punë praktike kuptojmë veprimtaritë që kryejnë nxënësit në natyrë dhe në laborator. Këto punë kryhen me qëllim të konkretizimit të pjesës teorike të lëndës.

Detyrat dhe ushtrimet për punë praktike (që duhet të kryhen në grupe ose individualisht) janë të lidhura me përmbajtjen e lëndës, prandaj për kryerjen e tyre nuk kërkohet njohuri jashtë përmbajtjes së lëndës për këtë vit. Ushtrimet janë relativisht të thjeshta dhe të realizueshme për një orë. Nuk është vështirë të udhëhiqet me veglërinë e paraparë për ushtrime.

Për kryerjen e ushtrimit kërkohet nga nxënësi seriozitet, kujdes, saktësi, durim dhe punë sistematike. Nëse ushtrimi nuk ka sukses herën e parë, nuk duhet humbur durimin, por duhet përsëritur ushtrimin më me shumë kujdes.

Nxënësi për të qenë i suksesshëm në punë praktike duhet të kuptojë metodat e punës praktike, zotërojë shkathtësitë për manovrim me veglërinë (aparartet, instrumentet) laboratorike dhe të sillet në pajtim me udhëzimet për sjellje në laborator apo terren etj.

## PRAKTIKUMI

Në mësimin e biologjisë për klasën e X<sup>te</sup> nxënësi duhet :

- të njoh rregullat e sjelljes gjatë punës në laborator dhe në terren - ekskursionet shkencore
- të zotërojë teknikën e përgatitjes së preparateve mikroskopike, të përkohshme dhe afatgjata
- të shohë me mikroskop tharmin e bukës. Vizaton qelizat e tharmit të bukës që vërehen në fushën vizive të mikroskopit dhe krahasohen me vizatim,
- të shohë me mikroskop plastidet në qelizat e bimëve
- në mikropreparate të gatshme të njihet me ndërtimin e indeve bimë dhe shtazore muskulor, ashtëror, etj)
- të njoh ndërtimin e lules ( me ndihmën e llupës) në material natyror (lulet e qershisë, të dredhëzës, të vjollcës, të kaçës, të kumbullës),
- të koleksionojë forma të ndryshme të frutave dhe ( indi epidermal, indin arave të bimëve që rriten afër shkollës dhe në bazë të dukjes gjykon si shpërndahen ato,
- të vrojtojë (me llupë ose mikroskop) parashtazorët: parameciumin, amebën, (në infuzum të përgatitur nga sana, ose gjethi i ndonjë bime që një kohë të gjatë ka qëndruar në ujë moçali, kënete. Procedurën e mëtejme e sqaron arsimtari), ose kërbacorit të gjelbër në ujë dhe gjelbër të ndonjë moçali,
- Të përcjellë zhvillimin embrional të bretkosa dhe zogu i pulës
- Të përgatis dhe ngjyrore lamën e gjakut, identikoj eritrocitete dhe leukocitete në të me ndihmën e mikroskopit.

**Gjimnazi i Shkencave Shoqërore  
Gjimnazi i Gjuhëve****ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS**

Përmbajtja e lëndës është organizuar në theksimet e tërësitë kryesore apo thelbësore të lëndës së biologjisë, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përgjithshëm të lëndës së biologjisë për klasën X të Gjmnazit të Shkencave Shoqërore dhe të Gjmnazit të Gjuhëve.

Organizimi i përmbajtjes përfshin: ndërtimin, balancimin dhe mbarështrimin.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin pesë tërësi mësimore, me anë të së cilave përfshihet fundamenti i lëndës.

Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara sipas tërësive mësimore.

	<b>Organizimi i përmbajtjes mësimore</b>		
<b>Nr</b>	<b>Tërësitë mësimore</b>	<b>Ore mësimi</b>	<b>%</b>
1	Biologjia e qelizës	6	8.10
2	Funksionet jetësore të gjallesave	10	13.51
3	Trashëgimia	16	21.62
4	Cikli qelizor dhe jetësor i organizmave	6	8.10
5	Organizmi ha dhe hahet nga të tjerët	30	40.54
6	Punë praktike	6	8.10

Mbarështimi i përmbajtjes së lëndës në klasë bëhet për jo më pak se 74 orë mësimi sipas kësaj forme :

- tërësitë mësimore,
- përmbajtja programore,
- rezultatet e pritura,
- ndërlidhja.



## Tërësia mësimore: BIOLOGJIA E QELIZËS

### **Objektivat specifikë**

Synohet që nxënësi:

- të kuptojë pozitën e biologjisë në sistemin e shkencave natyrore dhe shoqërore;
- të analizojë hierarkinë e organizimit të botës së gjallë nga niveli qelizor e deri në nivel të organizmit;
- të definojë karakteristikat e jetës;
- duke njohur përbërjen kimike dhe veçoritë fiziko-kimike të qelizës, të kuptojë unitetin e botës së gjallë dhe jo të gjallë;
- të dallojë qelizën prokariote prej asaj eukariote, qelizën bimore nga ajo shtazore, si dhe qelizën somatike nga ajo seksuale;
- të kuptojë shkaqet e ndryshimeve degjenerative në qelizë dhe pasojat për qelizën dhe organizmin.

### **Përmbajtja programore**

- Qeniet e gjalla janë të ndërtuara nga njësia elementare e jetës – qeliza.
- Përbërja kimike e qelizës (uji, materiet minerale, proteinat, karbohidratet, lipoidet, enzimat) dhe rëndësia e tyre biologjike.
- Organizimi dhe funksionimi i strukturave qelizore (ribozomet, mitrokondriet, plastidet, bërthama).
- Membrana qelizore – struktura funksioni i saj (osmoza, difuzioni, transporti aktiv).
- Tipat e organizimit qelizor – qelizat pa bërthamë të diferencuar dhe qelizat me bërthamë të diferencuar.
- Metodat citologjike: mikroskopike, citokimike, citofiziologjike etj.

### **Rezultatet e pritura**

Nxënësi në fund të klasës X nga kjo tërësi mësimore:

- kupton kriteret për klasifikimin e biologjisë;
- radhit pozitën e biologjisë në sistemin e shkencave natyrore dhe shoqërore;
- hulumton ndërtimin dhe përshkruan funksionin e qelizës;

- parashikon se çka ndodh me qelizën nëse çrregullohet ose humb funksioni i ndonjë organeleje, p.sh. plastideve dhe mitokondrive;
- zbaton në praktikë mikroskopimin, ngjyrosjen e preparateve etj.
- analizon mjedisin e brendshëm të qelizës, në raport me mjedisin e jashtëm.

### **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje:

- me kiminë: në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të qelizës;
- me fizikën: në aspektin e njohjes së ligjshmërive fizike, të qarkullimit të materieve, osmozës, difuzionit etj.

Tërësia mësimore: FUNKSIONET JETËSORE TË GJALLESAVE

### **Objektivat specifikë**

Nxënësi:

- të kuptojë rritjen e organizmave përmes proceseve jetësore;
- të dijë për indet dhe organet vegjetative të bimëve;
- të zhvillojë njohuri për veçoritë thelbësore jetësore të qenieve të gjalla: metabolizmin, frymëmarrja qelizore, fermentimi etj.;
- të analizojë dallimet midis gjallesave fotoautotrofike dhe kemotrofike, saprofite dhe parazite;
- të kuptojë rëndësinë e energjisë së dritës dhe të energjisë kimike në krijimin e kompozimeve organike –fotosinteza;
- të dijë për natyrën kimike dhe për funksionin e substancave që mundësojnë proceset jetësore – enzimat.

### **Përmbajtja**

- Indet bimore, karakteristikat morfologjike të organeve vegjetative të bimëve me farë.
- Rëndësia e ujit për bimë.
- Qeliza si sistem osmotik, plazmoliza, deplazmoliza, qarkullimi i ujit nëpër bimë.
- Ndikimi i faktorëve të jashtëm në thithjen dhe largimin e ujit nga bima, transpirimi.

- Organizmat autotrofë dhe heterotrofë, fotosinteza, frymëmarrja qelizore, glikoliza, cikli i Krebsit, enzimat.
- Roli i elementeve minerale për qeniet e gjalla.
- Azoti, burimet, fiksimi biologjik i tij.

### **Rezultatet e pritura**

Nxënësi në fund të klasës X nga kjo tërësi mësimore:

- Kupton morfologjinë dhe funksionin e organeve vegjetative të bimës;
- përshkruan ndikimin e faktorëve të mjedisit të jashtëm në zhvillimin e proceseve jetësorep
- analizon varshmërinë e ndërsjellë në mes të bimëve dhe të kafshëve;
- kupton termin metabolizëm dhe analizon rëndësinë e fotosintezës për ekzistencën e jetës në tokë;
- përshkruan rolin e baktereve nitrifikuese në procesin e fiksimit biologjik të azotit;
- vërteton praninë e amidonit në gjethet e bimëve;
- aftësohet për kultivimin e bimëve në kushte artificiale dhe në tretësira ushqyese.

### **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me kiminë, fiziologjinë dhe anatominë.

Tërësia mësimore: TRASHËGIMIA

### **Objektivat specifikë**

Synohet që nxënësi:

- të definojë termin gjenetikë, të shpjegojë termat themelore gjenetikë;
- të kuptojë kryqëzimin mono, dy dhe tre hibrid – rregullat e Mendelit;
- të analizojë ndërtimin e bërthamës dhe rolin e saj në trashëgimi;
- të njohë ndërtimin e molekulës së ADN-së, ARN-së si përbërës kimikë të bërthamës, plastideve, mitokondrive;

- të kuptojë rolin e ADN-së dhe ARN-së në trashëgimi dhe biosintezën e proteinave;
- të dijë për strukturën dhe për klasifikimin e kromozomeve të njeriut;
- të kuptojë shkaqet e ndryshimeve strukturale dhe numerike në kromozome;
- të kuptojë rëndësinë e inxhinierisë gjenetike;
- të analizojë pasojat e ndryshimit në materialin gjenetik;
- të përshkruajë pasojat e kryqëzimit në farefisni;
- të kuptojë kushtëzimin gjenetik të sjelljeve të njerëzve, inteligjencën, çrregullimet mentale.

### **Përmbajtja**

- Gjenetika – definimi.
- Struktura dhe përbërja kimike e bërthamës.
- Kimia e ARN-së, ADN-së.
- Biosinteza e proteinave.
- Rregullat themelore të trashëgimisë –ligjet e Mendeli.
- Burimet e variabilitetit gjenetik të organizmave –mutacionet.
- Ndikimi i ambientit në paraqitjen e ndryshimeve trashëguese.

### **Rezultatet e pritura**

Nxënësi në fund të klasës X nga kjo tërësi mësimore:

- kupton rëndësinë e gjenetikës dhe ligjet themelore të trashëgimisë;
- përshkruan mekanizmin e trashëgimit të vetive të pasardhësit;
- analizon përcaktimin e seksit te njeriu në bazë të rekombinimit të kromozomeve të gametave (X dhe Y);
- vlerëson rolin e shumimit dhe të trashëgimit në kontinuitetin e jetës dhe në zhvillimin e botës së gjallë;
- di se biosinteza e proteinave kryhet në ribozome përmes tri fazave: replikimit, transkriptimit dhe translacionit;
- njihet me strukturën dhe me llojet e ARN-së dhe me mekanizmin e replikimit të ADN-së.
- definon termat alete, gjene, kod (shifër gjenetike), gjenomë, fenotip, gjenotip dhe dallon fenotipin nga gjenotipi;
- kupton se mutacionet janë pasojë e gabimeve gjatë replikimit të molekulës së ADN-së, si pasojë e ndikimit të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm.

## **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka lidhje me biokiminë, kiminë, fizikën, fiziologjinë etj.

Tërësia mësimore:

### **CIKLI QELIZOR DHE CIKLI JETËSOR I ORGANIZMAVE**

#### **Objektivat specifikë**

Nxënësi:

- të kuptojë rëndësinë thelbësore të procesit të shumimit;
- të përshkruajë dhe të vlerësojë fazat kryesore të një cikli qelizor dhe cikli jetësor të organizmave të ndryshëm;
- të kuptojë se me anë të shumimit ruhet kontinuiteti i jetës dhe bartja e vetive trashëguese në pasardhës.

#### **Përmbajtja programore**

- Bimët dhe kafshët i kanë të zhvilluara organet për shumim në të cilat prodhohen qelizat seksuale.
- Me bashkimin e gametave formohet zigota, pastaj bëhet zhvillimi embrional dhe postembrional (lindja, rritja, pjekja seksuale, trashëgimia, mplekja dhe vdekja).
- Shumimi i qelizave kryhet me anë të ndarjes direkte dhe indirekte (amitoza, mitoza, mejoza).

#### **Rezultatet e pritura**

Nxënësi në fund të klasës X nga kjo tërësi mësimore:

- Njeh dhe zbaton fjalët dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli qelizor (mitoza, mejoza, fazat e mitozës, mejozës;
- kupton rëndësinë e mejozës në krijimin e gametave dhe ruajtjen e numrit konstant të kromozomeve prej një gjenerate në tjetrën;
- di se “gabimet “ që shfaqen gjatë rikombinimit të kromozomeve të prindërve (gjatë ndarjes së qelizave) rezultojnë me patologji;
- emërton fazat e krijimit të gametit femëror dhe mashkullor;
- definon termat morullë, blastulë, gastrulë dhe organogjenezë;
- analizon fazat e ciklit të zhvillimit jetësor të njeriut;

- kupton dallimin midis qelizës haploide dhe diploide;
- di se si pasojë e rritjes dhe e shumimit të pakontrolluar të numrit të qelizave shfaqen tumoret.

### **Ndërlidhja**

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me kiminë, anatominë, fiziologjinë, biokiminë dhe mjekësinë.

Tërësia mësimore:

**ORGANIZMI HA DHE HAHET NGA TË TJERËT**

### **Objektivat specifikë**

Synohet që nxënësi:

- të njohë ndërvarësinë e organizmave me mjedisin jetësor;
- të përshkruajë ndikimin e faktorëve kryesorë të mjedisit në sigurimin e kushteve jetësore për qeniet e gjalla;
- të analizojë çrregullimet në ekosistem, si pasojë e veprimit të faktorit njeri;
- të identifikojë shkaqet e ndotjes së tokës, ajrit, ujit dhe të ushqimit;
- të kuptojë biomonitoringun dhe rëndësinë e organizmave indikatorë për detektimin e shkallës së ndotjes në mjedisin jetësor;
- të përshkruajë mundësinë e rivitalizimit dhe të rikultivimit të ekosistemeve të degjeneruara;
- të analizojë dhe të vlerësojë rolin e faktorëve të ndryshëm të evolucionit në procesin e krijimit të llojeve të ndryshme të bimëve dhe të kafshëve;
- të dijë për krijimin e jetës mbi tokë;
- të kuptojë rolin e biologjisë për zhvillimin e teknikës;
- të zbatojë njohuritë për rolin e mikroorganizmave në industri;
- të dijë se disa çrregullime psikosociale në popullatë janë pasojë e ndotjes;
- të dijë për bazat ekologjike të planifikimit hapësinor dhe për rregullimin e hapësirës;
- të kuptojë rëndësinë e parqeve nacionale dhe të rezervateve natyrore.

## **Përmbajtja programore**

- Organizmat janë të varur nga kushtet e mjedisit jetësor dhe nga mardhëniet ndërmjet tyre.
- Qarkullimi i materies dhe rrjedha e energjisë në ekosistem.
- Prodhimtaria organike e ekosistemit, sukcesionet e ekosistemit.
- Njeriu dhe raporti i tij ndaj botës së gjallë dhe jo të gjallë.
- Burimet dhe llojet e ndotjes së tokës, ujit, ajrit dhe të ushqimit.
- Zanafilla e jetës dhe zhvillimi i botës së gjallë.
- Organizmat bimorë dhe shtazorë janë zhvilluar në kushte të ndryshme të mjedisit jetësor dhe kanë qenë të varur nga faktorë të ndryshëm të evolucionit.
- Organizmat gjatë zhvillimit të tyre u janë nënshtruar seleksionimit natyror dhe pastaj me ndërhyrjen e njeriut seleksionimit artificial.
- Organizmat janë të sistematizuar në kategori të ndryshme sistematike.

## **Rezultatet e pritura**

Nxënësi në fund të klasës X nga kjo përmbajtje mësimore duhet:

- të njohë dhe të kuptojë fjalët dhe përkufizimet në ekologji (biocenozë, ekosistem, biosferë, faktor biotik, abiotik etj.);
- të vlerësojë shkallën e ndryshueshmërisë në mes të ekosistemeve natyrore dhe artificiale;
- të kuptojë termat popullatë, suksesion, rrjetë trofike;
- të kuptojë qarkullimin e materies dhe rrjedhën e energjisë në ekosistem dhe në biosferë;
- të përshkruajë çrregullimet në ekosistem si pasojë e veprimit të faktorit njeri;
- të përshkruajë faktorët e ndryshëm evolutivë që ndikuan në zhvillimin dhe në përsosjen e qenieve të gjalla;
- të vlerësojë rolin e njeriut në biodiversitet;
- të përshkruajë dhe të identifikojë shkaqet e ndotjes së tokës, ujit, ajrit dhe të ushqimit;
- të vlerësojë pasojat afatgjata të ndryshimit të strukturës në biocenozë dhe në ekosistem;
- të kuptojë se si sistemi monitoring i kontribuon mbrojtjes së mjedisit jetësor nga ndotja;

- të zbatojë njohuritë për rolin e mikroorganizmave në industrinë ushqimore, kimike, farmaceutike etj., posaçërisht për zbërthimin biologjik të kontaminatëve;
- të kuptojë rolin e biologjisë për zhvillimin e kibernetikës, biotikës, bioarkitekturës, biologjisë kozmike.

### **Ndërlidhja**

Përmbajtja mësimore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me kiminë, fizikën, sistematikën, evolucionin, ekologjinë, gjeografinë dhe gje-netikën.

### **PUNËT PRAKTIKE**

Me punë praktike kuptojmë veprimtaritë që kryejnë nxënësit në natyrë dhe në laborator. Këto punë kryhen me qëllim të konkretizimit të pjesës teorike të lëndës.

Detyrat dhe ushtrimet për punë praktike (që duhet të kryhen në grupe ose individualisht) janë të lidhura me përmbajtjen e lëndës, prandaj për kryerjen e tyre nuk kërkohet njohuri jashtë përmbajtjes së lëndës për këtë vit. Ushtrimet janë relativisht të thjeshta dhe të realizueshme për një orë. Nuk është vështirë të përdoret veglëria e paraparë për ushtrime.

Për kryerjen e ushtrimit kërkohet nga nxënësi seriozitet, kujdes, saktësi, durim dhe punë sistematike. Nëse ushtrimi nuk ka sukses herën e parë, nuk duhet humbur durimin, por duhet përsëritur më me shumë kujdes.

Për të qenë i suksesshëm në punë praktike, nxënësi duhet të kuptojë metodat e punës praktike, të zotërojë shkathtësitë për përdorimin e veglërive (aparateve, instrumenteve) laboratorike dhe të sillet në pajtim me udhëzimet për sjellje në laborator apo në terren etj.

### **PRAKTIKUMI**

Në mësimin e biologjisë për klasën X nxënësi duhet:

- të njoh rregullat e sjelljes gjatë punës në laborator dhe në terren-ekskurzionet shkencore
- të zotërojë teknikën e përgatitjes së preparateve mikroskopike, të përkohshme dhe afatgjata
- të njohë ndërtimin e lules (me ndihmën e llupës) në material natyror (lulet e qershisë, të dredhëzës, vjollcës, të kaçës, të kumbullës)



- të vërtetojë prezencën e amidonit në gjethin e ndonjë bime
- të demonstrojë plazmolizën dhe deplazmolizën në qelizat e epidermës së qepës
- të vrojtojë (me llupë ose mikroskop) parashtazorët: parameciumin, amebën (në infuzum të përgatitur nga sana ose gjethi i ndonjë bime që një kohë të gjatë ka qëndruar në ujë moçali, kënete. Procedurën e mëtejme e sqaron arsimtari), ose kërbazorit të gjelbër në ujin e gjelbër të ndonjë moçali
- Zhvillimi embrional i zogut të pulës

#### **Disa porosi për arsimtarin:**

- Para dhënies së detyrës arsimtari sigurohet a e kanë përvetësuar mirë nxënësit konceptin e asaj që do ta vëzhgojnë gjatë punës eksperimentale.
- Preferohet që arsimtari të demonstrojë para nxënësve metodën se si do të realizohet eksperimenti apo puna praktike.
- Arsimtari porositi nxënësit që krahas të dhënave që i marrin nga eksperimenti apo vrojtimi, në fletoren e tyre të shënimeve të japin gjykimin për atë që vërejnë.

### **METODOLOGJIA**

Mësimi në biologji si dhe në çdo lëmë tjetër mund të kryhet në disa mënyra, d.m.th. mund të shfrytëzohen disa metoda mësimore. Praktika ka treguar se është i suksesshëm vetëm ai mësim që realizohet me metoda të ndryshme, ku secila sosh ka rëndësi dhe vlerë të veçantë metodike.

Çdo lëndë përpos metodave të përgjithshme mësimore i ka edhe metodat e veçanta. Prej metodave të shumta që mund të përdoren në mësimet e biologjisë po përmendim:

- metodën e shpjegimit,
- metodën e bisedës,
- metodën e leximit dhe të punës me tekst,
- metodën e punës praktike në laboratorin biologjik apo në terren (ekskursionet),
- metodën e të mësuarit dhe të të nxënësve ndërveprues (në kompjuter, CD- programe simuluese kompjuterike etj.),

Përveç metodave të lartshënuara, në shkollat ku arsimtarët janë trajnuar për zbatimin e metodave dhe të strategjive të reja të mësimdhënies, mund të aplikohen

#### **Format e punës:**

- individuale,
- në çifte,
- punës në grupe,
- punës me gjithë nxënësit,
- brainstormingu etj.

Natyrisht, arsimtari i trajnuar, duke përdorur strategji të ndryshme mësimore, gjithmonë ka parasysh se nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes, me qëllim që tek ai të zhvillohen të menduarit kritik dhe aftësitë njohëse.

Çdo ndryshim në punë, pra edhe zbatimi i metodave të ndryshme mësimore e freskon mësimin, e bën atë më interesant, njëkohësisht edhe reflektimi nga ana e nxënësve do të jetë më i mirë. Me fjalë të tjera, arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, në natyrë etj., të mund të njohin, të vrojtojnë, të radhisin, të masin, të shënojnë, të mbledhin të dhënat, të eksperimentojnë, të mbikëqyrin, të mendojnë në mënyrë të pavarur, të mbrojnë dhe të argumentojnë mendimet e tyre etj., por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: **prej së njohurës drejt së panjohurës, prej së afërmes drejt së largëtës, prej së thjeshtës drejt së përbërës, prej konkretes drejt abstraktes, prej së veçantës drejt së përgjithshmes.**

#### **TEKSTET DHE MJETET MËSIMORE**

Krahas tekstit shkollor, si burim tradicional i mësimnxënies, për zbatimin e suksesshëm të përmbajtjes mësimore sugjerojmë përdorimin e doracakëve si ndihmë shtesë në procesin mësimor (atlasë botanikë, zoologjikë etj.), si dhe të mjeteve mësimore (veglëria konform kërkesave të punës praktike, diagramet e luleve, herbariumin, insektariumin, terrariumin, preparatet e thata dhe likuide, internetin, CD-të).

Preferohet që mësuesi të përdorë më shumë mjete dinamike, pasi ato mundësojnë për të kuptuar thelbin e parimeve, proceseve apo ligjësive që studiohen e që nuk mund të arrihet nëpërmjet demonstrimit me mjete statike.

## VLERËSIMI

Vlerësimi është pjesë përbërëse e mësimit, prandaj si i tillë ai kërkon objektiva të qartë mësimore. Arsimtari cakton qartë se çfarë duhet mësuar nxënësit. Ky përcaktim tregon atë që duhet të vlerësohet. Vlerësimi realizohet gjatë tri etapave:

- **kontrolli** - realizohet çka di (**çka u arrit**) e çka nuk di (**çka nuk u arrit**) nxënësi;
- **matja** - nxënësi ka nevojë të dijë për rezultatin e kontrollit. Matjen e bën arsimtari që shprehet me pikë, simbole, shenja dalluese etj.
- **vlerësimi** – nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi cilësor apo sasior të bazuar në matjen. Vlerësimin e bën arsimtari me notë, simbol ose shprehje.

Arsimtari i mirë parashikon disa vlerësime përmbledhëse gjatë vitit.

Vlerësimi bazohet në ç'thonë, ç' shkruajnë dhe ç'bëjnë nxënësit.

Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe të sjelljeve të nxënësve ka një sërë teknikash:

- vlerësimi me shkrim,
- vlerësimi me gojë,
- vlerësimi me anë të dëgjimit,
- vlerësimi praktik,
- vlerësimi me anë të pyetësorëve të nxënësve,
- vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në terren.
- **Testimi** - është ecuria e matjeve sipas një synimi ose objektivi të caktuar. Në praktikë përdoren lloje të ndryshme të testeve, si p.sh.:
  - testet me përgjigje alternative,
  - testet me kombinime,
  - testet me alternativa të shumta,
  - testet me përgjigje të shkurtra dhe me plotësim.

Nxënësi për njohurinë e vet duhet të marrë notë reale dhe të ketë vlerësim kompleks, prandaj mësuesi verifikon dijen e tij me të gjitha mënyrat e mundshme. Njohuria, të cilën patjetër duhet ta zotërojë nxënësi, është përcaktuar nga rezultatet e pritura, gjegjësisht standardi i arritshmërisë.

### **Vlerësimi duhet të jetë:**

- **I vlefshëm** - duhet të vlerësohet ajo që realisht dëshirojmë të matim,
- **I besueshëm** - të gjitha detyrat vlerësohen me të njëjtin standard,
- **I barabartë** - nxënësit duhet të kenë mundësi të barabarta edhe kur përvojat e tyre nuk janë të njëjta,
- **I paanshëm** - nuk diskriminohen nxënësit e sekseve, gjuhëve te ndryshme,
- **Formues** - nxënësit njohin ecurinë e përparimit të tyre,
- **Duhet të bëhet në kohën e duhur** - vlerësimi që bëhet në fund të semestrit ose vitit nuk i krijon mundësi nxënësit për t'u përmirësuar. Duhet dhënë disa mundësi vlerësimi nxënësit gjatë vitit.

## **NIVELET E VLERËSIMIT TË NJOHURIVE**

Vlerësimi i njohurive nga lënda e biologjisë bëhet në tri rrafshë:

- A. Njohja dhe të kuptuarit,**
- B. Përpunimi i të dhënave dhe zgjidhja e problemeve,**
- C. Vlerësimi i shkathtësive eksperimentale.**

### **A. NJOHJA DHE TË KUPTUARIT**

Nxënësit njohin dhe kuptojnë:

- dukuritë, ligjëshmëritë, veprimet, definicionet, kuptimet dhe teoritë;
- teknikën, aparaturën bazë dhe atë ndihmëse;
- sjelljet gjatë punës në klasë, laboratorin biologjik dhe terren;
- çrregullimet në mjedis, pasojat për shoqërinë dhe mënyrën e tejkalimit të tyre.

Pyetjet që shtrohen për verifikim të qëllimit të bazuar në njohje dhe të kuptuar zakonisht fillojnë me fjalët: **defino, shëno, përshkruaj, skico, arsyeto, apliko, sqaro, cakto, emërto etj.**

### **B. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE**

Nxënësit janë të aftë që njohuritë e fituara t'i shprehin në forma të ndryshme (**skematike, grafike, numerike**):

- të mbledhin, të zbresin dhe të radhisin informatat në mënyra të ndryshme;
- t'i riformulojmë informatat prej një forme në tjetrën;
- t'i përdorin të dhënat në mënyrë logjike;
- t'i sqarojnë dukuritë, ligjshmëritë, si dhe ndërlidhjet e tyre në mënyrë logjike;
- japin supozime dhe hipoteza duke lidhur njohuritë nga kaptina të ndryshme të biologjisë dhe të lëndëve të tjera;
- përdorin njohuritë në situata të reja, zgjidhin probleme, t'i analizojnë problemet në mënyrë kritike.

Pyetjet me të cilat verifikohen këto qëllime fillojnë me fjalët: **propozo, përdor, ndërlidh, përmend etj.**

### HYRJE

Fizika mbështetet në përvojën e njeriut dhe në një numër të vogël të ligjeve fundamentale (ligjet e ruajtjes: të energjisë, të masës, të ngarkesës elektrike, të sasisë së lëvizjes dhe të momentit të sasisë së lëvizjes), të cilat janë fituar si rezultat i përgjithësimit të një numri shumë të madh të eksperimenteve.

Dikur fizika në vete i përfshinte të gjitha shkencat e natyrës, si astronominë, kiminë, biologjinë, gjeologjinë, matematikën dhe shkencat e tjera, prandaj është e arsyeshme që çdo shkencë e re e natyrës ndërtohet mbi bazën e saj dhe i përdor metodat dhe mjetet që zbulohen në fizikë. Gjithashtu fizika është shkencë eksperimentale, sepse të gjitha teoritë e saj mbështeten në eksperimente dhe së bashku me përvojën shërbejnë si kritere të vetme të vërtetësisë së tyre.

Fizika është shkencë dinamike dhe evolutive, prandaj dituritë tona për natyrën vazhdimisht përparojnë në cilësi, për ç'arsye ndihet nevoja e freskimit të vazhdueshëm të programeve mësimore në shkollat tona. Në këtë mënyrë nxënësi aftësohet më mirë që t'i njohë, t'i kuptojë e më vonë edhe t'i zbatojë këto njohuri të reja. Në vitet e fundit ndryshimet më të mëdha janë bërë në metodologjinë e mësimdhënies së lëndës së fizikës. Në procesin e mësimin nxënësi dhe arsimtari përbëjnë një tërësi. Nga nxënësit kërkohet që të jenë aktivë, kurse arsimtari të jetë i përgatitur. Me ndihmën e përvojës, eksperimenteve dhe të teorisë mundësohet formimi i kuptimeve fundamentale shkencore, të cilat nxënësi më vonë do t'i përdorë për zgjidhjen e problemeve praktike dhe teorike.

### QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Nxënësi do:

- të njihet me dukuritë natyrore dhe me ligjshmërinë e tyre që studohen në fizikë;
- të njihet me metodat e punës shkencore- kërkimore në fizikë;
- të fitojë aftësi për konkludime, përgjithësim, argumentim kuantitativ dhe për shpjegim të qartë të dukurive fizike;

- të njihet me zbatimet teknologjike më të rëndësishme, me ndikimet pozitive dhe negative të njohurive në mjedisin jetësor;
- të krijohet lidhja aktive ndaj natyrës dhe të krijohet vetëdija e ndërlidhjes së individit me shoqërinë, me botën në të cilën jeton dhe të krijojë ndenjën e përgjegjësisë ndaj mjedisit dhe ekzistencës së jetës në Tokë;
- të njihet me ndikime historike dhe sociale të shkencave të natyrës në përgjithësi e në veçanti të fizikës;
- të formojë bazë të fuqishme për shkollimin e mëtejshëm;
- të zhvillojë mendimin kritiki dhe të ketë qëndrim pozitiv ndaj jetës dhe mjedisit jetësor.

## **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

Nxënësi duhet:

- t'i thellojë njohuritë e fituara nga fizika nga vitet e mëparshme;
- t'i kuptojë në mënyrë të drejtë madhësitë fizike, t'i paraqesë ato me formula matematike dhe të aftësohet që ligjshmëritë t'i paraqesë në mënyrë grafike;
- të njihet më mirë me eksperimentin në fizikë dhe me rolin e tij;
- të planifikojë, të realizojë eksperimentet e thjeshta, të analizojë rezultatet e eksperimenteve dhe të bëjë sintezën e tyre;
- të zhvillojë më tej aftësitë e tij për vrojtim dhe matje të sakta;
- të aftësohet për të përdorur literaturën profesionale, internetin dhe burimet e tjera;
- të fitojë shprehje të punës individuale dhe të punës në grupe;
- të njihet me metodat dhe të zhvillojë aftësitë e shfrytëzimit racional dhe të kursimit të energjisë;
- të nxjerrë nga të dhënat eksperimentale përfundimet që i duhen atij.

## **KATEGORITË E FIZIKËS**

1. FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE
2. LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE
3. ELEKTRICITETI DHE MAGNETIZMI
4. OPTIKË
5. FIZIKA BASHKËKOHORE
6. ASTRONOMI

**Gjimnazi: Shkencat e Natyrës**

KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE	
NËNKATEGORIA: MADHËSITË FIZIKE DHE NJËSITË E TYRE (2)	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizohen madhësitë themelore ndërkombëtare SI dhe njësitë e tyre; bëhet matja e madhësive themelore fizike me instrumentet standarde matëse; përfitohen njësitë ndihmëse si produkt dhe pjesëtim i njësive matëse themelore.</li> <li>- Përdoret mënyra eksponenciale e shkrimit për numër të madh dhe të vogël të njësive; në bazë të shumë matjeve njehsohet vlera mesatare e madhësisë matëse dhe vlerësohet devijimi nga kjo vlerë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë dhe të kuptojë madhësitë themelore ndërkombëtare SI dhe njësitë e tyre;</li> <li>- të analizojë madhësitë themelore fizike;</li> <li>- të zbatojë instrumentet standarde matëse;</li> <li>- të krijojë dhe të zhvillojë mënyra eksponenciale të shkrimit për numër të madh dhe të vogël të njësive.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE:</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>-Lënda dhe metodat e studimit në fizikë.</li> <li>- Lidhmëria e fizikës me shkencat e tjera dhe teknikën.</li> <li>- Madhësitë fizike.</li> <li>- Sistemi ndërkombëtarë i njësive.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë madhësitë dhe njësitë themelore fizike;</li> <li>- të fitojë shkathtësi që njësitë e madhësive të vogla dhe të mëdha t'i shprehë në formën e potencave dhe emrat e potencave themelore: mili, mikro, etj.;</li> <li>- të zhvillojë aftësi për vërtetim të saktë dhe kritik dhe shkathtësi gjatë matjeve;</li> <li>- të fitojë aftësi për arritjen e përfundimeve, për përgjithësime, për argumentim sasior dhe për vendosjen e lidhjeve funksionale.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE:</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Për këtë nënkategori përdoren mjetet ndihmëse të matjes së gjatësisë, kohës etj.</li> <li>- Nxënësi kyçet në metodat themelore të punës në fizikë, njihet me madhësitë fizike dhe matjet e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika,</li> <li>- funksionet eksponenciale,</li> <li>- funksionet lineare,</li> <li>- metrologjia etj.</li> </ul>
LITERATURA	
Sistemi SI i njësive	



<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: LËVIZJET DREJTVIZORE (7)</b>	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizohet shpejtësia mesatare dhe shpejtësia e çastit; duhet të kuptojë përkufizimin e nxitimit dhe të njihet me lëvizjen me shpejtësi dhe nxitim konstant.</li> <li>- Të dijë të shkruajë ekuacionet e rrugës, të shpejtësisë dhe të nxitimit në funksion të kohës dhe të dijë <math>t'</math> i zbatojë në problemet numerike; të arrijë aftësi të vizatojë grafikisht madhësitë themelore kinematike dhe të dijë çka paraqesin varshmëritë në grafik.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihet me ekuacionin themelor të përshkrimit të lëvizjes drejtvizore;</li> <li>- të kuptojë paraqitjen grafike të madhësive kinematike si marrëdhënia e shpejtësisë dhe kohës, rrugës dhe kohës etj.;</li> <li>- të analizojë formulat matematikore të kinematikës dhe të aftësohet për zgjidhjen e problemeve të ndryshme numerike.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTTJET PROGRAMORE:</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pika materiale.</li> <li>- Përkufizimi i shpejtësisë.</li> <li>- Lëvizjet e njëtrajtshme drejtvizore.</li> <li>- Përkufizimi i nxitimit.</li> <li>- Lëvizjet drejtvizore me nxitim konstant.</li> <li>- Paraqitja grafike e lëvizjeve drejtvizore.</li> <li>- Shpejtësia dhe nxitimi si madhësi vektoriale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi duhet të dijë të përkufizojë shpejtësinë mesatare dhe shpejtësinë e çastit;</li> <li>- të dijë të përkufizojnë nxitimin, të shkruajë dhe të zbatojë ekuacionet themelore të lëvizjeve;</li> <li>- të dijë se si nga shpejtësia e dhënë të parashikojë pozitën e trupit pas një kohe të caktuar;</li> <li>- të kuptojë se përshkrimi i lëvizjes do të jetë aq më i saktë, sa më e shkurtër të jetë intervali i kohës.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE:</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në bazë të matjeve eksperimentale nxënësi të arrijë deri te përshkrimi matematik i lëvizjeve;</li> <li>- të dijë se edhe rënia e lirë është lëvizje e nxituar, ndërsa hedhja vertikale lëvizje e ngadalësuar;</li> <li>- të bëjë dallimin e lëvizjeve sipas rrugës, shpejtësisë dhe nxitimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika.</li> <li>- funksionet eksponenciale,</li> <li>- funksionet lineare,</li> <li>- funksionet kuadratike,</li> <li>- vektorët etj.</li> </ul>
<b>LITERATURA:</b>	
Fizika për klasën I gjimnaz, faqe 13-30	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: LËVIZJA RRETHORE (3)</b>	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi duhet të kuptojë përkufizimin e shpejtësisë këndore; të përkufizojë frekuencën e lëvizja rrethore e njëtrajtshme, të dijë lidhshmërinë në mes të shpejtësisë këndore, dhe kohës së rrotullimit të plotë.</li> <li>- Të dijë lidhshmërinë në mes të shpejtësisë lineare, rrezes dhe të shpejtësisë këndore; të kuptojë nxitimin radial të lëvizja e njëtrajtshme nëpër vijë rrethore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë të përkufizojë frekuencën, kohën e rrotullimit të plotë, rrugën (këndin), shpejtësinë këndore dhe të zakonshme të lëvizja e njëtrajtshme nëpër rreth;</li> <li>- të kuptojë dhe të zbatojë rregullën e vidhës së djathtë;</li> <li>- të dijë për nxitimin radial dhe tangjencial;</li> <li>- të jetë i aftë të njehsojë detyra për këto madhësi.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE:</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëvizja e njëtrajtshme e pikës materiale nëpër vijë rrethore.</li> <li>- Lëvizja e nxituar e pikës materiale nëpër vijë rrethore.</li> <li>- Lidhja në mes të shpejtësisë këndore dhe shpejtësisë lineare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi të arrijë aftësi që në mënyrë sasiore të përshkruajë lëvizjen rrethore;</li> <li>- veçanërisht të dijë kuptimin e nxitimit radial dhe të nxitimit tangjencial;</li> <li>- të fitohen shkathtësitë për llogaritjen e nxitimit radial dhe të nxitimit tangjencial;</li> <li>- nxënësi të arrijë aftësi që pa vështirësi të zgjidhë detyra numerike nga ky lëmë.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Duke numëruar shembuj nga natyra të kuptohet më lehtë lëvizja rrethore. Lëvizja rrethore rreth Diellit.</li> <li>- Duke përdorur modele të përshtatshme didaktike të stimulohen nxënësit më të suksesshëm dhe ata mesatarë përmes mësimin ndërveprues në kuadër të lëndës.</li> <li>- Duke shfrytëzuar materiale të llojshme didaktike të realizohen qëllimet dhe objektivat e përgjithshëm dhe specifikë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika</li> <li>- gjeografia; orientimi në detari</li> <li>- filozofia (sistemi heliocentrik dhe gjeocentrik; vendi i Tokës në gjithësi etj.)</li> </ul>
<b>LITERATURA</b>	
Fizika për klasën I gjimnaz, faqe 31-35	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: VEPRIMI RECIPROK I TRUPAVE (12)</b>	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë përshkrimin e forcës si madhësi vektoriale dhe të kuptojë mbledhjen grafike të forcave si madhësi vektoriale, si dhe zbërthimin e tyre në komponentë;</li> <li>- të dijë baraspeshimin e forcave dhe të dallojë llojet e forcave: forcat e brendshme dhe të jashtme, ligjin e veprimit dhe të kundërveprimit;</li> <li>- të kuptojë si punon dinamometri; të kuptojë masën, inercinë, peshën dhe sasinë e lëvizjes;</li> <li>- të dijë për sistemet e referencës dhe për parimin e relativitetit, si dhe për ligjet e Njutonit për mekanikë;</li> <li>- nxënësi duhet të kuptojë përkufizimin e punës mekanike, fuqisë, energjisë kinetike dhe dy llojet e energjisë potenciale (gravitetale dhe elastike).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë përkufizimin e forcës dhe lidhjet me lëvizjet që rrjedhin nga ligjet e Njutonit;</li> <li>- të bëjë dallimin në mes të masës dhe peshës;</li> <li>- të aftësohet të dallojë punën mekanike nga ajo e zakonshme, si dhe fuqinë dhe energjinë mekanike;</li> <li>- të kuptojë ligjin e inercisë dhe ligjin themelor të dinamikës;</li> <li>- të analizojë forcën e rëndimit, peshën, dendësinë dhe peshën specifike;</li> <li>- të njihet dhe të kuptojë ligjin e veprimit dhe të kundërveprimit, punën, fuqinë dhe energjinë kinetike dhe potenciale.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE:</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Inercia dhe masa.</li> <li>- Sasia e lëvizjes.</li> <li>- Forca.</li> <li>- Ligji i inercisë.</li> <li>- Ligji themelor i dinamikës.</li> <li>- Forca e rëndimit.</li> <li>- Pesha. Dendësia.</li> <li>- Pesha specifike.</li> <li>- Ligji i veprimit dhe i kundërveprimit.</li> <li>- Puna.</li> <li>- Fuqia.</li> <li>- Energjia kinetike dhe potenciale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi të njihet me kuptimin dhe vetitë e forcave, mbledhjen dhe zbërthimin e tyre;</li> <li>- të njihet me forcat që i takojmë në jetën e përditshme, forca e rëndimit, forca e fërkimit etj.</li> <li>- të dijë se ka forca gjatë takimit dhe forca në largësi;</li> <li>- të bëjë dallimin e veprimit të forcës në trup dhe të forcës së trupave në rrethinën e vet;</li> <li>- të kuptojë përkufizimin e punës dhe të energjisë.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi duhet të krijojë parafytyrimin për forcën nga eksperimenti dhe nga shembujt nga jeta e përditshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika,</li> <li>- vektorët dhe veprimet me ta,</li> <li>- vkologjia dhe mjedisi si rezultat i shfrytëzimit të energjisë.</li> </ul>
<b>LITERATURA</b>	
Fizika për klasën I gjimnaz, faqe 36-56.	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: DINAMIKA E TRUPAVE RROTULLUES (8)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të bëhet përkufizimi i nxitimit centripet si dhe përkufizimi i forcës centripetale dhe centrifugale;</li> <li>- të jepet përkufizimi për shpejtësinë e parë kozmike;</li> <li>- të jepen sqarimet e nevojshme për momentin e forcës dhe për llozin; të sqarohet momenti i inercisë dhe momenti i sasisë së lëvizjes;</li> <li>- të jepet përkufizimi për ligjin themelor të dinamikës së rrotullimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë forcën centripetale dhe centrifugale;</li> <li>- të llogaritë shpejtësinë e parë kozmike dhe momentin e forcës;</li> <li>- të bëjë dallimin në mes të momentit të inercisë dhe momentit të sasisë së lëvizjes;</li> <li>- të kuptojë dhe të zbatojë ligjin themelor të dinamikës së rrotullimit.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Forca centripetale dhe centrifugale.</li> <li>- Shpejtësia e parë kozmike. Momenti i forcës. Llozi.</li> <li>- Momenti i inercisë. Momenti i sasisë së lëvizjes.</li> <li>- Ligji themelor i dinamikës së rrotullimit. Analogjia në mes të madhësive të lëvizjet translate.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi të njihet me kuptimin dhe vetitë e forcave centripetale dhe centrifugale;</li> <li>- të bëjë dallimin në mes të forcave centripetale dhe centrifugale;</li> <li>- të njihet me veçoritë e momentit të forcës dhe zbatimin e tri rasteve të llozit;</li> <li>- të bëjë dallimin në mes të momentit të sasisë së lëvizjes dhe momentit të inercisë;</li> <li>- të njihet dhe ta kuptojë ligjin themelor të dinamikës së rrotullimit dhe të kuptojë analogjinë në mes të madhësive të lëvizjet translate dhe rrotulluese.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE:</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi përmes shembujve dhe demonstrimeve të krijojë parafytyrime të qarta për forca centripetale dhe centrifugale.</li> <li>- Përmes shembujve dhe detyrave të sqarohen përmbajtjet programore dhe të jepet ngjashmëria në mes të madhësive të lëvizjet translate dhe rrotulluese.</li> <li>- Modeli didaktik që duhet përdorur duhet të nxjerrë në pah konceptet kryesore, të dhënat dhe faktet e domosdoshme për njohjen e koncepteve, marrëdhënien dhe metodat e përshtatshme për trajtimin metodologjik të lëndës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika,</li> <li>- gjeografia,</li> <li>- astronomia,</li> <li>- zbatimi i centrifugës.</li> </ul>
<b>LITERATURA:</b>	
Fizika për klasën I gjimnaz, faqe 57-60.	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: FORCA E FËRKIMIT (5)</b>	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të bëhet përkufizimi i fërkimit të jashtëm dhe të brendshëm; të bëhet përkufizimi për fërkimin e qetësisë dhe fërkimi i rrëshqitjes.</li> <li>- Të jepet përkufizimi për lëvizjen nëpër rrafshin e pjerrët; të jepen sqarimet e nevojshme për fërkimin e rrokullisjes.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë nocionin për fërkimin e jashtëm dhe të brendshëm;</li> <li>- të kuptojë dhe të analizojë ç'është fërkimi i qetësisë, fërkimi i rrëshqitjes dhe fërkimi i rrokullisjes;</li> <li>- të zbatojë ligjin e lëvizjes nëpër rrafshin e pjerrët;</li> <li>- të aftësohet të dallojë fërkimin e rrokullisjes nga tipat e tjerë të fërkimit.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE:</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fërkimi i jashtëm dhe i brendshëm.</li> <li>- Fërkimi i qetësisë dhe i rrëshqitjes.</li> <li>- Lëvizja nëpër rrafsh të pjerrët.</li> <li>- Fërkimi gjatë rrokullisjes.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi të njihet me kuptimin dhe vetitë e fërkimit të jashtëm dhe të brendshëm;</li> <li>- të bëjnë dallimin në mes të fërkimit të jashtëm dhe të brendshëm;</li> <li>- të njihet me veçoritë e fërkimit të qetësisë dhe të rrëshqitjes;</li> <li>- të bëjë dallimin në mes të fërkimit gjatë rrokullisjes dhe të fërkimit të rrëshqitjes.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi përmes shembujve dhe demonstrimeve të krijojë parafytyrime të qarta për forcat e fërkimit;</li> <li>- përmes shembujve dhe detyrave të sqarohen përmbajtjet programore dhe të jepet ngjashmëria në mes të madhësive të fërkimit të jashtëm dhe të brendshëm si dhe në mes të fërkimit gjatë rrokullisjes dhe fërkimit të rrëshqitjes.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika,</li> <li>- shkencat teknike dhe teknologjike.</li> </ul>
<b>LITERATURA</b>  Fizika për klasën I gjimnaz, faqe 75-79.	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: LËNGJET NË PREHJE (4)</b>	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të bëhet përkufizimi i shtypjes hidrostatike dhe përkufizimi për ligjin e Arkimedit dhe ligjin e Paskalit.</li> <li>- Të jepet përkufizimi për tensionin sipërfaqësorë; të jepen sqarimet e nevojshme për dukuritë kapilare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë me çka merret statika e fluideve;</li> <li>- të kuptojë ç'është forca e shtytjes dhe si përhapet shtypja te lëngjet;</li> <li>- të kuptojë dhe të zbatojë ligjin e enëve komunikuese;</li> <li>- të aftësohet të dallojë dukuritë në sipërfaqe të lëngjeve dhe në kapilare.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shtypja hidrostatike.</li> <li>- Ligji i Arkimedit.</li> <li>- Ligji i Paskalit.</li> <li>- Tensioni sipërfaqësor.</li> <li>- Dukuritë kapilare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi të njihet me kuptimin shtypjes në lëngje;</li> <li>- të njihet me kuptimin shtytjes;</li> <li>- të njihet me ligjin e përhapjes së shtypjes;</li> <li>- të kuptojë dukurinë e tensionit sipërfaqësor dhe të dukurive kapilare;</li> <li>- të bëjë dallimin në mes të meniskut konkav dhe meniskut konveks.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi përmes shembujve dhe demonstrimeve të krijojë parafytyrime të qarta për shtypjen hidrostatike.</li> <li>- Përmes shembujve dhe detyrave të sqarohen përmbajtjet programore për shtytjen, tensionin sipërfaqësorë etj.</li> <li>- Të bëhen demonstrime dhe të shfrytëzohen mjetet e tjera për sqarimin e dukurive të tensionit sipërfaqësor dhe të dukurive kapilare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika,</li> <li>- shkencat teknike dhe teknologjike.</li> </ul>
<b>LITERATURA</b>	
Fizika e përgjithshme – Statika e lëngjeve dhe e gazeve.	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: GRAVITETI (9)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të bëhet përkufizimi i ligjit të Njutonit për gravitet; të sqarohet eksperimenti i Kevendishit.</li> <li>- Të bëhet përkufizimi për fushën e gravitetit; të jepet përkufizimi për punën në fushën e gravitetit.</li> <li>- Të jepen sqarimet e nevojshme për lëvizjet në fushë të gravitetit të Tokës; të sqarohet gjendja pa peshë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë çka është tërheqja universale;</li> <li>- të kuptojë ç'është forca e gravitetit;</li> <li>- të kuptojë dhe të zbatojë ligjin e Njutonit për gravitet;</li> <li>- të aftësohet të dallojë dukuritë e lëvizjes në fushë të gravitetit të Tokës;</li> <li>- të sqarohet lëvizja e pikës materiale në fushën e rëndimit të Tokës: hedhja vertikale, rënia e lirë dhe gjendja pa peshë.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji i Njutonit për gravitet. Fusha e gravitetit.</li> <li>- Puna në fushën e gravitetit.</li> <li>- Lëvizjet në fushë të gravitetit të Tokës.</li> <li>- Hedhja vertikale; rënia e lirë; gjendja pa peshë.</li> <li>- Ligjet e Keplerit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi të njihet me ligjin për tërheqjen universale të trupave në natyrë;</li> <li>- nxënësi të njihet me kuptimin fushës së gravitetit;</li> <li>- të aftësohet të bëjë llogaritje mbi punën në fushë të gravitetit;</li> <li>- të njihet, të kuptojë dhe të aftësohet të bëjë llogaritje për rastin e lëvizjeve në fushë të gravitetit;</li> <li>- të zhvillojë llogaritje për hedhjen vertikale dhe rënie të trupave.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi përmes shembujve dhe demonstrimeve të krijojë parafytyrime të qarta për dukuritë e gravitetit.</li> <li>- Përmes shembujve dhe detyrave të sqarohen përmbajtjet programore për forcën e gravitetit, fushën e gravitetit, punën e gravitetit dhe për lëvizjen në fushë të gravitetit.</li> <li>- Çështjet metodologjike të përqendrohen në atë çka është e përbashkët për mësimdhënie e nxënie të mirë dhe çka është specifike në kuadër të përmbajtjeve programore të lëndës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika,</li> <li>- shkencat teknike dhe teknologjike,</li> <li>- astronomia.</li> </ul>
<b>LITERATURA:</b>	
Fizika për klasën I gjimnaz, faqe 80-96.	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: LIGJET E RUAJTJES (10)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të bëhet përkufizimi për sistemet e mbyllura dhe të ligjit mbi ruajtjen e impulsit; të jepen shembuj të zbatimit të ligjit mbi ruajtjen e impulsit; të bëhet përkufizimi i ligjit mbi ruajtjen e energjisë mekanike dhe të ligjit mbi ruajtjen e momentit të impulsit.</li> <li>- Të jepet përkufizimi për ligjet e Keplerit, si dhe sqarimet e nevojshme për zbatimin e ligjit mbi ruajtjen e energjisë mekanike dhe të ligjit mbi ruajtjen e momentit të impulsit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë çka është sistemi i mbyllur dhe çka thotë ligji mbi ruajtjen e impulsit;</li> <li>- të aftësohet t'i kuptojë shembujt e zbatimit të ligjit mbi ruajtjen e impulsit;</li> <li>- të kuptojë ç'është ligji mbi ruajtjen e energjisë mekanike dhe ligji mbi ruajtjen e momentit të impulsit;</li> <li>- të kuptojë dhe të zbatojë ligjin e ruajtjes së energjisë mekanike dhe ligjin mbi ruajtjen e momentit të impulsit;</li> <li>- të kuptojë çka thonë ligjet e Keplerit;</li> <li>- të jepin shembuj për zbatimin e ligjit mbi ruajtjen e energjisë mekanike dhe të ligjit mbi ruajtjen e momentit të impulsit.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemi i mbyllur. Ligji i ruajtjes së impulsit.</li> <li>- Shembuj të zbatimit të ligjit të ruajtjes së impulsit.</li> <li>- Ligji i ruajtjes së energjisë mekanike. Ligji i ruajtjes së momentit të sasisë së lëvizjes.</li> <li>- Shembuj të zbatimit të ligjit të ruajtjes së momentit të sasisë së lëvizjes.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi të njihet me sistemin e mbyllur dhe me ligjin e ruajtjes së impulsit;</li> <li>- nxënësi të njihet me shembujt të zbatimit të ligjit të ruajtjes së impulsit;</li> <li>- nxënësi të njihet dhe të aftësohet të bëjë llogaritje nga ligji i ruajtjes së energjisë mekanike dhe nga ligji i ruajtjes së momentit të impulsit;</li> <li>- nxënësi të njihet me ligjet e Keplerit.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi përmes shembujve dhe demonstrimeve të krijojë parafytyrime të qarta për sistemin e mbyllur dhe për ligjin e ruajtjes së impulsit.</li> <li>- Përmes shembujve dhe detyrave të sqarohen përmbajtjet programore për ligjin e ruajtjes së energjisë mekanike dhe ligjin e ruajtjes së momentit të impulsit.</li> <li>- Nxënësi të njihet me ligjet e Keplerit dhe me rëndësinë e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika,</li> <li>- shkencat teknike dhe teknologjike,</li> <li>- astronomia.</li> </ul>
<b>LITERATURA:</b>	
Fizika për klasën I gjimnaz, faqe 97-130.	



<b>KATEGORIA: LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: TEORIA MOLEKULARE - KINETIKE E LËNDËS (22)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të bëhet përkufizimi i madhësisë dhe masës së molekulave; të jepen shembuj për matjen e shpejtësisë së molekulave dhe për shpërndarjen e molekulave sipas shpejtësisë; të jepen shembuj për gjatësinë mesatare të rrugës së lirë të molekulave.</li> <li>- Të bëhet përkufizimi i ligjit të difuzionit; të jepet përkufizimi për gazet e përsosura; të jepen sqarimet e nevojshme për kuptimin e temperaturës absolute, si dhe për termometrat dhe llojet e tyre; të jepen sqarimet e nevojshme për kuptimin e izoproceseve; të jepet përkufizimi për ekuacionin e gjendjes së gazit të përsosur, për ligjin e Avogadros dhe për ekuacionin e gazit real.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë dhe të kuptojë çka është madhësia e molekulës;</li> <li>- të aftësohet t'i kuptojë shembujt e zbatimit të shpërndarjes së molekulave sipas shpejtësisë;</li> <li>- të kuptojë ç'është gjatësia mesatare e rrugës së lirë të molekulave dhe atë ta zbatojë në detyra konkrete;</li> <li>- të kuptojë dhe të zbatojë ligjin e difuzionit;</li> <li>- të kuptojë çfarë janë gazet e përsosura;</li> <li>- të formojë shembuj për ekuacionin e gjendjes së gazit të përsosur dhe për ekuacionin e gazit real.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE:</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hyrje. Madhësia dhe masa e molekulave.</li> <li>- Matja e shpejtësisë së molekulave.</li> <li>- Gazet e përsosura. Kuptimi i temperaturës. Termometrat dhe llojet e tyre</li> <li>- Ekuacioni i Klauziusit.</li> <li>- Ligji i Bojl-Mariotit, Ligji i Gej-Lisakut, Ligji i Sharlit.</li> <li>- Temperatura absolute dhe izoproceset.</li> <li>- Ekuacioni i gjendjes së gazit të përsosur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi të njihet me madhësinë dhe masën e molekulave;</li> <li>- të njihet me shembuj të zbatimit të ligjit të shpërndarjes së molekulave sipas shpejtësisë;</li> <li>- të njihet dhe të aftësohet të bëjë llogaritje nga ligji i difuzionit dhe nga gjatësia mesatare e rrugës së lirë të molekulave;</li> <li>- të njihet me shembuj për ekuacionin e gjendjes së gazit të përsosur dhe për ekuacionin e gazit real;</li> <li>- të kuptojë ç'është temperatura absolute dhe ç'janë izoproceset.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi përmes shembujve dhe demonstrimeve të krijojë parafytyrime të qarta për teorinë kinetike-molekulare të gazeve.</li> <li>- Përmes shembujve dhe detyrave të sqarohen përmbajtjet programore për ligjin e shpërndarjes së molekulave sipas shpejtësisë, gjatësisë mesatare të rrugës së lirë të molekulave dhe për ligjin e difuzionit.</li> <li>- Përmes shembujve dhe detyrave të sqarohen Ligji i Bojl-Mariotit, Ligji i Gej-Lisakut, Ligji i Sharlit. Të sqarohet temperatura absolute dhe izoproceset.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika,</li> <li>- shkencat teknike dhe teknologjike,</li> <li>- kimia dhe biologjia</li> </ul>
<b>LITERATURA:</b>	
Fizika për klasën e II gjimnaz , faqe 4-27 .	
<b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë: <u>Termodinamika dhe gazet:</u></b> <a href="http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html">http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html</a> <a href="http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html">http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html</a>	

<b>KATEGORIA: LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE</b>	
<b>NËNKATEGORIA:TERMODINAMIKA (22)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të bëhet përkufizimi i energjisë së brendshme të trupave dhe të gazeve të përsosura.</li> <li>- Të sqarohet sasia e nxehtësisë, termokapaciteti i trupave dhe termokapaciteti i gazeve; të shpjegohet parimi i parë i termodinamikës dhe proceset adiabatike; të sqarohet puna gjatë zgjerimit të gazeve dhe proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme.</li> <li>- Të bëhet përkufizimi i parimit të dytë të termodinamikës; të sqarohen motorët termikë, rendimenti i makinave termike dhe cikli i Karnos si dhe aparatet për ftohje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë çka është energjia e brendshme e trupave dhe e gazeve;</li> <li>- të dijë të llogarisë ndryshimin e energjisë së brendshme të trupave dhe të gazeve të përsosura;</li> <li>- të kuptojë çka është termokapaciteti i trupave dhe termokapaciteti i gazeve;</li> <li>- të dijë për parimin e parë të termodinamikës dhe për zbatimin e tij;</li> <li>- të kuptojë çka është puna gjatë zgjerimit të gazeve dhe çka janë proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme;</li> <li>- të dijë për motorët termikë, për rendimentin e makinave termike dhe për ciklin e karnos;</li> <li>- të analizojë aparatet për ftohje.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE:</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimet themelore. Energjia e brendshme e trupave.</li> <li>- Ndryshimi i energjisë së brendshme të trupave. Energjia e brendshme e gazeve të përsosura.</li> <li>- Sasia e nxehtësisë. Termokapaciteti i trupave.</li> <li>- Termokapaciteti i gazeve. Parimi i parë i termodinamikës.</li> <li>- Zbatimi i parimit të parë të termodinamikës në gazin e përsosur.</li> <li>- Proceset adiabatike. Efekti i Xhaul-Tomsonit.</li> <li>- Puna gjatë zgjerimit të gazeve.</li> <li>- Proceset kuazistatike.</li> <li>- Proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme.</li> <li>- Parimi i dytë i termodinamikës.</li> <li>- Motorët termikë. Rendimenti i makinave termike. Cikli i Karnos. Aparatet për ftohje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi të fitojë njohuri nga energjia e brendshme e trupave dhe gazeve të përsosura dhe për ndryshimin e energjisë së brendshme të trupave;</li> <li>- nxënësi të njihet dhe të kuptojë sasinë e nxehtësisë, termokapacitetin e trupave, termokapacitetin e gazeve, parimin e parë të termodinamikës;</li> <li>- nxënësi të njihet dhe t'i kuptojë proceset adiabatike, efektin e Xhaul-Tomsonit dhe punën gjatë zgjerimit të gazeve;</li> <li>- nxënësi të njihet dhe ta kuptojë parimin e dytë të termodinamikës si dhe motorët termikë.</li> <li>- të kuptojë rendimentin e makinave termike, ciklin e Karnos dhe aparatet për ftohje.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE:</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi përmes shembujve dhe demonstrimeve të krijojë parafytyrime të qarta për energjinë e brendshme të gazeve të përsosura, sasinë e nxehtësisë, termokapacitetin e trupave, termokapacitetin e gazeve dhe parimin e parë të termodinamikës.</li> <li>- Përmes shembujve dhe detyrave të sqarohen përmbajtjet programore për zbatimin e parimit të parë të termodinamikës në gazin e përsosura.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matematika,</li> <li>- shkencat teknike dhe teknologjike,</li> <li>- kimia,</li> <li>- biologjia.</li> </ul>
<b>LITERATURA</b>	
<p>Fizika për klasën II gjimnaz , faqe 30-60.</p> <p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë: <u>Termodinamika dhe gazet:</u></b>  <a href="http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html">http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html</a>  <a href="http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html">http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html</a></p>	

### Mësimet zgjedhore (MZ)

PËRMBAJTJET PROGRAMORE	QËLLIMET
<ul style="list-style-type: none"><li>- Sistemet inerciale dhe joinerciale të referencës.</li><li>- Parimi i pavarësisë së veprimit të forcave.</li><li>- Lëvizja e përbërë translative dhe rrotulluese.</li><li>- Goditjet elastike.</li><li>- Shpërndarja e molekulave sipas shpejtësive.</li><li>- Gjatësia mesatare e rrugës së lirë të molekulave.</li><li>- Ligji i difuzionit.</li><li>- Ekuacioni i gjendjes së gazit real.</li><li>- Gradët e lirisë dhe energjia e brendshme e gazeve.</li><li>- Besueshmëria termodinamike. Rregulli dhe kaosi.</li><li>- Përkufizimi i entropisë. Karakteri statistik i saj.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Për nxënësit të cilët dëshirojnë t'i thellojnë dituritë nga tërësitë programore të veçanta arsimtari ka në dispozicion leksionet e paraqitura si MZ.</li></ul>

### Ushtrimet laboratorike (7 orë)

1. Verifikimi i ligjit të Arkimedit.
2. Shqyrtimi i lëvizjes së nxituar me ndihmën e makinës së Atvudit.
3. Përcaktimi i koeficientit të fërkimit në rrafshin e pjerrët.
4. Verifikimi i ligjit mbi ruajtjen e energjisë me ndihmën e karrocës.
5. Matja e tensionit sipërfaqësor me metodën e gypit kapilar.
6. Përcaktimi i raportit  $c_p/c_v$  me metodën e Klement-Desormesit.
7. Verifikimi eksperimental i ligjit të rrugës gjatë rënies së lirë.

**Gjimnazi i Përgjithshëm**

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: LËVIZJET E NJËTRAJTSHME DREJTVIZORE (12)</b>	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njihet me përkufizimin e madhësive themelore mekanike.</li> <li>- Të kuptojë njësitë matëse dhe rolin e matjeve në fizikë.</li> <li>-Të njihet me karakteristikat dhe llojet e lëvizjeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë nocionet themelore të lëvizjeve drejtvizore, të lakuara dhe rrotullilimit të trupave;</li> <li>- të kuptojë se lëvizjet kryhen në hapësirë dhe në kohë;</li> <li>- të njohë paraqitjen grafike të llojeve të ndryshme të lëvizjeve;</li> <li>- të kuptojë se gjatë rënies së lirë trupat nuk kanë peshë.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Lënda dhe metodat e studimit të fizikës. Dimensionet e madhësive dhe sistemi i njësive SI . Lëvizjet mekanike. Pika materiale . Koncepti mbi vektorët. Mbledhja dhe zbritja e vektorëve. Lëvizja e njëtrajtshme drejtvizore. Paraqitja grafike e rrugës dhe shpejtësisë në lëvizjet e njëtrajtshme. Lëvizjet e ndërrueshme. Nxitimi. Lëvizjet njëtrajtësisht të nxituara. Rënia e lirë. Hedhja vertikale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë se ç'është fizika dhe me çka merret ajo;</li> <li>- të kuptojë madhësitë fizike, simbolin e tyre, shprehjen analitike, dimensionin dhe paraqitjen grafike, mënyrat e matjes, njësitë dhe gabimet në matje;</li> <li>- të dijë madhësitë kryesore në sistemin SI;</li> <li>- të kuptojë përkufizimin e pikës materiale, arsyen pse përdoret;</li> <li>- të kuptojë mirë se ç'janë lëvizjet mekanike dhe relativitetin e tyre;</li> <li>- t'dijë të shprehë me anë të formulave lëvizjen e njëtrajtëshme drejtvizore dhe ta paraqesë grafikisht;</li> <li>- t'i njohë e të dijë t'i përdorë konceptet themelore të mekanikës: zhvendosjen, trajektoren, rrugën, nxitimin, shpejtësinë etj.;</li> <li>- të jetë i aftë të përdorë saktë terminologjinë e fizikës.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Duhet të bëhen punët praktike me qëllim të organizimit të eksperimentit.</li> <li>- Të furnizohen dhe të kontrollohen aparatet matëse, instrumentet dhe pajisjet e tjera.</li> <li>- Të zbatojë rregullat e përdorimit të tyre, si dhe të sigurimit teknik.</li> </ul>	<p>Matematika: Ekuacionet me një dhe dy të panjohura, funksionet lineare dhe kuadratike, jobarazimet, sistemet koordinative, figurat gjeometrike, përpjesëtimet, paraqitja grafike e funksioneve dhe vektorët.</p> <p>Biologjia: Rritja e bimëve është proces kinematik, kurse lëvizja e gjallesave është proces dinamik.</p> <p>Teknika me teknologji: Fizika në këta dy lëmenj realizohet në mënyrë konkrete dhe praktike. Teknika e ndihmon fizikën në përgatitjen e bazës teknike duke siguruar instrumente për matje precize.</p>
<b>LITERATURA: Fizika për kl. I gjimnaz</b>	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: LËVIZJET E LAKUARA (4)</b>	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njihet me karakteristikat e lëvizjeve të lakuara si lëvizje më të përgjithshme në natyrë.</li> <li>- Të njohë se çdo lëvizje e lakuar mund të paraqitet me një varg lëvizjesh rrethore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizojë llojet e ndryshme të lëvizjeve të lakuara;</li> <li>- të kuptojë se lëvizja rrethore është rast i veçantë i lëvizjes së lakuar;</li> <li>- të njohë karakteristikat themelore të lëvizjeve rrethore si lëvizje periodike.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
Lëvizjet e lakuara. Shpejtësia në lëvizjet e lakuara. Lëvizja rrethore e njëtrajtshme. Nxitimi në lëvizjet e lakuara. Lëvizja rrotulluese e trupit të ngurtë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë të përshkruajë lëvizjet e lakuara;</li> <li>- të kuptojë se si formohen lëvizjet e lakuara, e në veçanti lëvizjet rrethore;</li> <li>- të dijë shprehjen matematike për nxitim në lëvizjet rrethore;</li> <li>- të njihet me atë se çdo lëvizje e lakuar mund të paraqitet me një varg lëvizjesh rrethore;</li> <li>- të dijë se vektori i shpejtësisë <math>\vec{v}</math> është i njëjtë për të gjitha pikat e trupit të ngurtë;</li> <li>- të dijë lidhjen e shpejtësisë <math>\vec{v}</math> dhe shpejtësisë këndore <math>\vec{\omega}</math> ;</li> <li>- të dijë se ç'janë perioda dhe frekuenca e rrotullimeve.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëvizja rrethore të demonstrohet me ndihmën e një sfere (ose të ndonjë trupi tjetër të ngurtë) të lidhur me spango.</li> <li>- Lëvizja rrethore mund të demonstrohet edhe me ndihmën e lavjerrësit të Fukosë të lidhur në skajin e diskut rrotullues.</li> </ul>	Matematika: Ekuacionet lineare dhe kuadratike, mbledhja dhe zbritja e vektorëve dhe proporcionet.
<b>LITERATURA: Fizika për kl. I gjimnaz</b>	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: BASHKËVEPRIMET NDËRMJET TRUPAVE (15)</b>	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njohë përkufizimet themelore të madhësive dinamike: masa, inercia, sasia e lëvizjes, pesha, forca etj. dhe njësitë matëse të tyre.</li> <li>- Të njihet me momentet në dinamikë: të forcës, sasisë së lëvizjes dhe të inercisë.</li> <li>- Të njihet me rolin dhe rëndësinë e dinamikës në zgjidhjen e problemeve teorike dhe praktike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të bëjë dallimin ndërmjet masës, inercisë dhe peshës së trupave;</li> <li>- të ketë të qartë se forca shkakton lëvizjen e trupave si pasojë e bashkëveprimit ndërmjet tyre: tërheqjes, shtyrjes, deformimeve dhe ndërrimit të sasisë së lëvizjes;</li> <li>- të kuptojë shprehjen simbolike <math>\vec{F} = m\vec{a}</math> dhe të kuptojë se kjo shprehje vlen për të gjitha llojet e forcave në natyrë;</li> <li>- të dijë se ndërrimi i energjisë kinetike <math>\Delta E_k</math> është i barabartë me punën A të forcave të jashtme, <math>\Delta E_k = A</math>.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Masa dhe inercioni i trupave. Sasia e lëvizjes. Kuptimi i forcës. Ligji i inercionit. Ligji themelor i dinamikës. Ligji i aksionit dhe reaksionit. Mbledhja dhe zëbrthimi i forcave. Forcat që paraqiten në lëvizjet rrethore. Ligji i ruajtjes së sasisë së lëvizjes. Shembuj të zbatimit të ligjit të ruajtjes së sasisë së lëvizjes (lëvizjet reaktive). Puna dhe fuqia. Energjia potenciale dhe kinetike. Ligji i ruajtjes së energjisë mekanike. Momenti i forcës. Momenti i inercisë. Momenti i sasisë së lëvizjes dhe ligji i ruajtjes. Fërkimi dhe forcat e fërkimit. Elasticiteti dhe forcat elastike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë se bashkëveprimi i trupave është veti universale e lëndë;</li> <li>- t'i zotërojë ligjet e dinamikës dhe t'i zbatojë ato në disa mekanizma e pajisje mekanike që përdoren në industri, transport, bujqësi dhe ndërtim;</li> <li>- të kuptojë se forcat e aksionit dhe e reaksionit lindin dhe zhduken në të njëjtën kohë, edhe pse veprojnë në trupa të ndryshëm;</li> <li>- të shfrytëzojë shprehjen <math>P=A/t</math>;</li> <li>- të kuptojë se kur harxhohet energji - kryhet punë;</li> <li>- të dijë se energjia potenciale është energji e pozitës, kurse energjia kinetike është energji e lëvizjes;</li> <li>- të dijë të sqarojë fenomenin e goditjes me ndihmën e ligjit të ruajtjes së sasisë së lëvizjes dhe të energjisë kinetike.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji i dytë i Njutonit ose ligji i forcës të demonstrohet me anë të karrocës laboratorike për masa dhe forca të ndryshme.</li> <li>- Ligji i aksionit dhe reaksionit të demonstrohet me dy dinamometra të tërhequr me dy forca në dy skajet e kundërta të tij.</li> <li>- Ekzistimi i energjisë potenciale të demonstrohet me ndihmën e sustës kur ajo ngjeshët dhe kur ajo tërhiqet.</li> <li>- Forca centrifugale të demonstrohet me një sferë të lidhur për spango dhe me një dinamometër e cila rrotullohet. Kjo mund të bëhet edhe me ndihmën e diskut rrotullues.</li> </ul>	<p>Matematika: Funkzionet kuadratike dhe vektorët</p> <p>Astronomia: Lëvizja e planetëve i nënshtrohet ligjit të ruajtjes së momentit të sasisë së lëvizjes.</p> <p>Kimi: Energjia e reaksioneve kimike.</p> <p>Biologji: Energjia në organizmat e gjallë dhe lëvizja e gjallesave në ujë si lëvizje reaktive.</p>
LITERATURA: <b>Fizika për kl. I gjimnaz.</b>	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: GRAVITETI (8)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njohë arsyen e rënies së lirë të trupave në sipërfaqe të Tokës.</li> <li>- Të dijë se forca tërheqëse gravitetale është forcë e përgjithshme që vepron ndërmjet të gjithë trupave.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë se forca e gravitetit është vetëm tërheqëse;</li> <li>- të kuptojë se planetët lëvizin rreth Diellit si rezultat i forcës gravitetale;</li> <li>- të kuptojë se edhe satelitët artificialë lëvizin në orbitat e tyre pikërisht si rezultat i kësaj force.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Ligji i Njutonit mbi tërheqjen e përgjithshme. Forca e rëndimit. Pesha e trupave. Qendra e masës. Lëvizja e planetëve. Ligjet e Keplerit. Lëvizja e trupave në afërsi të sipërfaqes së Tokës (hedhja horizontale dhe e pjerrët). Lëvizja e satelitëve artificialë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpejtësia e parë kozmike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë ligjin e Njutonit mbi tërheqjen e përgjithshme;</li> <li>- të njihet me konceptin e fushave, e në veçanti me konceptin e fushës së gravitetit;</li> <li>- t'i kuptojë hedhjen e pjerrët dhe horizontale, si lëvizje të përbëra;</li> <li>- t'i kuptojë tri ligjet e Keplerit dhe lidhjen e tyre me ligjin e tërheqjes së përgjithshme.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Forca tërheqëse e Tokës të demonstrohet me anë të një trupi të varur për dinamometër.</li> <li>- Me rënie të lirë të lëshohen trupa të ndryshëm nga trupa të ndryshëm.</li> <li>- Të kuptojë dallimin ndërmjet fizikës së Aristotelit dhe asaj të Galileit.</li> <li>- Të njihet me eksperimentin e Kevendishit.</li> </ul>	<p>Gjeometria: rrethi, forma e hiperbolës, forma e parabolës, forma e elipsës.</p> <p>Astronomia: lëvizja e planetëve dhe satelitëve të sistemit diellor.</p>
<b>LITERATURA:</b>	
Fizika për kl. II gjimnaz (kapitulli I) që është përdorur deri sot.	

<b>KATEGORIA: LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: BAZAT E TEORISË MOLEKULARE-KINETIKE TË LËNDËS (14)</b>	
<b>QËLLIMET:</b>	<b>OBJEKTIVAT:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptojë natyrën grimcore të lëndës dhe karakteristikat themelore të molekulave: diametri, masa, vëllimi dhe shpejtësia.</li> <li>- Të kuptojë se lëvizja e molekulave të lëndës së ngurtë, të lëngët dhe të gaztë, është lëvizje e përhershme dhe kaotike.</li> <li>- Të njohë ligjet themelore të gazeve ideale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë rëndësinë e energjisë së brendshme dhe mënyrën e ndërrimit të saj;</li> <li>- të kuptojë se të gjitha llojet e substancave përbëhen prej molekulave;</li> <li>- të dijë të dallojë formën matematike të ligjeve të ndryshme të gazeve ideale;</li> <li>- të kuptojë se ekuacioni i Klauzius-Klapejronit në vetvete përfshin të gjitha ligjet e gazeve;</li> <li>- të krijojë përfytyrimin për temperaturën, matjen e saj, shkallët e ndryshme të ndarjes në termometër.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Ndërtimi molekular i lëndës. Madhësia dhe masa e molekulave. Lëvizja kaotike e molekulave. Lëvizja e Braunit. Forcat e bashkëveprimit ndërmjet molekulave. Energjia potenciale e molekulave . Energjia e brendshme e trupave. Modeli i gazit ideal. Madhësitë që përcaktojnë gjendjen e gazit ideal. Proceset themelore të gazeve ideale. Temperatura absolute. Ekuacioni i përgjithshëm i gjendjes së gazeve ideale. Gazet reale. Ekuacioni i Van der Vallsit. Energjia e sipërfaqes së lirë të lëngut. Tensioni sipërfaqësor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë se këto molekula ndodhen në lëvizje të përhershme kaotike;</li> <li>- të dijë se molekula karakterizohet me këto madhësi (është dhënë vetëm rendi i madhësisë): diametri <math>10^{-10}</math> m, masa – <math>10^{-27}</math> kg, vëllimi <math>-10^{-30} m^3</math> dhe shpejtësia –(300-400) m/s;</li> <li>- të dijë se për shkak të lëvizjes së tyre kaotike, molekulat edhe goditen midis tyre;</li> <li>- të kuptojë se gjatësia e rrugës së lirë është ajo gjatësi, të cilën molekula e kalon pa u goditur me molekulat e tjera;</li> <li>- të njihet me fenomenin e difuzionit dhe rëndësinë e tij në natyrë dhe të mësojë se gazet mund të zgjerohen dhe të ngjeshën;</li> <li>- të kuptojë tensionin sipërfaqësor të lëngjeve dhe rëndësinë e tij.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëvizja kaotike (e çrregullt) e molekulave dhe shpërndarja e tyre sipas shpejtësive të demonstrohet me anë të kutisë së Haltonit.</li> <li>- Demonstrimi i ligjeve të Bojl-Mariottit, Sharlit dhe të Gej-Lysakut të bëhet në aparatrat përkatëse që i disponon laboratorit i shkollës.</li> </ul>	<p>Matematika: ekuacionet lineare. Mjekësia: frymëmarrja e qenieve të gjalla. Biologjia: kapilarët dhe ngritja e lëngjeve në kapilarë, presioni osmotik, polenizimi i luleve etj. Ekologjia: ndotja nga gazrat helmuese.</p>
<b>LITERATURA: Fizika për kl. II gjimnaz (kapitulli II) që është përdorur deri sot.</b>	
<b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë:</b>	
<b><u>Termodinamika dhe gazet:</u></b>	
<a href="http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html">http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html</a>	
<a href="http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html">http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html</a>	



<b>KATEGORIA: LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: HYRJE NË TERMODINAMIKË (16)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njohë terminologjinë e termodinamikës.</li> <li>- Të njohë faktin se studimi i dukurive të natyrës studiohet me metoda termodinamike-nga aspekti energjetik.</li> <li>- Të njohë proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme në natyrë, rregullin dhe kaosin, si dhe tendencën e kalimit nga rregulli në kaos.</li> <li>- Të njohë mundësinë e përfitimit të punës së dobishme nga nxehtësia (rendimenti i makinave termike).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë se energjia mund të bartet dhe të shndërrohet në lloje tjera të energjisë;</li> <li>- t'i kuptojë në nivel zbatimi të dy parimet e termodinamikës dhe të ketë të qartë se kur nga nxehtësia fitohet punë e dobishme;</li> <li>- të analizojë të dhënën se përse në natyrë nuk mund të fitohet punë e dobishme pa shpenzimin e ndonjë lloji energjie;</li> <li>- të kuptojë arsyen pse rendimenti i makinave termike është gjithmonë më i vogël se 100%.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE:</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Njohuri themelore mbi termodinamiken. Ndryshimi i energjisë së brendshme dhe nxehtësia. Sasia e nxehtësisë dhe matja e saj. Termokapaciteti i trupave dhe i gazeve. Puna gjatë zgjerimit të gazeve. Parimi i parë i termodinamikës dhe zbatimi i tij në gazet ideale. Proceset adiabatike. Efekti i Xhaul Thomsonit. Proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme. Rregulli dhe kaosi. Parimi i dytë i termodinamikës. Përkufizimi i cikleve termodinamike. Cikli Karno. Motorët termikë. Aparatet për ftohje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptoj se, nxehtësia është formë e energjisë;</li> <li>- rritja e temperaturës shkakton ndërrimin e ngjyrës, madhësisë ose të gjendjes agregate të substancës;</li> <li>- të kuptojë se, termodinamika mbështet në dy ligje, të cilat në i quajmë parime. Të dijë se kalimi i një sistemi termodinamik nga një gjendje në tjetrën mund të bëhet vetëm sipas njërit prej këtyre proceseve: izotermik, izobarik ose adibatik;</li> <li>- të njihet me proceset e ekuilibruara termodinamike;</li> <li>- të njihet me mundësinë e bartjes së energjisë dhe se kjo bartje mund të bëhet vetëm nëse ekziston ndryshimi i temperaturave;</li> <li>- të dijë se nxehtësia rrjedhë gjithmonë prej trupave me temperaturë më të lartë në trupa me temperaturë më të ulët;</li> <li>- të kuptojë mirë nocionin e cikleve;</li> <li>- të njihet me motorët termikë (vetëm ata më kryesorë).</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sasia e nxehtësisë të matet me kalorimetër.</li> <li>- Të bëhet demonstrimi i proceseve adiabatike (ose si quhen ndryshe, procese të shpejta).</li> <li>- Proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme të demonstrohen me ndihmën e një gote me ujë në të cilën hidhët pak ngjyrë.</li> <li>- Motorët termikë të demonstrohen me anë të modeleve standarde që duhet t'i ketë çdo laborator i shkollës.</li> </ul>	<p>Teknika: Ndërtimi i motorëve termikë.  Biologjia: ndotja e mjedisit nga gazet që lirohen gjatë djegies. Proceset e gjalla biologjike si procese të pakthyeshme që i nënshtrohen ligjit të dytë të termodinamikës.  Kimia: Reaksionet dhe proceset e ndryshme kimike dhe llojet e ndryshme të karburanteve.  Astronautikë: Motorët reaktivë të raketave.</p>
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga kjo lëmi: <u>Termodinamika dhe gazet:</u></b>  <a href="http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html">http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html</a>  <a href="http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html">http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html</a></p>	

## MËSIMET ZGJEDHORE (MZ)

NJËSITË MËSIMORE	QËLLIMET
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Sistemet e referimit dhe relativiteti i lëvizjes.</li><li>2. Përcaktimi i masës së Hënës duke shfrytëzuar qendrën e masës të sistemit Tokë-Hënë.</li><li>3. Goditjet e trupave.</li><li>4. Gjatësia e rrugës së lirë të molekulave.</li><li>5. Ligji i difuzionit.</li><li>6. Përfitimi i ligjit të sipërfaqeve të barabarta (ligji i dytë i Keplerit) nga ligji i ruajtjes së momentit të sasisë së lëvizjes.</li><li>7. Përkufizimi i entropisë.</li></ol>	<p>- Mësimet e zgjedhura u dedikohen nxënësve të cilët dëshirojnë t'i thellojnë njohuritë e tyre nga lëmenj të ndryshëm të fizikës.</p>

## USHTRIME LABORATORI (5)

1. Matja e gjatësive dhe masave të disa trupave. Gabimet në matje. Vlera mesatare.
2. Caktimi i dendësisë së një trupi të ngurtë.
3. Përcaktimi i koeficientit të fërkimit të një rrafshi të pjerrët.
4. Përcaktimi i koeficientit të tensionit sipërfaqësor me anë të gypit kapilar.
5. Përcaktimi i nxehtësisë specifike të një trupi të ngurtë me kalorimetër.

**Gjimnazi i Shkencave Shoqërore  
Gjimnazi i Gjuhëve**

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: ZHVILLIMI I MENDIMIT SHKENCOR NGA ANTIKA DERI TE NJUTONI (10)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të krijohet ideja për pozitën e Diellit dhe planetëve para Koperikut dhe pas paraqitjes së tij dhe përparësia e sistemit heliocentrik ndaj atij gjeocentrik.</li> <li>- Të veçohet kontributi i Njutonit në shpjegimin e kuptimit të ligjeve të Keplerit dhe për dukuritë e tjera mekanike nga paraardhësit e tij.</li> <li>- Të bëjë dallimin e punës mekanike, fuqisë dhe energjisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të krijojë përfytyrim për sistemin gjeocentrik dhe heliocentrik;</li> <li>- të kuptojë kontributin e Tiho Brahes në vrojtime dhe fatin historik që pati Kepleri t'i shfrytëzojë ato;</li> <li>- të kuptojë çka ndryshoi Koperniku në sistemin e Ptolemeut;</li> <li>- të njohë kontributin e jashtëzakonshëm të Njutonit për kuptimin e bashkëveprimit në mes të trupave;</li> <li>- të njihet me zbulimet e Galileit;</li> <li>- të analizojë ligjet e Njutonit në mekanikë;</li> <li>- të zbatojë kuptimet: punë, fuqi dhe energji në jetën e përditshme.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Shkenca në Greqinë vjetër. Sistemi gjeocentrik i Ptolemeut. Shkenca në mesjetë. Reforma e Kopernikut. Zbulimet e Galileit. Vrojtimi i Tiho Brahes. Ligjet e Keplerit. Ligji i Njutonit për gravitet. Inercia dhe masa. Sasia e lëvizjes. Forca. Ligjet e Njutonit në mekanikë. Pësha. Puna mekanike dhe fuqia. Energjia kinetike dhe potenciale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të arrijë nivelin e tillë të të kuptuarit që vetë të jetë në gjendje të përcaktojë përparësitë e sistemit heliocentrik ndaj atij gjeocentrik;</li> <li>- të bindet me shembuj nga jeta e përditshme se përparësia i takon sistemit heliocentrik;</li> <li>- të arrijë t'i dallojë nocionet mekanike: inerci, masë, sasi e lëvizjes, forcë, peshë, punë mekanike, fuqi, energji potenciale, energji kinetike etj;</li> <li>- të arrijë nivel të dallojë njësitë matëse të madhësive të cekura dhe t'i zbatojë në jetën e përditshme, si p. sh. në leximin e shpenzimit të energjisë elektrike, energjisë së furnelës etj.</li> </ul>

UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Duhet të fillohet nga shkenca e grekëve të vjetër dhe kontributi i tyre për fillet e njohjes së sistemit diellor. Të tregohet se në atë nivel të gjitha shkencat janë studiuar së bashku. Vazhdohet me kontributin e shkencës arabe në mesjetë: në astronomi, elektricitet, optikë dhe arrihet deri te paraqitja e Kopernikut. T'i tregohet nxënësit se çka ndryshoi Koperniku në sistemin e deriatëhershëm gjeocentrik. Të vazhdohet me zbulimet që bëri Galileu pas ndërtimit të teleskopit, por edhe me korrigjimin që i bëri Kepleri orbitave rrethore të Kopernikut. Të përkufizohen madhësitë mekanike dhe ardhja e logjikshme e qëndrimeve të Njutonit për shpjegimin e shumë dukurive mekanike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Historia e kohës së vjetër për shpjegimin e shumë detajeve nga kultura greke dhe helene.</li> <li>- Astronomia në kuadër të zhvillimit historik të ideve të vjetra.</li> <li>- Matematika elementare e shkollës fillore: ekuacionet lineare dhe operimi me thyesa është i mjaftueshëm.</li> <li>- Histori e fizikës për të dhënat biografike të Arkimit, Aristotelit, Ptolemeut, Kopernikut, Keplerit, Galileit dhe Njutonit.</li> </ul>
<p><b>LITERATURA</b></p> <p>Në mungesë të librit adekuat, nxënësit dhe veçanërisht arsimtarët mund të përdorin librin e astronomisë i cili është në përdorim për gjimnaz (fq. 56-66) duke iu shmangur matematikës, librin e kl. I gjimnaz (fq. 49-52. , fq 85-87), disa mësimet në mes të fq. 108-120, por duke iu shmangur matematikës aty ku është e mundur. Mund të përdoret edhe libri i historisë së vjetër, në mësimet për shkencën, kulturën dhe astronominë.</p>	
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga kjo lëmi:</b>  <b><u>Historia e fizikës dhe astronomisë:</u></b>  <a href="http://pratt.edu/~arch543p/help/physics.html">http://pratt.edu/~arch543p/help/physics.html</a>  <a href="http://www.physlink.com/Education/History.cfm#general">http://www.physlink.com/Education/History.cfm#general</a>  <a href="http://www.weburbia.demon.co.uk/pg/hist1.htm">http://www.weburbia.demon.co.uk/pg/hist1.htm</a></p>	

<b>KATEGORIA: FIZIKA BASHKËKOHORE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: NGA NJUTONI DERI TEK AJNSHTAJNI ( 7 )</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të krijohet ideja e ekzistimit të eterit kozmik, që lind nga kërkesa e analogjisë së gabuar në mes të dukurive mekanike dhe dukurive të elektromagnetike.</li> <li>- Të njihet me ndryshimin e mbledhjeve të shpejtësisë në fizikën e Njutonit dhe atë të Ajnshtajnit.</li> <li>- Të njihet me përkufizimin relativist të madhësi: masë relativiste, energji relativiste, impuls relativist dhe <math>t'</math> krahasojë me përkufizimin tyre njutonian.</li> <li>- Të përfytyrojë se shpejtësia e dritës është madhësi absolute dhe ligj natyrorë.</li> <li>- Të krahasojë mbledhjen klasike të shpejtësive me atë relativiste.</li> <li>- Të krijojë përfytyrim se në shqyrtimin realtivist koha brymehet, kurse gjatësia shkurtohet.</li> <li>- <math>T'</math> i sqarohet se në cilat raste një dukuri shqyrtohet si relativiste dhe jorelativiste.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë dallimin në mes të shqyrtimit relativist dhe jo relativist të një madhësie apo dukurie;</li> <li>- të njihet me arsyetimin pse është paraqitur hipoteza e ekzistimit të eterit kozmik;</li> <li>- të kuptojë këtë dallim për madhësitë themelore si: masën, impulsin dhe energjinë;</li> <li>- të analizojë rrjedhimet që dalin nga kuptimi i dilatacionit të kohës dhe të shkurtimeve të gjatësive në kah të lëvizjes;</li> <li>- të arrijë të krijojë bindjen se efektet relativiste nuk mund të realizohen me shpejtësitë teknike të sotit;</li> <li>- të kuptojë se trajtimi relativist i dukurive është depërtim më i thellë në fshehtësitë e natyrës dhe njohjes njerëzore në përgjithësi.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Shembuj nga jeta e përditshme për karakterin relativ të madhësive (p. sh. djathtas – majtas, poshtë – lart etj. ).</p> <p>Hipoteza e ekzistimit të eterit kozmik.</p> <p>Vlera konstante e shpejtësisë së dritës dhe karakteri absolut i saj. Mbledhja e shpejtësive në fizikë klasike dhe relativiste. Dilatacioni i kohës. Shkurtimi i gjatësive. Karakteri relativ i masës. Impulsi relativist. Energjia relativiste.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të arrijë nivel të atillë të të kuptuarit që vet të paraqet ndonjë shembull për kuptimet relativiste nga jeta e përditshme;</li> <li>- të jetë i aftë të dallojë shqyrtimin relativist dhe klasik të dukurive: dilatacioni i kohës dhe shkurtimeve të gjatësive;</li> <li>- duke u bazuar në shembuj të mbledhjes së shpejtësive të vogla me shpejtësinë e dritës të dijë të arsyetojë se shpejtësia e dritës nuk mund të zmadhohet me asgjë;</li> <li>- të zotërojë kuptimet relativiste të madhësive themelore fizike.</li> </ul>

UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Që të arsyetohen kuptimet relativiste në fizikë duhet të fillohet nga konceptet relativiste klasike të jetës së përditshme, por për të cilat kurrë nuk jemi përqendruar. P. sh. kuptimet majtas apo djathtas, poshtë apo lart, afër apo larg dhe shumë të tjerë. Me këtë edhe nxënësi do të kyçet duke paraqitur ndonjë shembull nga jeta e përditshme. Arsyetohet me disa shembuj se drita nuk mund të zmadhohet ashtu që vlera e pandryshueshme e saj paraqet ligj natyror. Merren shumë shembuj nga fizika bashkëkohore ku tregohet çfarë depërtimi në thellësi të njohjes paraqesin kuptimet dilatacion i kohës dhe shkurtim i gjatësisë. Mund të merret si shembull edhe paradoksi i binjakëve. Arsyetimet e tjera vazhdojnë si krahasim në mes të kuptimeve klasike dhe relativiste. Gjatë gjithë kësaj duhet ikur aparatit matematik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Matematikë: mbledhja dhe zbritja e madhësive.</li> <li>- Histori e fizikës për të dhënat biografike të Ajnshtajnit.</li> </ul>
<p><b>LITERATURA</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit dhe arsimtarët do të kuptojnë më së miri teorinë e relativitetit të cilën e përpiloi Ajnshtajni nëse e shfrytëzojnë doracakun me titull <b>Teoria speciale dhe e përgjithshme e relativitetit</b> të autorit prof. dr. Rasim Bejtullahu, i cili është shkruar për nevojat e nxënësve të shkollës fillore dhe të shkollave të mesme. Në këtë doracak i cili është shkruar pa asnjë formulë matematike por vetëm me ilustrime të lira të piktorit mund të mësoni jo vetëm për biografinë e Ajnshtajnit, por për të gjitha problemet e tjera që shtrohen në teori të relativitetit duke mos e njohur fare matematikën.</li> <li>- Fizika për kl. I të gjimnazit (fq. 131-135).</li> </ul>	
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga kjo lëmi:</b>  <b><u>Ajnshtajni dhe relativiteti:</u></b>  <a href="http://www.astro.ucla.edu/~wright/relatvty.htm">http://www.astro.ucla.edu/~wright/relatvty.htm</a></p>	

<b>KATEGORIA: LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: GAZET E PËRSOSURA (5)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njihet me ligjet e gazeve dhe ligjshmëritë në mes të tyre.</li> <li>- Të kyçet në metodat elementare të hulumtimit të gazeve.</li> <li>- Të fitojë aftësi për arritjen e përfundimeve për përgjithësime, për argumentim sasior dhe vendosjen e lidhjeve funksionale të vetive të gazeve të përsosur.</li> <li>- Të zhvillojë vetëdijen për nevojën e shfrytëzimit racional të energjisë së gazeve dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor.</li> <li>- Të njihet me rolin e studimit të gazeve në tektologjitë bashkëkohore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë se lënda ndërtohet prej molekulave;</li> <li>- të krijojë përfytyrim për madhësitë e molekulave;</li> <li>- të krijojë idenë çka është temperatura dhe mundësinë e matjes së saj me termometra;</li> <li>- të njohë vetitë që i karakterizojnë gazet e përsosura;</li> <li>- të njohë dallimin në mes të gazeve të përsosur dhe gazeve reale;</li> <li>- të kuptojë ligjet themelore sipas së cilave zotërojnë gazet e përsosura.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Metodat e studimit të dukurive të nxehtësisë. Ndërtimi i lëndës. Madhësia e molekulave. Vetitë e gazeve të përsosura. Kuptimi i temperaturës. Termometrat. Izoproceset: ligji i Boil-Mariotit, ligji i Gej – Lysakut, ligji i Sharlit. Temperatura absolute dhe izoproceset. Ekuacioni i gjendjes së gazeve të përsosura. Ligji i Avogadros.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të arrijë nivel të mjaftueshëm për operim me numra shumë të vegjël në formë eksponenciale, për shprehje të nënfishave të kg;</li> <li>- të dijë të shprehë masën e molekulave në kg;</li> <li>- të kuptojë ndërtimin e lëndës së ngurtë, të lëngët dhe të gaztë nga molekulat;</li> <li>- të arrijë që edhe vetë të vërtetojë saktësinë e ligjeve të gazeve të përsosura me aparaturën që ka shkolla;</li> <li>- të kuptojë parimin e punës së termometrave;</li> <li>- të njihet me shkallë të ndryshme të matjes së temperaturës.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<p>Duhet të fillohet me ekzistimit e dy ecurive për studimin e nxehtësisë, sipas studimit të lëvizjes kaotike të grimcave të gazit që njihet si teori kinetike – molekulare e gazeve dhe studimit nga aspekti energjetik që njihet me emrin termodinamikë. Vazhdohet me përkufizimin e madhësive të molekulave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Matematika elementare e shkollës fillore. Funksionet eksponenciale me qëllim të arritjes së të kuptuarit të shprehjes së numrave shumë të vegjël në formë eksponenciale. Preferohet që njëkohësisht të mësohet edhe shprehja e numrave shumë të mëdhenj në formë eksponenciale, sepse do t'i shërbejë për</li> </ul>

<p>Veçanërisht t'i kushtohet vëmendje që nxënësi të kuptojë mundësinë e shprehjes së numrave të vegjël në formë eksponenciale. Në këtë drejtim ai do të arrijë që të shprehë masën e një apo të shumë molekulave me ndihmën e kg. Kjo do t'i nevojitet atij gjatë tërë jetës. Vetitë e gazeve të përsosura mund të shpjegohen në formë demonstrimi duke përdorur shumë pak aparatit matematik. Gjatë demonstrimit të kyçen medoemos edhe nxënësit dhe do të jetë e preferuar që gjatë përsëritjes arsimtari të ketë rol dytësor.</p>	<p>shprehjen e numrit të molekulave në substancë. - Ekologjia. Sa herë që kemi punë me gaze dhe shfrytëzimin e energjisë së tyre duhet përkujtuar edhe ruajtjen e mjedisit jetësor.</p>
<p>LITERATURA</p> <p>Për të gjithë përmbajtjen programore të kësaj nënkategorie mjafton Fizika e kl. II gjimnaz, drejtimi i shkencave të natyrës, me kusht që aparati matematik të zvogëlohet deri në minimum. Nxënësit e që dëgjojnë këto leksione nuk kanë nevojë për analiza të thella matematikore.</p>	
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë:</b>  <b>Termodinamika dhe gazet:</b>  <a href="http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html">http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html</a>  <a href="http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html">http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html</a></p>	



<b>KATEGORIA: LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: TERMODINAMIKA (7)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohja me nocionet themelore që përdoren në termodinamikë.</li> <li>- Njohja me kuptimin e energjisë së brendshme dhe me mundësitë e ndryshimit të saj.</li> <li>- T'i afrohen fakte se njeriu nuk mund të shfrytëzoj tërë energjinë e gazeve natyrore.</li> <li>- Të zhvillojë vetëdijen për nevojën e shfrytëzimit racional të energjisë së gazeve dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor, me theks të veçantë në punën e makinave termike.</li> <li>- Të njihet me përmbajtjen e ligjit energjetik të termodinamikës.</li> <li>- T'i ofrohen të dhëna dhe shembuj nga jeta e përditshme për ekzistimin e proceseve të kthyeshme dhe të pakthyeshme në natyrë.</li> <li>- T'i ofrohen fakte se proceset në natyrë rrjedhin nga rregulli në kaos, por jo në të kundërtën, nga kaosi në rregull.</li> <li>- Të njihet me kuptimin e rendimentit të motorëve termikë dhe të bindet se vetëm një pjesë e vogël e energjisë së gazeve shfrytëzohet për nevoja njerëzore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë se çka është energjia e brendshme e trupave;</li> <li>- të analizojë përmbajtjen e ligjit energjetik të termodinamikës;</li> <li>- të analizojë pse natyra nuk lejon shfrytëzimin e tërësishëm të energjisë së gazeve;</li> <li>- të bindet me fakte nga jeta e përditshme se nuk është i mundshëm procesi në të cilin nxehtësia shndërrohet vetëm në punë mekanike pa procese të tjera;</li> <li>- të bëjë dallimin në mes të proceseve të kthyeshme dhe të proceseve të pakthyeshme;</li> <li>- të kuptojë se ligji i dytë i termodinamikës thekson kushtet që e plotësojnë ligjin energjetik;</li> <li>- të kuptojë çka është rendimenti i makinave termike dhe të arrijë nivel të njehsimit të tij;</li> <li>- të analizojë pse në natyrë proceset rrjedhin nga rregulli në kaos.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Përkufizime themelore të nocioneve të termodinamikës.  Energjia e brendshme e trupave.  Ndryshimi i energjisë së brendshme.  Termokapaciteti i trupave dhe gazeve.  Ligji energjetik i termodinamikës.  Proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme. Rregulli dhe kaosi.  Parimi i dytë i termodinamikës.  Motorët termikë. Redimenti i makinave termike. Cikli i Karnos.  Aparatet për ftohje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë për dy aspekte të studimit të gazeve;</li> <li>- të kuptojë përmbajtjen e ligjit energjetik të termodinamikës dhe kufizimet e tij që shprehen me ligjin e dytë;</li> <li>- të kuptojë çka është rregulli, çka është kaosi dhe si rrjedhin proceset në natyrë;</li> <li>- të arrijë nivel të kënaqshëm në të kuptuarit e punës së motorëve termikë;</li> <li>- të kuptojë si punojnë aparatet për ftohje;</li> <li>- të dijë të njehsojë rendimentin e makinave termike.</li> </ul>

UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Nxënësi duhet të njihet së pari me nocionet që përdoren në termodinamikë. Vazhdohet me shpjegim se çka kuptojmë me energji të brendshme të trupit. Nga këtu vetvetiu rrjedhin mundësitë si të ndryshohet kjo energji. Këtu mund të shpjegojmë njëkohësisht rregullin dhe kaosin si dhe rrjedhjen e proceseve në natyrë nga rregulli ka kaosi. Me shembuj nga jeta e përditshme shpjegohet ligji energjetik i termodinamikës, si dhe kufizimet e tij të përshkruara me ligjin e dytë. Motorët termikë janë pjesë e pandarë e jetës sonë, sikurse edhe aparatet për ftohje. Me aftësimin e njehsimit të rendimentit të makinave termike tregohet se njeriu nga natyra shfrytëzon vetëm një pjesë shumë të vogël të energjisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Matematika elementare që mësohet në shkollë fillore.</li> <li>- Teknika e aparateve dhe rendimenti i tyre.</li> <li>- Ekologjia si nevojë e ruajtjes së mjedisit jetësor, sidomos kur flitet për lirim të gazeve nga motorët termikë, djegia e të cilëve nuk funksionon si duhet.</li> </ul>
<p>LITERATURA</p> <p>Të gjitha këto leksione mund të gjenden në librin e fizikës për kl. II të gjimnazit të drejtimit të shkencave të natyrës, por duhet të thjeshtësohen deri në minimum nga aparati matematikor, fq. 30-56. Është e mirëseardhur edhe ndonjë literaturë tjetër nga shkolla e mesme teknike ku bëhet fjalë për motorët termikë.</p>	
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë:</b>  <b><u>Termodinamika dhe gazet:</u></b>  <a href="http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html">http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html</a>  <a href="http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html">http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html</a></p>	

<b>KATEGORIA: ELEKTRICITETI DHE MAGNETIZMI</b>	
<b>NËNKATEGORIA: ELEKTROSTATIKA DHE RRYMA ELEKTRIKE NJËKAHORE (10 )</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohja me dy lloje të elektricitetit në natyrë nga struktura e atomit.</li> <li>- T'i afrohen fakte të ekzistimit të këtyre llojeve duke fërkuar thuprën e ebanitit dhe të qelqit.</li> <li>- Të njihet me bashkëveprimin e ngarkesave me emër të njëjtë dhe me emër të kundërt.</li> <li>- Të jepen fakte për përmbajtjen sasiore të ligjit të Kulonit.</li> <li>- Njohja e fushës elektrike.</li> <li>- T'i afrohen fakte se rryma elektrike është rrjedhim i ngarkesave nëpër përcjellës.</li> <li>- Të njihet me ligjin e Omit për pjesë të qarkut dhe qark të mbyllur elektrik.</li> <li>- Të njihet me efektet e rrymës elektrike e në rend të parë me punën dhe fuqinë e saj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë si bashkëveprojnë ngarkesat elektrike me të njëjtin emër dhe me emër të kundërt;</li> <li>- të kuptojë përmbajtjen e ligjit të Kulonit mbi të cilin ndërtohet bashkëveprimi i ngarkesave në natyrë;</li> <li>- të njohë se puna mekanike matet me njësi të njëjta sikurse puna elektrike;</li> <li>- të analizojë pse rezistenca elektrike shprehet me ngritje të temperaturës;</li> <li>- të kuptojë përmbajtjen e ligjit të Omit;</li> <li>- të zbatojë në jetën e përditshme njohuritë e arritura nga njohja e qarkut elektrik dhe kyçjen e shpenzuesve në të;</li> <li>- të kuptojë si lexohet ora elektrike në shtëpi për harxhimin e energjisë elektrike dhe si njehsohet vlera e pagesës.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Dy lloje të elektricitetit. Ligji i Kulonit. Fusha elektrostatische. Puna në fushë elektrostatische. Potenciali. Tensioni. Intensiteti dhe dendësia e rrymës elektrike njëkahore . Ligji i Omit për pjesë të qarkut dhe qark të mbyllur elektrik. Rezistenca elektrike. Rezistorët dhe lidhje e tyre. Puna dhe fuqia e rrymës elektrike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të arrijë nivel të mjaftueshëm për vrojtim të bashkëveprimit të ngarkesave me elektroskop dhe elektrometër;</li> <li>- të dijë të bëjë dallimin në mes të punës elektrike, potencialit dhe tensionit;</li> <li>- të dijë njësitë matëse të punës, potencialit dhe të tensionit;</li> <li>- të arrijë njohje nga rryma elektrike të nivelit që të mund të lidhë siguresat në shtëpinë e vet;</li> <li>- të dijë se gjatë punës me rrymë elektrike duhet pasur kujdes të veçantë, sepse çdo gabim i vogël mund të jetë fatal.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<p>Fillohet nga struktura e lëndës duke treguar se ekzistojnë ngarkesat elementare pozitive dhe negative. Arsyetohet fakti se këto ngarkesa bashkëveprojnë sipas ligjit sasiore të</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Matematika elementare e nivelit të shkollës fillore.</li> <li>- Teknologji me TIK për njohjen e materialeve të cilët përdoren në qarqet elektrike.</li> </ul>

<p>Kulonit. Tregohet se ngarkesa krijon një fushë me të cilën komunikon me rrethinën. Njehsohet puna në këtë fushë dhe arrihet deri te përkufizimi i potencialit. Nxënësi duhet të dijë domosdo si përkufizohen: fusha, potenciali dhe tensioni, si dhe njësitë matëse të tyre. Rryma elektrike të trajtohet si lëvizje e ngarkesave nën veprimin e ndryshimit të tensionit. Të merren shembuj nga jeta e përditshme që të kuptohet me lehtë rezistenca elektrike, por kurrësi të mos bëhet analogji në mes të rrjedhjes së ujit dhe rrymës elektrike. Nxënësit gjatë orës mund të tregojnë se si lidhen rezistorët të cilët gjenden në kabinetin e shkollës, por edhe të paraqesin lidhjen në qark elektrik me burim në bateri apo akumulator.</p>	
<p>LITERATURA</p> <p>Të gjitha këto leksione mund të gjenden në librin e fizikës për kl. II të gjimnazit të drejtimit të shkencave të natyrës, por duhet të thjeshtësohen deri në minimum nga aparati matematikor, fq. 97-124. Është e mirëseardhur edhe ndonjë literaturë tjetër nga shkolla e mesme teknike, ku bëhet fjalë për elektrostatikën dhe rrymën elektrike.</p>	
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë:</b>  <b><u>Elektriciteti dhe magnetizmi:</u></b>  <a href="http://www.mip.berkeley.edu/physics/bookddx.html">http://www.mip.berkeley.edu/physics/bookddx.html</a></p>	

<b>KATEGORIA: ELEKTRICITETI DHE MAGNETIZMI</b>	
<b>NËNKATEGORIA: FUSHA MAGNETIKE DHE INDUKSIONI ELEKTROMAGNETIK (EM) (5 )</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohja me dy lloje të fushave magnetike. Me fushën magnetike të magneteve të përhershëm dhe fushën magnetike rreth përcjellësit me rrymë.</li> <li>- Në mënyrë empirike të shehë se rreth përcjellësit drejtvizor i cili kalon nëpër grimca të pluhurit krijohen vijat e fushës magnetike.</li> <li>- T'i afrohen fakte dhe dëshmi se edhe Toka është magnet gjigant me dy pole magnetike.</li> <li>- Në mënyrë empirike të arrijë deri te kuptimi i veprimit të fushës magnetike në përcjellësin me rrymë.</li> <li>- Të njihet me disa metoda për induksion EM.</li> <li>- Të njihet me faktet që i zbuloi Faradei dhe i formuloi në formë të ligjit.</li> <li>- T'i arsyetohet e dhëna se rryma alternative gjenerohet pikërisht duke u bazuar në induksionin EM.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë ekzistimin e dy llojeve të magneteve;</li> <li>- të kuptojë se rreth përcjellësit paraqitet fushë magnetike;</li> <li>- të analizojë arsyeshmerinë pse Toka trajtohet si magnet gjigant;</li> <li>- të zbatojë veprimin e fushës magnetike në përcjellësin me rrymë në ndërtimin e elektromotorit;</li> <li>- të kuptojë forcën elektrolëvizore të induktuar;</li> <li>- të njohë shumë metoda me të cilat sigurohet forca elektrolëvizore e induktuar;</li> <li>- të kuptojë se të gjitha metodat e krijimit të forcës elektrolëvizore të induktuar nuk janë të përshtatshme për zbatime praktike;</li> <li>- të kuptojë se krahas burimeve të rrymës njëkahore ekzistojnë edhe burimet e rrymës alternative, të cilat gjenerohen në gjenerator duke zbatuar dukurinë e induksionit EM.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Fusha magnetike e përcjellësit drejtvizor. Fusha magnetike magneteve të përhershme. Fusha magnetike e Tokës. Veprimi i fushës magnetike në përcjellësin me rrymë. Ligji i Amperit. Zbulimet e Faradeit për induksion EM. Induksioni magnetik në përçuesin e palëvizshëm. Ligji i Faradeit për induksion EM. Vetinduksioni.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë për dy fusha magnetike;</li> <li>- të kuptojë se rreth përcjellësit me rrymë krijohet fusha magnetike;</li> <li>- të kuptojë parimin për induksion EM;</li> <li>- të arrijë njohje të atillë që vetë të propozojë ndonjë ide për induksion EM e cila nuk është shpjeguar në leksione;</li> <li>- të dijë të interpretojë ligjin e Faradeit për induksion EM;</li> <li>- të kuptojë parimin e gjenerimit të rrymës alternative.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<p>Preferohet që shumica e këtyre leksioneve të shpjegohen në formë të</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Matematika elementare në nivel të operimeve themelore.</li> </ul>

<p>demonstrimeve. Për këtë qëllim nuk kërkohet ndonjë veglëri e veçantë: tel i hollë, kartuç, pluhur hekuri, bateri xhepi apo akumulator, bobinë, magnet i përhershëm në formë thupre, busull magnetike etj. Për nxënësin do të jetë shumë efektive dhe e paharrueshme kur i sheh vijat rrethore nga pluhuri i hekurit në kartuç rreth telit të kyçur në bateri xhepi. Ai do të arrijë vetë deri te përfundimi se vijat e fushës magnetike të rrymës elektrike janë vija të mbyllura. Me këtë do të krahasojë fushën e sasisë pikësore të elektricitetit (vijat dalin nga burimi) dhe do të kuptojë se vijat e fushës elektrike kanë burim, kurse të fushës magnetike nuk kanë. Në mënyrë të ngjashme do të provojmë edhe induksionin EM ta shpjegojnë duke demonstruar. Aparati matematik që përdoret do të jetë shumë i ulët, gati i panevojshëm</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjeometria për përcaktimin e drejtëve, kaheve të madhësive.</li> <li>- Anatomia për shfrytëzim të rregullës së dorës së djathtë.</li> <li>- Teknologji me TIK për njohjen e materialeve që përdoren në qarqet elektrike.</li> </ul>
<p>LITERATURA</p> <p>Leksionet për fushë magnetike mund të gjenden në librin e fizikës për kl. II të gjimnazit të drejtimit të shkencave të natyrës, por duhet të thjeshtësohen deri në minimum nga aparati matematikor (fq. 136-144), ndërsa leksionet për induksion EM mund të gjenden në librin e kl. III të gjimnazit të drejtimit të përgjithshëm dhe shoqëror- gjuhësor (fq. 49-56), por edhe këtu duhet të kursehem nga matematika sa është e mundur.</p>	
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë:</b>  <b><u>Elektriciteti dhe magnetizmi:</u></b>  <a href="http://www.mip.berkeley.edu/physics/bookddx.html">http://www.mip.berkeley.edu/physics/bookddx.html</a></p>	

<b>KATEGORIA: FIZIKA BASHKËKOHORE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: STRUKTURA E ATOMIT (10)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njohë zhvillimin historik të ideve të para për ndërtimin e atomit.</li> <li>- Të njohë modelin e parë të Xh. Xh. Tomsonit dhe modelin planetarë të E. Raterfordit.</li> <li>- Të kuptojë se hipoteza e Plankut për rrezatim të trupit absolut të zi paraqet shkëputje nga fizika klasike.</li> <li>- Të njohë postulatet e Borit.</li> <li>- Të kuptojë se drita e ka burimin në kalimet e elektroneve brenda atomit.</li> <li>- Të njohë faktin se drita mund të trajtohet edhe si grimcë edhe si valë, në varësi prej natyrës së problemeve që i shqyrtojmë.</li> <li>- Të kuptojë se po ky dualizëm vlen edhe për të gjitha grimcat e tjera.</li> <li>- Të njohë me karakteristikat themelore të bërthamës së atomit.</li> <li>- Të krijojë qëndrim të drejtë për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe të kujdeset për mbrojtjen e organizmit të vet nga rrezatimi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë zhvillimin e ideve të ndërtimit të atomit nga Tomsoni dhe Raterfordi;</li> <li>- të kuptojë se hipoteza e Plankut për rrezatim paraqet një prej revolucioneve më të mëdha në fizikë dhe paraqet shkëputje nga konceptet klasike;</li> <li>- të njohë ato dukuri për shpjegimin e së cilave duhet supozuar se drita ka karakter grimcor dhe dukuritë e tjera për shpjegimin e së cilave duhet të merret karakteri valorë i dritës;</li> <li>- të kuptojë se dualizmi grimcë - valë mund të shtrihet edhe për të gjitha grimcat e tjera elementare dhe të njohë mundësinë se postulatet e Borit mund të arsyetohen nga hipoteza e ekzistimit të valëve të materie;</li> <li>- të kuptojë karakteristikat themelore të bërthamës së atomit;</li> <li>- të dijë se atomi në gjendje normale është elektroneutral;</li> <li>- të dijë si duhet mbrojtur nga rrezatimi radioaktiv.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Modelet e Tomsonit dhe Raterfordit për atom. Hipoteza e Plankut për rrezatim. Postulatet e Borit. Fotonet. Dualizmi foton- valë për dritën. Dualizmi grimcë-valë për grimca të tjera elementare. Hipoteza e De Broilit dhe postulatet e Borit. Masa dhe ngarkesa e bërthamës së atomit. Përmasat e bërthamës. Rrezatimi radioaktiv. Ligji i zbërthimit radioaktiv. Mbrojtja nga rrezatimi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të fitojë atë nivel të njohjes, që të jetë në gjendje të bëjë dallimin në mes të modelit të Tomsonit dhe të Raterfordit;</li> <li>- të dijë postulatet e Borit;</li> <li>- të kuptojë se dualizmi valë – grimcë është veti fundamentale e grimcave;</li> <li>- të kuptojë karakteristikat themelore të bërthamës së atomit;</li> <li>- të dijë të zbatojë ligjin e zbërthimit radioaktiv;</li> <li>- të dijë njësitë që përdoren për mbrojtje nga rrezatimi.</li> </ul>

UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Të gjitha leksionet që ceken më lart kanë karakter teorik, por meqë shpjegimi i përpiktë i tyre kërkon njohje të mirë të matematikës, atëherë do të kënaqemi me një përshkrim historik të dukurive. Fillohet nga tentimi i parë i Tomsonit që të paraqesë modelin e atomit dhe vazhdohet me modelin planetar të Raterfordit, i cili vërtetoi se gati e tërë masa e atomit është e koncentruar në bërthamë. Pastaj paraqitet N. Bori me postulatet e veta, të cilat i zbaton në atomin e hidrogjenit. Kuantet energjetike që krijohen gjatë kalimit të elektronit nga një nivel energjetik në tjetrin Ajnshtajni i quajti fotone. Fotonet kanë natyrë duale, sepse manifestohen edhe si grimcë edhe si valë. Këtë dualizëm më vonë e zgjeroi edhe L. de Broli për valët e materies.</p> <p>Zbërthimi radioaktiv duhet të shpjegohet pa ngarkesë matematike, sepse nxënësit nuk kanë njohuri të mjaftueshme. Si të mbrohemi nga rrezatimi bërthamor është njëri nga leksionet me prioritet, sepse është nevojë e kohës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Matematika elementare. Në kuadër të saj funksionet eskponenciale dhe operimi me thyesa.</li> <li>- Radiometria si nevojë e mbrojtjes nga rrezatimi.</li> </ul>
<p>LITERATURA</p> <p>Leksionet për ligje të rrezatimit dhe ligjin e Plankut gjenden në fizikën për kl. IV dega: shëndetësi, tekstil, lëkurëtari dhe veterinë, (fq. 8-35), kurse fizika bërthamore dhe zbërthimi radioaktiv në fizikën e kl. IV gjimnaz, drejtimi shoqëror- gjuhësor, dhe i përgjithshëm (fq. 21-70). Arsimtari do të marrë leksionet nga faqet e cekura duke e ulur kërkesën e arsyetimeve matematikore.</p>	
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë:</b>  <b>Struktura e atomit dhe e bërthamës:</b>  <a href="http://web.jjay.cuny.edu/~acarp/NSC/3-atoms.htm">http://web.jjay.cuny.edu/~acarp/NSC/3-atoms.htm</a>  <a href="http://www.sciencejoywagon.com/physicszone/lesson/10modern.htm">http://www.sciencejoywagon.com/physicszone/lesson/10modern.htm</a></p>	



<b>KATEGORIA: ASTRONOMIA</b>	
<b>NËNKATEGORIA: KOZMOLOGJIA (20)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Që lënda të bëhet sa më interesante dhe më atraktive.</li> <li>- Njohja e nxënësve me trupa qiellorë dhe ligjshmërinë në mes të tyre.</li> <li>- Të zhvillojë aftësitë për vrojtim të saktë dhe kritik.</li> <li>- Të fitojë aftësi për arritjen e përfundimeve, përgjithshme, argumentim të fakteve dhe për vendosjen e lidhjeve funksionale në mes të dukurive të vrojuara në sferë qiellore.</li> <li>- Të njihet me karakteristikat themelore të trupave qiellorë dhe kozmologjinë në përgjithësi.</li> <li>- Të krijojë përfytyrim racional për gjithësinë.</li> <li>- Të njihet me rolin e vrojtimit në astronomi.</li> <li>- Të dallojë llojet e trupave në gjithësi.</li> <li>- Të arrijë aftësi të përcaktojë pozitat e yjeve më të ndritshëm në sferë qiellore.</li> <li>- Të njihet me unitetin e trupave qiellorë dhe me krijimin e tyre nga materiali i njëjtë i gjeneratave të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë pozitën e Tokës në sistem diellor, pozitën e Diellit në Galaktikë dhe pozitën e Galaktikës në raport me galaktikat e tjera në Gjithësi;</li> <li>- të dallojë yjësitë në sferë qiellore përnga forma dhe koha e paraqitjes gjatë vitit;</li> <li>- të kuptojë ekzistimin e llojeve të ndryshme të trupave qiellorë të cilët janë krijuar nga materiali i njëjtë në gjenerata të ndryshme;</li> <li>- të krijojë përfytyrimin për dy modelet ekzistuese të gjithësisë;</li> <li>- Të njohë vetitë fizike, temperaturën dhe karakteristikat e tjera të trupave qiellorë;</li> <li>- të bëjë dallimin në mes të vetive të yllit, planetit, satelitit, meteorit, kometës etj.;</li> <li>- të kuptojë se lansimi i teleskopëve në fluturake në orbitë të Tokës ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për zbulimin masiv të trupave të vegjël që nga Toka janë të padukshëm.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<p>Yjësitë dhe orientimi në qiell. Trupat që e përbëjnë sistemin diellor. Të dhëna të përgjithshme dhe karakteristikat e Diellit. Planetët e sistemit diellor. Trupat e vegjël në sistem diellor. Fazat e Hënës. Karakteristikat fizike të Hënës. Origjina e krijimit të sistemit diellor. Vetitë fizike, përbërja kimike dhe tipat spektralë të yjeve. Lëvizjet vetjake të yjeve. Yjet e dyfishta. Yjet e ndryshueshme. Lindja dhe evolucioni i yjeve. Yjet e reja dhe super të reja. Pulsarët dhe vrimat e zeza. Të dhëna themelore për ndërtimin e Galaktikës. Grumbullimet yjore. Materia ndëryjore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përvetësojë terminologjinë kozmologjike;</li> <li>- të përvetësojë emrat e yjeve më të ndritshëm në qiell dhe pozitat e tyre;</li> <li>- të dijë të përcaktojë pikat e horizontit në përgjithësi dhe të objekteve të tjera në raport me to (pozitën e shkollës, shtëpisë apo objekteve ndaj pikave të horizontit duke u orientuar nga lartësia e Diellit mbi horizont);</li> <li>- të dijë të orientohet në hapësirë me pozitën e yjësisë;</li> <li>- nga vrojtimi i fazës dhe koha e paraqitjes së Hënës të nxjerrë përfundim të saktë për katërshinën e saj;</li> </ul>

<p>Fusha magnetike, rrezet kozmike dhe radiorrezatimi. Galaktikat dhe llojet e tyre. Ligji i Hablit dhe kuptimi i tij. Kuazarët. Metagalaktika dhe rrezatimi mikrovalorë. Fotonet relik. Zgjerimi i gjithësisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të aftësohet të dallojë në sferë qiellore planetët nga yje;</li> <li>- të aftësohet të gjejë në mes të yjeve pozitat e planetëve;</li> <li>- të dijë që përafërsisht të gjejë pozitën e radiantëve në mes të yjësive për vrojtimin e rrebesheve meteorike;</li> <li>- të aftësohet të dallojë ndryshimin e yjeve sipas ngjyrës.</li> </ul>
<p><b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b></p>	<p><b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b></p>
<p>Këto leksione do të shpjegohen plotësisht në mungesë të matematikës. Është e preferuar që arsimtari të zgjedhë kohën e bukur, qiellin e hapur dhe pa pluhur që një pjesë të lëndës ta verifikojë me vrojtim. Për këtë qëllim duhet të ketë hartën qiellore dhe të diktojë pozitat e yjeve në të. Pastaj, së bashku me nxënës, në pjesët e qytetit më pak të ndritura do të dalë në vrojtim. Në vrojtimit e para përcaktohet pozita e yjeve dhe objekteve të tjera në sferë qiellore, pozita e Hënës ndaj ndonjë ylli dhe emërtimet e këtyre objekteve, kurse më vonë mund të huazohet nga ndonjë shkollë tjetër, teleskopi shkollor (nëse shkolla nuk ka) dhe vrojtohen satelitët e Jupiterit, unaza madhështore e Saturnit, krateret e Hënës, fazat e Venerës, mjegullina e Andromedës e Orionit etj. Vrojtimit varen nga koha e përshtatshme e jo nga materia e shtjelluar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kimia, për njohje të vetive fiziko-kimike të trupave qiellorë, elementeve përbërëse etj.</li> <li>- Arti pamor si kërkesë e ngjyrave të trupave qiellorë, si njëra prej vetive karakteristike të tyre.</li> <li>- Historia si kërkesë e njohjes së kohës së zbulimeve apo ndryshimeve të modeleve të ndryshme kozmogonike.</li> <li>- Filozofia e cila prek shumë probleme të astronomisë.</li> <li>- Biologjia e cila në katër dekadat e fundit është zhvilluar si ekzobiologji-biologji e gjithësisë, kërkesë e identifikimit të qenieve dhe të organizmave të gjallë jashtokësorë.</li> </ul>
<p><b>LITERATURA</b></p> <p>Të gjitha leksionet gjenden në librin e autorit prof. dr. R. Bejtullahu <i>Astronomia</i> për kl. IV të gjimnazit dhe këtu janë zgjedhur vetëm leksionet deskriptive. Mund të shfrytëzohet edhe fizika e kl. IV të gjimnazit shoqëroro- gjuhësor dhe i përgjithshëm i bashkautorit të njëjtë</p>	
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë:</b>  <b><u>Kozmologji:</u></b>  <a href="http://www.astro.ucla.edu/~wright/cosmolog.htm">http://www.astro.ucla.edu/~wright/cosmolog.htm</a></p>	

**Gjimnazi: Matematikë dhe Informatikë (TIK)**

<b>KATEGORIA : FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: LËVIZJET E NJËTRAJTSHME DREJTVIZORE (11)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptojë madhësitë fizike, simbolin e tyre, shprehjen analitike, dimensionet, paraqitjen grafike, mënyrat e matjes, njësitë dhe gabimet e matjes.</li> <li>- Të jetë i aftë të përdorë në mënyrë të saktë terminologjinë e fizikës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë mirë kuptimet themelore të lëvizjeve drejtvizore dhe të lakuara;</li> <li>- të kuptojë rrotullimin e trupave;</li> <li>- të kuptojë se këto lëvizje bëhen në hapësirë dhe në kohë;</li> <li>- të fitojë shkathtësi për paraqitjen grafike të madhësive të ndryshme fizike.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>STANDARTET E ARRITSHMËRISË</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lënda dhe metodat e studimit të fizikës. Matja e disa madhësive fizike. Sistemi ndërkombëtarë i njësive SI.</li> <li>- Pika materiale dhe pozita e saj në hapësirë.</li> <li>- Zhvendosja. Koncepti mbi vektorët.</li> <li>- Mbledhja dhe zbritja e vektorëve.</li> <li>- Lëvizja e njëtrajtshme drejtvizore.</li> <li>- Lëvizjet e ndërrueshme. Shpejtësia mesatare.</li> <li>- Lëvizjet njëtrajtësisht të nxituara. Nxitimi.</li> <li>- Rënia e lirë e trupave.</li> <li>- Hedhja vertikale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë madhësitë fizike, simbolin e tyre, shprehjen analitike, dimensionin dhe paraqitjen grafike, mënyrat matjes, njësit dhe gabimet në matje;</li> <li>- të dijë madhësitë kryesore në sistemin SI;</li> <li>- të dijë metodat e studimit në fizikë;</li> <li>- të kuptojë përkufizimin e pikës materiale;</li> <li>- të dijë se ç'janë lëvizjet mekanike dhe relativitetin e tyre;</li> <li>- të shprehë me anë të formulës lëvizjen e njëtrajtshme drejtvizore dhe ta paraqesë grafikisht;</li> <li>- të njohë dhe të dijë të përdorë konceptet themelore të mekanikës;</li> <li>- të përkufizojë nxitimin;</li> <li>- të përcaktojë nxitimin mesatar, vektorin e ndërrimit të shpejtësisë, shpejtësinë dhe nxitimin momental.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<p>Duhet të bëhen punët praktike me qëllim të organizimit të matjeve eksperimentale, të furnizohen dhe të kontrollohen aparatet matëse, instrumentet dhe pajisjet e tjera. Të zbatojë rregullat e përdorimit të tyre, si dhe të sigurimit teknikë. Demonstrimi lëvizjes së njëtrajtshme drejtvizore me ndihmën e karrocës ose me ndihmën e makinës së Atvudit. Matja e shpejtësisë dhe e nxitimit me ndihmën e karrocës, cilindrit apo sferës në rrafshin e pjerrët.</p>	<p>Matematikë –vektorët, proporcionet, figurat e ndryshme gjeometrike, këndët, ekuacionet me një dhe dy të panjohura, funksionet lineare dhe kuadratike si dhe paraqitja e tyre grafike , jobarazimet dhe sistemet koordinative. Biologji-rritja e bimëve është një proces kinematik, kurse lëvizja e gjallesave është një proces dinamik.</p>
<b>LITERATURA</b>	
<p>Për përmbajtjet programore të kësaj nënkategorie arsimtari dhe nxënësit mund të përdorin librin e fizikës për klasën e parë gjimnaz, si dhe librin e fizikës për klasën e dytë gjimnaz, drejtimi i shkencave matematike-natyrore.</p>	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKAGORIA: LËVIZJET E LAKUARA (4)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njoh lidhshmërin e hapësirës, kohës dhe lëvizjes.</li> <li>- Të mësojë, në nivel zbatimi, ligjet kryesore kinematike të translacionit dhe rrotacionit (në mënyrë kuantitative) si dhe të mësojë për madhësit kryesore kinematike që janë të lidhura me ato ligje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë mirë kuptimet themelore të lëvizjeve të lakuara;</li> <li>- të kuptojë kuptimet themelore të rrotullimit të trupave.</li> <li>- Të dijë për nxitimin te lëvizjet rrethore.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITURA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëvizjet e lakuara.</li> <li>- Shpejtësia në lëvizjet e lakuara.</li> <li>- Lëvizja rrethore e njëtrajtëshme.</li> <li>- Nxitimi në lëvizjet e lakuara.</li> <li>- Lëvizja rrotulluese e trupit të ngurtë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë përshkruajë dhe të kuptojë si formohen lëvizjet e lakuara, e në veçanti lëvizjet rrethore;</li> <li>- të dijë shprehjen matematikore për nxitim në lëvizjet rrethore;</li> <li>- të dijë se çdo lëvizje e lakuar mund të paraqitet me një varg lëvizjesh rrethore;</li> <li>- të dijë se vektori i shpejtësisë <math>\vec{v}</math> është i njëjtë për të gjitha pikat e trupit të ngurtë;</li> <li>- të dijë lidhjen e shpejtësisë <math>\vec{v}</math> dhe të shpejtësisë këndore <math>\vec{\omega}</math> ;</li> <li>- të dijë se çka janë perioda dhe frekuenca e rrotullimeve.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<p>Demonstrimi i ligjit të dytë të Njutonit me ndihmën e karrocës për forca të ndryshme. Eksperimenti i Galileit-Lëvizja e sferës poshtë dhe lart nëpër pjesën lugore të rrafshit të pjerrët.</p> <p>Matja e peshës specifike dhe përcaktimi i densitetit për trupa të ndryshëm.</p> <p>Demonstrimi i energjisë potenciale me ndihmën e sustës spirale të ngjeshur dhe të tërhequr. Forca centripetale me ndihmën e dinamometrit ose të diskut rrotullues.</p> <p>Lidhja e momentit të inercionit dhe momentit të impulsit me ndihmën e rrotës së Oberbekut.</p>	Matematikë-gjeometri
<b>LITERATURA</b>	
Nxënësit dhe arsimtarët mund të përdorin librin e fizikës për klasën e parë gjimnaz.	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: BASHKËVEPRIMET NDËRMJET TRUPAVE (17)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të fitojë njohuri për bashkëveprimin ndërmjet trupave;</li> <li>- të njihet me faktin se shumë ligje të fizikës që zbatohen në praktikë dhe në teknikë, rrjedhin nga ligjet e ruajtjes;</li> <li>- të zhvillojë vetëdijen për shfrytëzimin racional të energjisë;</li> <li>- të kuptoj se ligjet e Njutonit nuk vlejnë në të gjitha sistemet e referimi, por vetëm në sistemet joinerciale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të bëjë dallimin ndërmjet masës , inercionit dhe peshës së trupave;</li> <li>- të ketë të qartë se forca shkakton lëvizjen e trupave në keto raste si pasojë e bashkëveprimit ndërmjet tyre: tërheqjes, shtyrjes, deformimeve ose ndërrimit të sasisë së lëvizjes;</li> <li>- të dijë të zbatojë të tri ligjet e Njutonit në rastet konkrete;</li> <li>- t'i zbatojë ligjet e ruajtjes në ato raste kur nuk njihen forcat ndërmjet trupave.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>STANDARTET E ARRITSHMËRISË</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Masa dhe inercioni i trupave. Sasia e lëvizjes.</li> <li>- Kuptimi i forcës. Ligji i inercionit.</li> <li>- Ligji themelor i dinamikës.</li> <li>- Ligji i aksionit dhe reaksionit.</li> <li>- Mbledhja dhe zbrërthimi i forcave.</li> <li>- Forcat që paraqiten në lëvizjet rrethore.</li> <li>- Ligji i ruajtjes së sasisë së lëvizjes. Lëvizjet reaktive.</li> <li>- Puna dhe fuqia. Energjia potenciale dhe kinetike.</li> <li>- Ligji i ruajtjes së energjisë mekanike.</li> <li>- Momenti i forcës. Momenti i inercisë</li> <li>- Momenti i sasisë së lëvizjes dhe ligji i ruajtjes.</li> <li>- Fërkimi dhe forcat e fërkimit.</li> <li>- Vetitë elastike të trupave dhe forcat që veprojnë në të.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë masën e trupave si madhësi dinamike, e jo si sasi e lëndës;</li> <li>- të kuptojë se bashkëveprimi ndërmjet trupave është veti universale;</li> <li>- të ketë të qartë se masa e trupave lidhet me vetinë e inercionit, por nuk është inercion;</li> <li>- të dijë të zbatojë parimin e inercionit për të analizuar forcat që veprojnë në një trup, qoftë ai në lëvizje apo jo;</li> <li>- të zotërojë ligjet e dinamikës dhe t'i zbatojë ato në disa mekanizma e pajisje mekanike që përdoren në industri, transport, bujqësi dhe në ndërtim;</li> <li>- të kuptojë se forcat e aksionit dhe të reaksionit lindin dhe zhduken në të njëjtën kohë, edhe pse veprojnë në trupa të ndryshëm;</li> <li>- të kuptojë se kur harxhohet energjia kryhet punë;</li> <li>- të dijë se energjia potenciale është energji e pozitës, kurse energjia kinetike është energji e lëvizjes.</li> <li>- të dijë të shprehë me formula punën, fuqinë, energjinë dhe të dijë njësitë dhe dimensionet e tyre.</li> </ul>

UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Ligji i dytë i Njutonit të demonstrohet me anë të karrocës laboratorike për masa dhe forca të ndryshme. Ligji i aksionit dhe reaksionit të demonstrohet me dy dinamometra të tërhequr me dy forca të njëjta në dy skajet e kundërta të tij. Ekzistimi i energjisë potenciale të demonstrohet duke e ngjeshur ose tërhequr sustën elastike. Forcat centrifugale dhe centripetale të demonstrohen me anë të një sfere të lidhur për spango dhe kjo për një dinamometër, e cila rrotullohet me dorë. Kjo mund të bëhet edhe me ndihmën e një disku rrotullues. Momenti i sasisë së lëvizjes të demonstrohet me anë të një rrote të biçikletës ose me anë të diskut të Oberbekut.</p>	<p>Matematika elemetare. ekuacionet lineare dhe operimet me thyesa.</p>
<p>LITERATURA</p> <p>Libri i fizikës për klasën e parë gjimnaz.</p>	

<b>KATEGORIA: FORCA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: GRAVITETI ( 8 )</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptojë dallimin ndërmjet fizikës së Aristotelit dhe fizikës së Galileit. Të njihet me eksperimentin e Kevendishit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë se forca e gravitetit është vetëm tërheqëse;</li> <li>- të dallojë forcat inerciale dhe joinerciale (njutoniane);</li> <li>- të kuptojë ligjet e Keplerit;</li> <li>- të kuptojë në nivel zbatimi lëvizjen horizontale dhe hedhjen e pjerrët të trupave.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>STANDARTET E ARRITSHMËRISË</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji i Njutonit mbi tërheqjen e përgjithshme.</li> <li>- Forca e rëndimit. Pesha e trupave.</li> <li>- Qendra e masës.</li> <li>- Lëvizja e planetëve. Ligjet e Keplerit.</li> <li>- Lëvizja e trupave në afërsi të sipërfaqes së Tokës.</li> <li>- Hedhja horizontale.</li> <li>- Lëvizja e satelitëve artificiale - shpejtësia e parë kozmike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë ligjin e Njutonit mbi tërheqjen e përgjithshme;</li> <li>- të njihet me konceptin e fushave e në veçanti me konceptin e fushës së gravitetit.</li> <li>- të kuptojë hedhjen e pjerrët dhe hedhjen horizontale;</li> <li>- të dijë për shpejtësinë e parë kozmike;</li> <li>- të definojë ligjet e Keplerit dhe të dijë për lidhjen e tyre me ligjin e tërheqjes;</li> <li>- të dijë të llogarisë masën e Hënës.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<p>Forca tërheqëse e Tokës të demonstrohet me anë të një trupi të varur në dinamometër.</p> <p>Rënia e lirë e pllakës metalike dhe letrës me sipërfaqe të njëjtë.</p>	<p>Matematikë- në aspektin e shpjegimit të ligjit të Njutonit, lëvizjes së trupave në afërsi të sipërfaqes së Tokës.</p> <p>Astronomi- në aspektin e shpjegimit të ligjeve të Keplerit dhe të shpejtësisë së parë kozmike.</p>
<b>LITERATURA</b>	
Fizika për klasën e parë gjimnaz	

<b>KATEGORIA: LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE</b>	
<b>NËNKATEGORIA: BAZAT E TEORISË MOLEKULARE – KINETIKE TË LËNDËS (14)</b>	
<b>QËLLIMET</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të fitojë aftësi për arritjen e përfundimeve, për përgjithësime, për argumentimin sasior dhe vedosjen e lidhjeve funksionale të vetive të gazeve ideale;</li> <li>- të zhvillojë vetëdijen për nevojën e shfrytëzimit racional të energjisë së gazeve dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihet me faktin se të gjitha llojet e substancave përbëhen prej molekulave;</li> <li>- të kuptojë lëvizjen kaotike të molekulave;</li> <li>- të kuptojë rëndësinë e energjisë së brendshme dhe mënyrën e ndërrimit të saj;</li> <li>- të shprehë matematikisht ekuacionin e gjendjes së gazit ideal dhe ekuacionin e gazit real.</li> </ul>
<b>PËRMBAJTJET PROGRAMORE</b>	<b>STANDARTET E ARRITSHMËRISË</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi molekular i lëndës. Madhësia dhe masa e molekulave.</li> <li>- Lëvizja kaotike e molekulave-lëvizja e Braunit.</li> <li>- Forcat e bashkëveprimit ndërmjet molekulave dhe energjia potenciale e tyre. Energjia e brendshme e tyre.</li> <li>- Modeli i gazit ideal –madhësitë që përcaktojnë gjendjen e gazit ideal. Proceset themelore të gazeve ideale.</li> <li>- Temperatura absolute. Ekuacioni i përgjithshëm i gjendjes së gazeve ideale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë se çdo trup (i ngurtë, i lëngët apo i gaztë) përbëhet prej një numri të madh të molekulave;</li> <li>- të dijë se këto molekula ndodhën në lëvizje të përhershme kaotike;</li> <li>- të kuptojë se shpejtësit e molekulave nuk janë të njëjta për arsye të lëvizjes kaotike të tyre;</li> <li>- të dijë se molekula karakterizohet me këto madhësi (është dhënë vetëm rendi i madhësisë): diametri <math>10^{-10}</math> m, masa <math>10^{-27}</math> kg, vëllimi <math>10^{-30}</math> m<sup>3</sup> dhe shpejtësia 300-400 m/s;</li> <li>- të dijë se çështë gazi ideal;</li> <li>- të kuptojë se gjendja e një gazi ideal përcaktohet me tre parametra: shtypjen, temperaturën dhe vëllimin.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
Demonstrimi i modelit me sfera për të treguar lëvizjen molekulare. Lëvizja kaotike e molekulave dhe shpërndarja e tyre sipas shpejtësive të demonstronhet me anë të kutisë së Heltonit.	Matematika elementare e shkollës fillore. Funksionet eksponenciale me qëllim të arritjes së të kuptuarit të shprehjes së numrave shumë të vegjël në formë eksponenciale. Preferohet që njëkohsisht të mësohet edhe shprehja e



<p>Demonstrimi i ligjeve të Bojl-Mariotit, Sharlit dhe Gej-Lisakut të bëhët me aparatura përkatëse që disponon laborator i shkollës.</p>	<p>numrave shumë të mëdhenj në formë eksponenciale, sepse do t'i shërbejë për shprehjen e numrit të molekulave në substance.</p> <p>Kimi. Në aspektin e shpjegimit të ndërtimit molekular të lëndës, bashkëveprimet ndërmjet molekulave, modelit të gazit ideal, gazit real etj.</p> <p>Ekologji. Sa herë që kemi punë me gaze dhe shfrytëzimin e energjisë së tyre duhet përkujtuar edhe ruajtjen e mjedisit jetësor.</p>
<p>LITERATURA</p> <p>Për të gjitha tërësit programore të kësaj nënkategorie mjafton të përdoret libri i fizikës për klasën e dytë gjimnaz, drejtimi i shkencave matematika-natyrore.</p>	
<p><b>Adresa e internetit për kërkim të literaturës nga ky lëmë:</b>  <b><u>Termodinamika dhe gazet:</u></b>  <u><a href="http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html">http://www.physics.usyd.edu.au/rcfta/thermo.html</a></u>  <u><a href="http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html">http://oldsci.eiu.edu/physics/DDavis/1150/14Thermo/ToC.html</a></u></p>	

## MËSIMET ZGJEDHORE

NJËSITË MËSIMORE	QËLLIMET
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Sistemet e referimit dhe relativiteti i lëvizjes.</li><li>2. Përcaktimi i masës së Hënës duke shfrytëzuar qendrën e masës të sistemit Tokë-Hënë.</li><li>3. Goditjet e trupave.</li><li>4. Gjatësia e rrugës së lirë të molekulave.</li><li>5. Ligji i difuzionit.</li><li>6. Përfitimi i ligjit të sipërfaqeve të barabarta (ligji i dytë i Keplerit) nga ligji i ruajtjes së momentit të sasisë së lëvizjes .</li><li>7. Përkufizimi i entropisë.</li></ol>	<p>- Mësimet e zgjedhura u dedikohen nxënësve të cilët dëshirojnë t'i thellojnë njohuritë e tyre nga lëmenj të ndryshëm të fizikës.</p>

### USHTRIME LABORATORIKE (5)

1. Matja e gjatësive dhe masave të disa trupave . Gabimet në matje. Vlera mesatare.
2. Caktimi i dendësisë së një trupi të ngurtë.
3. Përcaktimi i koeficientit të fërkimit të një rrafshi të pjerrët.
4. Përcaktimi i koeficientit të tensionit sipërfaqësor me anë të gypit kapilar.
5. Përcaktimi i nxehtësisë specifike të një trupi të ngurtë me kalorimetër.

### VLERËSIMI I DITURIVE TË NXËNËSVE

#### 1. Vlerësimi sipas aktivitetit

Në radhë të parë, arsimtari duhet të pranojë nxënësin si partner të bashkëbisedimit. Prandaj, duke provuar që nxënësin ta kyçë në bashkëbisedim gjatë procesit të shpjegimit, njëkohësisht do ta çmojë sa është në gjendje të përvetësojë njësinë mësimore të shpjeguar. Kësisoj nxënësi do të jetë vazhdimisht aktiv në nxjerrjen e përfundimeve për ligjshmëritë së

bashku me arsimtarin. Nxënësit e ndryshëm për të njëjtën problematikë mund të arrijnë në përfundime të ndryshme. Ky aktivitet i tyre për arritje deri te konkludimet së bashku me arsimtarin apo edhe në mënyrë të pavarur duhet të merret si parametër i vlerësimit të diturisë.

## **2. Vlerësimi me gojë**

Ka nxënës të tillë që janë mjaft të përgatitur, por të tërhequr, jo aq aktivë dhe nuk marrin pjesë në bashkëbisedim. Për këtë arsye arsimtari duhet këta nxënës t'i thërresë dhe t'i pyesë në mënyrë klasike, që të kuptojë nivelin e arritshmerisë së tyre. Edhe kjo mënyrë realizohet në formë bashkëbisedimi dhe nuk duhet t'i nënshtrohet e tërë klasa.

## **3. Vlerësimi nga zgjidhja e detyrave në klasë**

Gjatë zgjidhjes së detyrave numerike të parapara me program në orët e ushtrimeve disa nxënës janë vazhdimisht aktivë dhe kyçen në zgjidhjen e tyre në tabelë ose në fletore. Ky aktivitet duhet të merret si parametër për vlerësim të diturisë.

## **4. Provimi me shkrim**

Nga fundi i çdo gjysëmvetori parashikohet të mbahet nga një provim me shkrim, në të cilën do të jepen detyra dhe probleme të cilat nxënësi do të mundohet t'i zgjidhë. Arsimtari do të japë detyra të zgjidhura, por edhe të pazgjidhura, të cilat janë përpunuar apo nuk janë përpunuar më parë në orët e ushtrimeve. Qëllimi i paraqitjes së detyrave të pazgjidhura në provim me shkrim qëndron në vlerësimin e aftësive kreative të nxënësve, sepse pikërisht nga ecuria e zgjidhjes së këtyre detyrave vlerësohet mënyra e të menduarit të tyre.

## **5. Vlerësimi me anë të testeve**

Mënyra e vlerësimit të njohurive të nxënësve të tërë klasës me teste të pyetjeve arsimtarit i ofron një pasqyrë për nivelin e zotërimit të lëndës mësimore. Kjo metodë do të jetë aq më e saktë sa më tepër kohë që arsimtari do t'i kushtojë mënyrës së përpilimit të testeve, duke pasur para-

sysh kriteret e hartimit të testeve sipas taksonomisë së Blumit të cilat janë: niveli i njohjes (kognitiv), kuptimi, zbatimi, analiza dhe sinteza . Në çdonjërin gjysëmvjetor përpilohet nga një test me qëllim që arsimtari të krijojë një përfytyrim për dituritë e përvetësuara.

## **6. Aktiviteti në laboratorin e shkollës**

Në ato shkolla ku ekziston kabineti i fizikës, arsimtari sipas programit do të demonstrojë ose do të kryejë ndonjë matje të ndonjë madhësie ose dukurie fizike. Pikërisht gjatë këtij angazhimi të arsimtarit disa nxënës nga kureshtja do të jenë më aktivë se të tjerët. Ata do t'i ndihmojnë arsimtarit në procesin e demonstrimit apo të matjes, apo do ta kryejnë në mënyrë të pavarur, ashtu që ky aktivitet merret si një nga parametrat për vlerësimin e diturive të tyre.

## **7. Puna e pavarur praktike**

Vlerësimi i diturive të nxënësve kryhet edhe nga ndjekja e aktivitetit të tyre në punë praktike individuale dhe në grupe. Nxënësit do të marrin nga arsimtari detyra konkrete të cilat do t'i realizojnë në mënyrë praktike, p. sh. ndërtimi i një elektromagneti, elektromotori, periskopi etj.

## **HYRJA**

Kimia është shkencë natyrore e cila për bazë e ka punën eksperimentale, analizën dhe sintezën si metodat kryesore dhe të arriturat tjera shkencore në lëminë e Biologjisë, Fizikës, Matematikës, Informatikës, Gjeologjisë etj.

Kimia studion ose merret me:

- Zbulimin e lëndëve prej të cilave është e ndërtuar natyra e tokës dhe e gjithësisë.
- Studimin e ndërtimit (përbërjes) të lëndëve, vetive të tyre dhe mënyrave të krijimit të tyre.
- Përgatitjen e lëndëve (komponimeve) të reja.
- Gjetjen e mundësive (metodave) për prodhimin dhe zbatimin e lëndëve në teknikë, industri, bujqësi dhe në jetën e përditshme.

Kimia nuk i studion vetëm komponimet të cilat gjinden në natyrë. Ajo krijon lëndë të reja të cilat nuk ekzistojnë, e as që kanë ekzistuar në natyrë. Deri më tani kimistët kanë krijuar mbi 15 milion komponime (lëndë) të ndryshme kimike të cilat dukshëm kanë përmirësuar jetën e njeriut në tërësi.

## **QËLLIMET**

- Zhvillimi dhe thellimi i mëtejshëm i njohurive në lëminë e kimisë së përgjithshme, inorganike, organike dhe teknologjisë kimike dhe rëndësia e saj në shërbim të njeriut.
- Të kuptuarit e filozofisë së kimisë si shkencë natyrore dhe eksperimentale.

- Krijimi i shprehive dhe shkathtësive gjatë punës teorike dhe praktike, aftësive të kërkimit të informatave.
- Aktivizimi i sa më shumë shqisave (të pamurit, të prekurit, ndëgjimit, shijimit, nuhaturit) për nxënie të qëndrueshme të njohurive.
- Zhvillimi i të menduarit autonom dhe kritik për të kuptuar, shprehur dhe zbatuar fenomenet dhe dukuritë kimike që ndodhin në natyrë dhe në laboratorin kimik.
- Stimulimi dhe motivimi i nxënësve për mësim teorik dhe praktik duke përdorë metoda të mësimdhënies dhe teknologji të re arsimore atraktive e racionale, mjete mësimore të konkretizimit, mjete vizuele dhe audivizuele, mësim në terren dhe ekonomi etj.
- Edukimi i nxënësve, prindërve të tyre dhe komunitetit më të gjerë shkollor për ambientin.

**Gjimnazi i Shkencave Shoqërore dhe të Gjuhëve****OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

Nxënësit duhet:

- Të njihen me filozofinë e kimisë si shkencë natyrore dhe eksperimentale, me nocionet dhe me emërtimin e komponimeve kimike sipas standardeve të IUPAC-it (Bashkimi Ndërkombëtar i Kimisë së Pastër dhe të Zbatuar).
- Të fitojnë njohuri për grupet më të rëndësishme të substancave inorganike dhe organike, për vetitë dhe përdorimin e tyre.
- Të kuptojnë rregullat, parimet dhe ligjshmëritë kimike gjatë analizës dhe sintezës.
- Të krijojnë shprehi dhe shkathtësi për punë, përdorim të aparaturave, teknikave dhe metodave laboratorike dhe të kenë qëndrim të drejtë si të sillen në laborator.
- Të zbatojnë njohuritë dhe përvojat e lëmenjve të tjerë shkencore (të Fizikës, Biologjisë, Matematikës, Gjeografisë, Teknologjisë etj.)
- për të kuptuar, analizuar, njohur, sendërtuar e zbatuar lëndën e kimisë.
- Të analizojnë përbërjen e materialeve natyrore dhe të kuptojnë nocionet materie, masë dhe energji.
- Të aktivizojnë shqisat për të kuptuar, analizuar e zbatuar rezultatet e dukurive që ndodhin gjatë shndërrimeve kimike.
- Të zhvillojnë aftësitë krijuese për zbatimin e njohurive teorike në praktikë në shërbim të njeriut (në mjekësi, farmaci, bujqësi, teknikë, në amvisni dhe industri ushqimore etj.), si dhe shkathtësitë për shfrytëzimin e informacioneve të nevojshme me qëllim të thellimit të njohurive dhe zbatimit të tyre në jetë.
- Të aftësohen për aktivitete të pavarura hulumtuese dhe krijuese.
- Të arrijnë një nivel bazë për të kuptuar dhe vlerësuar rëndësinë e kimisë për individin dhe shoqërinë.
- Të formohen si personalitet me përgjegjësi për bashkëpunim profesional, solidarizim dhe komunikim me arsimtarë, kolegë, prindër dhe rreth më të gjerë, si dhe për ruajtjen e mjedisit dhe ndikimit të tij për efekte urbane dhe më gjerë.

<b>Përmbajtja programore</b>	<b>Objektivat specifike</b>	<b>Metodologjia dhe udhëzimet didaktike</b>	<b>Standdardet e arritshmërisë</b>	<b>Lidhjet ndërlëndore</b>
<b>Kimia si shkencë natyrore (3)</b>				
o Hyrje në kimi o Kimia si shkencë natyrore dhe eksperimentale	<i>Nxënësit duhet:</i> Të njihen me rëndësinë e kimisë për jetë  Të njohin pajisjet laboratorike, rregullat e punës në laborator dhe rreziqet e mundshme gjatë eksperimentimit	<input type="checkbox"/> Metoda e komunikimit  <input type="checkbox"/> Metoda ndërvepruese  <input type="checkbox"/> Metoda eksperimentale	<i>Nxënësit do të:</i>  Dinë çka studion kimia dhe shkencat tjera natyrore  Dinë për rolin e kimisë për jetë  Aftësohen për përdorimin e mjeteve laboratorike, substancave dhe për mbrojtjen nga rreziqet e mundshme gjatë punës eksperimentuese	Të gjitha shkencat natyrore dhe teknologjia kimike
<b>Substancat kimike (5)</b>				
o Përzierjet dhe substancat e pastërta o Simbolet, formulat	<i>Nxënësit duhet:</i> Të njihen me nocionet përzierje, substancë e pastër dhe me metodat	<input type="checkbox"/> Metoda e komunikimit <input type="checkbox"/> Metoda ndërvepruese	<i>Nxënësit do të:</i> Bëjnë dallimin midis përzierjeve dhe substancave të pastërta	Matematika F izika



<p>dhe ekuacionet kimike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o Masa atomike relative dhe masa molekulare relative</li> <li>o Moli, masa molare dhe vëllimi molar</li> <li>o Bazat e llogaritjeve stekimometrike</li> </ul>	<p>për ndarjen e tyre</p> <p>Të njihen me simbolet, formulat dhe ekuacionet kimike</p> <p>Të bëjnë llogaritjet stekimometrike</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Punë eksperimentale</li> <li><input type="checkbox"/> Përdorimi i fletores së punës</li> </ul>	<p>Zgjedhin metodat për ndarjen e përzierjeve sipas kriterëve të ndryshme.</p> <p>Përshkruajnë dhe barazojnë reaksionet kimike, gjendjet agregate të reaktantëve dhe të produkteve të reaksionit</p>	
<b>Struktura e atomit dhe Sistemi periodik i elementeve (4)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>o Përbërja e atomit</li> <li>o Bërthama e atomit dhe izotopet</li> <li>o Nivelet, nënivelet dhe orbitalet atomike</li> <li>o Ndërtimi i Sistemit periodik të elementeve</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njohin grimcat elementare të atomit</p> <p>Të dallojnë numrin atomik, numrin e masës dhe izotopet</p> <p>Të kuptojnë renditjen e elektroneve në nivele dhe nënivele energjetike</p> <p>Të analizojnë ndryshimin periodik të</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues (arsimtar-nxënës, nxënës-nxënës)</li> <li><input type="checkbox"/> Përdorimi i modeleve për orbitalet s dhe p</li> <li><input type="checkbox"/> Përdorimi i Sistemit periodik të elementeve</li> <li><input type="checkbox"/> Përdorimi i të</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Dinë të dallojnë grimcat elementare</p> <p>Aftësohen për përdorimin e numrit atomik, numrit të masës dhe lidhmërinë e tyre me izotopet</p> <p>Bëjnë dallimin e niveleve, nëniveleve energjetike dhe orbitaleve atomike</p>	<p>Fizika</p> <p>Matematika</p> <p>Biologjia</p>

	vetive fizike e kimike të elementeve të grupeve dhe periodave të ndryshme si pasojë e strukturës së atomeve	dhënave multimediale për paraqitjen e grimcave subelementare  <input type="checkbox"/> Përdorimi i fletores së punës  <input type="checkbox"/> Vlerësimi me testim		
<b>Lidhjet kimike dhe struktura e molekulave (5)</b>				
o Lidhja jonike o Lidhja kovalente o Lidhja hidrogjenore	<i>Nxënësit duhet:</i> Të bëjnë definimin e lidhjes jonike, kovalente dhe hidrogjenore  Të përdorin strukturat e Luisit (Lewis)  Të bëjnë përcaktimin e ndryshimeve të molekulave polare dhe atyre jopolare	<input type="checkbox"/> Metoda ndërvepruese duke përfshirë edhe punën eksperimentuese  <i>Eksperiment:</i>  <input type="checkbox"/> Përcaktimi i vetive të kristaleve <input type="checkbox"/> Sublimimi i jodit (arsimtari)	<i>Nxënësit do të:</i> Dinë për mënyrën e formimit të joneve  Dinë të sqarojnë formimin e lidhjes jonike dhe asaj kovalente si dhe dallimet në mes tyre  Dallojnë strukturën e diamantit si kristal kovalent, të grafitit dhe atë të fulorenit	Fizika Matematika Biologjia

	Të identifikojnë lidhjen hidrogjenore te makromolekulat biologjike (proteinat)	<input type="checkbox"/> Pika e vlimit <input type="checkbox"/> Tretshmëria e alkoolit dhe e vajit ushqimor në ujë	Analizojnë ndikimin e lidhjes hidrogjenore në vetitë fizike dhe kimike të komponimeve dhe rolin e saj për jetën e gjallë	
<b>Termodinamika kimike (3)</b>				
o Ndërrimet energjetike gjatë reaksioneve kimike o Burimet alternative të energjisë	<i>Nxënësit duhet:</i> Të definojnë reaksionet ekzotermike, endotermike Të dinë për burimet alternative të energjisë Të kuptojnë ndikimin e produkteve të djegies në mjedisin jetësor	<input type="checkbox"/> Metoda ndërvepruese <input type="checkbox"/> Shfrytëzimi i materialeve multimediale <i>Eksperiment:</i> <input type="checkbox"/> Tregimi i reaksioneve endotermike dhe ekzotermike <input type="checkbox"/> Përdorimi i tabelave me vlerat e entalpive standarde	<i>Nxënësit do të:</i> Dallojnë reaksionet ekzotermike dhe endotermike Zbatojnë ligjin e Hessit Dinë për burimet alternative të energjisë	Biologjia, Fizika Ekologjia
<b>Tretësirat (3)</b>				
o Tretësirat dhe llojet e tyre	<i>Nxënësit duhet:</i>	<input type="checkbox"/> Metoda hulumtuese	<i>Nxënësit do të:</i>	Biologjia,

o Përbërja e tretësirave	Të njihen me proceset që zhvillohen gjatë tretjes Të dinë t'i dallojnë tretësirat sipas madhësisë së grimcave Të analizojnë faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e tretjes	<input type="checkbox"/> Përdorimi i grafiqeve dhe i tabelave për tretshmërinë  <i>Eksperiment:</i>  <input type="checkbox"/> Varshmëria e tretshmërisë nga temperatura	Bëjnë dallimin e llojeve të tretësirave në bazë të madhësisë së grimcave dhe sasisë së substancës së tretur  Aftësohen për llogaritje dhe për përgatitjen e tretësirave me përqëndrime të ndryshme	Fizika Ekologjia
<b>Kinetika e reaksioneve kimike (2)</b>				
o Shpejtësia e reaksioneve kimike  o Faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve kimike	<i>Nxënësit duhet:</i>  Të definojnë shpejtësinë e reaksioneve kimike  Të kuptojnë ndikimin e përqendrimit dhe të temperaturës në shpejtësinë e reaksioneve kimike,  Të kuptojnë reaksionet	<input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues  <input type="checkbox"/> Metoda demonstruese  <i>Eksperiment:</i>  <input type="checkbox"/> Ndikimi i përqendrimit dhe i temperaturës në shpejtësinë e	<i>Nxënësit do të:</i> Dinë të shprehin shpejtësinë e reaksioneve kimike  Vlerësojnë ndikimin e faktorëve që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve kimike	Teknologjia kimike Biologjia Fizika Matematika

	katalitike dhe veprimin e katalizatorëve	reaksioneve kimike.		
<b>Ekulibri kimik (2)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>o Reaksionet kimike ekuilibruese</li> <li>o Faktorët që ndikojnë në zhvendosjen e ekuilibrit kimik</li> </ul>	<p><i>Nxënësi duhet:</i></p> <p>Të njihen me reaksionet ekuilibruese</p> <p>Të definojnë ndikimin e faktorëve të jashtëm në ekuilibrin kimik</p> <p>Të kuptojnë konstantën ekuilibruese (Kc)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues</li> <li><input type="checkbox"/> Metoda e demonstrimit</li> <li><input type="checkbox"/> Testimi</li> </ul> <p><i>Eksperiment:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Reaksioni midis: <math>\text{BaCl}_2 + \text{Na}_2\text{CO}_3</math> (arsimtari)</li> <li><input type="checkbox"/> Reaksioni midis: <math>\text{FeCl}_3 + \text{KCNS}</math> (arsimtari)</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Dallojnë reaksionet reversibile dhe ato ireversibile</p> <p>Shpjegojnë ndikimin e faktorëve të jashtëm (përqendrimi, temperatura, shtypja) në zhvendosjen e ekuilibrit kimik</p>	<p>Biologjia</p> <p>Teknologjia kimike</p> <p>Matematika</p>
<b>Ekulibri kimik në tretësirat ujore (3)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>o Acidet dhe bazat</li> <li>o Produkti jonik i ujit</li> <li>o (Vlera pH)</li> <li>o Pufferët</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të definojnë acidet dhe bazat në tretësirat ujore</p> <p>Të definojnë kuptimin e ekuilibrit protolitik.</p> <p>Të dijnë të llogarisin</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues</li> <li><input type="checkbox"/> Ushtrime llogaritjeje të vlerës pH në shembuj të thjeshtë</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Shpjegojnë acidet dhe bazat sipas teorisë së Arrheniusit dhe të Bronsted-Lowrit</p> <p>Përcaktojnë fortësinë e</p>	<p>Biologji</p> <p>Fizikë</p> <p>Matematikë</p>

	<p>vlerën <math>p^H</math> tek acidet dhe bazat e forta</p> <p>Të kuptojnë mekanizmin e sistemeve puferike</p>	<p><i>Eksperiment:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Matja e vlerës <math>p^H</math> duke i përdorë indikatorët (rasoji i lakrës së kuqe me limon dhe me NaOH) (nxënësi)</li> </ul>	<p>acideve dhe të bazave në bazë të konstantave <math>K_a</math> dhe <math>K_b</math></p> <p>Llogarisin vlerën <math>p^H</math> në shembuj të thjeshtë</p> <p>Vlerësojnë rolin e puferëve në organizëm</p>	
<b>Reaksionet e oksido-reduktimit (2)</b>				
<p>o reaksionet e oksido- reduktimit</p> <p>o Barazimi i reaksioneve të oksido-reduktimit</p>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njihen me kuptimet oksidim dhe reduktim, Të dinë për lidhmërinë në mes të oksidimit dhe reduktimit</p> <p>Të kuptojnë barazimet e ekuacioneve të oksido-reduktimit</p> <p>Të zbatojnë reaksionet e oksido-reduktimit në proceset e ndryshme kimike</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues</li> <li><input type="checkbox"/> Vizita e ndonjë reparti industrial</li> <li><input type="checkbox"/> Eksperimente:</li> <li><input type="checkbox"/> Tretja e metaleve në HCl (arsimtari)</li> <li><input type="checkbox"/> Elektroliza e ujit në tretësirën e KI (arsimtari)</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Dinë të dallojnë proceset e oksidimit dhe të reduktimit</p> <p>Aftësohen për llogaritjen e numrave oksidues dhe për barazimin e reaksioneve të oksido-reduktimit në shembujt e thjeshtë,</p> <p>Dinë për mbushjen dhe zbrazjen e akumulatorit</p>	<p>Teknologjia kimike</p> <p>Biologjia</p> <p>Fizika</p>

<b>Kimia inorganike (10)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>o Elementet në Sistemin periodik dhe pozita e tyre</li> <li>o Elementet e grupit 1</li> <li>o Elementet e grupit 2</li> <li>o Elementet e grupit 3</li> <li>o Elementet e grupit 17</li> <li>o Elementet e grupit 16</li> <li>o Elementet e grupit 15</li> <li>o Elementet e grupit 14</li> <li>o Elementet kalimtare</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njihen me radhitjen e elementeve në Sistemin periodik</p> <p>Të dallojnë elementet s, Nxënësit duhet: Të njihen me radhitjen e elementeve në Sistemin periodik Të dallojnë elementet s,p, d dhe f dhe vetitë e përbashkëta të tyre në kuadër të grupeve</p> <p>Të kuptojnë vetitë periodike të disa elementeve</p> <p>Të dinë për gjetjen në natyrë, vetitë, komponimet dhe rëndësinë e elementeve të grupit (1, 2, 3, 17, 16, 15, 14 dhe elementeve kalimtare)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Shfrytëzimi i Sistemit periodik të elementeve</li> <li><input type="checkbox"/> Shfrytëzimi I Sistemit periodik të elementeve</li> <li><input type="checkbox"/> Eksperiment:</li> <li><input type="checkbox"/> Reaksionet në flakë</li> <li><input type="checkbox"/> Reaksioni i natriumit në ujë</li> <li><input type="checkbox"/> Përcaktimi i fortësisë së ujit</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Dallojnë vetitë e elementeve kimike në bazë të konfiguracionit elektronik të tyre</p> <p>Dallojnë elementet s, p, d dhe f dhe vetitë e përbashkëta të tyre</p> <p>Përshkruajnë vetitë, komponimet dhe rëndësinë e elementeve të grupeve (1, 2, 3, 17, 16, 15, 14 dhe elementeve kalimtare)</p> <p>Përshkruajnë plehrat minerale dhe rolin e tyre në rritjen e redimenteve bujqësore</p> <p>Dinë për komponimet komplekse dhe rolin e tyre në mjekësi dhe</p>	<p>Biologjia</p> <p>Bujqësia</p> <p>Mjekësia</p> <p>Fizika</p> <p>Teknologjia</p> <p>Edukata ekologjike</p>

			proceset biologjike (hemoglobina dhe klorofili)	
<b>Kimia e komponimeve të karbonit (2)</b>				
o Klasifikimi i komponimeve të karbonit o Orbitalet atomike dhe llojet e hibridizimit	<i>Nxënësit duhet:</i> Të njihen me vetitë e komponimeve të karbonit Të klasifikojnë komponimet e karbonit në bazë të grupeve funksionore, Të dallojnë orbitalet e hibridizuara $sp^3$ , $sp^2$ dhe $sp$ të karbonit	<input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues  <input type="checkbox"/> Përdorimi i modeleve molekulare për ndërtimin e strukturave të molekulave	<i>Nxënësit do të:</i> Definojnë komponimet e karbonit dhe të përshkruajnë rëndësinë e tyre për jetë Klasifikojnë komponimet organike në bazë të grupeve funksionore Bëjnë dallimin midis orbitaleve të hibridizuara $sp^3$ , $sp^2$ dhe $sp$ të karbonit dhe llojet e lidhjeve që formohen nga këto orbitale	Biologjia Mjekësia Bujqësia Teknologjia kimike
<b>Hidrokarburet (6)</b>				
o Alkanet dhe cikloalkanet o Alkenet dhe alkadienet	<i>Nxënësit duhet:</i> Të njihen me hidrokarburet dhe të bëjnë dallimin e tyre në	<input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues  <input type="checkbox"/> Metodat e	<i>Nxënësit do të :</i> Dinë të bëjnë dallimin midis llojeve të	Biologjia Mjekësia Bujqësia Teknologji kimike



o Alkinet dhe hidrokarburet aromatike (arenet)	<p>bazë të vargut karbonik dhe në bazë të llojit të lidhjeve karbon-karbon</p> <p>Të përcaktojnë përfaqësuesit më të rëndësishëm të hidrokarbureve dhe zbatimin e tyre në jetë</p> <p>Të emërtojnë këto komponime sipas rregullave IUPAC-it</p> <p>Të kuptojnë rëndësinë e hidrokarbureve si lëndë djegëse dhe si lëndë të para industriale</p> <p>Të dallojnë izomerinë dhe llojet e izomerëve</p>	<p>zakonshme të komunikimit</p> <p><input type="checkbox"/> Metoda e demonstrimit përmes modeleve molekulare</p> <p><i>Eksperiment:</i></p> <p><input type="checkbox"/> Përfitimi i hidrokarbureve (arsimtari)</p>	<p>hidrokarbureve</p> <p>Dinë t'i klasifikojnë hidrokarburet (aciklike, ciklike, alifatike, aromatike, të ngopura, të pangopura, alkane, alkene, alkine, diene etj.)</p> <p>Bëjnë emërtimin e hidrokarbureve sipas rregullave të nomenklaturës IUPAC-it</p> <p>Dinë për hidrokarburet si lëndë djegëse (karburante) dhe si lëndë të para industriale</p>	
<b>Lëndët djegëse fosile (3)</b>				
o Thëngjilli dhe llojet	<i>Nxënësit duhet:</i> Të njihen me formimin	<input type="checkbox"/> Metodën e zakonshme të	<i>Nxënësit do të:</i> Dinë për teoritë mbi	Teknologjia kimike Metalurgjia

<p>o Nafta dhe derivatet e saj o Gazi natyror</p>	<p>e lëndëve djegëse fosile</p> <p>Të bëjnë klasifikimin e tyre në bazë të gjendjes agregate të tyre</p> <p>Të analizojnë në mënyrë detale rëndësinë e lëndëve djegëse fosile si karburantë dhe si lëndë të para për industri</p> <p>Të kuptojnë teknologjinë e përpunimit të naftës dhe llojet e produkteve që përfitohen prej saj</p>	<p>komunikimit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues</li> <li><input type="checkbox"/> Metoda e demonstrimit (shfrytëzimi i koleksioneve të ndryshme të derivateve të naftës dhe të llojeve të thëngjillit)</li> </ul> <p><i>Eksperiment:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Distilimi fraksional i naftës (arsimtari)</li> </ul>	<p>originën e lëndëve djegëse fosile</p> <p>Klasifikojnë lëndët djegëse fosile në bazë të gjendjeve agregate</p> <p>Dinë për rëndësinë e lëndëve të djegëse fosile si karburante dhe si lëndë të para për industri</p> <p>Përshkruajnë teknologjinë e përpunimit të naftës dhe llojet e produkteve që përfitohen prej saj</p>	
<b>Komponimet organike me oksigjen (11)</b>				
<p>o Alkoolet o Fenolet o Eteret o Aldehydet dhe ketonet</p>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njihen me komponimet organike që posedojnë oksigjen në formë të grupit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Metodatat e zakonshme të komunikimit</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Dinë të bëjnë klasifikimin e komponimeve organike me oksigjen, në bazë të grupeve</p>	<p>Biologjia Mjekësia Farmacia etj</p>

<p>o Acidet organike dhe derivatet e tyre</p> <p>o Lipidet, sapunet dhe detergjentet</p> <p>o Karbohidratet</p>	<p>funkcionor hidroksil (alkoolet, fenolet), eterik, karbonil (aldehidet dhe ketonet), karboksil (acidet organike dhe derivatet e tyre)</p> <p>Të dallojnë alkoole primare, sekondare dhe terciare</p> <p>Të emërtojnë alkoole sipas nomenklaturës IUPAC-it</p> <p>Të njihen me fenolet si komponime aromatike që përmbajnë grupin (-OH)</p> <p>Të kuptojnë përdorimin e fenoleve në mjekësi dhe në industri</p> <p>Të njihen me strukturën e etereve dhe me nomenklaturën e tyre</p> <p>Të analizojnë</p>	<p><input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues</p> <p><input type="checkbox"/> Metoda e demonstrimit (shfrytëzimi i skicave, vizatimeve etj.)</p> <p><input type="checkbox"/> Përdorimi i modeleve molekulare</p> <p><i>Eksperiment:</i></p> <p><input type="checkbox"/> Përfitimi i acetatit të etil (etanoli + ac. acetik) (nxënësi).</p> <p><input type="checkbox"/> Reaksioni i pasqyrës së argjendit tek aldehidi acetik dhe tek glukozja. (arsimtari)</p> <p><input type="checkbox"/> Reaksioni i sapunifikimit</p>	<p>funkcionore të tyre</p> <p>Bëjnë dallimin midis alkooleve dhe fenoleve.</p> <p>Analizojnë strukturën, vetitë dhe përdorimin e komponimeve organike me oksigjen</p> <p>Përvetësojnë rregullat për emërtimin e komponimeve organike që përmbajnë oksigjen sipas nomenklaturës IUPAC-it</p> <p>Vlerësojnë rolin e komponimeve organike me oksigjen për jetë</p> <p>Dinë të përshkruajnë strukturën e acideve organike dhe të derivateve të tyre</p>	
---	--	---	---	--

	<p>strukturën e aldehideve dhe të ketoneve, Të bëjnë emërtimin e tyre Të njihen me strukturën e acideve karbo-silike dhe me derivatet e tyre Të njihen me strukturën e yndyrave dhe të lipideve si lëndë vitale për jetë Të bëjnë përfitim të sapuneve me hidrolizë të yndyrave. Të njihen me strukturën e karbohidrateve si biomolekula. Të bëjnë klasifikimin e karbohidrateve në bazë të numrit të njësive strukturale.</p>	<p>(arsimtari dhe nxënësit) <input type="checkbox"/> Reaksioni i amidonit me jod (nxënësit).</p>	<p>Zhvillojnë reaksionet e sapunifikimit dhe të dinë për përdorimin e sapuneve  Bëjnë klasifikimin e karbohidrateve në bazë të njësive monomere (monosakaride, disakaride, oligosakaride dhe polisakaride )  Zhvillojnë reaksionet e oksidimit të aldehideve dhe të sheqerëve reduktues.</p>	
<b>Komponimet organike me azot (10)</b>				
o Nitrokomponimet o Aminat	<i>Nxënësit duhet:</i> Të njihen me	<input type="checkbox"/> Metodat e	Nxënësit do të:	Biologjia Mjekësia

<p>o Aminoacidet o Proteinat o Komponentet heterociklike o Acidet nukleike o Enzimet, Hormonet, Vitaminat dhe Alkaloidet</p>	<p>komponimet organike që përmbajnë azot në formë të grupeve funksionore (aminat, nitrokomponimet, aminoacidet etj.) dhe në formë të heteroatomeve (komponimet heterociklike) Të definojnë strukturën e komponimeve organike me azot, vetitë dhe rëndësinë e tyre Të përshkruajnë vetitë e alkaloidëve si produkte natyrore me origjinë bimore dhe përdorimin e tyre Të analizojnë strukturën dhe aktivitetin biologjik të alkaloidëve Të dinë për përdorimin e tyre për qëllime humane</p>	<p>zakonshme të komunikimit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues</li> <li><input type="checkbox"/> Metoda e demonstrimit (shfrytëzimi i vizatimeve, skicave etj.)</li> <li><input type="checkbox"/> Përdorimi i modeleve molekulare</li> <li><input type="checkbox"/> Përdorimi i njësive multimediale (interneti etj)</li> <li><input type="checkbox"/> Përdorimi i publikimeve revijale <i>Eksperiment:</i></li> <li><input type="checkbox"/> Denaturimi i proteinave me</li> </ul>	<p>Përshkruajnë komponimet organike që përmbajnë azot Bëjnë klasifikimin e tyre në bazë të grupeve funksionore</p> <p>Analizojnë vetitë e alkaloidëve si produkte me origjinë bimore, të dinë për efektet e tyre në organizëm dhe për efektet e tyre të dëmshme gjatë përdorimit të pakontrolluar</p> <p>Identifikojnë grupet funksionore të aminoacideve</p> <p>Klasifikojnë aminoacidet në bazë të numrit të grupeve karboksile dhe amine</p> <p>Përshkruajnë strukturën e lidhjes peptide dhe</p>	<p>Farmacia Bujqësia etj</p>
--	---	---	--	----------------------------------

	<p>Të kuptojnë rreziqet nga përdorimi i pakontrolluar i tyre (drogimi),  Të kuptojnë rëndësinë vitale të aminoacideve dhe proteinave si përbërës themelorë të organizmave të gjallë  Të njihen me strukturën dhe me llojet e acideve nukleike (ADN, ARN)  Të përshkruajnë rolin e tyre në funksion të ruajtjes dhe të bartjes së vetive trashëguese tek organizmat e gjallë  Të njihen me rolin e enzimeve, hormoneve dhe vitaminave</p>	<p>acide dhe baza (të bardhët e vesë) (arsimtari dhe nxënësi)  <input type="checkbox"/> Reaksionet e precipitimit tek proteinat</p>	<p>rëndësinë biologjike të saj  Përshkruajnë strukturën e ADN-së dhe ARN-së, njësitë ndërtuese të tyre dhe rolin e tyre në bartjen e vetive trashëguese prej prindërve tek pasardhësit  Dinë për rolin e enzimeve, hormoneve dhe vitaminave për jetë</p>	
--	--	---	--	--

**Gjimnazi i Shkencave Natyrore,  
Matematikë e Informatikë  
dhe i Përgjithshëm**

**OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

Nxënësit duhet:

- Të njihen me filozofinë e kimisë si shkencë natyrore dhe eksperimentale, nocionet dhe me nomenklaturën (emërtimin) kimike sipas standardeve IUPAC - Bashkimi Ndërkombëtar i Kimisë së Pastër dhe të Zbatuar,
- Të kuptojnë rregullat, parimet dhe ligjshmëritë kimike gjatë analizës dhe sintezës kimike,
- Të krijojnë shprehje dhe shkathtësi për punë, përdorim të aparaturave, teknikave dhe metodave laboratorike dhe të kenë
- qëndrim të drejtë si të sillen në laborator.
- Të zbatojnë njohuritë dhe përvojat e lëmive tjera shkencore (të Fizikës, Biologjisë, Matematikës, Gjeografisë, Teknologjisë etj.) për të kuptuar, analizuar, njohur, sendërtuar e zbatuar lëndën e kimisë së përgjithshme.
- Të analizojnë përbërjen e materialeve natyrore dhe të kuptojnë nocionet materie, masë dhe energji.
- Të aktivizojnë shqisat për të kuptuar, analizuar e zbatuar rezultatet e dukurive që ndodhin gjatë shndërrimeve kimike.
- Të formohen si personalitet për bashkëpunim profesional, solidarizim dhe komunikim me arsimtarë, kolegë, prindër dhe
- rreth më të gjerë.
- Të zhvillojnë aftësitë krijuese për zbatimin e njohurive teorike në praktikë në shërbim të njeriut (në mjekësi, farmaci, bujqësi, teknikë, në amvisni dhe industri ushqimore etj.),
- Të sendërtojnë aftësitë dhe shkathtësitë për shfrytëzimin e informacioneve të nevojshme me qëllim të thellimit të njohurive, të kuptuarit dhe zbatuarit e tyre në jetë.
- Të aftësohen për aktivitete të pavarura hulumtuese dhe krijuese.
- Të edukohen si personalitet i përgjegjshëm, për ruajtjen e mjedisit dhe ndikimin e tij për efekte urbane dhe më gjerë.

Përmbajtja programore	Objektivat specifike	Metodologjia dhe udhëzimet didaktike	Rezultatet e pritura	Lidhjet ndërlëndore
<b>Kimia si shkencë natyrore(4)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Hyrje në kimi</li> <li>○ Kimia si shkencë natyrore eksperimentale dhe rëndësia e saj për jetë</li> <li>○ Puna në laboratorin e kimisë</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njihen me kiminë dhe shkencat tjera natyrore</p> <p>Të njihen me rëndësinë e kimisë për jetë</p> <p>Të kuptojnë lidhmërinë e kimisë me shkencat tjera natyrore dhe me teknologjinë</p> <p>Të njohin pajisjet laboratorike substancat dhe shenjat e rrezikut të tyre</p> <p>Të njihen me rregullat e punës në laborator, dhe me rreziqet e mundshme gjatë eksperimentimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Metodatat e komunikimit</li> <li>□ Metoda ndërvepruese</li> <li>□ Puna eksperimentuese</li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <p>Dinë çka studion kimia dhe shkencat tjera natyrore,</p> <p>Dinë për rolin e kimisë për jetë</p> <p>Aftësohen për përdorimin e mjeteve laboratorike substancave dhe mbrojtjen nga rreziqet e mundshme gjatë punës eksperimentuese</p>	<p>Të gjitha shkencat natyrore dhe teknologjia</p>



<b>Substancat kimike (10)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Përzierjet dhe substancat e pastërta</li> <li>○ Metodat për ndarjen e substancave nga përzierjet</li> <li>○ Simbolet dhe formulat kimike</li> <li>○ Masa atomike relative dhe masa molekulare relative.</li> <li>○ Sasia e substancës-moli,</li> <li>○ masa molare dhe vëllimi molar.</li> <li>○ Ekuacionet kimike.</li> <li>○ Bazat e llogaritjeve stekiometrike</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njihen me nocionet përzierje dhe substancë e pastër</p> <p>Të njihen me metodat për ndarjen e substancave dhe me kriteret për zgjedhjen e këtyre metodave, Të njohin simbolet, formulat dhe ekuacionet kimike.</p> <p>Të njihen me kuptimin e masës atomike relative dhe masës molekulare relative, Të njihen me kuptimin e sasisë së substancës, Të llogarisin sasinë e substancës, masën dhe vëllimin molar të saj,</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Metoda ndërvepruese</li> <li>□ Puna eksperimentale (demostrimi nga arsimtari dhe puna eksperimentale e nxënësve)</li> <li>□ Ndarja e hekurit dhe e sulfurit (nxënësit)</li> <li>□ Metodat hulumtuese</li> <li>□ Djegia e magnezit (nxënësit)</li> <li>□ Llogaritjet duke e përdorë Sistemin periodik të elementeve.</li> <li>□ Përdorimi i fletores së punës</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Bëjnë dallimin e përzierjeve nga substancat e pastërta</p> <p>Dinë të zgjedhin metodat për ndarjen e përzierjeve</p> <p>Bëjnë llogaritjen e masës molekulare nga të dhënat e Sistemit periodik të elementeve,</p> <p>Shprehin raportin në mes të masës së substancës, sasisë dhe masës molare të saj, Përshkruajnë dhe barazojnë reaksionet kimike, gjendjet agregate të reaktantëve dhe produkteve të reaksionit,</p>	<p>Matematika Fizika Biologjia</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Gazet dhe ekuacioni i gjendjes së gazeve</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përcjellja e vazhdueshme e punës së nxënësve dhe testimi</li> </ul>	<p>Të zbatojnë llogaritjet për pjesëmarrjen e elementeve në komponime dhe të përcaktojnë formulat kimike nga shembujt e thjeshtë,</p> <p>Të shprehin raportet molare të gazeve dhe përdorin ekuacionin e gjendjes së gazeve.</p>	
<b>Struktura e atomit dhe Sistemi periodik i elementeve (9)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Përbërja e atomit</li> <li>○ Bërthama e atomit dhe izotopet,</li> <li>○ Nivelet, nënnivelet energjetike dhe orbitalet atomike</li> <li>○ Radhitja e elektroneve nëpër orbitale të atomeve dhe joneve</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njohin grimcat në bazë të ngarkesës elektrike dhe masës së tyre</p> <p>Të sqarojnë numrin atomik dhe numrin e masës, relacionin midis tyre dhe definicionin për izotopet</p> <p>Të analizojnë renditjen e elektroneve në nivele dhe nënnivele energjetike të atomeve të elementeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Mësimi ndërveprues (arsimtar-nxënës, nxënës-nxënës)</li> <li>□ Përdorimi i modeleve për orbitalet s dhe p</li> <li>□ Përdorimi i Sistemit periodik i elementeve</li> <li>□ Përdorimi i fletores së punës</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Bëjnë dallimin e grimcave elementare të atomit</p> <p>Aftësohen për përdorimin e numrit atomik dhe numrit të masës dhe lidhmërinë e tyre me izotopet</p> <p>Bëjnë dallimin e niveleve, nënniveleve</p>	<p>Fizika Matematika</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ndërtimi i Sistemit periodik të elementeve</li> <li>○ Ligjshmëritë periodike të vetive të elementeve (radiusi atomik dhe energjia e parë e jonizimit, afiniteti ndaj elektronit dhe elektronegativiteti)</li> <li>○ Metalet, jometalet dhe metaloidet në Sistemin periodik të elementeve</li> </ul>	<p>Të kuptojnë radhitjen e elementeve në Sistemin periodik të elementeve si pasojë e strukturës së tyre atomike</p> <p>Të analizojnë ndryshimin periodik të vetive fizike dhe kimike të elementeve të grupeve dhe periodave të ndryshme si pasojë e strukturës së atomeve</p>	<input type="checkbox"/> Vlerësimi me testim	<p>energjetike dhe orbitaleve atomike</p> <p>Përshkruajnë renditjen e elektroneve në atome dhe jone të elementeve të ndryshme</p> <p>Përcaktojnë vendin e metaleve, jometaleve dhe metaloideve në Sistemin periodik të elementeve</p>	
<b>Lidhjet kimike dhe struktura e molekulave (12)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Lidhja jonike dhe kristalet jonike</li> <li>○ Lidhja kovalente dhe kristalet</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të bëjnë definimin e lidhjes jonike dhe kovalente</p> <p>Të njihen me formimin e kristaleve jonike në</p>	<input type="checkbox"/> Metoda ndërvepruese <input type="checkbox"/> Puna eksperimentuese	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Dinë për mënyrën e formimit të joneve</p> <p>Sqarojnë formimin e</p>	<p>Biologjia Fizika Matematika</p>

<p>kovalente</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Molekulat polare dhe jopolare</li> <li>○ Momenti dipolar</li> <li>○ Modifikimet alotropike të karbonit</li> <li>○ Lidhja metalike dhe kristalet metalike</li> <li>○ Forcat ndërmolekulare</li> <li>○ Lidhja hidrogjenore</li> </ul>	<p>shembullin e NaCl dhe atë të CsCl, Të përdorin strukturat e Luisit (Lewis) Të kuptojnë momentin dipolar si kriter për përcaktimin e polaritetit të molekulave Të definojnë forcat midis molekulave Të dinë të arsyetojnë rëndësinë e kristaleve molekulare në shembullin e jodit, dioksidit të karbonit të ngurtë dhe të glukozës Të dinë të definojnë lidhjen hidrogjenore dhe ndikimin e saj tek uji Të identifikojnë lidhjen hidrogjenore tek makromolekulat biologjike (proteinat)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Përdorimi i modeleve për lidhjen metalike</li> <li>□ Sublimimi i jodit (arsimtari)</li> <li>□ Pika e vlimit</li> <li>□ Tretshmëria e alkoolit dhe e vajit ushqimor në ujë</li> </ul>	<p>lidhjes jonike dhe asaj kovalente si dhe dallimet midis tyre Dallojnë molekulat polare dhe ato jopolare në bazë të momentit dipolar Analizojnë vetitë fizike të komponimeve jonike (NaCl – elektrolit, p.shkr. , p.vl.) Dallojnë strukturën e diamantit si kristal kovalent, grafitit dhe fulorenit, vetitë dhe zbatimin e tyre Analizojnë strukturën e lidhjes metalike, vetitë fizike të tyre (përçueshmëria elektrike dhe e nxehtësisë, përpunimi, përdorimi) Përshkruajnë llojet e forcave ndërmolekulare dhe</p>	
---	---	---	--	--

			formimin e lidhjes hidrogjenore Vlerësojnë ndikimin e lidhjes hidrogjenore në vetitë fizike dhe kimike të komponimeve dhe rolin e saj për jetën e gjallë	
<b>Termodinamika kimike (6)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Burimet energjetike fosile</li> <li>○ Burimet e reja të energjisë (solare, të erës etj.)</li> <li>○ Ndërrimet energjetike gjatë reaksioneve kimike</li> <li>○ Entalpia e formimit gjatë reaksioneve kimike</li> <li>○ Ligji i Hessit</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njohin lëndët djegëse fosile Të dinë për burimet e reja të energjisë, Të njihen me përmbajtjen e energjisë gjatë reaksioneve kimike</p> <p>Të kuptojnë entalpinë standarde të formimit</p> <p>Të dinë të llogarisin entalpinë standarde të</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Metoda ndërvepruese</li> </ul> <p><i>Eksperiment:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Tregimi i reaksioneve endotermike:</li> <li>□ Tregimi i reaksioneve ekzotermike</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Dinë të dallojnë lëndët djegëse fosile</p> <p>Vlerësojnë rolin e burimeve të reja të energjisë për të ardhmen</p> <p>Dallojnë reaksionet kimike (ekzotermike dhe endotermike)</p> <p>Zbatojnë Ligjin e</p>	<p>Biologjia Fizika Ekologjia</p>

	<p>formimit në bazë të ligjit të Hessit</p> <p>Të kuptojnë ndikimin e produkteve të djegies në mjedisin jetësor</p>		<p>Hess-it, gjatë ndryshimeve energjetike të treaksioneve kimike</p> <p>Dinë për ndikimin e sasive të mëdha të CO<sub>2</sub> në atmosferë (klima, të reshurat acidike, shkatërrimi i shtresës së ozonit, rrezatimi fotokimik etj.)</p>	
<b>Tretësirat (12)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Tretësirat dhe përbërja e tyre</li> <li>○ Llojet e tretësirave</li> <li>○ Entalpia e hidratimit</li> <li>○ Entalpia e rrjetës kristalore të kristaleve jonike</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njihen me proceset që zhvillohen gjatë tretjes së kristaleve jonike</p> <p>Të dinë t'i dallojnë tretësirat</p> <p>Të analizojnë faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e tretjes</p> <p>Të njihen me kuptimet e</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Metodatat ndëraktive</li> <li><input type="checkbox"/> Përdorimi i grafiqeve dhe i tabelave për tretshmërinë</li> </ul> <p><i>Eksperiment:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Tretja e KCl</li> <li><input type="checkbox"/> Varshmëria e tretshmërisë nga temperatura</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Bëjnë dallimin e tretësirave në bazë të madhësisë së grimcave</p> <p>Përshkruajnë proceset që zhvillohen gjatë tretjeve të kristaleve jonike dhe lidhja e tyre me entalpin e tretjes</p> <p>Aftësohen për</p>	<p>Biologjia, Fizika Edukata Ekologjike</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Tretshmëria e substancave</li> <li>○ Përbërja e tretësirave:</li> <li>○ a. Raportet dhe pjesëmarrjet</li> <li>○ b. Përqendrimet (sasi, vëllimor dhe i masës)</li> <li>○ Molaliteti</li> <li>○ Vetitë koligative të tretësirave (ulja e pikës së ngrirjes, ngritja e pikës së vlimit, shtypja osmotike)</li> </ul>	<p>entalpisë së hidratimit (solvatimit) dhe të entalpisë së rrjetës kristalore</p>		<p>llogaritje dhe për përgatitjen e tretësirave me përqëndrime të ndryshme</p> <p>Bëjnë dallimin e osmozës nga shtypja osmotike</p> <p>Dinë të llogarisin shtypjen osmotike, uljen e pikës së ngrirjes dhe rritjen e pikës së vlimit në varshmëri nga lloji i tretësirës dhe ndryshimi i përqëndrimit.</p>	
<b>Kinetika e reaksioneve kimike (6)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpejtësia e reaksioneve kimike</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i> Të definojnë shpejtësinë e reaksioneve kimike</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Mësimi ndërveprues</li> <li><input type="checkbox"/> Metoda demonstruese</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i> Dinë të shprehin</p>	<p>Teknologjia kimike Biologjia</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve kimike</li> <li>○ Kataliza dhe katalizatorët</li> </ul>	<p>Të kuptojnë ndikimin e përqendrimit dhe të temperaturës në shpejtësinë e reaksioneve kimike</p> <p>Të analizojnë teorinë e ndeshjeve dhe energjinë e aktivizimit</p> <p>Të kuptojnë reaksionet katalitike dhe veprimin e katalizatorëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Eksperiment:</li> <li>□ Ndikimi i përqendrimit dhe i temperaturës në shpejtësinë e reaksioneve kimike</li> </ul>	<p>shpejtësinë e reaksioneve kimike përmes formulave</p> <p>Përcaktojnë faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve kimike</p> <p>Përdorin diagramet energjetike për energjinë aktivuese të kompleksit aktiv tek reaksionet ekzoterme dhe ato endoterme,</p> <p>Zbatojnë diagramet energjetike për reaksionet që zhvillohen pa katalizator dhe me katalizator</p>	<p>Fizika</p>
<p><b>Ekulibri kimik (4)</b></p>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Reaksionet kimike ekuilibruese</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njihen me reaksionet ekuilibruese</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Mësimi ndërveprues</li> <li>□ Testimi.</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Dallojnë reaksionet reversibile dhe ato</p>	<p>Biologjia Teknologjia kimike Fizika</p>



<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ligji i veprimit të masave</li> <li>○ Konstanta e ekuilibrit</li> <li>○ Faktorët që ndikojnë në zhvendosjen e ekuilibrit kimik Parimi Le Chatelier (Lë Shatellie)</li> </ul>	<p>Të kuptojnë ndikimin e faktorëve të jashtëm në zhvendosjen e ekuilibrit kimik</p> <p>Të llogarisin përqendrimet në ekuilibër dhe konstantën ekuilibruese (Kc)</p>	<p><i>Eksperiment:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Reaksioni midis: <math>BaCl_2 + Na_2CO_3</math> (arsimtari)</li> <li>□ Reaksioni midis: <math>FeCl_3 + KCNS</math> (arsimtari)</li> </ul>	<p>ireversibile</p> <p>Llogarisin përqendrimet e substancave reaguese dhe produkteve të reaksionit</p> <p>Vlerësojnë ndikimin e faktorëve të jashtëm në ekuilibrin kimik</p> <p>Formojnë qëndrim kritik se për cilat reaksione kimike zbatohet Ligji i Veprimit të Masave</p>	
<b>Ekuilibri kimik në tretësirat ujore (5)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Tretësirat e elektrolitëve dhe teoria e shpërbashkimit elektrolitik</li> <li>○ Acidet, bazat dhe kripërat</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njihen me tretësirat elektrolite dhe joelektrolite</p> <p>Të dinë të njehsojnë shkallën e shpërbashkimit</p> <p>Të definojnë acidet dhe bazat në tretësirat ujore sipas teorisë së Arrheniusit dhe të</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Mësimi ndërveprues</li> <li>□ Ushtrime llogaritjeje të vlerës pH në shembuj të thjeshtë</li> </ul> <p><i>Eksperiment:</i></p>	<p>Nxënësit do të:</p> <p>Dinë të dallojnë tretësirat elektrolite nga ato jo elektrolite</p> <p>Vlerësojnë se cilët elektrolit e përçojnë</p>	<p>Biologjia</p> <p>Ekologjia</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ekuilibri në tretësirat e acideve dhe bazave, produkti jonik i ujit dhe vlera pH</li> <li>○ Proceset acido-bazike (Neutralizimi dhe Hidroliza e kripërave)</li> <li>○ Pufferët</li> </ul>	<p>Bronsted-Lowrit</p> <p>Të shprehin konstantat ekuilibruese <math>K_w</math>, <math>K_a</math>, <math>K_b</math></p> <p>Të dinë të llogarisin vlerën <math>p^H</math> tek acidet dhe bazat</p> <p>Të vlerësojnë vlerën <math>p^H</math> të tretësirave të kripërave varësisht se prej cilave acide dhe baza janë formuar</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Neutralizimi i acideve të forta me baza të forta; <math>HCl + NaOH</math> (arsimtari)</li> <li>□ Matja e vlerës pH duke i përdorë indikatorët (rasoji i lakrës së kuqe me limon dhe me <math>NaOH</math>) (nxënësi)</li> </ul>	<p>më mirë rrymën elektrike</p> <p>Shpjegojnë acidet dhe bazat sipas teorisë së Arrheniusit dhe të Bronsted-Lowrit</p> <p>Përcaktojnë fortësinë e acideve dhe të bazave në bazë të konstantave <math>K_a</math> dhe <math>K_b</math></p> <p>Llogarisin vlerën pH në shembuj të thjeshtë</p> <p>Të vlerësojnë rolin e pufferëve në organizmat e gjallë</p>	
<b>Elektrokimia (6)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Reaksionet e oksido-reduktimit dhe barazimi i tyre</li> <li>○ Potencialet standarde redoks</li> </ul>	<p><i>Nxënësit duhet:</i></p> <p>Të njihen me kuptimet oksidim dhe reduktim</p> <p>Të dinë të hartojnë reaksionet e thjeshta oksido-reduktuese</p> <p>Të njohin llojet e mjeteve</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>□ Mësimi ndërveprues</li> <li>□ Vizita e ndonjë reparti industrial</li> <li>□ Testim</li> </ul>	<p><i>Nxënësit do të:</i></p> <p>Dinë të dallojnë proceset e oksidimit dhe të reduktimit dhe lidhmërinë midis tyre</p> <p>Dinë të bëjnë</p>	<p>Fizika</p> <p>Teknologjia</p> <p>Ekologjia</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Elementet galvanike</li> <li>○ Elektroliza</li> </ul>	<p>oksiduese dhe reduktuese</p> <p>Të njihen me elementin galvanik si burim i rrymës njëkahëshe,</p> <p>Të kuptojnë procesin e elektrolizës</p> <p>Të dinë për veprimin e mbeturinave galvanike në mjedis dhe për procesin e reciklizimit të tyre</p>	<p><i>Eksperiment:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>□ Tretja e metaleve në HCl (arsimtari)</li> <li>□ Përgatitja e elementit galvanik të Danielit (arsimtari).</li> <li>□ Elektroliza e ujit</li> </ul>	<p>barazimin e reaksioneve të oksido-reduktimit në shembujt e thjeshtë</p> <p>Analizojnë zbatimin praktik të reaksioneve oksido-reduktuese</p> <p>Të sqarojnë elementin galvanik të Danielit</p> <p>Vlerësojnë për rreziqet që rrjedhin nga mbeturinat galvanike dhe për procesin e reciklimit të mbeturinave galvanike</p>	
--	---	---	---	--

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për organizimin e procesit mësimor në lëndën e kimisë zbatohen metoda, strategji, teknika dhe forma të shumëllojta të punës. Është e drejtë profesionale e mësimit që të bëjnë zgjedhjen e metodave, edhe pse në këtë program ato u janë preferuar për çdo temë mësimore.

Metodat didaktike janë të domosdoshme të ndërthurën me njëra tjetren gjatë gjithë orës së mësimit, në përputhje me nivelin e dijeve, objektivat e lëndës, por edhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësimit dhe nxënësit.

Metodologjia e mësimit dhe mësimit duhet të jetë në funksion të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të kimisë, e veçanërisht të atyre që ju nevojiten për të zgjidhur problemet e jetës së përditshme.

- Metodat e mësimit dhe të komunikimit në lëndën e kimisë:
- Metoda e shpjegimit
- Metoda e bisedës
- Metoda e leximit dhe punës me tekst
- Metoda e punës eksperimentale dhe hulumtuese
- Metoda e punës me kompjuter
- Metoda e të mësuarit dhe të nxënimit ndërveprues
- Metoda e diskutimit të lirë dhe debatit.

Në mësimit dhe në të nxënimit të nxënësit zbatohen strategji të ndryshme mësimore:

- Mësimi zbulues (heuristik)
- Mësimi i zgjidhjes së problemeve
- Mësimi i programuar
- Mësimi ekzemplar (me shembuj)
- Mësimi dhe të nxënimit ndërveprues
- Mësimi në natyrë dhe objekte industriale.

### **Teknikat:**

- Insert
- Ditari dy pjesë
- Mësimdhënie e ndërsjelltë
- Diagrami i Venit

- Kllaster
- Brainsterming
- ATS
- Kubimi
- Tabela e koncepteve

**Format e punës:**

- Puna individuale
- Puna në çifte
- Puna në grupe
- Puna me të gjithë nxënësit

I tërë ky proces do të arrihet përmes mësimit teorik, eksperimental-laboratorik, me përdorim të gjerë të mjeteve mësimore teknike-teknologjike të konkretizimit dhe të komunikimit dhe me mësimin në objektet jashtë lokaleve shkollore.

## **VLERËSIMI**

Nocioni i vlerësimit dhe realizimi i tij është me rëndësi të veçantë për të përcaktuar shkallën e përvetësimit të njohurive, shprehive, shkathtësive, vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve të nxënësve, si dhe për të konstatuar punën e mësimit dhe se sa ka qenë efektive puna e tij. Vlerësimi i nxënësve duhet të bëhet në të gjitha etapat e orës mësimore, ai mund të jetë sistematik (për çdo temë mësimore), periodik (në përfundim të çdo kapitulli), semestral dhe vjetor. Për vlerësimin e nxënësve është e domosdoshme të zbatohen teknika të shumëllojta:

1. Vlerësimi me gojë.
2. Vlerësimi me shkrim (testim, pyetësor, kontrollimi i fletore së punës etj.).
3. Vlerësimi praktik në klasë, laborator dhe teren.
4. Vlerësimi gjatë ekskurzioneve shkollore.
5. Vlerësimi i punës së pavarur të projekteve dhe punëve kërkimore.
6. Vlerësimi autentik (krahasimi me nxënësit tjerë, por edhe me vetëveten).

## BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Për realizimin me sukses të përmbajtjeve programore në lëndën e Kimisë në klasën e X, është e domosdoshme të sigurohen kushtet elementare për zhvillimin e mësimi si dhe mjetet mësimore:

1. Laboratori (kabineti) i kimisë ose laborator mobil.
2. Teksti i kimisë, doracak, fletore pune si ndihmë shtesë.
3. Teknologjia e nevojshme mësimore (TV, Kompjuteri, Interneti, CD, Grafoskopi)
4. Tabela, modele atomike- molekulare, diagrame, filma etj.
5. Materiale nga jeta e përditshme që gjenden në treg.

Mësimdhënësi duhet ta shfrytëzojë autonominë që gëzon për të shfrytëzuar dhe kërkuar burime të ndryshme informacioni dhe mjete tjera mësimore për realizimin e planprogramit të Kimisë.

Deri në hartimin e tekstit për klasën e X mësimdhënësve u rekomandojmë që ta shfrytëzojnë dhe konsultojnë këtë literaturë e cila ekziston:

1. **Dr. Rexhep Mehmeti**, *KIMIA* për klasën e parë gjimnaz, Libri Shkollor, Prishtinë.
2. **Dr. Mustafë Bacaj**, *KIMIA INORGANIKE* për klasën e II gjimnaz, Libri Shkollor, Prishtinë.
3. **Dr. I. Filipoviq, Dr. S. Lipanoviq** (shqipëruar nga **Dr. Xhavit Ahmeti**), *KIMIA E PËRGJITHSHME dhe INORGANIKE*.
4. **Dr. Nexhat Daci, Dr. Osman Leci**, *KIMIA ORGANIKE*, Libri Shkollor, Prishtinë.
5. **Dr. Pandeli Troja, Dr. Muhamet Bicaj**, *KURS I SHKURTËR I KIMISË ORGANIKE*, Libri Shkollor, Prishtinë.
6. *FJALORI I KIMISË*, SH. B. "8 Nëntori" Tiranë.

---

## GJEOGRAFI

---

### HYRJE

Gjeografia si shkencë hapësinore (natyrore e shoqërore) në klasën X ka për objekt studimi njohjen e hapësirës (Tokën dhe Gjithësinë), sferave të Tokës, bashkëveprimin e tyre, objektet dhe dukuritë natyrore e shoqërore në Tokë dhe rolin e tyre për jetën e njerëzve dhe botën e gjallë bimore e shtazore. Përmbajtja e gjeografisë përfshin katër kategoritë e lëndës së gjeografisë: vendin dhe hapësirën, mjedisin natyror (sistemet fizike), mjedisin human (sistemet humane) dhe mjedisin e shoqërinë.

### QËLLIMET

#### **Qëllimet e mësimit të gjeografisë janë që nxënësit:**

- të zotërojnë njohuritë dhe konceptet për gjeografinë si shkencë, Tokën dhe Gjithësinë, formën, madhësinë dhe lëvizjet e Tokës si planet, sistemet fizike, humane, duke zhvilluar mënyrën e të menduarit kritik;
- të zhvillojnë aftësitë për të formuluar dhe për të zgjidhur probleme me ndihmën e gjeografisë, nga vendi, hapësira, mjedisi natyror, mjedisi human, rajoni dhe mjedisi e shoqëria;
- të zhvillojnë aftësitë për të përdorur dhe për të punuar modele të thjeshta gjeografike (si skica, plane, harta tematike, modele);
- të kuptojnë format dhe teknikat e grumbullimit të informatave gjeografike, sistemi min, analizën, prezentimin grafik (skica, harta , aerofotografi, imazhe satelitore, GIS etj.) dhe përdorimin e tyre, të kuptojnë ligjëshmëritë e përhapjes së dukurive dhe të proceseve natyrore e shoqërore dhe rolin e tyre në organizimin dhe zhvillimin e hapësirave konkrete;
- të zhvillojnë aftësitë për vlerësim dhe përdorim të librave, globit, hartave, atlasëve, literaturës, leksikoneve, enciklopedive, internetit dhe programeve të tjera kompjuterike, arsimore televizive;
- të zhvillojnë aftësitë për punë në bashkëpunim me komunitetet e tjera.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Me objektiva synohet që nxënësit të nxiten të hulumtojnë, të zhvillojnë dije, shkathtësi, shprehi, kompetenca, qëndrime dhe vlera të cilat do t'u nevojiten për të dhëne përgjigje në këto pyetje: ku gjendet objekti, dukuria, arsyet e vendosjes aty, si është formuar, çfarë ndikimi mund të ketë, si duhet të organizohet hapësira (territori) për mirëqenien e shoqërisë në mjedise të ndryshme.

### **Nxënësi duhet:**

- të krijojnë kuptimet e qarta mbi formën, madhësinë, lëvizjet e Tokës si pjesë e Sistemit Diellor, Gjithësisë dhe rrjedhimet nga
- forma, madhësia dhe lëvizjet e Tokës për njerëzit dhe botën e gjallë;
- të njihen me hartat, sistemin e koordinatave, përcaktimin e pikave, të vendeve, largësive, shenjave dhe të simboleve hartografike
- të dinë t'i përdorin këto për orientim, leximin dhe punimin e hartave të ndryshme;
- të formojnë koncepte të qarta për sferat e Tokës, përbërësit kryesorë, raportet në mes tyre, proceset dhe dinamikën e sferave dhe rëndë sinë për njerëzit dhe botën e gjallë;
- të dinë për përhapjen jo të barabartë të njerëzve në Tokë, për rritjen e popullsisë, shtimin natyror, migrimet, dallimet në përkatësinë etnike, racore, fetare, organizimin shtetëror e ndërkombëtar, zhvillimin ekonomik e social në përgjithësi;
- t'i kuptojnë shkaqet e vërteta të dukurive fizike dhe humane në botën e sotme si ngrohja globale, problemi i ujit, erozionit, ozonit, ndotjes, rritjes së shpejtë të popullsisë, urisë, refugjatëve, zhvillimit të pabarabartë ekonomik, pabarazive të tjera dhe konflikteve në botë.

## OBJEKTIVAT E VEÇANTA

- t'i njohin ligjshmëritë themelore të pozitës dhe lëvizjes së Tokës në Gjithësi;
- të dinë të përcaktojnë pozitën gjeografike të pikave, vendeve, shteteve;
- të zbatojnë shkallën numerike e grafike, të masin gjatësitë e lartësitë (absolute e relative) në hartat topografike, t'i dallojnë mirë hartat, veçoritë tyre dhe informatat tjera gjeografike;



- t'i kuptojnë mirë shtresat e Tokës, proceset në brendin e saj, dukuritë e vullkaneve e tërmeteve, format kryesore të korrës së Tokës, krijimin e formave, rolin e forcave nga brendia dhe veprimin e forcave të jashtme;
- të kuptojnë ndërtimin e atmosferës, strukturën vertikale, proceset termike, dinamike, motin dhe klimën;
- të dinë për objektet ujore, për qarkullimin e ujit në natyrë, vetitë e ujit, rëndësinë e ujit për proceset natyrore dhe shoqërore, shpërndarjen jo të njëjtë në sipërfaqen e Tokës dhe nevojën për ruajtje nga ndotja;
- të kuptojnë se bota bimore e shtazore varet prej kushteve klimatike, hidrografike e tokësore, të dinë t'i shpjegojnë shtrirjen vertikale e horizontale të bimëve e të kafshëve dhe rolin e njeriut në përhapjen e tyre në botë;
- të kuptojnë proceset ekstreme në natyrë dhe shkaqet e zhvillimit të tyre, të identifikojnë dhe të klasifikojnë dukuritë kryesore të fatkeqësive natyrore dhe rrethinën ku jetojnë e më gjerë;
- të kuptojnë dhe të interpretojnë rritjen e numrit të njerëzve në ekumenë dhe zgjerimin e saj, shpërndarjen jo të barabartë të popullsisë në ekumenë varësisht prej kushteve natyrore dhe shkallës së zhvillimit socio-ekonomik;
- të kuptojnë dhe të interpretojnë shtimin natyror dhe mekanik, komponentët e shtimit, strukturat themelore të popullsisë, migrimin e njerëzve, kuptimin, llojet, shkaqet, pasojat e migrimeve;
- të dinë për veprimtaritë prodhuese dhe shërbyese, për degët ekonomike, joekonomike, për mostrën e tyre hapësinore;
- të dinë për kuptimin e vendbanimit, për objektet që e përbejnë, për formën (e shpërndarë, e dendur), tipin (fshat, qytet), madhësinë (i vogël, i mesëm, i madh), planin (strukturën fizike), funksionin dhe për raportin me rrethinën;

## SHKATHTËSITË E SYNUARA

Përmes mësimin të gjeografisë synohet që nxënësit të fitojnë këto shkathtësi, shprehi dhe vlera:

- t'i dallojnë shenjat konvencionale të legjendës së hartës, ta përdorin shkallën e zvogëlimit, të përcaktojnë largësitë në mes të objekteve në hartë, t'i përdorin simbolet dhe ngjyrat;

- të ndërtojnë dhe të lexojnë grafikët, diagramet, tabelat, hartat dhe modelet e përpiluara për qëllime të caktuara mësimore;
- të aftësohen për përshkrimin, hulumtimin, shpjegimin, regjistrimin e tipareve natyrore të Tokës si përmbajtje madhore të gjeografisë, të cilat përcaktojnë veçoritë e vendit (format e ndryshme relievo, objektet ujore, elementet e motit e të klimës);
- të demonstrojnë të kuptuarit e nocioneve të lartësisë relative dhe absolute, duke përdorur harta fizike me shkallë të ndryshme;
- të ndërtojnë modele të thjeshta për format e ndryshme të relievit, të ndërtojnë grafikë dhe diagrame për elementet klimatike e hidrografike dhe të dinë t’i interpretojnë ato;
- të zbulojnë informacione gjeografike për popullsinë, mjediset urbane, rurale nga burimet e drejtpërdrejta (p.sh. vëzhgimet, intervistat), nga burimet dytësore (hartat, grafikët, modelet, tabelat, CD-të etj.);
- të lokalizojnë në hartë vendbanimet kryesore urbane dhe shpërndarjen e popullsisë në rajone të ndryshme të botës;
- të ndërtojnë dhe të interpretojnë lloje të shumta grafikësh, hartash etj. me karakter mësimor (p.sh. në lidhje me numrin dhe shpërndarjen e popullsisë në qendrat e banuara, objektet dhe prodhimet e degëve të ndryshme ekonomike etj.);
- të paraqesin rezultatet e kërkimeve dhe të vëzhgimeve, duke përdorur mjetet e medias, raportimet gojore e me shkrim, tabela, grafikë, harta etj.;
- të mbajnë qëndrim kritik ndaj shfaqjeve negative të ndërhyrjes së njerëzve në mjedisin ku ata jetojnë;

## **QASJE NDËRKURRIKULARE DHE NDËRLËNDORE**

Kurrikuli i lëndës së gjeografisë në përgjithësi, pra dhe ai për kl. X në veçanti, krijon hapësirë për qasje ndërkurrikulare dhe lidhje midis lëndëve të ndryshme, si:

### **a. Edukimi shëndetësore**

- duke nxënë njohuri për motin, nxënësi duhet të kuptojë se ndryshimet e shpejta të elementeve të motit-temperaturës, trysnisë, lagështisë etj. mund të reflektohen në shëndetin e njeriut dhe aktivitetet punuese. Për vlerësimin e këtyre ndryshimeve duhet t’u referohet njohurive për rendësinë e shëndetit dhe të mësuarit se si ta ruajnë;

- duke mësuar për klimën, nxënësi do të kuptojë se popujt jetojnë dhe veprojnë në kushte të ndryshme klimatike dhe ndeshen me probleme të ndryshme shëndetësore, kështu p.sh. popujt që kultivojnë kulturën e orizit në Azin Jugore dhe Lindore vuajë nga sëmundjet reumatike dhe gjatësia mesatare e jetës është më e shkurtër etj.;
- duke mësuar për ujin dhe rolin e tij për jetë nxënësi duhet të dijë se një numër i madh i sëmundjeve përhapet nëpërmjet përdorimit të pakontrolluar të ujit etj.;
- nxënësi duke fituar njohuri për pushimin dhe rekreacionin duhet të kuptojë se nuk është e lejuar larja në disa lumenj për shkak të shkallës së lartë të ndotjes së tyre;
- rreziqet në natyrë dhe situatat në të cilat mund të gjendet nxënësi gjatë daljes në terren ose në ekskursione shkollore shtrojnë nevojën e aftësimin të nxënësve për ofrimin e ndihmës së parë .

#### **b. Edukimi qytetar**

- Nëpërmjet fitimit të njohurive gjeografike për shtetet, kombet, besimet, organizatat shtetërore dhe joqeveritare edukimi gjeografik ka rëndësi të madhe për krijimin e ndjenjës për barazi njerëzore dhe lidhje të ndryshme shoqërore.

#### **c. Barazia gjinore**

- Kurrikuli i lëndës së gjeografisë luan rol shumë të rëndësishëm në të mësuarit dhe përvetësimin e konceptit dhe të praktikës së barazisë gjinore;
- kurrikuli i lëndës së gjeografisë mishëron parimin e barazisë gjinore në të gjitha aspektet nëpërmjet zhvillimit të përmbajtjeve si: lindshmëria, shtimi natyror i popullsisë, strukturat e popullsisë (gjinore, moshore, fetare, edukimit, zhvillimit të aktiviteteve ekonomike etj.). Në këtë mënyrë krijohen njohje dhe përvetësime të një sërë përvojash, njohurish, aftësish dhe aspiratash si për gratë dhe vajzat, ashtu dhe për burrat e djemtë.
- Teknologjitë e reja në edukimin gjeografik (GPS, GIS, hartat kompjuterike etj.) promovojnë aftësitë që i duhen, i kuptojnë dhe mund të përdorin që të dy gjinitë;
- Nëpërmjet fitimit të njohurive gjeografike për shtetet, kombet, besimet, organizatat shtetërore dhe joqeveritare edukimi gjeografik ka rëndësi të madhe për krijimin e ndjenjës për barazi njerëzore dhe lidhje të ndryshme shoqërore.

**Gjimnazi i Shkencav Natyrore****Struktura e programit mësimor**

<b>Kategoritë</b>	<b>Numri i orëve gjithsej</b>	<b>%</b>
<b>Hapësira dhe sistemet fizike</b>	<b>35</b>	<b>47</b>
<b>Sistemet humane</b>	<b>19</b>	<b>26</b>
<b>Mësim zgjedhor</b>	<b>6</b>	<b>8</b>
<b>Përsëritje</b>	<b>14</b>	<b>19</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>74</b>	<b>100</b>

<b>PËRMBAJTJET</b>	<b>STANDARDËT E ARITSHMËRISË</b>	<b>NOCIONET</b>	<b>LIDHJA NDËRKULIKULARE</b>
I. GJEOGRAFIA FIZIKE, lënda e studimit dhe ndarja	NXËNËSI: - shpreh lëndën e studimit të gjeografisë dhe ndërlidhjet me shkencat e tjera	Gjeografia fizike, gjeomorfologjia, hidrologjia, klimatologjia	Gjeologji, gjeofizikë, kimi, biologji
II. FORMA DHE MADHËSIA E TOKËS	- përshkruan formën dhe dimensionet e Tokës dhe rrjedhojat e tyre	Elipsoid, geoid, apioid	

III. HARTA DHE GLOBI, paraqitja e sipërfaqes së Tokës në hartë dhe në glob	- përshkruan teknikat e prezentimit të sipërfaqes tokësore në hartë, përmbajtjen dhe përdorimin e globit dhe të hartave	Harta, globi, shkalla, projeksioni, legjenda, ekuivalenca	gjeodezi
IV. PËRBËRJA DHE STRUKTURA E TOKËS, zhvillimi gjeologjik i korës tokësore	- përshkruan gjeosferat e Tokës, pllakat kryesore, gjeokronologjinë, tipat kryesorë të shkëmbinjve, mineralet dhe rendësinë e tyre	Gjeosfera, bërthama, astenosfera, korja, pllakat, minerali, magma, pangea, sedimenti, metamorfoza	Gjeologji gjeofizikë
V. RELIEVI I SIPËRFAQES TOKËSORE, faktorët dhe proceset relievformuese, tipat e relievit dhe format kryesore të paraqitjes	- përshkruan dhe dallon fuqitë e brendshme e të jashtme si faktorë kryesorë në formimin e relievit, shpjegon shkaqet dhe pasojat e vullkaneve, tërmeteve dhe të tregojë në hartë zonat kryesore të paraqitjes - shpjegon rolin e relievit në veprimtaritë njerëzore dhe rreziqet në litosferë	Relievi, endogjene, ekzogjene, tjetërsimi, vullkani, vatra, hipoqendër, erozioni, orogjeneza, antiklinala, sinklinala, deti Tetis, krasi	Gjeologji, gjeotektonikë
VI. MOTI DHE KLIMA, ndërtimi i atmosferës, proceset energjetike në atmosferë, dinamika e atmosferës, uji në atmosferë, tipat klimatikë-shtrirja gjeografike, shkaqet e ndryshimeve të klimës	- shpjegon përbërësit e atmosferës dhe ndikimi i tyre në proceset atmosferike, - shpjegon burimet e energjisë dhe shkaqet e shpërndarjes jo të njëjtë në sipërfaqen tokësore, - shpjegon sistemet kryesore barike dhe cakton pozitën e tyre, - shpjegon kuptimin mot dhe klimë dhe	atmosfera, troposfera, moti, klima, ozoni, konstanta diellore, albedo. cikloni, anticikloni, moti, prognoza e motit, harta sinoptike, klima, avullimi, kondensimi, inversioni, konvencioni,	Meteorologji, klimatologji, fizikë

	përhapjen gjeografike të tipave klimatike	adveksioni, reshjet, retë, vrërësit, insolacioni, masat dhe frontet ajrore, maritime	
VII. UJËRAT, përbërja e hidrosferës, oqeani botëror, ujërat kontinentale, rëndësia e ujërave si faktorë limitues të zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon ndarjen horizontale të oqeanit botëror dhe masave tokësore;</li> <li>- shpjegon dhe krahason raportin e ujërave të kriposura dhe të freskëta;</li> <li>- Shpjegon shkaqet e zvogëlimit të ujërave të freskëta, rreziqet në hidrosferë;</li> <li>- Shpjegon dhe tregon rastet e ndërhyrjes së shtetit në rregullimin e ujërave;</li> </ul>	Cikli hidrologjik, bilanci ujor, ujëra arteziane, burim, horizont ujëmbajtës. Sistemi lumor, ujëmbledhës, pellg, ujëndarës, akullnajë, cirk, det, oqean, liman, estuar, fjord, vrula, gurra	Hidrologji, hidrogeologji
VIII BIMËSIA, roli i faktorëve natyrorë në përhapjen gjeografike të botës organike (flora dhe fauna), krijimi i dherave dhe shtrirja zonale e tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon ndërvarësinë e zonave bimore ndaj zonave klimatike, ekosistemet kryesore tokësore;</li> <li>- shpjegon rolin e faktorit njeri në ndryshimin e mbulesës bimore dhe rrjedhojat;</li> </ul>	ekosistemi, biot, abiot, biomi, stepa, savana, tundra, pedosfera, kserofiti, mezofiti, higrofiti, kultura bimore, tajga	Botanikë, zoologji, ekologji
X. POPULLSIA, dinamika, struktura, përhapja gjeografike	- shpjegon rritjen e popullsisë, shkaqet, strukturën, migrimet, transicionin demografik, përhapjen gjeografike, politikat demografike;	lindshmëria, vdekshmëria, shtimi natyror, migrimet, dendësia e popullsisë,	Sociologji, mjekësi, ekonomi

		raca, mobilitet, transicioni demografik	
XI.VENDBANIMET, kuptimi, funksionet dhe tipizimi	- shpjegon krijimin e vendbanimeve njerëzore, funksionet dhe tipizimi i tyre.	vendbanime urbane, rurale, megapolis, planifikim hapësinor	
XII. EKONOMIA, veprimtaritë ekonomike: bujqësia, industria, transporti, turizmi	- shpjegon zhvillimin e veprimtarive ekonomike, faktorët e zhvillimit dhe shpërndarja gjeografike e veprimtarive.	ekonomi, bujqësi, dendësia agrare, industri, transport,	Ekonomi, teknologji,

**Vërejtje:** 6 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, të gjeografisë lokale etj. Në kuadër të këtyre orëve mund t'u bëhen vizita objekteve dhe dukurive natyrore, muzeve ose institucioneve me rëndësi për lëndën e gjeografisë.

**GJEOGRAFI**

(2 orë në javë, 74 orë në vit)

**Gjimnazi Shoqëror**

<b>Kategoritë</b>	<b>Numri i orëve</b>	<b>%</b>
Hapësira dhe sistemet fizike	17	23
Sistemet humane	31	42
Mësim zgjedhor	5	7
Orët për përsëritje	21	28
Gjithsej orë	74	100.0

**PËRMBAJTJET, STANDARDET E ARRITSHMERISË, NOCIONET DHE NDËRLIDHJET KURRIKULARE**

<b>Kategoritë - dhe nënkategoritë</b>	<b>Përmbajtjet</b>	<b>Standardet e arritshmerisë</b>	<b>Nocionet</b>	<b>Lidhjet ndërkurrikulare</b>
Vendi dhe hapësira	- Hyrje në gjeografinë fizike, lënda e studimit, ndarja.	Nxënësi duhet të shprehë kuptimin e gjeografisë fizike, ndarjen dhe lidhjen me shkencat e tjera.	Nga disiplinat e gjeografisë fizike.	Lidhjet me gjeologjinë, biologjinë, fizikën.
	- Veçoritë fiziko-gjeografike të Tokës, forma, madhësia, lëvizjet e Tokës dhe rrjedhojat e tyre.	Duhet të dijë të shprehë formën, madhësinë, dimensionet, lëvizjet dhe rrjedhimet e lëvizjeve.	Forma e sferës, gjeoidit, rrethi i ekuatorit, rrethi i meridianit, diametri i poleve.	Ndërlidhja me fizikën, astronominë dhe matematikën.



	- Harta dhe globi, harta gjeografike, ndarja, shkalla, përmbajtja.	Nxënësi duhet të shprehë kuptimin e hartës, të globit, sistemit të koordinatave dhe të izovijave, t'i caktojë pikat në Tokë, të përcaktojë largësinë, lartësinë, t'i përdorë shenjat hartografike.	Harta, globi, paralelet, meridianet, emisfera, tropiku, rrethi polar, shkalla e hartës, gjerësia, gjatësia gjeografike, projeksioni, plani, atlasit, izohipset, izobarët, koha lokale, zonale, kufiri i datës.	Lidhja me hartografinë, matematikën, gjeodezinë.
Sistemet fizike- Litosfera	- Përbërja dhe struktura e Tokës.	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të paraqesë përbërjen e Tokës, veçoritë dhe elementet kryesore të saj.	Korja e tokës, mbështjellësi, bërthama, litosfera, SiAl, SiMa, NiFe, gradienti i temperatures.	Lidhjet me gjeologjinë.
	- Korja e Tokës, krijimi dhe përbërja.	Nxënësi duhet të kuptojë si u krijua korja e Tokës, me cilat levizje tektonike u krijua dhe me cilat procese modifikohet.	Lëvizjet tektonike epirogjene, orogjene, antiklinale, sinklinale, rrudha, hendeku, shkarja, shariazhi, horsti, vargmalet etj.	Lidhja me gjeologjinë.
	- Shkëmbinjtë dhe mineralet.	Nxënësit duhet të kuptojnë çka janë shkëmbinjtë, mono dhe polimineralikë, magmatikë, sedimentarë, metamorfë, si krijohen xehet, llojet e tyre dhe rëndësia ekonomike.	Shkëmbinjtë mono dhe polimineralikë, magmatikë, eruptivë, efuzivë, sedimentues, organogjenë, tretës, metamorfikë, xehet metalike, jometalike.	Lidhjet me gjeologjinë.

	- Relievi i sipërfaqes së Tokës, format themelore, faktorët e krijimit (të brendshëm, të jashtëm).	Nxënësit duhet të dinë si krijohen format parësore dhe dytësore të relievit, vargmalet, malet, fushat, ultësirat, luginat dhe format e tjera relievore.	Kontinentet, ultësirat, vargmalet, fushëgropat, luginat, grykat, kanjonet, alterimi, erozioni, abrazioni, relievi fluvial, karstik, eolik, akullnajor.	Lidhjet me gjeologjinë.
	- Erozioni dhe rrëshqitjet.	Nxënësit duhet të kuptojnë procesin e erozionit dhe rrëshqitjet, faktorët që i shkaktojnë dhe e pengojnë atë, dëmet që i krijojnë për njerëzimin.	Erozioni si dukuri dhe proces, erozioni fluvial, format fluviale erozive, format akumulative fluviale, erozioni specifik.	Lidhjet me gjeologjinë, fizikën, biologjinë, kiminë, matematikën.
	- Roli i relievit në jetën dhe veprimtarinë e njerëzve.	Të kuptuarit e rolit të relievit në shfrytëzimin e tokave për veprimtari të ndryshme, për ndërtimin e vendbanimeve, ndërtimin e rrugëve, qarkullimin e mjeteve të transportit etj.	Relievi malor, ultësinor, fushor, bregor, kodrinor, pengesat relievore, pjerrtësia, energjia e relievit, ekspozicioni, gjatësia e ekspozimit ndaj diellit etj.	Lidhjet mes disiplinave gjeografike, urbanistikës, arkitekturës, agronomisë etj.
Atmosfera	- Ndërtimi i atmosferës dhe proceset dinamike në atmosferë.	Nxënësi duhet të kuptojë strukturën e atmosferës, shtresat e saja, veçoritë e masave ajrore në troposferë në gjerësitë e ndryshme gjeografike, mbi tokë dhe objektet ujore.	Troposfera, stratosfera, jonosfera, ngrohja e masave të ajrit në troposferë, masat ekuatoriale, tropike, subtropike, të mesme, polare, moti, klima, elementet e tyre.	Lidhjet me fizikën e atmosferës.

- Erërat, krijimi dhe ndarja.	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të sqarojë shkaktarët e lëvizjes së ajrit-erës, shpejtësinë e lëvizjes, drejtimet e lëvizjes, veçoritë specifike të erërave në viset e ndryshme në Tokë.	Erërat e përhershme, erërat përkohshme, globale, rajonale, lokale, të ngrohta, të ftohta, të thata, të lagëta, pasatet, antipasatet, monsunet, perëndimore, tajfunet, uraganet.	Lidhja me fizikën e atmosferës.
- Reshjet atmosferike, format, përhapja.  - Fenomeni “El Ninjo.”	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të shpjegojë llojet e reshjeve, format e reshjeve, sasinë e ndryshme dhe shkaqet, fenomenin e “El Ninjos” dhe pasojat e tij për viset tropikale dhe ekuatoriale.	Reshjet e ngurta, të larta, shiu, breshri, vesa, bora, rrebeshet e përhershme e periodike, ekuatoriale, tropikale etj.	Lidhja me fizikën e atmosferës.
- Ndotja e ajrit dhe problemi i ozonit.	Nxënësi duhet të kuptojë se ndotja e ajrit dhe problemi i ozonit është rezultat i zhvillimit të industrisë, qyteteve dhe të transportit bashkëkohor, është gati i pashmangëshëm, por edhe i kontrollueshëm.	Ndotja me gazra kimike, me grimca pluhuri, sasia e gazrave të dëmshëm, standardet e ndotjes, vrimat e ozonit, rrezatimi me infrarreze, ultraviolete.	Lidhjet me fizikën, kiminë, biologjinë.
- Ngrohja globale dhe klima	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të formojë mendimin se hedhja e gazrave nga industria, automjetet etj. po e shkakton “efektin e serrës” që po ndikon në ndryshimin e klimës, e cila do të ketë pasojat e konsiderueshme.	Ngrohja globale, emitimi i gazrave të CO, CO <sub>2</sub> , SO <sub>2</sub> , shirat e tharta, efekti i serrës.	Lidhjet me fizikën, kiminë, biologjinë..

Hidrosfera	- Ujërat, format e paraqitjes, objektet ujore, veçoritë, bilanci ujqor.	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të shpjegojë përhapjen e ujërave në Tokë, format e paraqitjes, vetitë fizike e kimike dhe bilanci e tij.	Deti botëror, detet, liqenet, lumenjtë, kënetat, moçalet, kripshmëria, temperatura, lëvizjet, batica, zbatia, rrymat detare.	Lidhja me fizikën, kiminë
	- Ujërat si faktor limitues i zhvillimit me shoqëror.	Nxënësit duhet të dinë se kërkesat për ujë po shtohen gjithnjë, kurse sasitë e tij mbeten të njëjta, në disa pjesë të botës ndihet mungesa e ujit dhe ai po bëhet faktor limitues i zhvillimit së bashku me ndotjen e ujit.	Shpërndarja jo e barabartë, mungesat e ujit, bilanci negativ, ndotja e ujit.	Lidhja me ekonominë dhe shkencat e tjera shoqërore.
Biosfera	- Shpyllëzimi dhe zhdukja e bimëve dhe kafshëve nga ekosistemet e ndryshme	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të zhvillojë mendimin se bota e gjallë bimore e shtazore është në rrezik nga shfrytëzimi joracional nga shkaku i shtimit të lartë të popullsisë dhe ndotjes së mjedisit	Prerja e pyjeve, djegia e pyjeve, shkurreve, hapja e sipërfaqeve për bujqësi, ndotja e mjedisit, zhdukja e llojeve të bimëve dhe të kafshëve.	Lidhja me biologjinë, kiminë
Pedosfera	- Dherat, krijimi, tipat kryesorë, zvogëlimi i fondit tokësor.	Nxënësi duhet të dijë se si krijohen dherat, veçoritë bazë fizike, kimike e biologjike të tyre, tipat më të njohur, fondi i tokave të mira dhe zvogëlimi i tyre.	Substrati, toka e shkrifët, toka e vdekur, toka e zezë, e kuqe, e murrme, e hirtë, produkte, skeletore, aluviale, toka e kriposur, degradimi i tokave.	Lidhja me gjeologjinë, pedologjinë, biologjinë, fizikën, kiminë.

Sistemet humane	- Gjeografia humane, lënda, ndarja, detyrat.	Nxënësi duhet të njohë disipinat e gjeogra-fisë humane, lëndën e studimit dhe rëndë-sinë e tyre	Gjeografia humane, sociale, ekonomi- ke, agrare, industriale, transportit, vendbanimeve rurale, agrare.	Lidhja me disipinat fqinje.
	- Hartat dhe metodat hartografike në gjeografinë humane	Nxënësi duhet t'i njohë elementet e hartës, simbolet dhe të dijë t'i përdorë ato në leximin dhe në punimin e hartave tematike.	Koordinatat, kuotat, shka-lla, projekcioni, hartat te- matike, hartodiagrami, har- togrami, piktogrami, stig- mogrami, harta me izo- linja, GIS-i, metodat grafike.	Lidhja me hartografinë, statistikën, matematikën
Njeriu dhe ekumena, njeriu, komunitetet, hapësira	- Popullsia në botë, lëvizja numerike, shpërndarja, dendësia, rritja e shpejtuar.	Nxënësi duhet t'i njohë kuptimet themelore dhe përmes numrave dhe paraqitjeve grafike të shprehë rritjen e popullsisë, dendësinë, lëvizjet e popullsisë.	Rritja, zvogëlimi, shtrirja, shpërndarja, shtimi, dyfishimi, shtimi absolut, relativ, determinantet, tranzicioni, fazat.	Lidhja me demo grafinë, statistikën, ekonominë, sociologjinë.
	- Lëvizja natyrore dhe migri met, problemi i refugjatëve.	Nxënësi duhet të dijë të analizojë lëvizjen natyrore dhe mekanike me faktorët socialë, ekonomikë, politikë e psikologjikë.	Nataliteti, mortaliteti, fer- tiliteti, fekonditeti, faktorët biologjikë, socialë, ekonomikë, psikologjikë, llojet e migrimeve, refugjatet.	Lidhja me shkencat sociale, ekonomike, medicinale, psikologjinë.
	- Strukturat e popullsisë, analfabetizmi, papunësia, pabarazia gjinore e tjera.	Nxënësi duhet të kuptojë se popullsia përbëhet prej shumë strukturave si biologjike, vitale, ekonomike, sociale, arsimore, etnike, racore, fetare, gjuhësore dhe duhet të dijë t'i sqarojë.	Popullsia aktive, joaktive, struktura gjinore, moshore, martesore, ekonomike, arsimore, etnike, racore, fetare, gjuhësore.	Lidhja me shkencat sociale, ekonomike.

Vendbanimet	- Vendbanimet, kuptimi, ndarja, tipat, funksionet.	Nxënësi duhet të dijë t'i dallojë vendbanimet fshatare, urbane, të dendura, të shpërndara, format e tyre, madhësinë dhe funksionet.	Fshatrat, qytetet, e përkohshme, e përhershme, e vogla, e mesme, të mëdha, të zgjatura, katrore, yjore, grumbullore, rendore, agrare, xehëtare, industriale, turistike etj.	Lidhja me shkencat shoqërore, ekonomike, urbanistike.
	- Urbanizimi si proces botëror	Nxënësi duhet të kuptojë se qytetet filluan të zhvillohen me zhvillimin e industrisë dhe të degëve shërbyese, me zhvillimin e transportit, se qytetet dallohen nga struktura e brendshme, fizionomia dhe funksionet.	Rritja popullore, fizike, mënyra e jetës, kategoritë e qyteteve, struktura e brendshme, areali metropolitan, konurbacioni, zona gravituese, sistemi rrugor, transporti mbi dhe nëntokësor urban.	Lidhje me shkencat teknike.
Organizimi i hapsirës	- Harta politike e botës	Nxënësi do të kuptojë se harta politike e botës ka ndryshuar shumë dhe po ndryshon gjithnjë, pas dekolonializimit, dhe pas shkapërderdhjes së disa vendeve socialiste.	Zbulimet e mëdha gjeografike, koloni-zimi, dekolonizimi, varësia ekonomiko-teknologjike, hyrja në borxhe, krijimi i shumë shteteve të vogla.	Lidhja me shkencat politike, ekonomike.

	- Shteti si element gjeografik	Nxënësi duhet të kuptojë se shteti përbëhet prej territorit, popullsisë, pasurive natyrore, njerëzore, rregullimit shoqëror-politik, kufijve dhe se ka shtete me madhësi të ndryshme territoriale, populative, forma të qeverisjes dhe rregullim politik.	Pozita gjeografike, shtete të vogla, të mesme ,të mëdha, kufi natyror, etnik, matematik, dalje në det, shtet kontinental, i pasur, i varfër, i (pa)zhvilluar, kapitalist, socialist, mikst, unitar, federal, ujëra territoriale.	Lidhja me shkencat politike
	- Grupimet ekonomike, ushtara ke dhe politike në botë	Nxënësit duhet të kuptojnë se shtetet për qëllime ekonomike e politike krijojnë grupacione shtetesh për të qenë më të forta dhe sigurta.	Grupimet ekonomike (OECD, EFTA, OPEC,GATT etj.), ushtarake, Pakti NATO, Liga Arabe, politike (OSCE, OKB, EU).	Lidhja me shkencat politike
	- Konfliktet dhe bashkëpu-nimi në mes të popujve e shteteve.	Nxënësit duhet të dinë se në mes të popujve dhe të shteteve ka interesa të ndryshme ekonomi ke e politike, probleme kufitare, etnike, por ka edhe bashkëpunim të mirëfilltë.	Konfliktet rreth territorit, ujërave, pasurive natyrore, kufinjve, pakicave etnike, bashkëpunim ndërkufitar, ndërshtetëror, ndërkulturor.	Lidhje me shkencat politike, ekonomike, kulturore.
Njerëzit dhe veprimtaritë	- Veçoritë ekonomiko-gjeo grafike të botës.	Nxënësi duhet të dijë për kuptimin e ekonomisë, për sektorët, llojet e veprimtarive prodhuese dhe joprodhuese, për faktorët që e ndihmojnë dhe pengojnë zhvillimin ekonomik.	Ekonomia prodhuese, shërbyese, sektorët e ekonomisë, veprimtaritë, faktori njerëzor, teknik, financiar, organizativ.	Lidhja me shkencat ekonomike.

	- Ekonomia dhe veprimtaritë ekonomike e shërbyese	Nxënësi duhet të zbatojë ndarjen e ekonomisë sipas veprimtarive e sektorëve dhe të tregojë rolin e tyre për ekonomi.	Veprimtaritë ekonomike, shërbyese, pesha specifike në strukturën e degëve.	Lidhja me shkencat ekonomike.
	- Revolucioni shkencor-tek nik-teknologjik dhe rrjedhimet për ekonomi	Nxënësi duhet të kuptojë se zhvillimi shkencor, teknik dhe teknologjik është ndër faktorët shumë të rëndësishëm për përparimin e ekonomisë dhe të shoqërisë në përgjithësi.	Revolucioni shkencor, teknik dhe teknologjik, revolucionet industriale, përdorimi i qymyrit, naftës, elektrikut, energjisë bërthamore, elektronika, inxhinjeringu, robotika.	Lidhja me shkencat teknike, teknologjike, informative etj.
	- Prodhimtaria bujqësore, kush tet dhe faktorët e zhvillimit	Nxënësi duhet të dijë se për zhvillimin e bujqësisë nevojiten kushtet optimale natyrore ose kompensimi i tyre me faktorët teknikë organizativë e financiarë.	Relievi, klima, lagështia, ujitja, dherat, rritja e popullsisë, ngritja profesionale, teknike, zhvillimi i industrisë, transportit, tregut, përkrahja shtetërore etj.	Lidhja me shkencat agronomike.
	- Tipat e prodhimitarisë bujqësore	Nxënësi duhet të dijë se si rezultat i ndikimit të kushteve natyrore dhe nivelit të zhvillimit ekonomik e teknik janë krijuar tipa të ndryshëm të prodhimitarisë bujqësore.	Tipi tradicional, ekstensiv, intensiv, forma komerciale ekstensive, ekonomia e tregut, sistemi i fermave i bujqve të specializuar.	Lidhja me shkencat agronomike.
	- Prodhimtaria bimore në brezin e mesëm	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të sqarojë se në brezin e mesëm rriten kulturat që i përgjigjen këtij brezi.	Prodhimi i grurit, misrit, patates, panxharit, lule diellit, pemëve dhe perimeve të brezit të mesëm.	Lidhja me shkencat agronomike.



- Prodhimtaria bimore në brezin subtropik	Nxënësi duhet të sqarojë përhapjen e bimëve që i përgjigjen brezit subtropikal.	Agrumet, ulliri, fiku, hardhia, hurma, pambuku, duhani.	Lidhja me shkencat agronomike.
- Prodhimtaria bimore në brezin tropik dhe ekuatorial	Nxënësi duhet të sqarojë përhapjen e bimëve në brezin tropikal dhe ekuatorial.	Orizi, kafja, çaji, banana, palma e kokosit, vajit, sisali, juta.	Lidhja me shkencat agronomike.
- Prodhimtaria blegtorale dhe peshkimi në botë.	Nxënësi do t'i analizojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e blegtorisë, tipat e saj, zhvillimin e tregut, transportit, rajonet e peshkimit, sasinë e peshkimit dhe industrinë e përpunimit të peshkut.	Blegtoria ekstensive, intensive, racat (jo)produktive, numri i gjedheve, deleve, derrave, kuajve, prodhimet bazë blegtorale.	Lidhja me shkencat agronomike.
- Problemi i urisë në botë, përhapja, shkaqet dhe pasojat.	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të sqarojë pse ndodh uria në kohën e sotme, ku ndodh dhe si mund të zgjidhet ky problem.	Uria si dukuri, kufiri i poshtëm i të ushqyerit, kufiri i mesëm, i sipërm, viset me mungesa ushqimi.	Lidhja me shkencat ekonomike e mjekësore.
- Industria dhe zhvillimi, veçoritë e prodhimit industriale.	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të sqarojë çka është industria, si u zhvillua dhe cilat janë veçoritë e prodhimit industriale.	Zejtaria, manifaktura, industria, revolucioni i parë, i dytë, i tretë industrial, industrializimi si proces, treguesit e industrializimit	Lidhja me shkencat ekonomike dhe teknik.
- Faktorët e lokalizimit të industrisë.	Për të kuptuar dhe për ta sqaruar shpërndarjen hapësinore të industrisë sipas degëve, nevojitet të njihen faktorët e lokalizimit të industrisë.	Lënda e parë, energjia, fuqia punëtore, kapitali, transporti, tregu, hapësira, uji, faktorët e fortë dhe të butë të lokacionit	Lidhjet me shkencat ekonomike dhe teknike.

- Energjetika dhe rëndësia e saj për zhvillimin ekonomi.	Për të sqaruar zhvillimin e energjetikës nevojitet të kuptohen etapat e zhvillimit të energjisë krahas zhvillimit ekonomik dhe teknik.	Energjia e Diellit, erës, kafshëve, njeriut, makinës me avull, djegie të brendshme, energjia elektrike, bërthamore, struktura e burimeve, prodhimi i tyre në botë.	Lidhja me shkencat teknike.
- Lëndët e para, përhapja dhe rëndësia e tyre për ekonomi.	Nxënësi duhet të dijë se industria ka nevojë për lëndë të para të cilat duhet të përpunohen, porse ato kanë shtrirje të ndryshme në botë.	Lëndët e para energjetike, metalike (të metalurgjisë së zezë, me ngjyra), jometalike, industrisë për punuese.	Lidhja me gjeologjinë dhe me shkencat teknike
- Rajonet industriale dhe veçoritë e tyre ekonomiko-gjeografike.	Nxënësi duhet të dijë se industria ka veti të përqendrimit dhe të lidhjes, prandaj edhe krijon rajone industriale.	Rajonet e vjetra dhe të reja industriale, rajonet metalurgjike, metalike dhe të makinave, të industrisë së lehtë, rajonet pranëbregdetare, pranë qymyrit, naftës etj.	Lidhja me shkencat ekonomike dhe teknike.
- Zhvillimi i pabarabartë industrial, shkaqet dhe pasojat.	Nxënësi duhet të kuptojë se zhvillimi i industrisë me përqendrimit e saj hapësinor ndikon në zhvillimin e pabarabartë ekonomik duke shkaktuar edhe pasoja të tjera.	Indikatorët e zhvillimit, brutoprodhimi shoqëror për kokë banori, lartësia e të ardhurave kombëtare, shtetet eksportuese, importuese, kreditimi i zhvillimit industrial.	Lidhjet me ekonominë dhe me sociologjinë.

	Transporti, komunikacioni, tregtia dhe turizmi.	Nxënësi duhet të dijë se këto degë kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e gjithëmbarshtëm dhe se janë të lidhura për zhvillimin e teknikës, ekonomisë, kushteve gjeografike.	Kuptimi i transportit, komunikacionit, tregtia e brendshme, e jashtme, turizmi, llojet e turizmit.	Lidhja me shkencat ekonomike, humane, teknike.
	- Kushtet dhe faktorët e zhvillimit të transportit dhe të komunikacionit.	Nxënësi duhet të sqarojë se për zhvillimin e transportit dhe të komunikacionit duhet njohur mirë kushtet natyrore, shoqërore, ekonomike dhe teknike.	Kushtet natyrore, si relievi, klima, hidrografia, pozita, pasuritë natyrore, zhvillimi teknik.	Lidhja me shkencat natyrore, ekonomike dhe teknike.
	- Degët e komunikacionit, veçoritë dhe shpërndarja.	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të sqarojë cilat janë degët e komunikacionit, cilat janë veçoritë specifike të tyre dhe si janë shpërndarë në botë.	Komunikacioni tradicional, modern, tokësor, ujor, ajror, rrugor, hekurudhor, detar, liqenor, lumor, kanalor, teleferik, TT, elektronik.	Lidhjet me shkencat teknike dhe ekonomike.
	- Këmbimi i mallrave në botë.	Nxënësi duhet të dijë dhe të sqarojë se këmbimi është një veprim shumë i nevojshëm për të mundësuar prodhimin dhe konsumin e produkteve.	Këmbimi, llojet e këmbimit, tregu i brendshëm, i jashtëm, bilanci pozitiv, negativ tregtar, organizatat tregtare botërore e rajonale, vëllimi i këmbimit.	Lidhja me shkencat ekonomike.
	- Turizmi si fenomen bashkë kohor dhe funksioni i shumëfishtë i tij.	Nxënësi duhet të dijë dhe të zbatojë në praktikë njohuritë e veta për turizmin si fenomen modern dhe funksionin e shumëfishtë të tij, faktorët që e nxiten dhe po e mbajnë.	Argëtimi, rekreacioni, pushimi, viset emetive, receptive, kapacitetet turistike, motivet natyrore, kulturore, qendrat, rajonet receptive.	Lidhjet me shkencat ekonomike dhe humane.

Mjedisi dhe shoqëria	- Mjedisi dhe shoqëria, llojet e mjediseve dhe veçoritë e tyre.	Nxënësi duhet të formojë idenë se në mjedis ndërthuren kushtet natyrore dhe veprimi i njeriut, duke krijuar rrethana specifike për jetë.	Mjedisi natyror, human, kulturor, mjedisi gjeografik, ndërthurje elementesh gjeografike.	Lidhja me biologji, ekonomi, sociologji.
	- Ndikimi i mjedisit natyror në zhvillimin e shoqërisë.	Nxënësi duhet të kuptojë se elementet e natyrës ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë përmes relievit, resurseve natyrore, klimës, ujit, dheut, botës bimore e shtazore.	Raportet reliev, klimë, ujëra, dhera, vegjetacion me popullsi, vendbanime, shfrytëzim të tokave, veprimtari, transport, shëndetësi.	Lidhja me shkencat natyrore dhe humane
	- Roli i shoqërisë në transformimin e mjedisit natyror.	Nxënësi duhet të kuptojë dhe të shprehë rolin e njeriut përmes aktiviteteve të organizuara, mjeteve dhe diturisë në mjedisin natyror.	Transformimi i mjedisit natyror, mjedise agrare, industriale, turistike, rurale, urbane.	Lidhja me shkencat ekonomike dhe teknike
	- Mjediset tipike madhore në botë.	Nxënësi duhet të kuptojë se në botë dallohen mjedise tipike madhore, si shkretëtirat, pyjet ekuatoriale, tropike, savane, stepa, tajga, tundra etj.	Viset shkretinore të nxehta, të ftohta, pyje ekuatoriale, tropike, monsunike, savane, stepe, tajge, tundra.	

**Vërejtje:** 5 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, gjeografisë lokale etj. Në kuadër të këtyre orëve mund t'u bëhen vizita objekteve dhe dukurive natyrore, muzeve ose institucioneve më rëndësi për lëndën e gjeografisë.

**Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë****Struktura e përmbajtjeve programore**

<b>Kategoritë</b>	<b>Numri i orëve</b>	<b>%</b>
<b>Hapësira dhe hartografia</b>	20	27.0
<b>Sistemet fizike</b>	15	20.3
<b>Sistemet humane</b>	15	20.3
<b>Mësim zgjedhor</b>	5	6.7
<b>Përsëritje</b>	19	25.7
<b>Gjithsej</b>	74	100.0

<b>Kategoritë</b>	<b>Nënkategoritë-temat</b>	<b>Standardet e arritshmerisë</b>	<b>Lidhja ndërkurikulare</b>
Hapësira dhe hartografia	<b>Hartografia me GIS.</b> - Lënda, ndarja, zhvillimi, aplikimi	Nxënësi duhet të kuptojë e të zbatojë njohuritë elementare hartografike.	Lidhja me gjeodezi
“	<b>Baza matematike e hartës.</b> - Shkalla numerike dhe grafike e zvogëlimit, - përcaktimi i shkallës kur ajo mungon.	Duhet ta njohë bazën matematike të hartës dhe të zbatojë njohuritë nga shkalla numerike dhe grafike dhe të dijë ta përcaktojë atë kur ajo mungon.	Lidhja me gjeodezi dhe matematikë.

“	<b>Sistemi i koordinatave gjeografike.</b> - Gjerësia dhe gjatësia gjeografike, llogaritja e tyre.	Të kuptojë sistemin e koordinatave dhe të dijë të llogaritë gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike.	Lidhja me gjeodezi dhe me matematikë.
“	<b>Baza gjeodezike e hartës.</b> - Rrjeti gjeodezik (trigonometrik, nivelimit), - Sistemi GPS, - Caktimi i shkallës së aerofotografisë, - Ftoharta, shfrytëzimi i aerofotografive në gjeografi	Të kuptojë çka është rrjeti gjeodezik, të dijë ta përdorë sistemin GPS dhe të jetë në gjendje të përcaktojë shkallën e aerofotografisë. Po ashtu duhet të jetë i njohur me rastet se ku mund të përdoret aerofotografia në gjeografi.	Lidhja me gjeodezi.
“”	<b>Projeksionet hartografike</b> - Gjeoidi, elipsoidi, projeksioni i Gaus-Krügerit dhe Merkatorit	Të jetë në gjendje të zbatojë projeksionin e Gaus-Krügerit dhe Merkatorit.	Lidhja me matematikë dhe gjeodezi.
“	<b>Elementet e hartës gjeografike</b> - Objektet gjeografike në hartë (relievi, hidrografia, vegjetacioni, vendbanimet, komunikacioni, kufijtë, ekonomia, toponimet), - harta relievoe, plani, globi, atlasit.	Të jetë në situatë t’i dallojë elementet e hartës dhe të dijë t’i paraqesë në hartën gjeografike.	Lidhja me gjeografi, ekonomi dhe toponomastikë.
“	<b>Hartometria</b> - Orientimi i hartës, orientimi dhe lëvizjet me hartë në hapësirë, matja e gjatësisë dhe e koordinatave në hartë;	Nxënësi duhet të aftësohet që ta orientojë hartën dhe të orientohet me anën e saj në hapësirë, të dijë t’i matë gjatësitë, të caktojë këndin, ta matë pjerrtësinë, ta	Lidhja me gjeodezi dhe me matematikë

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- matja e këndeve dhe e kuotes në hartë,</li> <li>- matja e pjerrtësisë së terrenit;</li> <li>- matja e sipërfaqeve në harta;</li> <li>- punimi i profilit vertikal të terrenit në hartë.</li> </ul>	caktojë profilin vertikal dhe të dijë të masë sipërfaqet nga harta gjeografike.	
“	<b>Sistemi i informimit gjeografik (GIS)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptimin e GIS-it, përgatitja e të dhënave për GIS, Futja e të dhënave në GIS (numerike, vektoriale, rasterike);</li> <li>- Përpunimin e të dhënave gjeografike dhe menaxhimin e të dhënave numerike dhe hapësinore.</li> </ul>	Nxënësi duhet të kuptojë çka është GIS-i, si përgatiten të dhënat dhe si përpunohen ato me anën e GIS-it.	Lidhja me matematikë dhe me teknologji informative.
“	<b>Hartat tematike</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metodrat hartografike për punimin e hartave tematike,</li> <li>- Punimi i hartës tematike me GIS.</li> </ul>	Nxënësi duhet t’i zbatojë metodat hartografike për punimin e hartave tematike me metoda klasike dhe me GIS.	Lidhja me statistikë dhe me teknologji informative.
Hapësira dhe Gjithësia	<b>Forma dhe madhësia e Tokës</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëvizjet e Tokës dhe rrjedhimet.</li> <li>- Zënia e Diellit dhe Hënës.</li> </ul>	Nxënësi të jetë në situatë t’i kuptojë dhe t’i zbatojë ligjshmeritë e lëvizjes rreth vetes dhe rreth Diellit dhe të kuptojë drejt zënie e Hënës dhe të Diellit.	Lidhja me fizikë dhe me astronomi.
Sistemet fizike	<b>Përbërja dhe struktura e Tokës</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi i brendshëm i Tokës,</li> </ul>	Nxënësi të jetë në gjendje të kuptojë ndërtimin e brendshëm të Tokës, të kores	Lidhja me gjeologji.

	- Korja e Tokës, krijimi dhe përbërja.	së saj dhe përbërjen dhe të jetë në situatë ta paraqesë si model.	
“	<b>Relievi i sipërfaqes tokësore</b> - Veprimi i forcave të brendshme. - Vullkanet, tërmetet, shkaqet dhe pasojat. - Fuqitë e jashtme dhe ndikimi i tyre në modifikimin e relievit.	Nxënësi të jetë në situatë të kuptojë se relievi krijohet përmes veprimit të fuqive të brendshme dhe të forcave të jashtme, si ujit, erës, akullit, procesit kimik. Ai duhet të dijë si dhe ku paraqiten vullkanet e tërmetet dhe të tregojë pasojat e tyre.	Lidhja me gjeologji.
“	<b>Moti dhe klima</b> - Përbërja dhe ndërtimi i atmosferës. - Proceset dinamike në atmosferë (temperatura, shtypja, lagështia, vranësirat, reshjet). - Tipat klimatike.	Nxënësi duhet të krijojë kuptimin mbi përbërjen dhe ndërtimin e atmosferës, t’i njohë mirë elementet e klimës dhe ndryshimet e tyre në gjerësitë gjeografike. Duhet t’i njohë disa tipa të klimës dhe të dijë t’i dallojë ata sipas tipareve të tyre.	Lidhja me meteorologji, Klimatologji.
“	<b>Ujërat</b> - Ujërat sipërfaqësore, format, vetitë, shtrirja gjeografike. - Ujërat nëntokësore, format, vetitë, shtrirja gjeografike. - Bilanci i ujërave dhe rëndësia e tyre për zhvillim.	Nxënësi duhet të formojë kuptimin mbi qarkullimin e ujit në natyrë, ciklet e lëvizjes, format e paraqitjes, vetitë e ujërave dhe shtrirjen gjeografike të tyre. Të kuptuarit e bilancit i mundëson të gjykojë drejt mbi sasinë e ujërave në viset e ndryshme dhe ruajtjen e tij.	Lidhja me hidrologji.



“	<b>Dherat</b> - Krijimi dherave, veçoritë, tipat, shtrirja gjeogra fike.	Të kuptuarit e formimit të dherave i ndihmon nxënësve të formojë mendimin e drejt për përdorimin dhe ruajtjen e tyre për prodhimtarinë bujqësore.	Lidhja me pedologji.
“	<b>Bota bimore e shtazore</b> - Roli i kushteve natyrore dhe i njeriut në botën bimore dhe shtazore.	Më këto njohuri nxënësi duhet të formojë mendimin se përhapja gjeografike e botës bimore dhe shtazore është e lidhur ngushtë me kushtet natyrore, por edhe me veprimin e njeriut në mjedis.	Lidhja me biologji.
Sistemet humane	<b>Popullsia</b> - Lëvizja numerike e popullsisë, dinamika, dendësia. - Lëvizja natyrore, dallimet rajonale, shkaqet, pasojat. - Teoria e tranzicionit në vendin tonë dhe botë. - Migrimet, format, shkaqet, pasojat. - Strukturat e popullsisë dhe roli i tyre per shoqëri.	Duke i përdorur të dhënat tabelare, grafikonet dhe hartat nxënësi të jetë në gjendje të kuptojë ritmin e rritjes, shpërndarjen jo të njëjtë gjeografike, të dijë për shkaqet e shtimit jo të njëjtë, për pasojat e shtimit të lartë dhe të ulët të popullsisë. Me anën e modelit të thjeshtë të kuptojë teorinë e tranzicionit në botë dhe te ne, ndërsa përmes strukturave të dijë të vlerësojë nivelin e zhvillimit të shoqërisë në hapësirën dhe kohën e caktuar.	Lidhja me demografi, statistikë, ekonomi.
“	<b>Vendbanimet</b> - Vendbanimet rurale, llojet, format, zhvillimi, perspektiva - Vendbanimet urbane, madhësia, forma, funksionet, struktura e	Njohja e llojit dhe e formave të vendbanimeve në kushte të ndryshme natyrore dhe shoqërore u ndihmon nxënësve të kuptojnë faktorët e zhvillimit, formën, madhësinë, strukturën	Lidhja me statistikë, gjeodezi, sociologji, ekonomi.

	<p>brendshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Urbanizimi si proces botëror.</li> </ul>	<p>dhe funksionet e vendbanimeve. Të kuptuarit e urbanizimit dhe shkallës së tij ndihmon në njohjen e shkallës së zhvillimit të përgjithshëm.</p>	
“	<p><b>Ekonomia</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Veprimtaritë ekonomike dhe shërbyese.</li> <li>- Trendet bashkëkohore në zhvillimin e veprimtarive.</li> <li>- Kushtet dhe faktorët e zhvillimit të bujqësisë.</li> <li>- Prodhimtaria bimore dhe shtazore në botë.</li> <li>- Zhvillimi i industrisë dhe faktorët e lokalizimit.</li> <li>- Transporti dhe komunikacioni (rrugët, llojet, paraqitja grafike, dendësia, qarkullimi).</li> <li>- Turizmi si fenomen bashkëkohor (dukuria, faktorët e zhvillimit, zonat turistike, efektet e turizmit).</li> </ul>	<p>Nxënësi duke kuptuar strukturën e veprimtarive (ekonomike dhe shërbyese) do të formojë mendimin mbi nivelin e zhvillimit të vendit. Njohja e kushteve natyrore dhe shoqërore i mundëson të kuptojë ndërlidhjen e zhvillimit me faktorët e ndryshëm, qoftë në bujqësi, industri ose veprimtaritë të tjera. Duke i njohur edhe veprimtaritë e tjera si transportin, tregtinë, turizmin etj. nxënësi do të formojë mendimin mbi mundësitë e shfrytëzimit kompleks të kushteve të mjedisit dhe krijimin e të ardhurave nga shumë veprimtari.</p>	<p>Lidhja me ekonomi, statistikë.</p>

**Vërejtje:** 5 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, gjeografisë lokale etj. Në kuadër të këtyre orëve mund t’u bëhen vizita objekteve dhe dukurive natyrore, muzeve ose institucioneve më rëndësi për lëndën e gjeografisë.

## UDHËZIME DIDAKTIKE

Gjatë nxënies së mësimit të gjeografisë haset në mënyrë të pashmangshme me kuptime- nocione të ndryshme, emra gjeografikë dhe të dhëna statistikore si pjesë të inventarit gjeografik. Arsimtari duke shfrytëzuar faktografi duhet të zhvillojë shkathtësi për nxënie më të lehtë, të drejtë dhe më të shpejtë të kuptimeve gjeografike. Duhet zhvilluar shkathtësitë për pranimin, përpunimin dhe vlerësim kritik të informatave gjeografike.. Kuptimet e ndryshme nga gjeografia e përgjithshme duhet të **ilustrohen dhe të konkretizohen** me shembuj nga Kosova, trojet etnike, rajoni dhe bota.

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përzgjedhja e metodave mësimore është në kompetencë të mësimit-dhënësit dhe ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, veçoritë e përmbajtjes së temave dhe të njësive mësimore, nivelit të formimit të nxënësve si dhe në përshtatje të moshës dhe aftësive të nxënësve. Me qëllim të nxënies cilësore dhe arritjes së rezultateve optimale gjatë procesit mësimor sugjerohen këto metoda dhe teknika :

- shpjegimi dhe sqarimi,
- te mësuarit problemor,
- puna në grupe
- diskutim që zgjedh problemin (debate),
- teknika e të menduarit kritik,
- stuhi mendimesh,
- vetëhulumtimi (kërkimi),
- të shprehurit me gojë,
- të shprehurit me shkrim,
- demonstrimi dhe interpretimi.

Gjatë procesit mësimor organizimi i nxënësve mund të jetë:

- puna me tërë klasën,
- puna në grupe,
- puna në çifte,
- puna individuale.

Preferohet që me parë të punohet në **çifte**, me qëllim që nxënësit të çlirohen nga emocionet, e pastaj të kalohet në punë në **grupe**. Puna në

grupe mund të përfshijë 4-7 nxënës, vazhdon zakonisht pesë minuta e në fund bëhet përmbledhje e punës së grupit, ku vërehet lidhja e suksesit individual me suksesin e grupit ose sukcesi i grupit të jetë i lidhur me suksesin e klasës. Për tema të caktuara për të cilat ekzistojnë informacione të bollshme, mund të gjejë zbatim edhe **ligjërata interaktive** e kombinuar me aktivitete praktike.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore të përmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e **materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike** pa të cilat nuk mund të arrihen rezultate të pritura. Për tema mësimore që kanë specifika të veçanta mund të shfrytëzohen me sukses **mësimi në natyrë, vizitat** në institute të ndryshme hidrometeorologjike, seizmike, gjeologjike, statistikore, biblioteka dhe organizimi i **ekskursioneve** të ndryshme me karakter gjeografik.

**Metoda – diskutimi që zgjedh problemin** nuk mjafton që për çdo problem të jepet një zgjedhje, por për një problem të jepen sa ma shumë zgjidhje dhe të vlerësohet zgjidhja më e mirë.

**Metoda- stuhi mendimesh (brainstorming)** ka për qëllim të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë.

## VLERËSIMI DHE NOTIMI

Gjatë verifikimit dhe notimit të dijës (me shkrim ose gojarisht) arsimtari duhet të përgjithësojë qëllimet e taksonomisë së Bloom-it (njohje, kuptim, përdorim, analiza, sinteza, vlerësim). Vlerësimi realizohet gjatë tri etapave :

- kontrolli,
- matja,
- vlerësimi.

Kontrolli ka të bëjë me përfundimin e rezultateve të të mësuarit . Ai u përgjigjet pyetjeve “ç’di”, “ç’u arrit”, “çfarë nuk dinë nxënësit “ç’ nuk u arrit”.

**Matja** - ajo që u kontrollua duhet të matet. Nxënësi ka nevojë të dijë rezultatin e kontrollit. Ajo shprehet me pikë, përqindje (%) ose me një evidencë të thjeshtë të formuluar me shprehje, shenja dalluese e tij krahasuar me një standard të bazuar në kritere.

**Vlerësimi** është procesi i vrojtimit, mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në çfarë

shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat. Çfarëdo mjeti që përdoret nuk mund të matë të gjitha karakteristikat e arritshmërisë së nxënësit, andaj duhet përdorur sa ma shumë që të jetë e mundur mjete dhe teknika të ndryshme, në mënyrë që të mbledhim informacione të mjaftueshme për të vlerësuar shkallën e arritshmërisë së nxënësit. Vlerësimi nënkupton vendosjen e një vlere, gjykimin sasior ose cilësor të bazuar në matje. Kjo bëhet nga mësimdhënësi me notë ose me shprehje (fjalë, simbole).

### **Instrumentet për matje dhe vlerësim:**

- vrojtimi, raporti me shkrimi i një pune praktike apo hulumtimi, të shprehurit me gojë, (të shprehurit me shkrim, fletë kontrolluese (përdoret për shkathësitë manovruese të nxënësit), test i bazuar në kriter dhe objektiva etj.

### **ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR TË NXËNËSVE**

Kurrikuli i lëndës së gjeografisë në përgjithësi, si dhe në veçanti ai kl. X, duhet të japë orientime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit lidhur me çështjet se si mund të zhvillohet puna e pavarur e nxënësve me qëllim që t'u ndihmohet atyre të zhvillohen si mësimëmarrës. Veprimtaria e pavarur e nxënësve duhet të merret në konsideratë gjatë çmuarjes dhe vlerësimit të tyre. Për të pasur sukses në mësimin e lëndës së gjeografisë nxënësit i nevojitet një lloj autonomie, ndërsa arsimtari për t'i realizuar me sukses këto detyra duhet :

- të jetë koordinator, lehtësues, udhëzues;
- njohuritë e veta t'i përhapë te nxënësit;
- të futë në klasë klimë besimi;
- t'i inkurojë nxënësit në progreset e tyre;
- të nxitë motivimin dhe interesimin e nxënësve;
- t'i inkurojë nxënësit për të marrë iniciativa etj.

Lidhur me këtë nxënësi merr iniciativa (nuk pret të nxitet për të marrë fjalën), nuk ka frikë të bëjë gabime, prandaj:

- i përkushtohet punës së tij;
- nuk pret informata të gatshme nga arsimtari;
- hulumton burime të ndryshme të informatave;
- bashkëpunon gjatë punës në grupe;

- përpiqet t'i vlerësojë pikat pozitive dhe negative dhe të përmirësohet;
- merr përgjegjësi në punën kolektive.

#### UDHËZIMI PËR SHFRYTËZIMIN E LITERATURËS

1. **R. Pllana:** *Gjeografia fizike*, Libri shkollor, Prishtinë 2001
2. **A. Pushka:** *Gjeografia shoqërore*, Libri Shkollor, Prishtinë 2002
3. *Atlasi gjeografik për shkolla të mesme*,
4. **Bardhyl Musai:** *Metodologjia e mësimdhënies*, Tiranë 2003

## **HYRJE**

Sipas reformës së arsimit është paraparë që edhe në shkollën e mesme të lartë për herë të parë që të mësohet lënda e re mësimore edukatë qytetare.

Edukimi qytetar synon të përgatisë nxënësit si qytetarë të ardhshëm aktivë. Një gjë e tillë do të mund të arrihet përmes zbulimit të dimensioneve qytetare, sociale dhe politike të jetës shoqërore.

Edukimi qytetar është i rëndësishëm për çdo individ. Ai i aftëson nxënësit të përdorin mirë mendjen e tyre në shoqëri komplekse dhe në ndryshim. Lënda e Edukatës qytetare i ndihmon nxënësit të kuptojnë mirë të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve në shoqëri, si dhe natyrën dhe funksionimin e demokracisë. Nga ana tjetër, kjo lëndë synon të edukojë një qytetar të pajisur me shprehitë dhe të kuptuarit e proceseve të cilat i aftësojnë ata të shohin, gjykojnë, vendosin dhe të veprojnë.

Kjo lëndë mësimore, në arsimin e mesëm të lartë, mësohet vetëm në klasën e dhjetë me nga dy orë në javë, d.m.th. me 74 orë në vit, në të gjitha tipat e gjimnazeve, me përjashtim të gjimnazit matematikor (nuk mësohet në asnjë klasë), ndërsa në gjimnazin e shkencave shoqërore mësohet edhe në klasën e njëmbëdhjetë.

Përmbajtjet programore në shkollat e mesme të arsimit profesional, në klasë të dhjetë do të zhvillohen me një orë në javë dhe kanë si kategori të tyre qeverisjen, pushtetin, autoritetin, idealet dhe praktikat qytetare.

Qeverisja dhe qytetaria mësohen edhe në shkollën e mesme të ultë, por në klasën aktuale presupozohet thellimi i njohurive dhe i aftësive që duhet të fitojnë nxënësit në njohjen e parimeve dhe të institucioneve të demokracisë.

## **2. QËLLIMET E PËRGJITHSHME**

Qëllimet dhe parimet e përgjithshme të Edukatës qytetare përputhen plotësisht me ato të kornizës kurrikulare të Kosovës. Në veçanti, qëllimet që ka ky program lidhen me zhvillimin personal dhe social, kontri-

butin në zhvillimin moral të nxënësve dhe përgatitjen për t'i bërë ata qytetarë të përgjegjshëm.

Lënda e Edukatës qytetare synon:

- Krijojë kushte që nxënësi të përfitojë njohuri të nevojshme për qeverisjen dhe qytetarinë;
- mundësojë krijimin e qendrimeve dhe vlerave, mësimin e strategjive efektive të zgjidhjes së problemeve, pranimit kritik të informacionit dhe të mjeteve të komunikimit dhe
- kontribuojë në zhvillimin e vetëdijës se dukuritë janë të lidhura me njera – tjetrën në mënyrë të kushtëzuar dhe se janë në ndërveprim reciprok.

Qëllimet e veçanta:

- T'i japin nxënësit njohuri dhe t'i zhvillojë aftësitë intelektuale dhe qytetare, të domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe në mënyrat e zbatimit të tyre.
- Nxënësit të kuptojë dhe të analizojë veprimin e grupeve dhe të institucioneve si dhe ndikimin e tij në jetën e individëve.
- Të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësit dhe përfshirjen e tij të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- Të krijojë qytetarë të aftë, që të jenë të përgjegjshëm për veprime dhe marrëdhënie të pavarura me qytetarë të tjerë, me grupe dhe institucione të shoqërisë civile.

## **OBJEKTIVAT**

### **Objektivat e përgjithshëm**

- Të njohë rëndësinë e qeverisjes demokratike dhe format e ndryshme të qeverisjes;
- Të kuptojë se si ushtrohet pushteti dhe si fitohet autoriteti;
- Të njohë vlerat e shoqërisë bashkëkohore, si lirinë, barazinë, drejtësinë, solidaritetin etj.
- Të kuptojë rolin e ligjit në qeverisjen demokratike: të bëjë dallimin e llojeve të ligjeve dhe të kushtetutës;
- Të kuptojë rolin e mediave të shkruara dhe elektronike dhe të drejtën e publikut për informim.



### Objektivat e veçantë

- Të jetë i vetëdijshëm për rolin e pjesëmarrjes së individit në vendimmarrje;
- Të kuptojë rëndësinë e votimit dhe pjesëmarrjen në partitë politike;
- Të identifikojë se si bëhet mbrojtja e interesave të grupeve të ndryshme në qeverisjen demokratike;
- Të kuptojë dhe të analizojë funksionet e organeve ekzekutive të shtetit në nivel shtetëror dhe lokal;
- Të identifikojë problemet e qytetarëve dhe ndihmat që duhet dhënë shteti në raste emergjencash;
- Të kontribuojë në jetën e komuniteteve dhe në grupet e ndryshme vullnetare;
- Të kontribuojë në parandalimin e çdo lloj krimi të organizuar, ekonomik, politik dhe të trafikimit të qenieve njerëzore;

### STRUKTURA PROGRAMORE E PËRMBAJTJEVE

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtjet programore
Qeverisja dhe qytetaria	Qeverisja (14 + 4 = 18)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qeverisja në jetën e përditshme</li> <li>• Si marrin pjesë qytetarët në qeverisje</li> <li>• Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje</li> <li>• Kushtetuta</li> <li>• Llojet e qeverisjes</li> <li>• Pushteti legjislativ</li> <li>• Pushteti ekzekutiv</li> <li>• Pushteti gjyqësor</li> <li>• Presidenca</li> <li>• Qeveria</li> <li>• Gjykata kushtetuese dhe organet e tjera të drejtësisë</li> <li>• Pjesëmarrja në partitë politike</li> <li>• Votimet</li> <li>• Angazhimi i qytetarit në mbrojtjen e interesave të grupeve të ndryshme</li> </ul>
	Pushteti dhe autoriteti (20 + 2 = 22)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pushteti i qeverisjes shtetërore</li> <li>• Si punon shteti dhe dega legjislative e tij</li> <li>• Vendimmarrësit e shtetit (parlamenti)</li> <li>• Vendimmarrja nga votimet popullore (referendumet, zgjedhjet...)</li> <li>• Organet ekzekutive të shtetit (kryeministri, ministrët...)</li> <li>• Puna e kryeministrit</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organet e tjera shtetërore</li> <li>• Qeverisja lokale (llojet e qeverisjes lokale: komuna, bashkësia lokale)</li> <li>• Shërbimet në qeverisjen lokale (arsim, shëndetësi, rrugë, transport, polici)</li> <li>• Taksat për qeverisjen qendrore dhe lokale</li> <li>• Këshilli i qytetit dhe planet për qeverisjen e qytetit</li> <li>• Marrja e vendimeve</li> <li>• Ndikimet e grupeve të ndryshme në politikat lokale</li> <li>• Sfidat e rritjes së qyteteve</li> <li>• Problemet e qyteteve</li> <li>• Përmirësimi i jetës së qyteteve</li> <li>• Ndihmat shtetërore në rast emergjencash</li> <li>• Jeta në komunitet</li> <li>• Grupet vullnetare</li> <li>• Shqyrtim rastesh: Si punojnë të gjithë në qeverisjen e qytetit?</li> </ul>
	<b>Idealet dhe praktikat qytetare (6)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerat e shoqërisë bashkëkohore</li> <li>• Liria</li> <li>• Barazia</li> <li>• Drejtësia</li> <li>• Zgjidhja e konflikteve</li> <li>• Solidariteti</li> </ul>
	<b>Ligji (12 + 4 =16)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji dhe shoqëria</li> <li>• Llojet e ligjeve</li> <li>• Kriminaliteti dhe kushtet sociale dhe ekonomike të zhvillimit të tij</li> <li>• Krimi dhe format e tij</li> <li>• Krimi i organizuar (ekonomik dhe politik)</li> <li>• Trafikimi i qenieve njerëzore</li> <li>• Roli i komunitetit në parandalimin e krimit</li> <li>• E drejta civile</li> <li>• Marrëdhëniet civile dhe elementet e saj</li> <li>• E drejta e pronës</li> <li>• Bashkëpronësia dhe trashëgimia</li> <li>• Martesa – të drejta dhe përgjegjësitë</li> </ul>
	<b>Edukimi medial (6+4= 10)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Roli i mediave në edukimin qytetar</li> <li>• Llojet e mediave (publike, private, të shkruara, elektronike)</li> <li>• E drejta e publikut për informim</li> <li>• Liria e shtypit</li> <li>• Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve nga roli abuzues i mediave (dhuna, pornografia etj.)</li> <li>• Aftësi sociale: Të dallojmë faktin nga opinionin</li> </ul>

## REZULTATET E PRITURA

Kategoritë	Nënkategoritë	Rezultatet e pritura
<b>Qeverisja dhe qytetaria</b>	<b>Qeverisja</b>	<p>Nxënësi:                      Shpjegon dhe analizon tipat e demokracisë, dallimet rreth pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv në të gjitha nivelet e organizimit shoqëror.                      Shpjegon dhe paraqet ndryshimet që ndodhin gjatë qeverisjes në shoqërinë ku jeton dhe vepron.                      Analizon dhe krahason ndryshimet ndërmjet parlamentit, presidencës dhe qeverisë.                      Përshkruan dhe analizon rolin që kluajnë institucione të ndryshme të demokracisë në jetën e vendit.                      Përshkruan rolin e partive politike për zhvillimin e pluralizmit në demokraci, dhe analizon rolin e procesit të votimit në marrjen e vendimeve politike</p>
	<b>Pushteti dhe autoriteti</b>	<p>Nxënësi:                      Shpjegon domosdoshmërinë e funksionimit të pushtetit në mirëqenien njerëzore;                      Shpjegon se si arrihet autoriteti, të dallojë prestigjin nga fuqia shoqërore si arritje e autoritetit individual dhe shoqëror.                      Respekton dhe vlerëson autoritetin e pushtetit, duke filluar që nga qeverisja lokale e deri tek ajo qendrore.                      Përshkruan dhe jep shembuj nga jeta e komunitetit ku jeton për zgjidhjen e problemeve të ndryshme</p>
	<b>Idealet dhe praktikat qytetare</b>	<p>Nxënësi:                      Reflekton se e drejta sovrane e qytetarit duhet të jetë kudo e pacenueshme.                      Kupton dhe demonstroi se liria, barazia dhe drejtësia janë dhe duhet të bëhen vlerat më të larta njerëzore.                      Analizon, përshkruan dhe merr pjesë në zgjidhjen e konflikteve pa dhunë.                      Demonstroi akte solidariteti përkundrejt atyre që janë në nevojë dhe vështirësi.</p>
	<b>Ligji</b>	<p>Nxënësi:                      Të formojë vështrim konstruktiv ndaj formës dhe procedurës në nxjerrjen e ligjeve, si shkilen</p>

		ato dhe si sanksionohen në forma të ndryshme; Të shpjegojë se ligjet kanë karakter rregullues të marrëdhënieve midis njerëzve; Të përshkruajë në mënyrë kritike se vendosja e ligjeve në praktikën shoqërore ndihmon njohjen më të thellë të proceseve humane, në parandalimin e krimit dhe të kriminalitetit, në luftimin e shkaqeve dhe mosmarrjen me pasoja, siç janë problemet e pronës, trashëgimia, e drejta familjare dhe përgjegjësi të tjera të kësaj natyre.
	<b>Edukimi medial</b>	Nxënësi: Të përshkruajë dhe të analizojë në mënyrë kritike dhe konstruktive llojet e mediave publike dhe private, të shkruara dhe elektronike; Të jetë në gjendje të njohë rëndësinë dhe të dallojë ndikimet negative që vijnë si rezultat i mediave; Të debatojë nëpërmjet debateve dhe diskutimeve kritike se si krijohet opinioni publik në bashkësi dhe më gjerë.

## QASJA LËNDORE DHE NDËRLËNDORE

Edukata qytetare, si pjesë e grupit të lëndëve shoqërore, përveç se është në veten e saj multidisiplinare, ajo gërshetohet edhe me programet dhe përmbajtjet e lëndëve të tjera shoqërore, si historia, filozofia, sociologjia, gjeografia, gjuha dhe letërsia etj.

Në klasën e dhjetë arsimtari gjatë trajtimit të kategorisë *Qeverisja dhe qytetaria* do të hasë në aspekte historike të kësaj përmbajtjeje, duke filluar nga termi demokraci, që ka një zhvillim historik dhe një etimologji të largët që nga Greqia antike.

Po kështu te lëndët zgjedhore, sidomos nënkategoritë e Qeverisjes dhe të qytetarisë, mund të gërshetohen me përmbajtje ndërlëndore dhe të plotësohen edhe më konkretisht: qeverisja me etikën dhe standardet etike të politikës; pushteti dhe autoriteti me vështrime historike të llojeve të pushtetit dhe qeverisjes nëpër periudha historike; idealet dhe politikat qytetare, si liria, barazia, mirëqenia, mund të gërshetohen me përmbajtje letrare dhe artistike, si romane dhe diskutime që trajtojnë probleme të lirisë dhe të idealeve shoqërore që gjerësisht janë trajtuar në letërsinë kombëtare, por edhe botërore. Ligji dhe edukimi medial sigurisht se do të gërshetohen me përmbajtje ndërprogramore edhe me artet e interpretimit

(zgjedhore), ku do të mund të simulohen situata dhe ambiente në lidhje me rolin dhe funksionin e ligjit në shoqëri.

Përveç kësaj edukata qytetare do të jetë një rast i mirë për bashkëpunim të shkollës dhe arsimitarit me shoqërinë civile, ku angazhimet e ndryshme të saj mund të funksionalizohen në dobi të procesit mësimor. Këtu sugjerohet bashkëpunimi me organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të fëmijëve etj. për temat si pjesëmarrja e qytetarit në vendimmarrje, votimet, zgjidhja e konflikteve, solidariteti etj.

**Në relacion me historinë**, edukata qytetare do të gërshetohet pothuaj me të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë, duke shfrytëzuar njohjen e materialit historik, për t'u përqendruar më lehtë në të sotmen dhe çështjet qytetare të shoqërisë bashkëkohore kosovare. Bie fjala, të drejtat e njeriut dikur dhe sot; liria e fjalës dhe delikti verbal dikur dhe sot, gjithnjë duke nënvizuar progresin e arritur dhe përgjegjësinë qytetare karshi vlerave dhe idealeve qytetare.

**Gjeografi:** Aspektet si hapësira, planifikimi dhe menaxhimi i saj dhe pjesëmarrja qytetare në ato procese domethënëse, janë pikat prekëse dhe ndërlyndore shumë të dobishme edhe për edukatën qytetare.

**Artet figurative:** Përgatitja e materialeve ilustruese si posterët dhe efektet e tjera vizuale për një vetëdijësim qytetar demokratik në funksion të participimit aktiv dhe qeverisjes sa më të mirë. Kjo mund të përdoret po kështu në lidhje me zgjedhjet, votimet, rregullimin e ambientit, si p.sh. iniciativa “Kosova - shtëpia ime” etj. Edukimi artistik nëpërmjet të këngëve, valleve popullore dhe atyre të huaja, po ashtu rrit peshën e ndërveprimit të edukatës qytetare me muzikën, folklorin për tema globale si komuniteti lokal, rajonal, botëror, marrjen pjesë në vendime që përmirësojnë jetën e shoqërisë, etj.

**Gjuhë amtare:** Esetë dhe shkrime me temat e qytetarisë si, bie fjala, “Kush jam unë dhe në çfarë shoqërie jetoj”, mandej probleme dhe analiza në lidhje me edukimin medial, duke përdorur gazeta dhe shkrime për përditshmërinë. Gjuha amtare dhe e huaj shërbejnë mjaft për të dhënë tablonë e plotë të qytetarisë globale.

**Informatika dhe kompjutori:** ublikimi i gazetës së shkollës, lidhja nëpërmjet internetit dhe burime të shumëllojshme të informacionit për çështje të ndryshme të edukatës qytetare krijojnë një lidhje të vazhdueshme të nxënësit me të dyja lëndët njëkohsisht, duke ndihmuar reciprocisht në formimin e aftësive dhe kompetencave të ndërthurura lëndore.

**Matematikë:** Përdorimi i statistikave lidhur me tema aktuale të edukatës qytetare, interpretimi i të dhënave dhe dhënia e alternativave që lidhen me zgjidhjen e problemeve sociale, krijojnë mundësi për qasje ndërlyndore, etj.

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Me qëllim të realizimit të programit mësimor nga kjo lëndë mësimore duhet të organizohen takimet me njerëz, duhet të shfrytëzohen burimet e ndryshme dhe duhet të simulohen rastet për zgjidhje:

- Takimet me njerëz (vëzhgime, intervista, anketime, bashkëbisedime, konsulta me ekspertë etj.);
- Botimet (gazeta, buletine informacioni, tekste, videokaseta, dramatizime, posterë etj.);
- Simulimet (lojërat me role, stimulimi i debateve ose i situatave nga fusha të ndryshme të veprimtarive publike etj.);

Përveç metodave tradicionale, në lëndën e edukatës qytetare në shumë raste mund të zbatohet **loja me role**. Për aplikimin e kësaj forme të punës është e domosdoshme që të bëhet **simulimi** i një ngjarjeje. Nxënësit marrin role, p.sh. të prokurorit, gjykatësit, avokatit, të akuzuarit. Arsimtari në këtë rast luan rolin e koordinatorit, ndërsa të gjithë nxënësit e klasës marrin pjesë aktive në këtë proces. Ata mund të ndahen prapë në grupe, p.sh. grupi i deputetëve të pozitës dhe të opozitës, KRYETARIT TË PARLAMENTIT etj. Ata gjatë tërë një ore të mësimit mund të debatojnë rreth asaj si si është zgjidhur çështja problemit për të cilin „vendosin“.

Theks i veçantë në metodologjinë e punës do t'i kushtohet metodave aktive të punës, si:

- Puna projektuese mësimore,
- Mësimi problemor,
- Mësimi me bashkëpunim,
- Biseda, mësimi hulumtues,
- Puna në terren (organizatat e ndryshme vendimmarrëse).

Si forma të punës mësimdhënësve iu sugjerohet që të organizojnë punën në klasë në çifte dhe grupe. Ndarja e nxënësve në çifte dhe grupe nxënësve u jep mundësi për pjesëmarrje dhe bashkëpunim. Me këtë rast nxënësve çifteve dhe grupeve u jepen 5 minuta kohë për të vendosur p.sh. „Është e drejtë që dikush të vritet“. Kjo mund të arrihet përpara se të nisë diskutimi i gjithë klasës. Nxënësve duhet t'u tregohet koha për të cilën do të zgjidhet problemi. Ata ndahen në grupe apo çifte, ndërsa arsimtari luan rolin e mbikëqyrësit dhe sipas nevojës edhe jep udhëzime apo sqarime. Nga mbarimi i orës çifftet apo grupet raportojnë para të gjithë nxënësve të klasës. Secili grup duhet ta këtë kryesuesin i cili raporton para klasës.

## VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e edukatës qytetare duhet të jetë i përhershëm. Ky vlerësim ka qëllime të shumëfishta:

- përmes vlerësimit sigurohen informacione për përparimin e nxënësit,
- nxënësit aftësohen të krahasojnë arritjet e tyre me standardet e pritshme, duke bërë edhe vetëvlerësimin e asaj që kanë arritur ta zotërojnë,
- Vlerësimi ka për qëllim edhe motivimin e nxënësit për punë të mëtutjeshme,
- vlerësimi siguron edhe realizimin e objektivave.

### Tipat e vlerësimit

Në të gjitha lëndët mësimore ekziston një mori i tipave të vlerësimit. Në lëndën e edukatës qytetare duhet të aplikohen tipa të shumtë të vlerësimit. Secili prej këtyre tipave ka qëllimin e caktuar të vlerësimit. Propozojmë këta tipa të vlerësimit:

- **Vlerësimi i bazuar në normë** – Secili vlerësim duhet të bazohet në normë, p.sh. deri në 20 për qind të arritjes së një objektivi të caktuar nuk është i mjaftueshëm për notë pozitive. Prej 20 deri në 40 për qind do të vlerësohej nxënësi me notë të mjaftueshme. Prej 40 deri në 60 për qind nota do të ishte e mirë, prej 60 deri në 80 për qind notë e shumë mirë dhe mbi 80 për qind do të ishte notë e shkëlqyeshme. Ky vlerësim do të bëhej përmes testeve adekuate.
- **Vlerësimi bazuar në kritere** - siguron informacione për të identifikuar vështirësitë e nxënësve dhe ndihmon për kapërcimin e tyre. Ky vlerësim bëhet përmes testeve.
- **Vlerësimi përfundimtar** – bëhet zakonisht në fund të një periudhe të caktuar, në fund të gjysmësvjetorit dhe sidomos në mbarim të vitit mësimor.

Vlerësimi duhet të jetë i përhershëm duke filluar që nga orët e mësimi (vlerësimi pesëminutësh) e deri të vlerësimi përmes testeve zyrtare. Në klasë gjatë orës së mësimi mund të bëhen këto vlerësime:

- vlerësimi i zakonshëm gjatë pjesëve të ndryshme të orës,
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë,
- vlerësimi i testeve të hartuara nga vetë mësuesi.

## Standardet e arritjes

Nxënësi:

- përmendë dhe përshkruan disa nga funksionet kryesore të qeverisjes dhe rrugët e fitimit, ushtrimit dhe të justifikimit të pushtetit;
- identifikon dhe përshkruan mekanizimin me anë të të cilit qytetarët duhet të përdorin për plotësimin e disa prej nevojave dhe dëshirave të tyre;
- përmendë, përshkruan dhe të analizon mënyrat se si kombet dhe organizatat e ndryshme u përgjigjen konflikteve ndërmjet forcës së unitetit dhe të diversitetit;
- përshkruan, analizon dhe vlerëson kushtet, veprimet dhe motivimet që ndihmojnë në konfliktet dhe bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet kombeve;
- shpjegon dhe zbaton mënyra të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore;
- përmend, përshkruan dhe analizon llojet e qeverisjes: pushtetin legjislativ, pushtetin ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor;
- përshkruan rolin e presidencës, këshillave të ministrave;
- përshkruan mënyrën se si punon shteti dhe organet ekzekutive të tij;
- dallon qeverisjen qendrore prej asaj lokale dhe kupton shërbimet e qeverisjes së tyre;
- identifikon, përshkruan dhe analizon vlerat e shoqërisë bashkëkohore, lirinë, barazinë dhe drejtësinë;
- analizon ligjet e shtetit dhe bën dallimin e krimit të organizuar dhe të trafikimit të qenieve njerëzore;
- përshkruan dhe analizon raportin në mes të së drejtës civile dhe të së drejtës së pronës;
- përshkruan dhe analizon rolin e mediave (të shkruara dhe elektronike), lirinë e shtypit dhe mbrojtjen e fëmijëve nga roli abuzues i tyre.

## BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. **Erlehta Mato, Abdyl Ramaj, Nikoleta Mito, Kozma Grillo**, *Edukatë qytetare VI*, Prishtinë 2000
2. **Grup autoresh**, *Edukatë qytetare VII*, Prishtinë 2000



3. **Grup autoresh**, *Edukatë qytetare VIII*, Prishtinë 2000
4. **Dr. Fatmira Mybeteri & Astrit Dautaj & Majlinda Keta**, *Qytetaria I*, Tiranë 2000
5. **Instituti i Studimeve Pedagogjike**, *Standardet për nxënësit dhe mësuesit në lëndën e edukimit qytetar (DRAFT)*, Tiranë 1997
6. **Elehta Mato & Robert Gjedia & Marjana Sinani & Astrit Dautaj**, *Standardet e arritjes së lëndës së edukimit qytetar*, Tiranë 2003
7. **Bardhyl Musai**, *Metodologjia e mësimdhënies*, Tiranë 2003
8. **Bardhyl Musai**, *Psikologjia e edukimit*, Tiranë 2000
9. **Instituti i Studimeve Pedagogjike**, *Platforma e hartimit të standardeve të arritjeve për lëndët*, Tiranë 2002
10. **Grup autorësh**, *Strategji për të mësuarit e qytetarisë demokratike*, Tiranë 2000
11. **KËSHILLI PËR BASHKËPUNIM KULTUROR**, *Koncepte dhe kompetenca themelore për edukimin për qytetarinë demokratike*, (Përkthim), Tiranë 2000
12. Librat e mësuesit për edukimin qytetar, klasa 1 – 10
13. Standardet e edukimit qytetar 1- 10
14. [www.dadalos.org](http://www.dadalos.org)

---

## HISTORI

---

### Gjimnazi i përgjithshëm Gjimnazi i shkencave shoqërore

#### HYRJE

Historia si shkencë e rëndësishme shoqërore në klasën X për Gjimnazin e përgjithshëm dhe Gjimnazin e shkencave shoqërore, ka për objekt të studimit të kaluarën e shoqërisë njerëzore nga lashtësia deri te zbulimet e mëdha gjeografike (shekulli XV). Ajo studion të kaluarën në të gjitha dimensionet e saj: shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, fetare etj.

#### QËLLIMET

- Përmes lëndës së historisë nxënësit të kuptojnë dhe të analizojnë gjithanshëm proceset e zhvillimit të shoqërisë njerëzore nga bashkësitë e para njerëzore deri te zbulimet e mëdha gjeografike.
- Të njihen me: mënyrat e jetës dhe të të menduarit, personalitetet e njohura, ngjarjet e rëndësishme historike, vendet dhe institucionet shoqërore dhe shtetërore, besimet etj.
- Të thellojnë njohuritë mbi rëndësinë e burimeve dhe literaturës historike, të dinë t'i shfrytëzojnë ato për zgjerimin e njohurive në përgjithësi dhe prej historisë në veçanti.

#### OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Të krijojnë koncepte të qarta për zhvillimin e proceseve shoqërore nga Parahistoria deri te Zbulimet e Mëdha Gjeografike;
- Të thellojnë njohuritë për mënyrën e organizimit të jetës në periudhat e hershme, të dallojnë ndryshimet dhe të dinë të bëjnë krahasime me mënyrën e organizimit të jetës së sotme;
- Të kuptojnë konceptet themelore të shtetit dhe zhvillimin e tij nëpër periudha të ndryshme historike.

## **OBJEKTIVAT SPECIFIKE**

- Të konceptojnë qartë termat e periudhës parahistorike, antikitetit, Mesjetës së Hershme dhe Mesjetës së Vonë;
- Të krahasojnë ndryshimet në periudhën parahistorike, antike, të Mesjetës së Hershme dhe të Mesjetës së Vonë;
- Të krahasojnë dhe të argumentojnë me shembuj mënyrën e jetesës nga Parahistoria deri në Mesjetën e Vonë;
- Të konceptojnë qartë formimin dhe zhvillimin e shtetit në antikë dhe mesjetë duke krahasuar specifikat themelore të formacionit shtetëror;
- Të dallojnë ndikimin e zbulimeve teknike dhe pasqyrimin e të arriturave shkencore në jetën e njerëzve.

## **SHKATHTËSITË E SYNUARA**

Përmes mësimit të historisë si shkencë shoqërore në klasën e X synohet që nxënësit t'i fitojnë këto shkathtësi :

- të aftësohen për orientim në kohë dhe hapsirë që nga mjedisi ku jetojnë, regjioni e më gjerë;
- Përdorimi i njohurive të fituara mbi ngjarjet shoqërore për zgjidhjen e drejtë të konflikteve në situata të ndryshme;
- të aftësohen për komunikimin në frymën e tolerancës me të tjerët;
- të zhvillojnë shkathtësitë për të kuptuar drejt situatat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e fetare në shoqëri;
- të aftësohen për të kuptuar gërshetimin e kulturave të popujve të ndryshëm dhe ndikimin reciprok të tyre në periudha të caktuara historike;
- të fitojnë shkathtësi për një pjesëmarrje demokratike dhe qytetare në jetën politike të vendit dhe më gjerë.

### **Në fund të klasës së X nxënësit duhet :**

- të njohin shkaqet dhe arsyet e lindjes, organizimit dhe zhvillimit të shoqërisë dhe shtetit;
- të interpretojnë drejt mënyrën e llogaritjes së kohës për ngjarje, dukuri, procese e figura historike;
- të aftësohen si dhe të diskutojnë për pikpamjet e ndryshme të shfaqura, bazuar në argumente shkencore, lidhur me zhvillimet e proceseve në lashtësi dhe antikë;

- të thellojnë njohuritë dhe në mënyrë kritike të vlerësojnë ndikimin e miteve dhe legjendave, për ngjarjet e caktuara në antikë;
- të konceptojnë qartë ndikimin e raporteve shoqërore dhe ekonomike në kalimin nga rendi skllavopronar në atë feudal;
- të kuptojnë drejt reflektimin e pasojave të dyndjes së popujve;
- të shpjegojnë dhe konstatojnë lindjen dhe zhvillimin e qyteteve të reja si dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë;
- të thellojnë njohuritë dhe në mënyrë kritike të vlerësojnë rolin e fesë në mesjetë si dhe ndikimin e Humanizmit dhe Rilindjes.

<b>Nënkategoritë - Temat</b>	<b>Objektivat</b>	<b>Përmbajtjet programore (njësitë mësimore)</b>	<b>Rezultatet e pritura</b>	<b>Ndërlidhja</b>
<b>I Hyrje në lëndën e Historisë</b>	Thellimi i njohurive për objektin e historisë si shkencë dhe si lëndë mësimore	- Historia si shkencë dhe lëndë mësimore	Dinë të dallojnë historinë si shkencë dhe si lëndë mësimore. Dinë për burimet historike dhe për njehsimin e kohës të popujt e ndryshëm si dhe për periodizimin e historisë.	Arkeologjinë, artet, gjeografinë etj.
<b>II Parahistoria</b>	Të kuptojnë proceset e zhvillimit të bashkësive të para njerëzore dhe rolin e rëndësishëm që pati për përparimin shoqëror, zbulimi dhe përdorimi i metaleve.	- Jeta e njerëzve të parë Koha e Gurit - Koha e metaleve	Dallojnë specifikat kryesore të zhvillimit të shoqërisë njerëzore në kohë të gurit dhe metaleve.	Artin, gjeografinë, biologjinë, edukatën qytetare etj.
<b>III Lindja e Lashtë</b>	Do të kuptojnë kushtet dhe zhvillimin e shteteve të para, organizimin e tyre shoqëror dhe tiparet dalluese të këtyre shteteve; Të mësojnë për shkallën e zhvillimit të kulturës dhe besimin te popujt e Lindjes së Lashtë dhe faktorët që ndikuan në zhvillimin e saj.	- Egjipti i Vjetër - Mbretëria e Babilonisë dhe Asirisë - Mbretëritë e tjera të mëdha në vendet e Lindjes së Lashtë - Kultura dhe besimi te popujt e Lindjes së Lashtë	Nxënësit janë në gjendje të shpjegojnë shkaqet që ndikuan në lindjen e shteteve; Karakteristikat kryesore të shteteve të para, klasat, kastat dhe shtresat sunduese dhe të varfërit; Njohin disa nga figurat më të rëndësishme që ndikuan në zhvillimin e shoqërisë njerëzore si p.sh Hamurabi në Babiloni apo Tutmesi i III në Egjipt; Dinë për zhvillimin e kulturës dhe specifikat dalluese të saj në vetë	Gjeografinë, artin, edukatën qytetare, letërsinë etj.

			këto shtete si dhe lindjen e besimit te këta popuj.	
<b>IV Ilirët</b>	Do të dallojnë popujt më të lashtë të Ballkanit; Janë në gjendje të përshkruajnë shtrirjen dhe vendbanimet e fiseve ilire, zhvillimin shoqëror - ekonomik (jeta e përditshme); Mbretërit ilire, organizimin shtetëror të këtyre mbretërive; Luftërat e ilirve kundër pushtuesve, rezistencën e ilirëve kundër pushtimit romak; Të njohin zhvillimin e kulturës dhe besimit ilir.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Banorë më të lashtë të Ballkanit</li> <li>- Vendbanimet dhe fiset ilire</li> <li>- Bujqësia, blegtoaria, detaria dhe lindja e zejtarisë</li> <li>- Mbretërit e Enkelejve dhe Taulantëve</li> <li>- Mbretëria e Epirit - Mbretëria e Dardanisë</li> <li>- Mbretëria Ardiane dhe luftërat iliro - romake</li> <li>- Iliria nën sundimin romak</li> <li>- Kryengrita e madhe ilire e viteve 6 - 9 p.l.k.</li> <li>- Kultura dhe besimi ilir</li> </ul>	Dallojnë popujt më të lashtë të Ballkanit; Dinë për fiset kryesore ilire, vendbanimet dhe për zhvillimin shoqëror e ekonomik të tyre; Dallojnë mbretëritë ilire dhe organizimin shtetëror e politik të tyre, dinë për luftërat e ilirve për organizimin ushtarak të tyre. Kuptojnë e vlerësojnë realisht rezistencën e ilirëve kundër sundimit romak dhe masat e ndërmarra romake në Iliri; Kuptojnë e vlerësojnë në mënyrë kritike për disa nga ngjarjet dhe figurat më të rëndësishme, të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e shoqërisë ilire si p. sh. për Longarin, Pirron, Agronin, Teutën, Gencin etj.; Kuptojnë të arriturat në kulturë, karakteristikat kryesore të kësaj kulture, raportet me kulturën greke si dhe për besimin ilir, për perënditë ilire.	Arkeologjinë, etnografinë, gjuhën, gjeografinë, edukatën muzikore, artin, letërsinë etj.
<b>V Greqia e Vjetër</b>	Njohja me zhvillimin e hershëm grek dhe lëvizjet e hershme të	- Greqia në mijëvjeçarin e II dhe I p.l.K. dhe në periudhën homerike	Nxënësit dallojnë specifikat kryesore të kulturës së Kretës dhe Mikenës;	Arkeologjinë, gjeografinë, artin, edukatën qytetare,

	<p>popullsisë greke në Mesdhe e Iliri; Njohja me formimin e qytet-shteteve të para greke; organizimin e tyre të brendshëm, konfliktet mbrojtëse nga sulmet persiane dhe përsosjen e demokracisë në Athinë; Të njohin zhvillimin e kulturës në Greqinë e Vjetër dhe faktorët që ndikuan në atë zhvillim; Të mësojnë për besimin e grekve të vjetër dhe rolin që luajtën grekët në kulturë e besimin te ilirët, romakët etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Formimi i shtetit të Athinës dhe Spartës</li> <li>- Luftërat greko – persiane dhe luftërat e Peleponezit</li> <li>- Demokracia në Athinë</li> <li>- Kultura dhe besimi</li> </ul>	<p>Njohin zhvillimin ekonomik e shoqror të qytet - shteteve greke dhe bëjnë dallimin e organizimit demokratik shtetror në Athinë nga ai oligarkik në Spartë; Kuptojnë arsyet e luftërave mbrojtëse të qytet - shteteve greke nga persianët dhe luftërat e Peleponezit, për dominim të Spartës në qytetet tjera greke; Kuptojnë proceset e zhvillimit të demokracisë në Athinë dhe faktorët që ndikuan në zhvillimin e kësaj demokracie; Dinë për disa nga personalitetet më të rëndësishme të shoqërisë greke si p.sh. Perikleu, Demosteni, Aristoteli etj. Dinë për faktorët që ndikuan në zhvillimin e kulturës greke e po ashtu të dinë për ndikimin e kulturës greke në Iliri, Romë etj.</p>	<p>letërsinë, edukatën fizike etj.</p>
<p><b>VI Maqedonia e Lashtë</b></p>	<p>Do të shquajnë mendimet për prejardhjen e maqedonëve të lashtë, krijimin e shtetit maqedon, zgjerimin dhe pushtimet.</p>	<p>- Maqedonia në kohën e Filipit të II dhe Lekës së Madh</p>	<p>Nxënësit janë në gjendje të prezentojnë teoritë për prejardhjen e maqedonëve të lashtë, shtrirjen e shtetit maqedon në kohën e Filipit të II. Zgjerimin dhe pushtimet gjatë sundimit të Lekës së Madh dhe rrjedhojat e këtyre zgjerimeve;</p>	<p>Gjeografinë, artin, arkeologjinë letërsinë etj.</p>

			Dinë për shkaqet dhe faktorët që ndikuan në lindjen e kulturës helene si dhe për specifikat e kësaj kulture.	
<b>VII Roma e Lashtë</b>	Njohja me fillet e lindjes së shtetit romak, zgjerimin e tij. Organizimin shoqëror, shtetëror, ushtarak etj. Të dinë për shëndërrimin në perandori, për konfliktet e brendëshme dhe shkaqet e shkatrrimit të Perandorisë Romake. Besimi romak, arsyet e lindjes së krishterizmit dhe përhapjen e tij. Njohja me të arriturat e kulturës romake.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Periudha më e hershme e historisë së Romës</li> <li>- Zgjerimi i Romës në Gadishullin Apenin dhe Pellgun e Mesdheut</li> <li>- Kryengritjet e skllëvërve dhe reformat</li> <li>- Roma në kohën e Cezarit dhe Oktavian Augustit</li> <li>- Zhvillimi i Perandorisë Romake gjatë shek. I dhe II</li> <li>- Lindja dhe përhapja e krishterizmit</li> <li>- Dobësimi dhe rënia e Perandorisë Romake</li> <li>- Kultura dhe besimi romak</li> </ul>	Dinë për shoqërinë e hershme romake, për themelimin e Romës; Dinë për zgjerimin e Romës në Gadishullin Apenin, Mesdhe, Ballkan e Lindje si dhe për rrjedhojat e atyre pushtimeve; Dallojnë format e pushtetit republikan, mbretëror dhe atë perandorak; Kuptojnë pozitën shoqërore - ekonomike të shtresave të popullsisë, rezistencat e shtresave të ulëta, lufërat për lirinë e tyre nga jeta skllavrore romake, kryengritjet etj; Njohin figurat kryesore romake që ndikuan në rrjedhat historike si Cezari, Oktaviani, Ciceroni etj. Kuptojnë besimin romak, shkaqet e lindjes së krishterizmit, përhapjen e tij dhe rezistencën e sundimtarëve romak; Dinë për kulturën romake dhe ndikimin e saj në rrjedhat e historisë	Arkeologjinë, gjeografinë, artin, muzikën, edukatën qytetare, letërsinë, shkencat juridike, etj.



<p><b>VIII</b> <b>Dyndjet e popujve të ndryshëm në Evropë dhe Ballkan</b></p>	<p>Njohja me shkaqet e dyndjes së popujve në Evropë e Ballkan. Njohja me dy fazat e këtyre dyndjeve e veçanërisht me dyndjen e sllavëve të Jugut në Ballkan, vendosja e tyre dhe pasojat.</p>	<p>- Dyndjet e mëdha në Evropë dhe Ballkan - Sllavët e vjetër dhe dyndjet e tyre</p>	<p>Kuptojnë arsyet e dyndjeve të popujve, fazat e këtyre dyndjeve dhe pasojat e këtyre dyndjeve për Evropën dhe Ballkanin; Njohin dhe dallojnë disa nga popujt barbarë që u dyndën, njohin ndonjë figurë të këtyre popujve si p.sh. Atila etj. Dinë për vendbanimet e para të sllavëve, shkaqet e dyndjes, vendosjen e tyre në Ballkan dhe pasojat që pësuan popullsitë vendase prej këtyre vendosjeve.</p>	<p>Gjeografinë, demografinë, gjuhësinë etj.</p>
<p><b>IX</b> <b>Bizanti dhe Evropa në Feudalizmin e Hershëm</b></p>	<p>Të njihen me shkaqet e lindjes, krijimit dhe zhvillimit të shoqërisë feudale dhe karakteristikat e feudalizmit të hershëm. Të kuptojnë kushtet dhe rrethanat e krijimit të Perandorisë Bizantine, specifikat e feudalizmit bizantin. Të dinë për specifikat e feudalizmit në Evropë dhe për krijimin e shtetit të Frankëve.</p>	<p>- Bizanti gjatë shekujve V - XI - Shteti i Frankëve</p>	<p>Kuptojnë dhe janë në gjendje t'i përshkruajnë karakteristikat themelore të feudalizmit të hershëm. Mund t'i dallojnë specifikat e zhvillimit të shoqërisë feudale në Bizant dhe Evropë; Jenë në gjendje që në mënyrë kritike t'i gjykojnë shkaqet e nxitjes së zhvillimit ekonomik në Feudalizmin e Hershëm; Vlerësojnë realisht rolin e figurave të mëdha historike në progresin e gjithanshëm të zhvillimit të shoqërisë njerëzore siç ishte p.sh. Justiniani, Karli i Madh etj.</p>	<p>Arkeologjinë, gjeografinë, artin, letërsinë, shkencat juridike etj.</p>

<p align="center"><b>X</b> <b>Rendi feudal në Azi</b></p>	<p>Të njihen me zhvillimin e marrëdhënieve feudale të arabët si dhe me specifikat dalluese të tij nga ai bizantin e evropian. Të njohin shtetin e Kalifatit dhe zgjerimin e tij. Të njihen në mënyrë të gjithanëshme me shkaqet e lindjes së besimit islam. Të njihen me kulturën arabe dhe me ndikimin e saj në kulturat tjera të vendeve të regjionit e me tutje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Arabët</li> <li>- Kalifati arab</li> <li>- Kultura arabe</li> </ul>	<p>Kuptojnë dhe dinë të përshkruajnë shkaqet e lindjes së islamizmit, parimet themelore të tij dhe përhapjen; Kuptojnë arsyet e përhapjes së shpejtë të besimit islam në Gadishullin Arabik. Dinë për shtetin e kalifatit, zgjerimin dhe rënien e tij; Dinë dhe kuptojnë zhvillimin e kulturës arabe, specifikat e saj dhe ndikimin që ajo pati në Lindje dhe Evropë.</p>	<p>Gjeografinë, artin, matematikën, letërsinë etj.</p>
<p align="center"><b>XI</b> <b>Shoqëria feudale në Evropë</b></p>	<p>Njohja me zhvillimin e ekonomisë tregtare dhe zhvillimin e qyteteve në Mesjetë. Njohja me zhvillimin e kulturës në Evropë dhe me veçoritë e saj. Njohja me aspektet esenciale të organizimit të ekspeditave kryqëtare dhe rrjedhave të tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi ekonomik i Evropës gjatë shekujve XI - XII</li> <li>- Jeta qytetare dhe zhvillimi kulturor</li> <li>- Kryqëzatat</li> </ul>	<p>Dinë për karakteristikat themelore të zhvillimit ekonomik. Kuptojnë dhe vlerësojnë shkaqet ekonomike të lindjes dhe organizimit të jetës politike në qytete. Dallojnë tiparet e Feudalizmit të hershëm nga ai i zhvilluar. Kuptojnë e vlerësojnë këtë zhvillim ekonomik si proces të përparimit të përgjithshëm shoqëror e</p>	<p>Gjeografinë, artin, letërsinë, ekonominë, drejtësinë etj.</p>

			kulturor; Dinë për shkaqet e organizimit të kryqëzatave, ekspeditat e tyre në Lindje dhe pasojat që pësuan popujt e Lindjes nga luftat kryqtare.	
<b>XII Evropa në Mesjetën e Vonë</b>	Do të kuptojnë organizimin e pushtetit dhe tiparet dalluese të kësaj forme të organizimit shtetror. Të njihen me zhvillimin ekonomik e shoqëror të këtyre shteteve gjatë këtyre shekujve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Monarkia Franceze në shekujt XIV - XV</li> <li>- Monarkia Angleze në shekujt XIV - XV</li> <li>- Italia në shekujt XII - XV</li> </ul>	Kuptojnë tiparet dalluese të organizimit shtetror monarkist; Dinë për zhvillimin ekonomik të këtyre shteteve gjatë shekujve XIV – XV; Dinë të vlerësojnë shkaqet e zhvillimit të pabarabart të këtyre shteteve gjatë këtyre shekujve	Gjeografinë, letërsinë, gjuhën, artin etj.
<b>XIII Perandoritë e Mëdha të Lindjes</b>	Do të njohin zhvillimin ekonomik - shoqëror të këtyre shteteve dhe organizimin shtetëror të tyre. Të njihen me zhvillimin e Perandorisë Osmane dhe gjendjen në Ballkan para pushtimeve osmane. Të njohin luftërat mbrojtëse të popujve ballkanas.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shteti Mongol dhe Kinez</li> <li>- Perandoria Osmane</li> <li>- Popujt e Ballkanit në vigjiliet të depërtimeve osmane</li> <li>- Beteja e Maricës dhe Beteja e Kosovës</li> </ul>	Dinë për zhvillimin e marrëdhënjeve feudale në këto vende dhe organizimin shtetëror të tyre; Dinë për formimin e Perandorisë Osmane, dhe invazionin osman në Ballkanë; Dinë për rezistencën dhe përpjekjen e popujve të Ballkanit për mbrojtje të vendit kundruall pushtimit osman	Gjeografinë, artin, letërsinë etj.
<b>XIV Lindja e marrëdhënjeve feudale në Arbëri</b>	Do të shquajnë rrethanat ekonomiko - shoqërore në Bizant	- Arbëria nën Perandorinë Bizantine deri në shek. XI	Kuptojnë gjendjen e Arbërisë nën sundimin e Bizantit; Kuptojnë zhvillimin e	Gjeografinë, letërsinë, artin etj.

	dhe gjendjen e shqiptarëve (arbërve) nën sundimin bizantin.		marrëdhëniet feudale të Arbërisë nën sundimin bizantin; Dinë të interpretojnë përpjekjet e popullsisë së Arbërisë për rezistencë kundër sundimit bizantin.	
<b>XV Arbëria në shekujt XI - XV</b>	Do të vlerësojnë rrethanat dhe fazat e zhvillimit të shtetit të Arbërisë. Njohja me formimin e principatave të Arbërisë. Njohja me specifikat e zhvillimit të marrëdhënies feudale në Arbëri, kultura në Arbëri dhe zhvillimi i saj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shteti i Arbërisë</li> <li>- Principatat arbërore në shekujt XIII - XV</li> <li>- Kultura në Arbëri në shek. XIII - XV</li> </ul>	Radhisin drejt fazat e zhvillimit të shtetit të Arbërisë; Njohin sunduesit e shtetit të Arbërisë; Dinë të përshkruajnë dallimet mes principatave arbërore dhe të dallojnë zhvillimet e tyre; Dinë për kulturën në Arbëri dhe dallojnë karakteristikat kryesore të zhvillimit të kësaj kulture.	Arkeologjinë, etnografinë, gjeografinë, artin, letërsinë etj.
<b>XVI Invazioni osman dhe luftërat e mëdha shqiptaro - osmane të udhëhequra nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu</b>	Të njohin arsyet dhe rrethanat e pushtimit të tokave shqiptare. Të njohin qëndresën e popullit shqiptar, Beslidhja shqiptare nën drejtimin e Skënderbeut.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Arbërit përball invazionit osman</li> <li>- Fillimet e luftërave dhe fitoret e para të Skënderbeut 1443 - 1450</li> <li>- Shteti i Skënderbeut dhe fitoret kundër Sulltan Mehmetit të II - Fatihut</li> <li>- Bashkëpunimi i Skënderbeut me shtetet</li> </ul>	Kuptojnë dhe të mund të interpretojnë gjendjen e Arbërisë para invazionit osman, parakushtet e volitshme për pushtimin e Ballkanit nga osmanët; Vlerësojnë realisht rezistencën e fuqishme kundër pushtimit osman; Dallojnë dhe arsyetojnë drejt bashkëpunimit të Skënderbeut me shtetet evropiane si dhe kontributin për	Etnografinë, artin, gjeografinë, letërsinë etj.

		e Evropës - Gjergj Kastrioti Skënderbeu – Hero Kombëtar	mbrojtjen e qytetërimit evropian nga ekspansion osman; Mund të përshkruaj personalitetin e Skënderbeut në mënyrë të gjithanshme dhe rolin që pati ai në këto ngjarje madhore të historisë së popullit tonë	
<b>XVII Humanizmi dhe Rilindja evropiane</b>	Do të shpjegojnë rrethanat e shfaqjes së ideve humaniste. Do të përshkruajnë përfaqësuesit kryesorë të Humanizmit dhe Rilindjes, përhapjen e ideve humaniste në vende të ndryshme.	- Humanizmi dhe Rilindja evropiane	Spjegojnë drejt për kushtet dhe rrethanat e shfaqjeve të ideve humaniste. Njohin humanistët e parë dhe dijnë të përshkruaj veprimtarit kryesore të tyre. kanë informacione të mjaftueshme për shkaqet e lindje së humanizmit në Itali dhe ndikimin e saj në Evropë.	Gjeografinë, artin, letërsinë, ekonominë etj.

**37 × 2 = 74 orë (56 orë zhvillim, 4 orë mësim zgjedhor dhe 14 orë përsëritje)**

**Vërejtje:** 4 orë mësimore i mbesin në dispozicion arsimtarit dhe nxënësve që sipas dëshirës dhe interesimit të tyre të kenë mundësi për të zgjedhur ndojnë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë vendore etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, Instituteve shkencore, monumenteve etj.)

---

## HISTORI

---

### Gjimnazi i gjuhëve

#### HYRJE

Historia, si shkencë e rëndësishme shoqërore në klasën X për Gjimnazin e gjuhëve ka për objekt të studimit, të kaluarën e shoqërisë njerëzore nga lashtësia deri në gjysmën e dytë të shek XIX, gjegjësisht deri te Kriza lindore. Ajo studion të kaluarën në të gjitha dimensionet e saj: shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, fetare etj. Pra, historia si shkencë shoqërore na mëson të kaluarën, për të kuptuar të sotmen dhe për të projektuar të ardhmen.

#### QËLLIMET

- Përmes lëndës së historisë nxënësit të kuptojnë dhe të analizojnë proceset e zhvillimit të shoqërisë njerëzore nga lashtësia e deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX, respektivisht deri te Kriza lindore;
- Të njihen me: mënyrat e jetës dhe të menduarit, personalitetet e njohura, ngjarjet e rëndësishme historike, vendet dhe institucionet shoqërore dhe shtetërore, besimet etj;
- Të thellojnë njohuritë mbi rëndësinë e burimeve dhe literaturës historike, të dinë t'i shfrytëzojnë ato për zgjerimin e njohurive në përgjithësi dhe prej historisë në veçanti.

#### OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Të krijojnë koncepte të qarta për zhvillimin e proceseve shoqërore nga Parahistoria deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX respektivisht deri te Kriza Lindore;

- Të thellojnë njohuritë për mënyrën e organizimit të jetës së njerëzve gjatë periudhave të ndryshme historike, të dallojnë ndryshimet dhe të dinë të bëjnë krahasime me mënyrën dhe format e organizimit të jetës së sotme.

### **OBJEKTIVAT SPECIFIKE**

- Të konceptojnë qartë termat historike të: parahistorisë, antikitetit, mesjetës dhe kohës së re deri në mesin e vitet ‘70 –ta të shekullit XIX;
- Të krahasojnë ndryshimet në periudhën parahistorike, në antikë, në mesjetë dhe kohë të re;
- Të krahasojnë dhe të argumentojnë me shembuj konkret mënyrën e jetesës nga parahistoria deri në kohën e re;
- Të konceptojnë qartë formimin dhe zhvillimin e shtetit në antikë, në mesjetë e në kohë të re, duke krahasuar specifikat themelore të formacioneve shtetërore;
- Të dallojnë ndikimet pozitive të zbulimeve tekniko–teknologjike dhe pasqyrimin e të arriturave shkencore në përparimin e përgjithshëm shoqëror.

### **SHKATHTËSITË E SYNUARA**

Përmes mësimin të historisë si shkencë shoqërore, në klasën e X synohet që nxënësit t’i fitojnë këto shkathtësi:

- të aftësohen për orientim në kohë dhe hapësirë që nga mjedisi ku jetojnë, regjioni e më gjerë;
- Shfrytëzimi i njohurive të fituara mbi ngjarjet shoqërore për zgjidhjen e drejtë të konflikteve në situata të ndryshme;
- të aftësohen për komunikim në frymën e tolerancës me të tjerët;
- të zhvillojnë shkathtësitë për të kuptuar drejtë situatat politike, ekonomike, sociale, kulturore e fetare në shoqëri;
- të aftësohen për të kuptuar gërshetimin e kulturave të popujve të ndryshëm dhe ndikimin reciprok të tyre në periudha të caktuara historike;
- të fitojnë shkathtësi për një pjesëmarrje demokratike dhe qytetare në jetën politike të vendit dhe më gjerë.

### **Në fund të klasës së X nxënësit duhet :**

- të njohin shkaqet dhe arsyet e lindjes, organizimit dhe zhvillimit të shoqërisë dhe shtetit nga lashtësia e deri në vitet '70 – ta të shekullit XIX;
- të interpretojnë drejt mënyrën e llogaritjes së kohës për ngjarje, dukuri, procese e figura historike;
- të aftësohen si të diskutojnë për pikëpamjet e ndryshme të shfaqura, bazuar në argumente shkencore, lidhur me zhvillimet e proceseve në lashtësi dhe antikë, mesjetë dhe kohë të re;
- të thellojnë njohuritë dhe në mënyrë kritike të vlerësojnë ndikimin e miteve dhe legjendave, për ngjarjet e caktuara në antikë, në mesjetë dhe më vonë;
- të konceptojnë qartë ndikimin e raporteve shoqërore dhe ekonomike si dhe rrjedhat e shoqërisë njerëzore në periudhat historike: antikitet, mesjetë dhe kohën e re;
- të kuptojnë drejt reflektimin e pasojave të dyndjes së popujve;
- të shpjegojnë dhe konstatojnë lindjen dhe zhvillimin e qyteteve të reja si dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë.
- Të thellojnë njohuritë dhe në mënyrë kritike të vlerësojnë rolin e fesë në mesjetë si dhe ndikimin e Humanizmit dhe Rilindjes, Zbulimeve të Mëdha Gjeografike dhe ngjarjeve të tjera madhore deri në vitet '70 – ta të shekullit XIX.



## PËRMBAJTJA PROGRAMORE

2 orë në javë, 74 orë në vit

(58 orë zhvillim, 4 orë mësimi në dispozicion dhe 12 orë përsëritje)

Nënkategoritë - Temat	Objektivat	Përmbajtja programore (njësitë mësimore)	Rezultatet e pritura	Ndërlidhja
<b>I</b> <b>Hyrje në lëndën e historisë</b>	Thellimi i njohurive për objektin e studimit të historisë si shkencë dhe si lëndë mësimore	- Historia si shkencë dhe lëndë mësimore	Dallonjnë historinë si shkencë. Dinë për burimet historike dhe për njehsimin e kohës të popujt e ndryshëm si dhe për periodizimin e historisë.	Arkeologjinë, artet, matematikën, gjeografinë, etj.
<b>II</b> <b>Parahistoria</b>	Të kuptojnë proceset e zhvillimit të bashkësive të para njerëzore.	- Bashkësitë e para njerëzore	Dallojnë specifikat kryesore të zhvillimit të shoqërisë njerëzore në kohë të gurit dhe të metaleve.	Artet, biologjinë, arkeologjinë, gjeografinë, edukatën qytetare etj.
<b>III</b> <b>Lindja e Lashtë</b>	Të krahasojnë lindjen, zhvillimin, organizimin shoqëror, kulturor dhe besimet e këtyre vendeve me periudhat e mëvonshme historike.	- Egjipti dhe Mesopotamia - India dhe Kina - Kultura dhe besimi të popujt e Lindjes së Lashtë	Kuptojnë dhe dinë të shpjegojnë shkaqet që ndikuan në lindjen e shteteve. Karakteristikat kryesore të shteteve të para, klasat, shtresat sunduese; Dinë për figurat historike që ndikuan në progresin shoqëror si Hamurabi, Tutmesi III etj; Dinë për zhvillimin e kulturës e besimit, faktorët që ndikuan në zhvillimin e tyre si dhe specifikat dalluese të zhvillimit në këto shtete.	Gjeografinë, artet, matematikën, letërsinë, edukatën qytetare etj.

<p><b>I V</b> <b>Ilirët</b></p>	<p>Të njohin banorët e hershem të Ballkanit. Të informohen për ilirët shtrirjen e tyre, mbretëritë ilire, luftën mbrojtëse si dhe gjendjen e krijuar në Iliri pas pushtimit romak. Njohja me kulturën dhe besimin ilir</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Banorët më të lashtë të Ballkanit (Pellazgët, ilirët, grekët, thrakët, maqedonët)</li> <li>- Origjina e ilirëve, fiset ilire dhe shtrirja e tyre</li> <li>- Mbretëria e Enkelejëve, Taulantëve dhe Ardianëve</li> <li>- Mbretëria e Epirit</li> <li>- Mbretëria Dardane</li> <li>- Luftërat iliro – romake dhe rënja e Ilirisë nën sundimin romak</li> <li>- Kultura dhe besimi të Iliret</li> </ul>	<p>Dinë për popujt më të Lashtë të Ballkanit; Dinë për fiset kryesore ilire, shtrirjen e tyre, organizimin shtetëror të mbretërive ilire, organizimin e jetës ekonomike politike e shoqërore; Kuptojnë realisht luftërat mbrojtëse ilire nga pushtimi romak dhe organizimin e jetës ekonomike e shoqërore të tyre pas pushtimit të Ilirisë nga Roma. Dinë për personalitetet e shquara ilire, kulturën dhe vlerat e saj, besimin, perënditë ilire.</p>	<p>Arkeologjinë, gjuhën, artin, muzikën, gjeografinë, edukatën qytetare, arkitekturën, etj.</p>
<p><b>V</b> <b>Greqia e Vjetër</b></p>	<p>Njohja me zhvillimin e hershëm grek, formimin e poliseve, organizimin, luftërat për dominim. Njohja me besimin dhe kulturën greke, ndikimet e saj te popujt tjerë</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Greqia në mijëvjeçarin e II dhe periudhën home rike</li> <li>- Qytet-shtetet greke. Athina dhe Sparta</li> <li>- Luftërat greko- persiane dhe Luftërat e Peloponezit</li> <li>- Kultura dhe besimi të grekët e vjetër</li> </ul>	<p>Dinë për kulturën e hershme të Kretës dhe Mikenës, specifikat kryesore të tyre; Njohin dhe dinë të argumentojnë arsyet e zhvillimeve ekonomike e shoqërore të qytet- shteteve greke, tiparet dalluese të tyre, shkaqet e konflikteve të brendshme dhe karakterin mbrojtës nga sulmet pushtues persiane; Dinë për figurat e mëdha historike e shkencore si Perkleu, Demosteni, Aristroteli etj;</p>	<p>Filozofinë, letërsinë, artin, edukatën fizike, arkitekturën, edukatën qytetare, matematikën, gjeografinë, etj.</p>

			Dinë të argumentojnë faktorët që ndikuan zhvillimin e kulturës e besimit grek dhe ndikimin që pati kjo kulturë në Iliri, Romë etj.	
<b>VI Maqedonia e Lashtë</b>	Të njohin mendimet për origjinën e maqedonëve të lashtë, organizimin e tyre dhe pushtimet. Të njohin kulturën helene	- Maqedonia në kohën e Filipit II dhe Lekës së Madh	Njohin dhe mund të diskutojnë për teoritë lidhur me origjinën e maqedonëve të lashtë; Dinë shkaqet kryesore të zgjerimeve dhe pushtimet e Filipit II dhe Lekës së Madh; Dallojë karakteristikat kryesore të kulturës helene.	Arkeologjinë, artet, gjeografinë, arkitekturën, letërsinë, filozofinë, etj.
<b>VII Roma e Lashtë</b>	Njohja me fillet e lindjes së shtetit romak, zgjerimin, zhvillimin ekonomik e shoqëror, si dhe arsyet e shkatërrimit të Perandorisë Romake Njohja me besimin e vjetër romak, kulturën dhe lindjen e krishterizmit .	- Historia e hershme e Romës, luftërat e saj për pushtimin e Italisë dhe jashtë saj. - Roma në kohën e Cezarit dhe Oktavianit - Perandoria romake në shekujt I – IV, kriza dhe shthurja e Perandorisë - Lindja e krishterimit. - Kultura dhe besimi të romakët e vjetër	Dinë për themelimin e Romës, zhvillimin ekonomik e shoqëror, zgjerimin dhe pushtimin e Gadishullit Apenin dhe Pellgun Mesdhe. Shkaqet e konflikteve të brendshme dhe arsyet e shkatërrimit të saj; Dinë dhe kuptojnë lindjen e krishterizmit, librin e shenjtë Bibla, si dhe përhapjen e krishtërimin në territorin e Perandorisë dhe arsyet pse bënë rezistencë sundimtarët romak; Dinë për zhvillimin e kulturës e besimit dhe ndikimin që pati ajo nga kultura e besimi grek.	Arkeologjinë, artin, gjeografinë, edukatën qytetare, filozofinë, letërsinë etj

<p align="center"><b>VIII</b> <b>Dyndjet e popujve në Evropë dhe Ballkan</b></p>	<p>Kuptojnë shkaqet e dyndjes së popujve, pasojat për vendasit dhe ndryshimet në hartën gjeoetnike të Evropës e Ballkanit Njohja me dyndjet dhe vendosjen e sllavëve të jugut në Ballkan</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dyndjet e popujve dhe ndryshimet në Evropë e në Ballkan</li> <li>- Sllavët e vjetër dhe dyndjet e tyre</li> </ul>	<p>Dinë për arsyet e dyndjeve të popujve në Evropë e Ballkan, fazat e këtyre dyndjeve dhe pasojat e tyre në Evropë e Ballkan; Janë në gjendje të bëjnë ndërlidhjen e dyndjeve të mëdha sllave e në veçanti ato të sllavëve të jugut dhe ndryshimet gjeoetnike që pësoi Ballkani.</p>	<p>Gjeografinë, demografinë, gjuhësinë etj.</p>
<p align="center"><b>IX</b> <b>Bizanti dhe Evropa në Feudalizmin e hershëm</b></p>	<p>Njohja me organizimin politik e shtetëror të Bizantit e të Shtetit Frank si dhe mënyrën e jetesës gjatë asaj kohe.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bizanti në shekujt V–XI;</li> <li>- Shqiptarët nën sundimin bizantin</li> <li>- Shteti i frankëve</li> </ul>	<p>Dinë për Perandorinë Bizantine si trashigimtare e Perandorisë Romake të Lindjes, zhvillimin e feudalizmit, gjendjene e shqiptarëve nën sundimin bizantin; Janë në gjendje të analizojnë e shpjegojnë specifikat dalluese të zhvillimit feudal në Bizant e Evropë; Dinë për Shtetin Frank, zgjerimin e tij dhe karakteristikat e zhvillimit feudal në këtë vend dhe rolin që luajti Karli i Madh në zgjerimin dhe përparimin e këtij shteti.</p>	<p>Gjeografinë, artet, letërsinë, muzikën, etj.</p>
<p align="center"><b>X</b> <b>Rendi feudal në Azi</b></p>	<p>Njohja me specifikat e zhvillimit shoqëror e politik te arabët, zgjerimin e shtetit të Kalifatit arab dhe islamizmin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Islamizmi lindja dhe përhapja e tij</li> <li>- Themelimi i Kalifatit arab</li> </ul>	<p>Dinë për specifikat e feudalizmit arab, jetën ekonomike e shoqërore, organizimin dhe zgjerimin e shtetit të Kalifatit, klasat shoqërore etj. Dinë për rrëthanat e lindjes së Islamizmit, parimet themelore të tij dhe për librin e shenjtë Kuranin.</p>	<p>Gjeografinë, artin, matematikën etj.</p>

<p align="center"><b>XI</b> <b>Shoqëria feudale në Evropë në feudalizmin e zhvilluar shek. XI–XIII</b></p>	<p>Njohja me jetën qytetare, zhvillimin ekonomik në Evropën e asaj kohe. Njohja me Kryqzatat.</p>	<p>- Zhvillimi ekonomik i Evropës, jeta qytetare dhe zhvillimi i kulturës. - Kryqzatat</p>	<p>Dinë për zhvillimin e hovshëm ekonomik në feudalizmin e zhvilluar, specifikat dalluese të këtij zhvillimi nga ai i mëhershëm, mënyrën e ndryshimit të jetës së njeriut dhe shkaqet reale të fillimit të formimit të shteteve kombëtare në Evropë; Kuptojnë dhe vlerësojnë realisht arsyet e organizimit të luftërave kryqtare dhe pasojat që lindën nga këto ekspedita të shumta luftarake nga kryqtarët në Lindje.</p>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, muzikën, artin etj.</p>
<p align="center"><b>XII</b> <b>Evropa në Mesjetën e Vonë</b></p>	<p>Njohja me tiparet e organizimit shtetëror, zhvillimin ekonomik e shoqëror në Evropë.</p>	<p>- Monarkia Franceze e Angleze në shekujt XIII – XV - Gjermania dhe Italia në shekujt XII - XV</p>	<p>Dinë për formën e organizimit të pushtetit monarkik, arsyet e shfaqjeve të kundërthënieve në shoqëri; Analizojnë e vlerësojnë tiparet dalluese të organizimit shtetëror dhe zhvillimin ekonomik të shteteve Francë, Angli, Gjermani e Itali gjatë asaj kohe.</p>	<p>Gjeografinë, artin, letërsinë etj.</p>
<p align="center"><b>XIII</b> <b>Perandoria Osmane</b></p>	<p>Njohja me zhvillimin e shtetit Osman, specifikat e zhvillimit feudal, organizimin shtetëror, shkaqet dhe arsyet e fuqizimit ushtarak dhe pushtimet e</p>	<p>- Formimi i shtetit osman, pushtimet në Azi dhe Ballkan</p>	<p>Dinë për formimin, zgjerimin dhe organizimin e shtetit Osman, jetën ekonomike e shoqërore dhe zgjerimin e madh të këtij shteti në Azi e Ballkan.</p>	<p>Gjeografinë, artin, letërsinë, muzikën etj.</p>

	mëdha në Azi e Ballkan			
<b>XIV Arbëria në shekujt XI – XV</b>	Njohja me shtetin e Arbërit, rreziku nga invazioni osman. Njohja me rolin e Skënderbeut dhe organizimin e mbrojtjes së tokave shqiptare nga invazionet osmane	- Arbëria në shekujt XI – XIII, Shteti i Arbërisë - Principatat shqiptare në shekujt XIII – XIV - Shqiptarët përball invazionit osman - Populli shqiptar në Epokën e Skënderbeut - Marrëdhënjet e Skënderbeut me Evropën	Dinë për organizimin e shtetit të Arbërit, princiatat shqiptare, jetën ekonomike e shoqërore, zhvillimin e përgjithshëm të tij; Dinë për depërtimin osman në trevat shqiptare, luftën mbrojtëse të shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut etj.	Gjeografinë, artin, letërsinë etj.
<b>XV Humanizmi dhe Rilindja evropiane</b>	Njohja me shkaqet dhe rrethanat e shfaqjes së ideve humaniste, përfaqësuesit e Humanizmit dhe Rilindjes	- Humanizmi dhe Rilindja evropiane	Vlerësojnë drejt shkaqet e lindjes së Humanizmit dhe Renesancës; Dinë për humanistët e parë dhe idetë e tyre humaniste, shkaqet e lindjes së këtyre ideve në Itali etj. Dinë për humanistët dhe për përhapjen e ideve humaniste te shqiptarët.	Artin, letërsinë, gjeografinë etj.
<b>XVI Zbulimet e mëdha gjeografike</b>	Njohja me shkaqet dhe rëndësinë e këtyre zbulimeve dhe ndryshimet që pasuan në Evropë.	- Zbulimet e mëdha gjeografike; Rrjedhojat e këtyre zbulimeve	Kuptojnë shkaqet dhe arsyet që ndikuan në zbulimet gjeografike, interesimin e evropianëve për këto zbulime; Ndikimin e këtyre zbulimeve në përparimin ekonomik etj.	Gjeografinë, astronominë, teknikën, biologjinë, etj.
<b>XVII Reformacioni dhe kundërreformacioni katolik</b>	Njohja me protestanizmin, pikëpamjet dalluese nga doktrina e	- Reformacioni dhe kundërreformacioni katolik	Dinë për shkaqet dhe arsyet e shfaqjes së ideve reformiste, protestane, përfaqësuesit e parë të këtyre ideve si dhe rolin që luajtën	Gjeografinë, letërsinë, artin etj.

	krishter dhe arsyet e kundërvënies së kishës, ideve reformiste.		reformistët protestan në përparimin e përgjithshëm shoqëror.	
<b>XVIII Revolucionet borgjeze në Evropë</b>	Të jenë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e këtyre revolucioneve.	- Revolucionet në Vendet e Ulëta dhe krijimi i shtetit të Holandës - Revolucion i borgjez në Angli - Revolucion i borgjez në Francë	Dinë për arsyet e kthesave të mëdha shoqërore dhe përparimin që bartin këto revolucione. Vlerësojnë realisht tiparet dalluese të organizimit të këtyre revolucioneve në ato vende. Dinë për dallimin e shoqërisë feudale dhe shoqërisë kapitaliste që ishte në lindje e sipër	Gjeografinë, sociologjinë, teknologjinë etj.
<b>XIX Revolucioni amerikan, krijimi i SHBA-ve</b>	Në mënyrë të argumentuar të interpretojnë specifikat e luftës së popullit të Amerikës për pavarësi.	- Pushteti kolonialist anglez dhe lufta për pavarësi e SHBA-ve	Janë në gjendje që të shpjegojnë shkaqet e fillimit të konfliktit, luftën e drejtë të popullatës vendase për çlirim nga dominimi kolonial anglez, si dhe rëndësinë dhe jehonën që pati kjo luftë, për rrjedhat e mëvonshme për botën e veçanërisht për Evropën.	Gjeografinë, artin, edukatën qytetare, letërsinë etj
<b>XX Zbulimet shkencore, të arriturat në kulturë dhe shfaqja e ideve iluministe</b>	Të vlerësojnë drejt të arriturat shkencore, kulturore dhe shfaqjen e ideve iluministe në Evropë.	- Zhvillimi i shkencës, kulturës dhe shfaqja e ideve iluministe	Dallojnë të arriturat shkencore e kulturore dhe faktorët që ndikuan në këto zbulime. Vlerësojnë objektivisht shkaqet e shfaqjeve të ideve iluministe; Dinë për iluministët më të njohur të kohës.	Filozofinë, sociologjinë, gjeografinë, letërsinë, gjuhën frengje etj.
<b>XXI Perandoria Osmane</b>	Të kenë informacione për	- Perandoria Osmane në shekujtë XVI - XVIII	Dinë për shtrirjen e Perandorisë Osmane, zhvillimin ekonomik e	Gjeografinë, sociologjinë,

<p><b>dhe Ballkani në shekujt XVI – XVIII</b></p>	<p>zhvillimin ekonomik të Perandorisë Osmane, organizimin shtetëror si dhe për organizimin e qëndresës së ballkanasve për çlirim nga sundimi osman.</p>	<p>- Popujt e Ballkanit në shekujt XVI - XVIII</p>	<p>shoqëror të saj, si dhe organizimin shtetëror të osmanëve në Azi dhe Ballkan; Dinë për gjendjen e vështirë të popujve të Ballkanit dhe organizim të qëndresës, aspiratat e tyre për çlirim nga sundimi osman</p>	<p>letërsinë etj.</p>
<p><b>XXII Shqipëria në shekujt XVI - XVIII</b></p>	<p>Njohja me pozitën e popullsisë shqiptare, formimin e pashallëqeve shqiptare dhe përpjekjen e tyre për pavarësimin nga sundimi osman</p>	<p>- Qëndresa e shqiptarëve kundër sundimit osman - Krijimi i pashallaqeve shqiptare; - Pashallaku i Shkodrës dhe Pashallaku i Janinës</p>	<p>Dinë për pozitën e rëndë ekonomike e shoqërore të popullsisë shqiptare dhe përpjekjet e tyre për organizimin e qëndresës kundër sundimit osman dhe për çlirim; Dinë për avansimin e përpjekjeve të pashallarëve shqiptare në Shkodër e Janinë për pavarësim nga Stambolli dhe shkaqet objektive të dështimit të këtyre synimeve për çlirim.</p>	<p>Gjeografinë, artin, letërsinë, edukatën qytetare etj.</p>
<p><b>XXIII Evropa në periudhën e Napoleon Bonopartës</b></p>	<p>Do të jenë në gjendje të përshkruajnë gjendjen në Francë, arsyet e ardhjes së Napoleonit në pushtet, pushtimet e tij</p>	<p>- Franca në vitet e Direktoriumit dhe rënia e Perandorisë së Napoleonit.</p>	<p>Janë në gjendje të nxjerrin përfundimet e ardhjes së Napoleonit në pushtet, aftësitë e tij si politikan e strateg, aspiratat e borgjezisë franceze për pushtime; Janë në gjendje të shquajnë pushtimet e Napoleonit dhe shkaqet e disfatës së tij.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë etj.</p>



<p><b>XXIV</b> <b>Evropa gjatë viteve</b> <b>1815 - 1875</b></p>	<p>Do të njohin zhvillimin ekonomik e shoqëror të këtyre shteteve.</p>	<p>- Franca gjatë viteve 1815 – 1871 - Anglia gjatë viteve 1815 – 1873 - Gjermania gjatë viteve 1815 – 1871 - Italia gjatë viteve 1815 – 1871</p>	<p>Dinë për zhvillimin e madh ekonomik të këtyre vendeve; Përpjekjen për restaurimin monarkik dhe në anën tjetër paknaqësitë e shtresave të varfëra dhe borgjezisë, synimet e tyre për ndryshimin e shoqërisë që do ta çonin kah përparimi. Dinë për realizimin e bashkimit kombëtar në Gjermani dhe Itali</p>	<p>Gjeografinë, ekonominë, sociologjinë etj.</p>
<p><b>XXV</b> <b>Ballkani në gjysmën e parë të shekulli XIX e deri në vitin 1875</b></p>	<p>Njohja me përpjekjet e popujve të Ballkanit për çlirim dhe pavarësi nga osmanët</p>	<p>- Krijimi i shteteve autonome në Ballkan</p>	<p>Dinë për krizën ekonomike, politike e shtetërore në Perandorinë Osmane, përpjekjet për reforma dhe ndryshimin e gjendjes së rëndë të regjimit osman. Dinë për luftën e popujve të Ballkanit për çlirim dhe pavarësim nga Stambolli si dhe arsyet e çlirimit të tyre nga Porta e Lartë</p>	<p>Gjeografinë, shkencat juridike, letërsinë etj.</p>
<p><b>XXVI</b> <b>Fillet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare</b></p>	<p>Të kuptojnë esencën e gjendjes së rëndë nën sundimin osman dhe fillimet e organizimit të shqiptarëve në nivel kombëtar.</p>	<p>- Shqiptarët në periudhën e Tanzimatit - Rilindja Kombëtare Shqiptare nga vitet '30 të shekullit XIX deri te Kriza Lindore</p>	<p>Dinë për pozitën e rëndë e konomike e shoqërore të popullsisë shqiptare, rezistencën ndaj reformave formale (Tanzimatit), si dhe fillimin e organizimit të qëndresës në nivel kombëtarë për çlirimin nga robëria osmane.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë, edukatën qytetare etj.</p>

**Vërejtje:** 4 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, Instituteve, monumenteve etj.).

---

## HISTORI

---

### Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë Gjimnazi i shkencave natyrore

#### HYRJE

Historia, si shkencë e rëndësishme shoqërore në klasën X për Gjimnazin Matematikë dhe Informatikë si dhe Gjimnazin e shkencave të natyrës ka për objekt të studimit të kaluarën e shoqërisë njerëzore nga Kongresi i Vjenës (1814) e deri në ditët e sotme. Ajo studion të kaluarën në të gjitha dimensionet e saj: shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, fetare etj.

#### QËLLIMET

- Përmes lëndës së historisë nxënësit të kuptojnë dhe të analizojnë gjithanshëm proceset e zhvillimit të shoqërisë njerëzore nga Kongresi i Vjenës (1814) e deri në ditët e sotme.
- Të njihen me: mënyrat e jetës dhe të të menduarit, personalitetet e njohura, ngjarjet e rëndësishme historike, vendet dhe institucionet shoqërore dhe shtetërore, besimet, kulturën etj.
- Të thellojnë njohuritë mbi rëndësinë e burimeve dhe literaturës historike, të dinë t'i shfrytëzojnë ato për zgjerimin e njohurive në përgjithësi dhe prej historisë në veçanti.

#### OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Të krijojnë koncepte të qarta për zhvillimin e proceseve shoqërore gjatë shekujve XIX, XX e deri në ditët e sotme;
- Të thellojnë njohuritë për mënyrën e organizimit të jetës shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, arsimore përgjatë shekujve XIX dhe XX

## **OBJEKTIVAT SPECIFIKE**

- Të konceptojnë qartë termat historike të periudhave të Kohës së Re dhe Kohës Bashkëkohore;
- Të krahasojnë ndryshimet në periudhat historike të lartëpërmendura, Koha e Re dhe Koha Bashkëkohore;
- Të krahasojnë dhe të argumentojnë me shembuj konkret mënyrën e jetesës së njerëzve në shekujt XIX dhe XX;
- Të konceptojnë qartë formimin dhe zhvillimin e ideve shtetërore e politike si dhe marrëdhëniet ndërkombëtare gjatë shekujve XIX dhe XX.;
- Të dallojnë ndikimin e zbulimeve tekniko-teknologjike dhe pasqyrimin e të arriturave shkencore për përparimin e përgjithshëm shoqëror.

## **SHKATHTËSITË E SYNUARA**

Përmes mësimit të historisë si shkencë shoqërore, në klasën e X synohet që nxënësit t'i fitojnë këto shkathtësi :

- të aftësohen për orientim në kohë dhe hapsirë që nga mjedisi ku jetojnë, regjioni e më gjerë;
- përdorimi i njohurive të fituara mbi ngjarjet shoqërore për zgjidhjen e drejtë të konflikteve në situata të ndryshme;
- të aftësohen për komunikimin në frymën e tolerancës me të tjerët;
- të zhvillojnë shkathtësitë për të kuptuar drejt situatat politike, ekonomike, sociale, kulturore e fetare në shoqëri;
- të aftësohen për të kuptuar gërshetimin e kulturave të popujve të ndryshëm dhe ndikimin reciprok të tyre në periudha të caktuara historike;
- të fitojnë shkathtësi për një pjesëmarrje demokratike dhe qytetare në jetën politike të vendit dhe më gjerë.

### **Në fund të klasë së X nxënësit duhet :**

- të aftësohen dhe të diskutojnë për pikëpamjet e ndryshme të shfaqura, bazuar në argumente shkencore, lidhur me zhvillimet e proceseve shoqërore dhe përparimin e tyre gjatë shekujve XIX dhe XX.;
- të kuptojnë drejt reflektimin e zhvillimeve shkencore, ekonomike e politike në jetën e njerëzve gjatë shekujve XIX dhe XX.;
- të kuptojnë drejt dhe të jenë në gjendje të analizojnë e të elaborojnë në mënyrë kronologjike probleme e ngjarje të caktuara nga kjo periudhë.

## PËRMBAJTJA PROGRAMORE

2 orë në javë, 74 orë në vit

(58 orë zhvillim, 4 orë mësimi në dispozicion dhe 12 orë përsëritje)

Nënkategoritë- Temat	Objektivat	Përmbajtja programore (njësitë mësimore)	Rezultatet e pritura	Ndërlidhja
<b>I Kongresi i Vjenës dhe Aleanca e shenjtë</b>	Do të jenë në gjendje të shpjegojnë ndryshimet në Evropë pas disfatës së Napoleonit dhe përpjekjen për restaurimin e monarkive absolute.	- Kongresi i Vjenës dhe Aleanca e shenjtë	Janë në gjendje që në mënyrë të argumentuar të shpjegojnë rëndësinë e Kongresit të Vjenës dhe ndryshimin e hartës gjeopolitike në Evropë e Botë. Përpjekjet e reaksionit evropian për të rikthyer gjendjen e para Revolucionit Borgjez Francez dhe vendosjen e monarkisë absolute	Gjeografinë, Sociologjinë etj.
<b>II Evropa gjatë viteve 1815 - 1871</b>	Do të kuptojnë zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të këtyre vendeve gjatë asaj kohe.	- Franca në vitet 1815 - 1871 - Anglia në vitet 1815 - 1871 - Gjermania në vitet 1815 - 1871 - Italia në vitet 1815 - 1871 - Austria dhe Hungaria në vitet 1815 - 1871	Janë në gjendje të përshkruajnë përparimet ekonomike e shoqërore në këto vende, konfliktet shoqërore të shtresave të ndryshme, tendencën për zgjerime koloniale dhe realizimin e synimeve të Gjermanisë dhe Italisë për bashkim kombëtar.	Gjeografinë, ekonominë, sociologjinë etj.
<b>III Evropa dhe SHBA në fund të shekullit XIX dhe fillim të</b>	Njohja me zhvillimin ekonomik e shoqëror dhe tiparet dalluese të tyre. Ashpërsimin e marrdhënieve ndërmjet	- Gjermania në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX - Anglia në fund të shekullit XIX dhe në fillim të	Dinë për zhvillimin e hovshëm ekonomik të këtyre vendeve. Përpjekjet për pushtime koloniale, formimin e aleancave ushtarake dhe përgatitjen për fillimin e një konflikti botëror;	Gjeografinë, ekonominë, sociologjinë etj.

<b>shekullit XX</b>	këtyre shteteve, luftën për koloni dhe formimin e aleancave ushtarake përgatitjet luftarake për rindarjen e botës.	shekullit XX - Franca në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX - Rusia në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX - SHBA në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX - Austro - Hungaria në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.	Dinë për rindarjen e botës, në mënyrë që të kenë mundësi për shfrytëzimin e pasurisë natyrore të vendeve të pushtuara	
<b>IV Perandoria Osmane dhe Ballkani gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX</b>	Do të kuptojnë gjendjen e vështirë të Perandorisë Osmane dhe aspiratat e popujve të Ballkanit për çlirim dhe pavarësi kombëtare, por edhe aspiratat e disa prej këtyre shteteve për zgjerim në dëm të popujve tjerë	- Perandoria Osmane në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, krijimi i shteteve të pavarura në Ballkan. - Luftërat ballkanike	Dinë për krizën që e kishte përfshirë Perandorinë Osmane dhe reformat që bënte ajo për dalje nga kjo gjendje; Dinë dhe vlerësojnë objektivisht për aspiratat e popujve të Ballkanit për çlirim dhe fitimin e pavarësisë; Nxënësit objektivisht vlerësojnë qëndrimin e padrejtë të disa shteteve ballkanike për zgjerimin territorial në dëm të popujve fqinj.	Gjeografinë, sociologjinë, letërsinë etj.
<b>V Shqiptarët në shekullin XIX</b>	Do të jenë në gjendje të vlerësojnë drejt aspiratat çlirimtare të popullit shqiptar. Fazat dhe karakteristikat e tyre.	- Shqiptarët në periudhën e Tanzimatit dhe fillet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare - Formimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe lufta e saj	Janë në gjendje që të gjykojnë për përpjekjet e popullit shqiptar për çlirim nga sundimi osman dhe mbrojtja e territoreve nga coptimi. Kuptojnë e vlerësojnë objektivisht për vështërsitë e	Gjeografinë, sociologjinë, letërsinë etj.

	Njohja me të arriturat në kulturë, arsim si bazë për ndërgjegjësimin kombëtar.	për mbrojtjen e tokave shqiptare nga coptimi - Përpjekjet e Lidhjes së Prizrenit për formimin e shtetit shqiptar - Zhvillimi i arsimit dhe i kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XIX - Lidhja Shqiptare e Pejës 1899	shqiptarëve në luftë për realizimin e çlirimit kombëtar; Dinë për të arriturat në arsim e kulturë dhe ndërgjegjësim gjithnjë e më shumë të popullit në luftë për çlirim dhe pavarësi.	
<b>VI Shqiptarët në fillim të shekullit XX</b>	Do të jenë në gjendje të shpjegojnë përpjekjet e popullit shqiptar për çlirim nga sundimi osman, shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe rezistencën e popullsisë që mbeti jashtë kufijve londineze, ndaj tendencave shkombtarizu ese si dhe angazhimin e princit Vilhem Vid në Shqipëri.	- Lëvizja kombëtare në vitet 1908 – 1909 - Kryengritjet shqiptare kundër sundimit osman në vitet 1909 – 1912 - Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë - Veprimtaria e Qeverisë Kombëtare të kryesuar nga Ismail Qemali - Lufta për çlirimin e bashkimin kombëtar në viset e pushtuara nga Serbia, Mali i Zi dhe Greqia (1912 – 1914) - Shqipëria gjatë kohës së Princit Vilhem Vid	Janë në gjendje në mënyrë të argumentuar të shpjegojnë përpjekjet e mëdha dhe sakrificat e popullit shqiptar për çlirimin nga sundimi osman, shpalljen e pavarësisë dhe rolin që ka luajtur Ismail Qemali në këtë akt madhor; Dinë të vlerësojnë realisht për padrejtësitë që ju bënë popullit shqiptar me rastin e caktimit të kufinjëve dhe qëndresën e popullsisë të atyre trevave ndaj robërisë së re serbe, malazeze e greke. Dinë për kontributin e Vilhem Vidit në konsolidimin e brendshëm në Shqipëri.	Gjeografinë, shkencat politike, letërsinë, artin etj.
<b>VII Lufta e Parë</b>	Do të jenë në gjendje të gjykojnë arsyet e luftës,	- Lufta e Parë Botërore 1914 – 1916	Janë në gjendje të dallojnë shkaqet objektive të kësaj lufte. Luftimet	Gjeografinë, sociologjinë, artet,

<b>Botërore dhe Revolucionit i Tetorit</b>	operacionet kryesore luftarake si dhe pasojat që pati njerëzimi nga kjo luftë. Njohja me shpërthimin e Revolucionit në Rusi, pasojat e tij	- Lufta e Parë Botërore 1916 – 1918 - Revolucionit i Tetorit në Rusi (1917)	kryesore në frontet e luftës si dhe pasojat që pati njerëzimi nga kjo luftë; Kuptojnë e vlerësojnë objektivisht, arsyet e shpërthimit të Revolucionit në Rusi dhe pasojat që pati populli rus nga diktatura komuniste.	letërsinë etj.
<b>VIII Shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore</b>	Do të shquajnë përpjekjet e ruajtjes së tërësisë tokësore si dhe organizimin për kundërvënien ndaj pushtuesve të ndryshëm.	- Shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore	Janë në gjendje të ilustrojnë gjendjen e rëndë të popullit shqiptar gjatë Luftës së Parë Botërore, përpjekjen e tyre për organizimin e mbrojtjes ndaj synimeve pushtuese dhe qëndresën e popullsisë shqiptare që kishte mbetur jashtë kufijve londinez	Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë etj.
<b>IX Bota midis dy luftërave botërore</b>	Njohja me zhvillimin ekonomik e shoqëror të këtyre vendeve dhe zhvillimin e demokracisë në SHBA, Angli, Francë. Njohja me vendosjen e diktaturave në BRSS, Itali dhe Gjermani.	- Konferenca e Paqes në Versaj 1919 - Anglia dhe Franca në vitet 1918 -1939 - SHBA në vitet 1918 -1939 - BRSS në vitet 1918 -1939 - Gjermania në vitet 1918 - 1939 - Italia në vitet 1918 -1939	Dinë për zhvillimin ekonomik e demokracinë në SHBA, Angli dhe Francë dhe progresin e gjithanshëm shoqëror që arritën këto vende. Dinë dhe vlerësojnë objektivisht për pasojat që patën popujt e vendeve ku ngadhënyen sistemet diktatoriale si komunizmi në BRSS, fashizmi në Itali dhe nacizmi në Gjermani si dhe për pasojat që pati njerëzimi nga këto forca të errta.	Gjeografinë, sociologjinë, teknologjinë etj.
<b>X Ballkani midis dy luftërave</b>	Njohja me zhvillimin ekonomik e shoqëror dhe orientimet politike që	- Turqia, Jugosllavia, Greqia, Bulgaria, Rumania midis Dy Luftërave Botërore	Dinë për zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve, për proceset shoqërore e politike të tyre si dhe për relacionet	Gjeografinë, sociologjinë, teknologjinë etj.

<b>botërore</b>	patën këto vende midis Dy Luftërave Botërore		ndërfqinjësore e ndërkombëtare që patën.	
<b>XI Shqiptarët midis dy luftërave botërore</b>	Do të kuptojnë gjendjen e rëndë ekonomike e politike në Shqipëri pas luftës dhe përpjekjet për konsolidim. Njohja me pozitën e shqiptarëve jashtë kufijve. Njohja me të arriturat në arsim e kulturë gjatë kësaj periudhe.	- Shqiptarët në përfundim të luftës së Parë Botërore - Qëndresa e popullsisë shqiptare në Kosovë e viset tjera shqiptare për çlirim e bashkim kombëtarë - Shqipëria gjatë viteve 1925 - 1939 - Zhvillimi i arsimit e kulturës në Shqipëri dhe në viset tjera shqiptare midis dy luftërave	Dinë për gjendjen e rëndë ekonomike e shoqërore si dhe përpjekjet për të dalë nga kjo situatë; Dinë për politikën gjenocidale që ndoqën qarqet sunduese serbe ndaj popullit shqiptar në Kosovë e viset tjera si dhe organizimin e qëndresës kundër kësaj politike; Dinë për të arriturat në arsim e kulturë gjatë kësaj kohe.	Gjeografinë, shkencat politike, ekonominë, letërsinë etj.
<b>XII Lufta e Dytë Botërore</b>	Do të mund të shquajnë shkaqet dhe rrethanat që quan në Luftën e Dytë Botërore. Fillimin e luftës dhe pasojat, frontet kryesore të luftës, hyrja e SHBA-ve në luftë	- Bota në prag të Luftës së Dytë Botërore; Lufta e Dytë Botërore 1939 – 1943 - Lufta e Dytë Botërore 1943 - 1945	Përshkruajnë shkaqet e Luftës së Dytë Botërore, frontet e luftës, operacionet kryesore të luftës dhe pasojat; Dinë për rëndësinë që pati për përfundimin e shpejtë të luftës hyrja e SHBA-ve në luftë; Vlerësojnë realisht për pasojat që i solli njerëzimit kjo luftë	Gjeografinë, artin, letërsinë etj.
<b>XIII Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore</b>	Njohja me gjendjen e rëndë në Shqipëri pas pushtimit, fillet e organizimit të rezistencës, pushtimin nacist gjerman, rritjen e	- Pushtimi fashist italian i Shqipërisë dhe lufta e popullit shqiptar kundër tij (1939 – 1943) - Pushtimi nazist gjerman dhe lufta kundër tij (1943-1944)	Shpjegojnë gjendjen e rëndë pas pushti mit italian, format e organizimit të rezistencës, formimin e njësive ushtarake çlirimtare etj. Dinë për pushtimin nacist gjerman, masovisimin e luftës çlirimtare dhe	Gjeografinë, artin , letërsinë, ekonominë etj.



	rezistencës çlirimtare dhe çlirimi i vendit. Njohja me luftën çlirimtare të popullit të Kosovës, aspiratat për bashkim kombëtarë.	- Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore	fitoren përfundimtare çlirimtare të vendit; Dinë për pushtimin fashist italian, pushtimin bullgar dhe atë nacist gjerman të Kosovës, organizimin e rezistencës, shprehjen e aspiratës për bashkim kombëtarë në Konferencën e Bunjajt si dhe ripushtimin me forcë nga Jugosllavia.	
<b>XIV Bota pas Luftës së Dytë Botërore</b>	Janë në gjendje të përshkruajnë rrethanat e krijuara në botë pas Luftës së Dytë Botërore. Lufta e Ftohtë, Krijimin e OKB-së, shembjen e sistemeve diktatoriale komuniste.	- Situata ndërkombëtare pas Luftës së Dytë botërore; Lufta e Ftohtë - Evropa e Perendimit 1945 - 1990 - SHBA gjatë viteve 1945 - 1990 - BRSS gjatë viteve 1945 - 1990 - Vendet e Evropës Lindore gjatë viteve 1945 - 1990 - Vendet e Ballkanit gjatë viteve 1945 - 1990 - Problemet e sotme globale në botë dhe rëndësia e tyre	Përshkruajnë situatën e krijuar pas Luftës së Dytë Botërore, zhvillimin e hovshëm ekonomik e shoqëror, kundërthëniet midis shteteve të mëdha, formimi i OKB – së si organizatë për ruajtjen e paqes, kundërvënien politikës bllokiste dhe Luftës së Ftohtë; Dinë për sistemin totalitar të vendeve të Lindjes dhe Ballkanit sidomos për atë të BRSS. Përpjekjet e popujve të këtyre vendeve për rënien e kësaj forme të pushtetit nga skena. Kërkesat e popujve për paqe e mirëkuptim si dhe kundërvënien gjithnjë e më shumë sistemeve totalitare dhe rënia e tyre nga pushteti	Gjeografinë, shkencat politike, teknologjinë, ekonominë etj.
<b>XV Shqiptarët pas Luftës së Dytë</b>	Njohja me pozitën e shtetit shqiptar, vendosjen e diktaturës komuniste, pozitën	- Shqipëria gjatë viteve 1945 - 1990 - Zhvillimi i arsimit, shkencës dhe kulturës gjatë viteve	Dinë për marrjen e pushtetit nga komunistët, pozitën ndërkombëtare të shtetit shqiptar pasojat e popullsisë nga kjo formë e pushtetit, varfërimin e jetës	Gjeografinë, ekonominë, gjuhësinë, letërsinë etj.

<b>Botërore</b>	ndërkombëtare. Njohja me përmbysjen e komunizmit dhe fitoren e demokracisë. Njohja me gjendjen në Kosovë, situatën ekonomike e shoqërore, juridike, rezistenca paqësore në vitet '90 dalja në skenë e UÇK-së. Lufta çlirimtare gjatë viteve 1998 – 1999 ndërhyrja ndërkombëtare dhe çlirimi i Kosovës	1945 - 1990 - Përmbysja e diktaturës komuniste dhe fitorja e demokracisë - Kosova në vitet 1945 - 1989 - Arsimi, shkenca dhe kultura në Kosovë dhe viset tjera shqiptare në vitet 1945 - 1999 - Kosova në vitet 1990 – 1999	së popullit, rritjen gjithnjë e më shumë të paknaqësisë dhe fitoren e demokracisë në Shqipëri; Dinë për arsimin dhe arritjet në shkencë dhe formimin e Institucioneve si Universiteti, Akademia e Shkencave etj. Dinë për politikën serbe ndaj shqiptarëve, qëndresën e organizuar të shqiptarëve, zhvillimin ekonomik e shoqëror të Kosovës, pozitën juridike; Dinë për organizimin e rezistencës paqësore dhe krijimin e Institucioneve të shtetit të Kosovës. Rritjen e represionit serb dhe daljen në skenë të UÇK – së, si dhe për luftën çlirimtare 1998 – 1999. Ndërhyrjen e Natos dhe faktorve tjerë ndërkombëtarë dhe çlirimin e Kosovës.	
-----------------	---	---	--	--

**Vërejtje:** 4 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, Instituteve, monumenteve etj.).

## METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Zgjedhja e metodave mësimore është në kompetencë të mësimdhënësit të lëndës, ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, veçoritë e përmbajtjes së temave mësimore, bazës didaktike, nivelit të formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë stilet dhe mënyrat e nxënies së vetë nxënësve, prandaj gjatë një ore mësimore mësimdhënësi mund të përdorë disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra tjetrën në mënyrë që të arrijë rezultate optimale gjatë procesit mësimor. Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore me nxënësin në qendër sygjerohen metoda e teknika të tilla si:

*Shpjegimi, të mësuarit problemor, diskutim që zgjidh problemin, punë në grupe, kllasteri (teknikë e mendimit kritik-grumbulli apo pema e mendi meve), brainstormingu (“stuhi, mendimesh”), pesëvargëshi, xhigsou, historia gojore etj.*

Për tema të caktuara, të cilat karakterizohen nga një informacion i bollshëm, mund të gjej zbatim edhe **ligjerata ndërvepruese (interaktive)**

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore të lartëpërmendura duhet të shoqerohet me përdorimin e materiale përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultate e dëshiruara. Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses muzetë, galeritë, bibliotekat, arkivat, monumentet e ndryshme, ekskursionet me karakter historik etj.

## VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve, qoftë ky sistematik (për çdo temë mësimore), periodik (në përfundim të çdo kapitulli), semestral ose vjetor mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si me shkrim (ese, testim etj.), me gojë (pjesërisht), punë praktike, etj.

Gjatë zbatimit të testimit, sistemi i poentimit zgjidhet nga vetë mësimdhënësi.

Njohja dhe vlersimi i njohurive të fituara nga mësimdhënësi dhe nxënësi mund të plotësohet mëtej edhe nga shënimet individuale që mund të mbahen personalisht, pa përmendur këtu regjistrin e klasës.

### Tipat e vlerësimit

- **Vlerësimi formues** ka për qëllim ta udhëzojë mësuesin në planifikim dhe të nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies

(punës) me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.

- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim që të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies p.sh. pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti...etj.
- **Vlerësimi në bazë të kriterëve** kupton vlerësimin e çdo nxënës që përmbush kriteret e caktuara p.sh. krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësimdhënësit që të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmon në përmirësimin e tyre.
- **Vlerësimi diagnostikues** përcakton te nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.

Vlerësimi **formues** dhe **diagnostikues** nuk vlerëson me nota, por në bazë të tyre mësimdhënësi planifikon punën e tij.

- **Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor. Veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.
- **Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuese hartohen jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë).
- **Vlerësimi i përditshëm** bazohet në kontrollin e punës së nxënësit në klasë.
- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.
- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe bazohet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.
- **Vlerësimi** në proces bazohet në vlerësimin e mbikqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune ose detyre në zhvillim.

### Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- Kontrolli i zakonshëm i veprimtarive në klasë
- Detyrat e shtëpisë
- Testet
- Mësimdhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupton përparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre.
- Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurojmë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë. Në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherit mund

të jetë edhe e padobishme në rast se në vend që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

#### **Format e testeve janë:**

- Me gojë
- Me shkrim
- Përmes paraqitjes grafike etj.

Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përpunimin e nxënësit, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anët negative për arsye se te nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj.

- Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdorim edhe veprimtari tjera, p.sh.  
Vlerësimi i eseve  
Vlerësimi me dosje  
Vetëvlerësimi...etj

#### **BURIMET DHE MJETET MËSIMORE:**

1. *Aspekte të mësimdhënies së historisë*, Prishtinë, 1997
2. *Aspekte të mësimdhënies së historisë*, Tiranë, 1995
3. Bardhyl Musai, *Psikologjia e Edukimit*, Shtëpia botuese: Pegi, Tiranë, 1999
4. Bardhyl Musai, *Metodologjia e Mësimdhënies*, Tiranë 2003
5. Dr. Bep Jubani, Dr. Isa Bicaaj, Dr. Vilson Kuri, *HISTORIA* për klasën e parë të shkollave të mesme, Shtëpia botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
6. Dr. Fehmi Rexhepi, Dr. Isa Bicaaj, *HISTORIA* për klasën e parë të shkollave të mesme profesionale, Shtëpia botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
7. Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar*, për shkolla të mesme, botoi: Libri Shkollor, Prishtinë, 1998
8. Grup autorësh, *Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*, nën redaktimin e prof. Dr. Hysni Myzyrit, botoi: Siptinti, Prizren 2000
9. Dr. Agron Gani, Dr. Hysni Myzyri, Dr. Jusuf Bajraktari, *HISTORIA* për klasën e dytë të shkollave të mesme. botoi : Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
10. Grup autorësh, *Të kuptojmë të kaluarën e përbashkët për të ndërtuar të ardhmen, Ndryshime dhe vazhdimësi të jetës së përditshme në Shqipëri, Bullgari dhe Maqedoni 1945 – 2000*, botues: EUROCLIO, Shoqata e Mësuesve të Historisë të Shqipërisë, Shoqata Bullgare e Mësuesve të Historisë, Shoqata e Historianëve të Republikës së Maqedonisë, Tiranë 2003
11. Mikel Pjetrush, *Atlas historik i botës*, Shtëpia botuese: Camaj – Pipa, Shkodër, 2001
12. MASHT, *Plani dhe programi mësimor 9*, përgatiti për shtyp: Libri Shkollor Prishtinë, 2002

## HYRJE

Muzika është është pjesë e jetës së njeriut, ajo është e drejtë dhe nevojë e secilit, prandaj është e paraparë edhe në programin e këtij niveli. Muzika nxënësve u ofron botën e vlerave të saj, u mundëson zhvillim të plotë muzikor duke interpretuar, duke krijuar dhe duke dëgjuar dhe kjo i shpie drejt sensibilizimit estetik, cilësimit dhe vlerësimit kritik.

Lënda është e sajuar nga përmbajtjet muzikore të zgjedhura me kujdes, duke iu përshtatur moshës dhe inteligjencës se përgjithshme dhe asaj muzikore të nxënësve, për ta zhvilluar qëndrimin kritik të tyre ndaj jetës dhe botës.

Nxënësit e këtij niveli të shkollimit me potencialin e tyre intelektual paraqesin popullatë e cila në të ardhmen e përbën shtresën kulturore të shoqërisë kosovare. Muzika u mundëson nxënësve të formohen si dëgjues të mirëfilltë të muzikës, muzikëdashës dhe interpretues të saj. Muzika sot është është pjesë përberese e fisnikërimit shpirtëror, shëndetit mental dhe të qenit i suksesshëm në të gjithë lëmenjtë.

## QWLLIMET QËLLIMET DHE OBJETKIVAT OBJEKTIVAT E LËNDËS

### Qwllimet Qëllimet:

#### **Nxënësit:**

- edukohen që të jetojnë me artin dhe kulturën muzikore;
- me veprimtari aktive muzikore zhvillojnë dhe pasurojnë potencialet e tyre emocionale, racionale, intelektuale, psikomotorike, estetike, morale dhe sociale;
- e kuptojnë artin muzikor si art kohor në hapësirën tingullore.

## Objektivat

Nxënësit:

- përmes dëgjimit përjetojnë dhe pranojnë vlera muzikore të rëndësishme për kulturën kombëtare dhe botërore;
- njohin krijimtarinë muzikore popullore dhe artistike kombëtare për ta ruajtur dhe për ta kultivuar identitetin kombëtar;
- përjetojnë dhe pranojnë muzikën e epokave të ndryshme stilistike, gjinive dhe zhanreve muzikore, duke i zhvilluar aftësitë e përjetimit estetik, cilësimit kritik dhe sensibilitetit;
- përmes muzikës si gjuhë universale e komunikimit zhvillojnë aftësitë e bashkëpunimit dhe të krijimit të raporteve kulturore;
- përmes formave të ndryshme të veprimtarisë muzikore zhvillojnë aftësitë kreative, individuale;
- këndimi dhe veprimtaritë e tjera muzikore u sjellin gëzim;
- njohin lidhjen interdisiplinare të muzikës me lëndët e tjera, si dhe me artet e me shkencën;
- stimulohen për punë të pavarur studiuese dhe hulumtuese;
- u bëjnë vështrim kritik programeve muzikore mediale, si dhe krijojnë përmbledhje incizimesh;
- në mënyrë të organizuar dhe individuale ndjekin shfaqjet muzikore artistike;





## DETYRAT OPERATIVE TË LËNDËS DHE PËRMBAJTJET

### 1. Nxënësit dëgjojnë dhe njohin vepra të zgjedhura, krijues dhe interpretë nga tradita muzikore shqiptare dhe botërore

SYNIMET DHE VEPRIMTARITË	PËRMBAJTJET	BURIMET ARTISTIKE	NDËRLIDHJA
1.1. Dëgjojnë (në mënyrë analitike dhe përjetuese) vepra prej zanafillës së muzikës deri në klasicizëm.	<p><b>Zanafilla e muzikës</b></p> <p>Muzika në komunitetin e parë shoqëror.</p> <p>Kultura muzikore e lashtësisë në rendin shoqëror skllavopronar..</p> <p><b>Kultura muzikore antike</b></p> <p><b>Kultura muzikore në mesjetë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fillet e muzikës evropërendimore</li> <li>• Muzika vokale kishtare njëzëreshe.</li> </ul>	<p><i>Melodi e thjeshtë afrikane-Kongo, amerikane-Kolumbiane, Aziatike-Cejloni</i></p> <p>Oda e Pintarit Kënga e Seikilit</p> <p><i>Niketë Dardani: Te Deum</i></p>	<p>historia gjeografia <del>arkitekura</del><a href="#">arkitektura</a> etj.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Muzika shekullare.</li> <li>• Prej njëzëshmërisë deri të shumëzëshmëria.</li> </ul> <p><b>Muzika në epokën e Humanizmit dhe të Renesansës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijuesit e shquar të epokës së Renesansës.</li> </ul> <p>• Format e muzikës vokale.</p> <p><b>Muzika në epokën e Barokut</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Muzika instrumentale</li> </ul> <p>Format e <del>muzikes</del><u>muzikës</u> vokalo-instrumentale:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kantata</li> </ul>	<p><i>Koral gregorian: Kyrie, Dies irae</i></p> <p><i>Këngë trubadurësh</i></p> <p><i>Organum, diskant, gymel</i></p> <p><i>F. Landini: Baladë</i></p> <p><i>Zhusquin de Pre: Meshë ( fragment)</i></p> <p><i>Palestrina: Meshë (Papa Marcelo)</i></p> <p><i>Lasso: Echo( Jehona)</i></p> <p><i>Matona mia Cara</i></p> <p><i>Coreli: concerto grosso op.5,6</i></p> <p><i>La Folia</i></p> <p><i>Albinioni: Adagio</i></p>	
--	---	---	--



1.2. Shprehin përjetimet e përmbajtjeve muzikore.	Muzika dhe shprehja letrare.  Muzika dhe shprehja figurative.  Muzika dhe shprehja lëvizore-vallëzuese.	Mendimet e kompozitorëve dhe shkrimtarëve mbi muzikën.  Motivet muzikore në artin figurativ.  Muzika dhe lëvizja.	letërsia  arti figurativ  vallëzimi
1.3. Njohin mjetet dhe formacionet interpretuese.	zërat veçat formacionet vokale dhe instrumentale		
1.4. Dallojnë elemente shprehëse.	Tingulli- heshtja. Melodia, ritmi, harmonia.		
1.5. Njohin format muzikore.	Këngë një e më shumë kohëshe	Dëgjimi i formave të rëndësishme muzikore	Letërsia jonë dhe e huaj

## 2. Nxënësit këndojnë kompozime tona dhe të huaja

VEPRIMTARITË	PËRMBAJTJET	BURIMET ARTISTIKE	NDËRLIDHJA
2.1. Zhvillojnë interesin për kultivimin e kulturës së këndimit dhe e vlerësojnë atë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia e këndimit për zhvillimin psikofizik.</li> <li>• Këndimi dhe bashkëtingllima harmonike.</li> <li>• Ndjenja harmonike.</li> </ul>	<p><i>Këngë një, dy e më shumë zëshe me dhe pa shoqërim instrumental.</i></p> <p><i>Tema <u>perpër</u> interpretim nga muzika instrumentale dhe vokale:</i></p> <p><i>Himni i Shën Gjonit.</i></p> <p><i>Këngë trubadurësh</i></p> <p><i>Palestrina: Fragment nga Mesha: Papa Marcello</i></p> <p><i>Lasso: Matona Mia Cara</i></p> <p><i>Monteverdi: Lassate mi morire</i></p> <p><i>Gluk: Arie e Orfeut</i></p> <p><i>Koreli: La Folia( temë nga Sonata)</i></p> <p><i>Handell: Aleluja nga „Mesia“</i></p> <p><i>Bach: Motet( Jesus ist meine frojde)</i></p>	Shprehja letrare dhe ndërlidhja me fushat e tjera (historia, zhvillimi shoqëror etj).
2.2. Zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj traditës sonë të këndimit.	<p>Rëndësia e këngës për identitetin kombëtar.</p> <p>Këngë popullore të trevave të ndryshme.</p>	<p><b>Përzgjedhje e këngëve popullore :</b></p> <p><i>Dedë Gjo Luli</i></p> <p><i>Kush ma i pari bani <u>gurbetinkurbetin</u></i></p> <p><i>Vijnë vaporet</i></p> <p><i>Shkoj e vij <u>flutrimfluturim</u> si zogu</i></p> <p><i>Besa –besë</i></p> <p><i>Lule Çerçiz Topulli</i></p>	Gjeografia Historia

		<i>Nëntëqind e dymbëdhjeta Mir'mrama</i>	
2.3. Njohin teknikën e këndimit të bukur dhe të drejtë.	Frymëmarrja dhe formimi i zërit.	Në këngët që këndohen.	Fiziologjia

### 3. Nxënësit interpretojnë përmbajtje instrumentale dhe vokalo-instrumentale

<b>VEPRIMTARITË</b>	<b>PËRMBAJTJET</b>	<b>BURIMET ARTISTIKE</b>	<b>Ndërlidhja</b>
3.1. Luajnë pjesë instrumentale.	Ngjyra të reja tingullore.	<i>Përzgjedhje e pjesëve instrumentale.</i>	
3.2. Shoqërojnë këndimin me instrumente.	Instrumentet e ORF-it.		
3.3. Përvetësojnë teknikën e luajtjes në instrument.	Vegla elektronike muzikore.		

### 4. Nxënësit e riinterpretojnë veprën muzikore të mësuar

<b>VEPRIMTARITË</b>	<b>PËRMBAJTJET</b>	<b>BURIMET ARTISTIKE</b>	<b>Ndërlidhja</b>
4.1. Interpretojnë vepra vokale dhe instrumentale të shënuara, sipas përjetimit individual.	Shenjat interpretuese: tempoja, dinamika, agogjika, shprehja.	Ndërlidhja me këndimin dhe lojën instrumentale.	
4.2. Cilësojnë dhe vlerësojnë interpretimet individuale dhe të tjerëve.			Gjuha amtare

## 5. Nxënësit krijojnë përmbajtje muzikore

VEPRIMTARITË	PËRMBAJTJET	BURIMET ARTISTIKE	Ndërlidhja
5.1. <del>Hulumtojnë</del> Hulumtojnë, zgjedhin dhe kombinojnë tinguj.	Eksperiment tingullor		Akustika
5.2. Zhvillojnë tema melodike dhe tërësi ritmike.	Formësimi ritmik dhe melodik. Pjesët përbërëse dhe tërësitë.		
5.3. Improvizojnë			
5.4. Krijojnë melodi në tekst të dhënë.			Letërsia
5.5. Sajojnë shoqërime dhe përpunime.			
5.6. Krijojnë formë kënge dhe forma të tjera të thjeshta muzikore.			

## 6. Nxënësit sipas interesit dhe në mënyrë kreative shprehin përjetimet muzikore përmes mjeteve shprehëse të fushave të tjera

VEPRIMTARITË	PËRMBAJTJET	BURIMET ARTISTIKE	Ndërlidhja
6.1. Komentojnë përfytyrimet dhe përjetimet muzikore.	Komentim përjetues. Vështrim kritik.	Mendimet për muzikën.	Gjuha amtare
6.2. Shprehin mesazhin e muzikës përmes shprehjes figurative.	Simbolet grafike për muzikën. Të shprehurit figurativ të përmbajtjeve muzikore.	Shembuj muzikorë të ndërlidhur me artin figurativ.	Arti figurativ
6.3. Të shprehurit mbi muzikën përmes lëvizjes dhe vallëzimit.	Shprehja lëvizore. Vallëzimi.	Shembuj muzikorë të ndërlidhur me artin e vallëzimit.	Ritmika Vallëzimi

### 7. Nxënësit thelojnë dituritë mbi kulturën muzikore

<b>VEPRIMTARITË</b>	<b>PËRMBAJTJET</b>	<b>BURIMET ARTISTIKE</b>	<b>Ndërlidhja</b>
7.1. Njohin mundësitë e manipulimit me muzikën përmes mediave.	Muzika dhe teknika - anët e mira dhe të këqija. Llojet e ndryshme të incizimeve. Muzika në radio dhe në televizion.	Produksioni i ri muzikor.  Programi muzikor në mediat	Edukimi për mjedisin muzikor-ekologjia. tingullore teknologjia
7.2. Kuptojnë dhe orientohen me programet koncertale citimet dhe komentet.	Programi i shfaqjeve kulturore dhe ngjarjet muzikore aktuale		
7.3. Njohin dhe përdorin burimet tingullore dhe muzikore.	Leksikoni muzikor.		



## UDHËZIMET DIDAKTIKO-METODIKE

- Realizimi i lëndës arti muzikor duhet të ketë parasysh nivelin zhvillimor të nxënësve, veprimtaritë themelore muzikore dhe synimet kognitive dhe emocionale.
- Mësimdhënësi e udhëheq procesin mësimor në mënyrë që të rumbullakësohet ndërlidhja vertikale e edukimit muzikor. Kjo është përgatitje bazë për jetën muzikore të tyre të mëtejshme.
- Programi i pasur dhe me kërkesa nënkupton planifikim dhe realizim të kujdesshëm e racional të fondit të orëve.
- Mësimdhënësi në mënyrë kreative sajton njësitë mësimore, duke i ndërlidhur në mënyrë të logjikshme veprimtaritë e përcaktuara nga objektivat hyrës. Këta duhet të jenë tërësi përmbajtësore të ~~rumbullakësuar~~rumbullakuara, ngase programi mësimor nuk përcakton renditjen e tyre, por vetëm nismat për ndërlidhjen kreative të synimeve, veprimtarive dhe të përmbajtjeve muzikore.
- Komunikimi muzikor dhe krijimtaria janë veprimtari që duhet t'u mundësojnë nxënësve relaksim të nevojshëm shpirtëror.

## DËGJIMI

Kjo veprimtari themelore zhvillon aftësinë për njohje përjetuese, analitike dhe vlerësuese, ku prin përjetimi, i cili rrit vëmendjen dhe koncentrimin për dëgjim më të gjatë.

Mësimdhënësi nxit përjetimin dhe njohjen me forma të ndryshme të motivimit që nxënësit:

- të ndjekin veprat ose pjesët e saj përmes partiturës së adaptuar;
- përmes këndimit të njohin temat dhe meloditë e rëndësishme që vërejnë (rinjohin) gjatë dëgjimit;
- të kuptojnë përmbajtjet programore të veprës;
- përmes komentimit gjuhësor ose simboleve grafike të shënojnë rrjedhën e veprës;
- të krahasojnë përshtypjet tingullore të pjesëve të caktuara të veprës muzikore;
- në mënyrë kreative të komentojnë tekstualisht ose vizuelisht tërësinë e përmbajtjes muzikore;
- përmes lëvizjes dhe vallëzimit të shprehin përjetimin muzikor.

Gjatë dëgjimit kufizohemi në dhënien e informacioneve elementare, të cilat e ndihmojnë dëgjuesin për ta kuptuar veprën, siesic janë: komentet mbi formën muzikore, mjetet shprehëse, formacionet interpretuese që i thellojnë njohuritë paraprake.

Rëndësi të veçantëveçantë në këtë nivel i kushtohet përjetimit, njohjes, interpretimit dhe vlerësimit të veprës. Nxënësit i nxisin dhe i udhëheqim për debat kritik, krahasime dhe vlerësime të veprave artistike muzikore, duke zgjeruar njohuritënjohuritë mbi krijimtarinë e pasur muzikore.

## INTERPRETIMI

Interpretimi në mësimdhënien e muzikës përfshin këndimin dhe luajtjen instrumentale.

- Në këtë nivel këndimi duhet të përfshijë përmbajtje interesante që i nxisin nxënësit në përjetim;
- Përmbajtjet e këngëve duhet të zhvillojnë lirinë e të shprehurit vokal;
- Në raste të caktuara është mirë që të zhvillohet punë në grupe sipas mundësive të nxënësve, që ndikon në socializimin e tyre;
- Përzgjedhja e këngëve për këndim koral në klasë bëhet me kujdes, duke pasur parasysh vlerën artistike dhe interesimet aktuale të kësaj moshe;
- Këngët interpretohen sipas metodës së kombinuar (sipas veshitimitit dhe tekstit notal);
- Përforcojmë njohuritë e mëparshme, bëjmë ushtrime për këndiminkëndimin e drejtë dhe të bukur;
- Loja në instrumente gjen zbatim edhe në këtë nivel.

## KRIJIMI

Kjo veprimtari mësimore përfshin dëgjimin si inspirim për shprehje kreative me mjete të arteve të tjera, riinterpretimin e përmbajtjeve të mësuara dhe krijimin e tërësive të reja muzikore.

Në mënyrë të lirë nxënësit shprehin idetë e tyre muzikore dhe përmes intepretimitinterpretimit njëherësh socializohen dhe vlerësojnë arritjet e tyre.

## MËNYRAT E VLERËSIMIT

Mësimdhënësi i cilëson dhe i vlerëson dituritë e secilit nxënës brenda grupit. Vlerësimi është punë komplekse, prandaj kërkon nga mësimdhënësi t'i ndjekë arritjet dhe ~~ndieshmërinë~~ndjeshmërinë e nxënësit gjatë dëgjimit aktiv të muzikës, interesimin për veprimtari të caktuara, pjesëmarrjen ~~active~~aktive, aftësinë për komunikim dhe kreativitet. Po ashtu duhet të vlerësohet njohja dhe përdorimi i fjalorit muzikor elementar. Vlerësimi ka rëndësi të madhe dhe mësimdhënësi i mirë do të dijë ta bëjë duke u nisur nga synimi dhe objektivat e lëndës, duke iu përmbytur metodologjisë së vlerësimit të diturive të nxënësve dhe duke e shprehur vlerësimin përmes notës.

Format e përshtatshme të vlerësimit në lëndën e artit muzikor janë: prezentimi, këndimi, luajtja në instrument, puna seminarike, ~~përgjegjet~~përgjigjet me gojë, testi në dëgjimin e muzikës etj.

Që të arrihet cilësimi dhe vlerësimi cilësor, mësimdhënësi duhet të bazohet në kërkesat profesionale didaktike dhe psikologjike. Ai duhet të aplikojë mënyra të ndryshme vlerësimi, t'i respektojë ndryshimet individuale, të jetë ~~konsequent~~konsekuent dhe objektiv, i durueshëm, ta programojë punën dhe ta bëjë notimin publik.

Varësisht nga përmbytja dhe mënyra e mësimnxënies, do të rezultojë edhe suksesi. Nuk duhet të ~~vlersohet~~vlerësohet aq niveli i reprodukimit sa ai i *të kuptuarit dhe të aplikuarit e diturive*. Mësimdhënësi përmes cilësimit dhe vlerësimit merr informacione kthyesë mbi vlerat dhe qëndrimet e nxënësve (qëndrimin ndaj muzikës, gatishmërisë për ta pranuar të ndryshmen).

Baza e notimit është pranimi (përjetimi) dhe njohja e veprave muzikore.

Nxënësit që përcaktohen për lëndë të zgjedhur nga lënda arti muzikor, cilësohen dhe ~~vlersohen~~vlerësohen në mënyrë të ~~vecantë~~veçantë, duke mos e trajtuar këtë si selektim por si orientim.

## ARRITJET E ZHVILLIMIT MUZIKOR

- Në mësimdhënien e muzikës në këtë nivel nxënësit udhëzohen dhe ndihmohen për përzgjedhje të literaturës muzikore përkatëse.

- Veprimtaritë interpretuese ngrisin nivelin e shkathtësive muzikore-psikomotorike dhe të aftësive muzikore (veshin muzikor dhe **aftësinë** për formësim estetik).
- Përvojat e reja të nxënësve u mundësojnë njohjen e zhvillimit të krijimtarisë muzikore në epoka dhe në lëmenj të ndryshëm. Në mënyrë kritike vlerësojnë pozitën aktuale të artit muzikor.
- Zgjerojnë njohuritë mbi ndërlidhjen e muzikës me artet dhe lëmenjtë e tjerë.

## NDËRLIDHJA MES LËNDËSH

Veprimtaritë dhe përmbajtjet në lëndë arti muzikor ndërlidhen thuajse me të gjithë lëmenjtë artistikë dhe shkencorë .

Në këtë drejtim lidhjet më të ngushta realizohen me artet dhe gjuhën amtare e të huaj, psikologjinë, zhvillimin historik dhe sociologjik të shoqërisë, gjeografinë, lëndët nga shkencat e natyrës, fizikën, teknologjinë, ekologjinë etj.

## REZULTATET E PRITSHME

### **Nxënësit pas realizimit të programit duhet:**

- të njohin repertorin e veprave të cilat janë bazë për dëgjim aktiv të programeve koncertale dhe të produksionit muzikor;
- të dallojnë karakteristikat themelore të veprave sipas stileve, gjinive, zhanreve, formave dhe përmbajtjeve;
- të njohin informacionet themelore mbi krijuesit dhe interpretët dhe shprehjet elementare muzikore;
- varësisht nga mundësitë dhe përcaktimet e nxënësve, të realizojnë detyrat krijuese të propozuara.

## FORMAT E **VEÇANTA** TË MËSIMDHËNIES MUZIKORE

Puna me kor dhe orkestër është formë e **veçantë** dhe e obligueshme e edukimit muzikor në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Në kor dhe në orkestër marrin pjesë nxënësit me aftësi muzikore të theksuara dhe në bazë të interesit të tyre.

Këto forma të mësimdhënies muzikore paraqesin nivel të lartë të interpretimit muzikor dhe e përfaqësojnë shkollën në të gjitha shfaqjet publike në shkollë dhe jashtë saj.

Puna me korin dhe orkestrën e shkollës, si bazë për formimin e jetës artistike, do të jetë e planifikuar dhe e matshme me orar. Mund të formohen kore të niveleve të ndryshme, ora në kor zgjat sa ora ~~më~~ simoremësimore, 45 minuta.

## **HYRJE**

Në nivelin e tretë të shkollimit, domethënë në shkollën e mesme të lartë (klasa X-XII), lënda e artit figurativ, në një sistem të përbashkët me lëndët e tjera, është përqendruar në përgatitjen e të rinjve që të marrin përgjegjësinë për jetën e tyre, të inkuadrohen në shoqëri si qytetarë aktivë e kompetentë dhe të angazhohen me sukses në tregun e punës.

**Në këtë kontekst, lënda e artit figurativ duhet t'u mundësojë nxënësve që:**

- të zbatojnë njohuritë e tyre, duke krijuar shprehje origjinale të artit figurativ
- të zhvillojnë shkathtësitë e komunikimit, duke komunikuar dhe duke shprehur opinionet personale nëpërmjet gjuhës figurative dhe
- të kultivojnë shijen artistike, duke analizuar veprat e veta dhe të të tjerëve dhe duke ndërlidhur përvojat artistike me përvojat e tjera që u ofrohen në shkollë dhe në jetën e përditshme

**Programi i lëndës së artit figurativ është bazuar në:**

- **objektiva** të cilët përcaktojnë ato që duhet të synojnë mësuesit,
- rezultatet e pritura, të cilat definojnë ato që nxënësit duhet t'i dinë dhe ato që nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i bëjnë pas përfundimit të klasës së dhjetë dhe
- në proces, duke dhënë orientime për çështjet që duhet të trajtohen dhe aktivitetet që duhet të
- zhvillohen për realizimin sa më efektiv të objektivave dhe për arritjen e rezultateve të pritura.

Rëndësi e posaçme duhet t'i kushtohet ndërlidhjes me lëndët e tjera, duke pasur qasje integrale ndaj zhvillimit të procesit mësimor. Realizimi i lëndës së artit figurativ lidhet ngushtë:

- me lëndët shoqërore, për sa i përket kulturës së përgjithshme;
- me lëndët shkencore, për sa i përket vizuelizimit të koncepteve dhe materializimit të ideve;
- me gjuhët, për sa i përket zgjerimit të mundësive të komunikimit (relacionet e komunikimit **verbal dhe joverbal - konceptet, shenjat, simbolet etj.**)

## **QËLLIMET**

Qëllimi i lëndës së artit figurativ është të përforcojë njohuritë mbi elementet figurative dhe mbi parimet e artit si dhe të zhvillojë shkathtësitë themelore për aplikimin e tyre.

Vëmendje e posaçme i kushtohet artit dy dhe tredimensional, historisë së artit, kritikës artistike dhe estetike.

## **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

- I. Përvetësimi i njohurive dhe zhvillimi i shkathtësive artistike
- II. Zhvillimi i shprehjes figurative dhe i aftësive të paraqitjes
- III. Kultivimi i aftësive për vlerësim figurativ-estetik

## **PËRMBAJTJA PROGRAMORE**

- I. PËRVETËSIMI I NJOHURIVE DHE ZHVILLIMI I SHKATH-TËSIVE ARTISTIKE (14 orë)

Nxënësit përvetësojnë konceptet figurative dhe njohuritë për rolin dhe zhvillimin historik të arteve figurative.

### **1.1. Konceptet dhe fjalori artistik**

- Sqarimi i koncepteve
- Pasurimi i fjalorit artistik

## **1.2 Stilet e artistëve, të kulturave dhe të periudhave të ndryshme historike**

- Periudhat historike
- Stilet
- Kulturat

**Parahistoria, Arti egjiptian, Lindja e Afërt e vjetër, Arti i Egjeut, Arti grek, Skulptura klasike, Arti etrusk, Arti romak, Arti bizantin-shekulli i mesëm, Arti islam, Arti romanik, Arti gotik**

## **II. ZHVILLIMI I SHPREHJES FIGURATIVE DHE I AFTËSIVE TË PARAQITJES (14 orë)**

Nxënësit përvetësojnë teknikat, materialet, aplikojnë shkathtësitë artistike, shprehen dhe komunikojnë në gjuhën figurative.

### **2.1. Elementet figurative (vija, forma, tekstura, ngjyra, valeri, dritë-hija)**

- Laps
- Thëngjill
- Tush i laviruar
- Teknikë e kombinuar  
Aplikim-natyrë e qetë

### **2.2. Hulumtimi i medimeve të ndryshme duke shfrytëzuar parimet e kompozicionit (ritmi, baraspesha, lëvizja, kontrasti, harmonia)**

- Pikturë
- Kolazh
- Mozaik
- Vitraj  
Aplikim-tema sipas imagjinatës

### **2.3. Komponimi figurativ dhe formësimi nëpërmjet krijimeve në dy dhe tri dimensione**

- Modelim
- Reliev
- Grafikë
- Qeramikë



- Skulpturë
- Multimedie
- Disenj grafik

Për skulpturë/modelim-Aplikim në materiale të ndryshme (plastelinë, letër, metal, mellë, dru apo materiale të tjera)

Për disenj grafik - aplikim në teknika të ndryshme (pllakat, kopërtinë libri, Ilustrime të poezisë dhe të prozës)

#### **2.4. Shprehja e ideve ose e ndjenjave nëpërmjet artit figurativ**

#### **2.5. Planifikimi dhe aplikimi i njohurive dhe i shkathtësive artistike**

### III. KULTIVIMI

#### I AFTËSIVE PËR VLERËSIM FIGURATIV-ESTETIK (9 orë)

Nxënësit analizojnë, hulumtojnë dhe nxjerrin kuptime nga veprat artistike, përfshirë edhe punimet personale në bazë të elementeve figurative, parimet e formësimit dhe kualitetet

#### **3.1 Analiza dhe debate duke nxjerrë kuptime për vlerat e punimit figurativ**

- Shpjegim
- Analizë
- Interpretim
- Debat

#### **3.2. Shkrime eseistike dhe opinione personale për veprat figurative apo për ngjarjet artistike**

- Përkufizimet personale për artin apo për lëmin figurativ (shembujt që e mbështesin përkufizimin)
- Raporte, shkrime për veprat figurative ose për ngjarjet kulturore
- Opinionet personale mbi veprat artistike dhe mbi kritikën e artit

#### **3.3. Organizimi i paraqitjeve dhe i ekspozitave**

- Ekspozitat personale
- Ekspozitat e përbashkëta
- Ekspozitat tematike

### **3.4. Vizita ekspozitive, muzeve, galerive**

- Vizita në galeri
- Muze
- Paraqitje
- Ngjarje kulturore

## **UDHËZIME METODOLOGJIKE**

**Gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, është mirë që mësimdhënësit t'i kenë parasysh edhe këto parime metodologjike:**

- Nga e njohura drejt së panjohurës
- Kujdesi për përshtatjen metodiko-didaktike me aftësitë psikofizike të tipave figurativë
- Nxënësi në qendër – arsimtari orienton
- Zgjedhja e temave – motiveve, teknikave dhe materialeve të punës adekuate të përshtatur me gjithë elementet e tjera: psikosociale, etnotradicionale, festive e kohore.
- Roli aktiv i pedagogut si mentor interaktiv dhe konjitiv.
- Motivimi i nxënësve dhe kreativiteti individual
- Vlerësimi kolektiv i vlerave të punës praktike figurative (shpjegim dhe interpretim).

## **FORMAT E PUNËS**

- a) Puna në grupe
- b) Puna në çifte
- c) Puna individuale
- ç) Puna frontale
- d) Puna mediale

## **MOTIVIMI:**

- a) Rrethi jetësor – hapësinor
- b) Inteligjenca imagjorative
- c) Mediet me informacion artistik
- ç) Dukuritë dhe ngjarjet

- d) Literatura shkollore
- dh) Galeritë – muzetë
- e) Garat nëpërmjet ekspozitave
- ë) Ekskursion dhe biseda interaktive rreth kulturës së gjerë artistike.

#### VIZIONI (QASJET)

- a) Kuptimi i jetës së përditshme
- b) Imagjinata e lojës, e argëtimit dhe e kreacionit
- c) Kureshtja për të kërkuar përgjigje
- ç) Vetëdijësimi për përjetimet emocionale
- d) Besimi dhe sinqeriteti
- dh) Të drejtat dhe detyrimet
- e) Kujdesi ndaj talenteve të reja

#### VLERËSIMI

Vlerësimi është një proces i vrojtimit të vazhdueshëm, i dokumentimit të punës së nxënësve dhe ka të bëjë me çdo lloj veprimtarie dhe matjeje që përdoret për të gjykuar punën dhe arritjet e nxënësve.

Në mënyrë që të sigurohen informacione të mjaftueshme për të vlerësuar arritjet e nxënësve në lëndën e artit figurativ, duhet të përdoren mjete dhe teknika të ndryshme.

Disa qëllime të vlerësimit:

- Të identifikohet përparimi i nxënësve dhe t'u ofrohen të dhëna të mjaftueshme.
- Të motivohen nxënësit për punë
- Të sigurohen informacione për shkallën e arritshmërisë së objektivave
- Të ndihmohen nxënësit dhe mësuesit
- Të përmirësohen nxënësia dhe mësuesia
- Të sigurohen informacione për zhvillimin e nxënësve për orientimin e tyre të ardhshëm etj.

Rëndësia e këtyre qëllimeve është:

- Nëpërmjet vlerësimit mësuesit siguron informacione sa ka qënë e suksesshme mësuesia e tij për të arritur rezultate të caktuara dhe në bazë të arritjeve të tyre mësuesit t'u ofrojnë sqarime nxënësve dhe në të ardhmen përmbajtjet mësimore t'i planifikojë sipas nevojave të nxënësve.

Vlerësimi është i rëndësishëm për të kuptuar sa janë në gjendje nxënësit të punojnë një përmbajtje mësimore me qëllim që të organizohet më mirë puna në grupe dhe për të provuar në çfarë mase i kanë përvetësuar njësitë e mësuara. Në bazë të këtyre të identifikohen nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë dhe të bëjnë përforsimin e atyre njësive.

### **Me rastin e vlerësimit merren parasysh këto kritere:**

- Përvetsimi i koncepteve dhe demonstrimi i aplikimit të tyre.
- Shkathtësitë e paraqitjes.
- Aftësitë e vlerësimit dhe të analizës (për punën personale dhe të të tjerëve).
- Kreativiteti dhe origjinaliteti.
- Dosja (portfolio) e punimeve-aktiviteteve personale.
- Prirja personale e zhvillimit të shkathtësive.
- Koha për kryerjen e detyrave
- Saktësia dhe përpikëria në afate.
- Puna sipas detyrave dhe parametrave.

### **Rezultatet e pritshme**

Nxënësit duhet të kenë përfituar dije nga lënda e artit figurative, që u nevojitet për të qenë të aftë të shprehin ndjenjën artistike, të menaxhojnë situata si dhe të zgjidhin probleme me të cilat rëndom ballfaqohen në jetën e përditshme dhe që u nevojiten si bazë për arsimimin e mëtutjeshëm.

Brenda këtij planprogrami nxënësi duhet:

- të ketë të zhvilluar të kuptuarit mbi artin në përgjithësi, t'i njohë: vijat, ngjyrat, kombinimin e tyre, te vizatorjë, të pikturojë dhe të skulpturojë,
- të aftësohet mirë dhe të jetë në gjendje të vlerësojë dhe të përjetojë veprat artistike,
- të aftësohet për të përdorur mjete të cilat nevojiten për krijimin e veprave artistike, si: pikturë, grafikë, disenj, vitraj, mozaik, skulpturë, relief, torzo,
- të aftësohet të riprodhojë dhe të përshkruajë vepra artistike,
- të aftësohet të interpretojë domethënien apo ndjeshmërinë që përjeton në veprat artistike,
- të aftësohet të zhvillojë të kuptuarit, të shprehurit dhe imagjinatën.

TEKSTET DHE MJETET MËSIMORE

- Xhonson**, *Historia e artit*  
**Harvard Arnasona**, *Historia e artit modern*  
**Grup autorësh**, *Arti bashkëkohor i Kosovës*  
**Muharremi, H.** *Kultura figurative kl. II*  
**Goci, R.** *Kultura figurative kl. VII, VIII*  
**Goci, R.** *Edukatë estetike kl. I (për shkollat e mesme)*  
**Muriqi, N.** *Baraspesha estetike*  
**Muriqi, N.** *Kultura figurative kl. V – VI*  
**Nimani, Sh.** *Shqyrtime artistike*  
**Emërllahu, D.** *Edukata estetike*  
**Gaxholli, E.** *Mjeshtrit e pikturës*

---

## **TEKNOLOGJIA E INFORMIMIT DHE E KOMUNIKIMIT**

---

### **HYRJE**

Teknologjia e informimit dhe e komunikimit - TIK për klasën e dhjetë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake nga kjo fushë. Kjo lëndë nxënësit i familjarizon me teknologjitë moderne të informimit dhe të komunikimit siç janë: puna me kompjuter, puna me pajisjet tjera përcjellëse: DVD, skaneri, aparati digjital, kamera digjitale, etj., demonstrimi i shkathtësive në përdorimin e këtyre pajisjeve dhe programeve përkatëse. Përfshinë gjithashtu sistemet që mundësojnë grumbullimin, organizimin, ruajtjen, përdorimin dhe transmetimin e informacioneve në forma të ndryshme. Kjo përfshin komunikimet audio (zëri) dhe video (grafika), si dhe përdorimin e multimedive interaktive.

Në klasën e dhjetë nxënësit gjithashtu marrin dituri nga programi aplikativ për përpunim tabelar dhe grafik të të dhënave, mundësitë multimediale në sistemet kompjuterike si dhe nga programi aplikativ për përgatitjen e prezentimeve.

### **QËLLIMET**

Qëllimet kryesore të mësimin të TIK-ut tek nxënësit janë:

- Zhvillimi dhe thellimi i njohurive në lëminë e TIK-ut dhe rëndësia e saj në shërbim të njeriut.
- Krijimi i shprehive dhe shkathtësive gjatë punës teorike dhe praktike, aftësive të kërkimit të informacioneve nga fusha e TIK-ut.
- Tabelat, grafikët dhe vizatimi me përdorimin e programeve aplikative kompjuterike janë gjithashtu thelbësore në praktikat teknologjike për përcaktimin dhe sqarimin e ideve dhe zgjidhjeve të propozuara.
- Fuqizimi për t'i kontribuar shoqërisë teknologjike.

## **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME**

Objektivat e përgjithshme të mësimit të lëndës mësimore TIK janë:

- Të njohë nxënësit me dimensionin e TIK-ut në veprimtarinë e njeriut.
- Të zhvillojë mundësitë për lidhjen e teorisë me praktikën në fushën e TIK-ut në veprimtarinë e njeriut.
- Të ushtrojë përdorimin e mjeteve, procedurave dhe teknikave kompjuterike me qëllim të zgjidhjes së problemeve në mënyrë krijuese në situatat e jetës së përditshme.
- Që nxënësit të jenë në gjendje t'i përdorin aplikacionet softverike (EXCEL; POWER POINT) për realizimin e tabelave, grafikëve, administrimin e të dhënave, prezenteve, datotekave.
- T'i njohin mundësitë e pajisjeve multimediale që komunikojnë përmes kompjuterit dhe të jenë në gjendje t'i përdorin kombinimin e tyre në funksion të një prezantimi multimedial.

OBJEKTIVAT E VEÇANTA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	STANDARDET E ARRITSHMËRISË	UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<b>Programi aplikativ për përpunim tabelar dhe grafik të të dhënave: <u>MS EXCEL</u></b> <b>Tema 1: Libri i punës dhe fleta e punës në Excel</b>				
<b>Fondi i orëve: 4</b>				
Njohja me programin Excel. Njohja me librin e punës dhe fletën e punës në Excel.	Hyrje në programin Excel. Kuptimi i tasteve në toolbarin e Excel-it. Lëvizja nëpër fletën e punës. Futja dhe korigjimi i të dhënave në formë: teksti, numrash dhe formulash. Emërtimi dhe ruajtja e një pune në Excel. Shtypja e një flete pune. Dalja nga Exceli.	Dituri të përvetësuar në kryerjen e operacioneve themelore me librin e punës dhe fletën e punës në programin e Excel-it.	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i mënyrës së ekzekutimit të operacioneve. Puna individuale dhe grupore.	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze Matematikë
<b>Tema 2: Ndërtimi i një flete pune (worksheet-i)</b>				
<b>Fondi i orëve: 4</b>				
Njohja me mënyrën e ndërtimit të një flete pune (worksheet-i)	Fillimi i një dokumenti të ri. Puna me kufijtë. Lëvizja e përmbajtjes së celulave. Kopjimi i	Shkathësi të përvetësuar në kryerjen e operacioneve	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i mënyrës së ekzekutimit të	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze Matematikë



	përmbajtjes së celulave. Fshirja e përmbajtjes së celulave, shtimi ose heqja e celulave. Shtimi ose heqja e shtyllave dhe rreshtave si dhe ndryshimi i gjerësisë së shtyllave dhe gjatësisë së rreshtave.	themelore me të dhënat në celula dhe veprimet me shtylla dhe rreshta.	operacioneve. Puna individuale dhe grupore.	
<b>Tema 3: Formatimi i një flete pune (worksheet-i)</b>				
<b>Fondi i orëve: 8</b>				
Njohja me mundësitë e programit të Excel-it në formatimin e fletëve të punës.	Lëvizja nëpër fletë të punës brenda librit të punës. Përdorimi i mënyrës <b>Help</b> për Excel. Përdorimi i opsioneve: <b>Number, Font, Align, Border</b> dhe <b>Pattern</b> nga menyja <b>Format</b> .	Shkathësi të përvetësuar në kryerjen e operacioneve që kanë të bëjnë me formatin e fletëve të punës.	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i mënyrës së ekzekutimit të operacioneve. Puna individuale dhe grupore	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze
<b>Tema 4: Formulat dhe funksionet</b>				
<b>Fondi i orëve: 8</b>				
Njohja me formulat dhe funksionet që përdoren në programin e Excel-it.	Kuptimi i formulave. Shkruarja dhe ekzekutimi i formulave të zakonshme me Excel. Çka është funksioni.	Dituri të përvetësuar në lidhje me formulat dhe funksionet elementare të programit të Excel-it	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i mënyrës së ekzekutimit të operacioneve. Puna	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze Matematikë Fizikë

	Lista e funksioneve që përmban Exceli. Përdorimi i disa funksioneve elementare. Përdorimi i tastit <b>AutoSum</b> .	dhe demonstrimi i shkathtësive në përdorimin e disa prej tyre.	individuale dhe grupore.	
<b>Tema 5: Administrimi i një libri pune (workbook)</b>				
<b>Fondi i orëve: 4</b>				
Njohja me mundësitë e administrimit të një libri pune (workbook).	Riemërtimi i fletëve punuese brenda librit të punës. Lëvizja dhe kopjimi i fletëve të punës brenda librit të caktuar. Heqja dhe shtimi i fletëve të punës nga libri i punës. Përdorimi i komandës <b>Zoom</b> . Përdorimi i opcionit <b>Print Preview</b> . Ndarja e një flete pune në faqe. Shtypja e një flete pune (Print).	Dituri të përvetësuar në lidhje me administrimin e librit të punës dhe demonstrimi i shkathtësive në përdorimin e opsioneve të theksuara në përmbajtje.	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i mënyrës së ekzekutimit të operacioneve. Puna individuale dhe grupore	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze Matematikë

<b>Tema 6: Ndërtimi i grafikëve</b>				
<b>Fondi i orëve: 8</b>				
Njohja me mundësitë e paraqitjes grafike të të dhënave numerike të sistemuara në një fletë pune.	Tipat e ndryshëm të grafikëve. Krijimi i grafikëve në fletë të njëjtë të punës ose jo. Krijimi i tipave të ndryshëm të grafikëve. Zmadhimi dhe rregullimi i formatit të grafikëve. Shtypja e grafikëve.	Dituri të përvetësuar në lidhje me llojet e grafikëve dhe demonstrimi i shkathtësive në ndërtimin e grafikëve më të përdorshëm.	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i ekzekutimit të operacioneve, puna individuale dhe grupore	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze Matematikë
<b>Tema 7: Administrimi i të dhënave</b>				
<b>Fondi i orëve: 6</b>				
Njohja me mundësitë e administrimit të të dhënave.	Kuptimi i një Database (Regjistri). Ndërtimi i një Database. Përdorimi i komandës <b>Form</b> nga menyuja <b>Data</b> . Shtimi i një regjistrimi të ri në Database. Heqja e një regjistrimi nga Database. Përdorimi i komandës <b>Dataform</b> për të kërkuar një regjistrim. Përdorimi i opcionit <b>AutoFilter</b> .	Dituri të përvetësuar në lidhje me kuptimin e Database dhe demonstrimi i shkathtësive në administrimin e një Database të krijuar nga vetë nxënësi.	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i ekzekutimit të operacioneve, puna individuale dhe grupore.	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze

<b>MULTIMEDIA</b>				
<b>Tema 8: Mundësitë multimediale në sistemet kompjuterike</b>				
<b>Fondi i orëve: 10</b>				
Njohja me mundësitë e veprimeve multimediale. Njohja me pajisjet multimediale dhe programet për ekzekutimin e veprimeve multimediale.	Njohuri të përgjithshme mbi multimediat. Instalimi dhe demonstrimi i veprimeve me pajisjet multimediale: DVD, skaneri, aparati digjital, kamera digjitale, etj. Programet: Windows Media Player dhe Windows Movie Maker.	Dituri të përvetësuar në lidhje me multimediat dhe demonstrimi i shkathtësive në përdorimin e pajisjeve multimediale dhe programeve përkatëse.	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i ekzekutimit të operacioneve, puna individuale dhe grupore.	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze Edukatë muzikore Art
<b>Programi aplikativ për përgatitjen e prezentimeve: <u>MS POWERPOINT</u></b>				
<b>Tema 9: Njohuri fillestare për programin PowerPoint</b>				
<b>Fondi i orëve: 6</b>				
Njohja me veprimet fillestare për punë me programin e PowerPoint-it.	Startimi i Powerpoint-it. Krijimi i një prezantimi me <b>Autocontent Wizard, Design Template</b> dhe <b>Blank presentation</b> . Format e ndryshme të pamjes së prezantimit në ekran ( <b>NORMAL VIEW, OUTLINE</b>	Dituri të përvetësuar në lidhje me programin PowerPoint. Demonstrimi i shkathtësive në ekzekutimin e veprimeve elementare me këtë program. Paraqitja e prezantimit të secilit nxënës.	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i ekzekutimit të operacioneve, puna individuale dhe grupore. Krijimi i prezentimeve vetanake.	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze

	<b>VIEW, SLIDE VIEW, SLIDE SORTER VIEW).</b> Lëvizja nëpër prezentim përmes shiritit rrëshqitës. Ruajtja e një prezentimi ( <b>Save</b> ). Hapja e prezentimit të ruajtur më parë. Dërgimi i prezentimit në E-mail.	Shkëmbimi i përvojave në mes të nxënësve bazuar në krahasimin e prezentimeve të tyre.		
<b>Tema 10: Editimi i faqeve (slides) të një prezentimi</b>				
<b>Fondi i orëve: 6</b>				
Njohja me mundësitë e përpunimit të faqeve të një prezentimi.	Selektimi i tekstit. Insertimi i tekstit. Fshirja e tekstit. Anulimi i ndryshimeve. Lëvizja e tekstit. Ndryshimi i rëndësisë së tekstit në faqe. Ndërrimi i fondit të tekstit. Rregullimi i madhësisë së tekstit. Ndërrimi i ngjyrës së tekstit, etj. Krijimi i faqeve të reja të prezentimit.	Paraqitja e përmirësimit të prezentimeve nga secili nxënës, në bazë të njohurive të fituara nga kjo temë (editimi i teksteve). Shkëmbimi i përvojave në mes të nxënësve bazuar në krahasimin e prezentimeve të tyre.	Ligjërimi i përmbajtjes programore. Demonstrimi i punës me prezentime të ndryshme. Puna individuale dhe grupore.	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze

<b>Tema 11: Vendosja dhe organizimi i objekteve në faqet e një prezentimi</b>				
<b>Fondi i orëve: 6</b>				
Njohja me mundësitë e vendosjes së objekteve në faqet e një prezentimi dhe organizimi i tyre brenda faqes.	Përdorimi i opcionit <b>Slide Layot</b> . Vendosja e formave të gatshme ( <b>Autoshape</b> ). Efektet e teksteve me opcionin <b>WordArt Gallery</b> . Përdorimi i opcionit <b>Clip Art</b> . Përdorimi i grafikëve. Lëvizja dhe ndryshimi i përmasave të një objekti.	Paraqitja e përmirësimit të prezentimeve nga secili nxënës, në bazë të njohurive të fituara nga kjo temë (pasurimi i prezentimeve me objekte të ndryshme). Shkëmbimi i përvojave në mes të nxënësve, bazuar në krahasimin e prezentimeve të tyre.	Ligjërimi i përmbajtjes programore. Demonstrimi i punës me prezentime të ndryshme. Puna individuale dhe grupore.	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze
<b>Tema e 12: Animacionet dhe tranzicioni i faqeve (slajdeve)</b>				
<b>Fondi i orëve: 4</b>				
Njohja me mundësitë e animacioneve dhe tranzicionit të faqeve të një prezentimi.	Riorganizimi i faqeve dhe përdorimi i opcionit <b>Custom Shows</b> . Animacioni i objekteve në faqet e një prezentimi përmes opcionit <b>Custom Animation</b> . Tranzicioni i faqeve ( <b>Slide Transitions</b> ). Paraqitja e prezentimeve në ekran me opcionin <b>View show</b> .	Paraqitja e versioneve përfundimtare nga secili nxënës, në bazë të njohurive të fituara nga kjo temë (Vendosja e animacioneve të objekteve dhe tranzicionit të faqeve). Shkëmbimi i përvojave përfundimtare në mes të nxënësve, bazuar në krahasimin e prezentimeve të tyre.	Ligjërimi i përmbajtjes programore. Demonstrimi i punës me prezentime të ndryshme. Puna individuale dhe grupore.	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze

## **VLERËSIMI**

Vlerësimi i të nxënësve bëhet në këto mënyra:

1. Çmuarja e angazhimit të nxënësve gjatë realizimit të përmbajtjes programore
2. Çmuarja e punës individuale në punë me kompjuter
3. Çmuarja e kontributit në punën grupore
4. Testimi gjatë procesit mësimor
5. Vlerësimi i detyrave dhe projekteve individuale kompjuterike

## **UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TJERA MËSIMORE**

### **Literatura e propozuar**

1. “Kompjuterët dhe Informatika”, për nxënësit e kl. I të shkollës së mesme, autorë Dr. Agni Dika, Mr. Seb Rodiqi
2. “Kompjuteri për të gjithë”, autorë Dr. Agni Dika, Seb Rodiqi
3. “Programe Kompjuteri“, autor Harallamb Papakroni
4. Literatura në gjuhën angleze për: MS Office 97, MS Office 2000, MS Office XP, etj.
5. Udhëzimet e integruara në MS Office, etj.

### **Pajisjet dhe parakushtet tjera të nevojshme**

1. Kabineti me kompjuterë, shtypës dhe pajisje multimediale (DVD, skaneri, aparati digjital, kamera digjitale, etj.)
2. Aplikacionet e nevojshme softverike
3. Lidhja në Internet, rrjeti lokal në kabinet
4. Trajnime për arsimtarë
5. Mirëmbajtja

### **Kushtet minimale**

1. Një kompjuter në shkollë për demonstrim të programit mësimor
2. Trajnime për arsimtarë

## **VËREJTJE:**

Nëse shkolla nuk ka kompjuterë, të potencohen aspektet teorike të temave të parapara në program dhe të bëhet demonstrimi i tyre nëse shkolla ka së paku një kompjuter.

Në fondin e paraparë të orëve janë të përfshira ligjërimi, përforcimi i lëndës dhe testimi i nxënësve.

Nëse shkolla nuk ka kompjuterë propozohet që fondit i orëve të shpërndahet në temat tjera për të cilat këto kushte nuk janë të nevojshme.

### **UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME**

1. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore, p.sh. ligjërimi 25%, demonstrimi 25%, puna individuale dhe grupore 50%.
2. Ligjërimi i përmbajtjes programore (25% e orës) duhet domosdoshmërisht të bëhet me anë të prezentimeve kompjuterike e jo përmes tabelës, ndërsa ligjëratat që kanë të bëjnë me pjesët hardverike domosdo duhet të shoqërohen edhe me prezentimin vizual të tyre.
3. Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimit të dijes dhe shkaktësive ( puna interaktive).

Përsëritja e përmbajtjes përmes detyrave që përfshijnë zbatimin e më shumë njohurive të fituara.

### **ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR**

1. Puna grupore dhe individuale
  - 1.1. Krijimi i dokumenteve më të përbëra: prezentimeve të avancuara në programin e PowerPoint-it.
  - 1.2. Zgjidhja e problemeve matematikore me përdorimin e programit MS Excel.
  - 1.3. Publikimi i prezentimit më të mirë në PowerPoint



## **HYRJE**

Edukimi fizik dhe sportiv është një proces i domosdoshëm i pasurimit të njohurive, zhvillimit të aftësive dhe mjet i rëndësishëm për formimin e tipareve të personalitetit dhe të marrëdhënieve ndërmjet pjesëmarrësve.

Prandaj duhet insistuar, që përmes qëllimeve të zgjedhura, përmbajtjeve, metodave dhe formave të punës, të arrihet zhvillimi i drejtë psikosocial i të rinjve, relaksimi dhe kompensimi i ndikimeve negative të qëndrimit të gjatë ulur. Në synimin për zhvillim të shëndoshë, e kultivojmë dhe e mësojmë, në mënyrë që, në të gjitha fazat e jetës, të pasurohet koha e lirë me përmbajtje sportive. Me mënyrën e shëndoshë të jetës do të ndikohet në formimin e ndjenjës së mirë, në shëndet, në vitalitet dhe në optimizmin për jetë. Për nxënësit me aftësi të kufizuara (- 3 sigma) dhe për nxënësit e talentuar (+ 3 sigma) duhet të sigurohet trajtim i posaçëm përmes aktiviteteve lëvizore pesë herë në javë. Me nxënësit me aftësi të kufizuara duhet punuara përmes lëvizjeve korrigjuese. Ndërkaq nxënësit e talentuar duhet grupëzuar në paralele sportive, ku do të formohet së paku një paralele në çdo qendër komunale.

## **QËLLIMET**

Mjetet në edukimin sportiv orientues veçanërisht në:

- zhvillimin e aftësive lëvizore dhe funksionale të adaptuara sipas sporteve të ndryshme;
- dituria dhe aftësia për disa sporte;
- të kuptuarit e drejtë të rëndësisë së marrjes me sport për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit;
- përjetime pozitive në sport për pasurimin shpirtëror;
- relaksimi dhe largimi nga lodhjet e përditshme shkollore;
- mjet për zhvillim harmonik dhe shëndetsor;

- sporti dhe edukimi fizik, si dhe ushqimi i shëndoshë të ndikojnë në jetë të shëndoshë;
- marrëdhëniet në sport të jenë të shëndosha, sjelljet sportive të jenë me respekt (Fair Play);
- përjetimi i kënaqësisë në sport, formimi dhe zhvillimi i qëndrimit të drejtë;
- zhvillimi i këmbëgultësisë përmes aktiviteteve aerobe;
- zhvillimi i vetëbesimit gjatë pjesëmarrjes në sport, gjatë orës së mësimi;
- formimi i krijimtarisë lëvizore;
- kultivimi dhe ruajtja e ambientit dhe rrethit;
- të zhvilluarit e ndjenjes për vlerësimin dhe ruajtjen e traditës dhe të trashëgimisë kulturore;
- me forma dhe metoda të ndryshme të ndihmojmë në zhvillimin e sjelljeve pozitive në sport, në përjetimet dhe kënaqësitë në sport, në pjesëmarrje dhe ndihma të ndërsjella, në stabilitetin psikik të zhvillimit të shoqërimin.

## **OBJEKTIVAT**

Në secilën fazë të shkollimit objektivat janë të përfshira në katër grupe:

- zhvillimi i trupit dhe aftësive lëvizore dhe atyre funksionale;
- përvetësimi dhe sendërtimi i diturisë sportive;
- të mësuarit e karakteristikave teorike

përjetimet e këndëshme sportive, formimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm duke krijuar një baraspeshë.

### **Zhvillimi i trupit, aftësive lëvizore dhe funksionale**

- zhvillimi i aftësive lëvizore (forca, shpejtësia, koordinimi i lëvizjeve, fleksibiliteti, baraspesha dhe saktësia)
- zhvillimi i aftësive funksionale (qëndrueshmëria aerobe dhe anaerobe) para së gjithash jashtë orëve të mësimi me lëvizje të ndryshme të qëndrueshmërisë (shtigjet, shtigjet me ski, not, ecje në natyrë, shtigjet e orientimit etj.) me matjet e frekuencës së zemrës me programe individuale)
- me ushtrime adekuate me kultivue mbajtjen e drejtë të trupit
- formimi lëvizor i fleksibilitetit dhe aftësitë funksionale për rëndësinë trupore

### **Përvetësimi dhe sendërtimi i diturisë sportive**

- të mësuarit dhe plotësimi i elementeve bazike në atletikë dhe gjimnastikë
- sendërimi tekniko-taktik i lojrave sportive që t'i mundësoj suksese në situata të ndryshme të lojrave
- ekzekutimi i lëvizjeve të ndryshme harmonike dhe estetike me përcjellje muzikore
- krijimi i disponimit me lëvizje apo ndjenjes së mirë
- të mësuarit e teknikave të vallezimit
- sendërtimi i teknikes së notit
- njoftimi, të mësuarit dhe sendërtimi i sporteve të zgjedhura

### **Të mësuarit teorik të karakteristikave (teorike)**

- ndikimi i sporteve të ndryshme në shëndet dhe në ndjenjë të mirë
- me e kuptuar pjesmarrjen e organizmit me ngarkesë
- ndikimi i lëvizjeve në përgatitjen e qëndrueshmërisë
- të kuptojë parimet themelore të rëndësishme në sport
- ta kuptojë rolin e sportit si preventive ndaj devijimeve të ndryshme

### **Përjetimi i këndshëm i sportit, formimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm**

- formimi i raportit përgjegjës deri në shëndetin e duhur (aktivitete të ndryshme në sport, në shkollë, në orë të edukimit fizik, kultivimi i trupit, ushqimi i shëndoshë)
- të zhvillojë qëndrueshmërinë në orë të edukatës fizike, por edhe lëvizje aerobe (vrapime në natyrë, vrapime me ski, noti, ecjet në natyrë, vrapimi orientues, etj.

### **PËRMBAJTJA PROGRAMORE**

1. Teoria e edukimit Fiziko-Sportiv	3 orë
2. Vlerësimi i aftësive lëvizore	4 orë
3. Atletikë	8-10 orë
4. Gjimnastikë sportive dhe ritmike	12-16 orë
5. Sportet kolektive	34 orë
6. Sportet individuale:	
- sportet luftarake	6-10 orë
- sportet me raketë	4-8 orë
7. Noti	7-10 ditë
8. Shëtitjet	2 ditë në vit
9. Gara sportive së paku në dy sporte (sipas kushteve)	

<b>TËRËSITË MËSIMORE</b>	<b>PËRMBAJTJA PROGRAMORE</b>	<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b>	<b>REZULTATET QË DUHET ARRITUR</b>	<b>LIDHMËRIA ME LËNDËT TJERA</b>
<b>1. TEORIA E EDUKIMIT FIZIKO-SPORTIV</b>	Aktivitet e nxënësve gjatë mësimit të edukatës fizike dhe sportit	Format e punës frontale metoda e punës verbale	Ngritja e vetëdijes së nxënësve për aktivitete trupore	Gjuha amëtare Edukimi shëndetësor
<b>2. VLERËSIMI I AFTËSIVE MOTORIKE</b>	Matjet antropometrike dhe aftësive psikomotorike	Forma e punës në grup, metoda verbale dhe e demonstrimit	Shkalla e përparimit (vlerësimi fillestar dhe përfundimtar i veçorive antropometrike dhe lëvizore)	Matematika Edukimi shëndetësor
<b>3. ATLETIKË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nisjet dhe përshpejtimi</li> <li>Vrapimi në 80 m, 600m, F dhe 1000 m</li> </ul>	Forma e punës grupore dhe individuale	Të dinë nisjen e ulët dhe të lartë, teknikën e vrapimit të shpejtë dhe të qëndrueshëm. Të dinë të vrapojnë në mënyrë të koordinuar me tempo të caktuar	Matematika Biologjia
<ul style="list-style-type: none"> <li>Ecejtes dhe vrapimet</li> <li>Kërcimet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kërcim së gjati “trupi në hark”</li> <li>kërcim së larti “barkushë”</li> </ul>	Forma e punës grupore dhe individuale Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit, sintetike dhe e ilustrimit	Të dinë teknikën e kërcimit së largu dhe së larti me vrull	Biologjia Fizika
<ul style="list-style-type: none"> <li>Hedhjet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hedhja e tophave deri 200 gr. nga vendi dhe me hov, në cak dhe në largësi</li> <li>Hedhja e topave medicinalë</li> </ul>	Forma e punës Frontale dhe grupore Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit, sintetike dhe e ilustrimit	Të dinë të hedhin toptin me vrull Të dinë të shtytin topat medicinalë	Biologjia Fizika Matematika
<b>4. GJIMNASTIKA SPORTIVE DHE RITMIKE</b>	Ushtrimet në dysheme <ul style="list-style-type: none"> <li>Ekulibri ballor me kapërdim para</li> <li>Kapërdimi para nga vërtikalja mbi duar me asistim</li> <li>kapërdimi fluturimthi</li> <li>me asistim</li> <li>rrotullimi anësor “Ylli”</li> </ul>	Forma e punës frontale, në çifte dhe individuale	Nxënësit duhet të dinë kapërdimin fluturimthi, të dinë qëndrimin mbi duar, të dinë një kompozim të lirë	Fizikë

• Kërcimet:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërcimi i kaluqit këmbë-anash</li> <li>• Kërcimi i kaluqit këmbëmbledhur</li> </ul>	Forma e punës Frontale, në çifte dhe individuale	Të dinë të kërcejnë kaluqin me këmbë anash dhe këmbë të bashkuara	Fizikë
• Hekuri	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përsëritje nga klasa 9</li> </ul>	Forma e punës Frontale, në çifte dhe individuale	Të dinë të varen, kryejnë lëkundje në hekur dhe të dalin Të dinë një kompozim të lirë	Fizikë
• Paralelet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëkundje para prapa</li> <li>• Ecje me duar mbi drushta</li> </ul>	Forma e punës Frontale, në çifte dhe individuale	Të dinë hyrjen në paralele, të kryejnë lëkundje dhe qëndrim me forcë dhe të dinë një dalje të thjeshtë Të dinë një kompozim të lirë	Fizikë
• Trau Gjinnastikor	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përsëritje e elementeve nga klasa 9</li> </ul>	Forma e punës Frontale, në çifte dhe individuale  Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit, analitike dhe sintetike	Të dinë të ecin mbi tra, të bëjnë kthim, të mbajnë baraspeshën dhe t'i kombinojnë elementet në tërësi	Fizikë
• Valle popullore kombëtare dhe ndërkombëtare	Vallja: Shota <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një valle ndërkombëtare</li> <li>• Vallëzim modern</li> </ul>	Forma e punës Frontale	Të dinë të luajnë vallen me përcjellje muzikore, Të dinë vallëzimin modern	Kulturë muzikore
<b>5. SPORTET KOLEKTIVE</b>  • Futbolli	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasimet dhe pranimet me shpejtësi më të madhe</li> <li>• Driblimi- udhëheqja me kundërshtar aktiv</li> <li>• Mashtrimet me kundërshtar aktiv</li> <li>• Goditjet- gjuajtjet me pengesa</li> <li>• mbrojtja grupore dhe ekipore</li> <li>• sulmi grupor dhe ekipor</li> </ul>	Forma e punës Frontale dhe individuale Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Të dinë dinë të përdorin elementet themelore teknike dhe taktike në situatë të lojës, Të dinë në tërësi rregullat e lojërave sportive	

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hendbolli</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasimet dhe pranimet me shpejtësi më të madhe</li> <li>• Driblimi- udhëheqja me kundërshtar aktiv</li> <li>• Mashtrimet me kundërshtar aktiv</li> <li>• Goditjet- gjuajtjet me pengesa</li> <li>• mbrojtja grupore dhe ekipore</li> <li>• sulmi grupor dhe ekipor</li> </ul>	<p>Forma e punës Frontale dhe individuale</p> <p>Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit dhe sintetike</p>	<p>Të dinë dinë të përdorin elementet themelore teknike dhe taktike në situatë të lojës,</p> <p>Të dinë në tërësi rregullat e lojërave sportive</p>	Matematika
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Basketbolli</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasimet dhe pranimet me shpejtësi më të madhe</li> <li>• Driblimi- udhëheqja me kundërshtar aktiv</li> <li>• Mashtrimet me kundërshtar aktiv</li> <li>• Goditjet- gjuajtjet me pengesa</li> <li>• mbrojtja grupore dhe ekipore</li> <li>• sulmi grupor dhe ekipor</li> </ul>	<p>Forma e punës Frontale dhe individuale</p> <p>Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit dhe sintetike</p>	<p>Të dinë të përdorin elementet themelore teknike dhe taktike në situatë të lojës,</p> <p>Të dinë në tërësi rregullat e lojërave sportive</p>	Matematika
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Volejboli</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasimi i topit</li> <li>• Shërbimi dhe pranimi i tij</li> <li>• Gjuajtja nga pozicionet 4,3 dhe 2 – me bllok të kundërshtarit.</li> <li>• Blloku 1 dhe 2</li> <li>• mbrojtja grupore dhe ekipore</li> <li>• sulmi me kombinime të thjeshta (2:4).</li> </ul>	<p>Forma e punës Frontale dhe individuale</p> <p>Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit dhe sintetike</p>	<p>Të dinë dinë të përdorin elementet themelore teknike dhe taktike në situatë të lojës,</p> <p>Të dinë në tërësi rregullat e lojërave sportive</p>	Matematika
<p><b>6. SPORTET INDIVIDUALE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sportet luftarake:</li> </ul>	<p>Elementet teknike Pa kundërshtar dhe me kundërshtar</p> <p>Elementet taktike:</p>	<p>Forma e punës Frontale dhe individuale</p> <p>Metodat e punës:</p>	<p>Nxënësit duhet të dinë elementet themelore teknike dhe taktike të karatesë mundjes dhe xhudos.</p>	Biologji

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundja</li> <li>• Karate</li> </ul>	Me kundërshtar gjysmë-aktiv dhe aktiv	Gojore, e demonstrimit dhe sintetike		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sportet me raketë:</li> <li>• Pingpongu</li> </ul>	Lëvizjet e dorës dhe të këmbëve. Kapja dhe mbajtja e raketës. Goditjet themelore të topit: forhend, bekhend, shërbimi dhe pranimi i shërbimit.	Forma e punës Frontale dhe individuale Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Të dinë goditjet themelore të topit me raketë si: forhendi, bekhendi, shërbimi Të dinë elementet taktike të lojës	Matematika
<b>7. AKTIVITETET NË UJË</b>  <b>7-10 ditë</b>	Teknikat e notit: Krol, bretkosë. Nisjet dhe kthimet shkollore	Forma e punës Frontale dhe individuale  Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Të kenë qëndrueshmëri për ta notuar largësinë 50 m duke e përdorur secilën teknikë, si dhe nisjen dhe kthimet	Biologjia Fizika Edukimi shëndetësor
<b>8. SHËTITJE</b>	Shëtitje në natyrë, së paku 3 herë në vit	Forma e punës në grupe dhe individuale	Ecje 10-15 km	Socializimi i nxënësve dhe forcimi moralosportiv
<b>9. GARA SPORTIVE</b>	Aktivite sportive në formë të garave, së paku në dy disiplina sportive në kuadër të shkollës dhe ndërmjet shkollave të komunës	Format e punës ekipore (situacionale)	Zbatimi i rregullave të lojërave dhe sjellja sportive (fair –play)	(Sociologji dhe psikologji)

Nga katër sportet kolektive të ofruara shkolla duhet të zgjedhë së paku dy, varësisht nga kushtet dhe kuadrin që ka.

Përmbajtjet shtesë:

Vozitja me roshulla, me biçikletë, tenis, badminton, ragbi etj. Zgjedhjen e këtyre përmbajtjeve e bën mësuesi dhe shkolla në bazë të kushteve materiale, kadrovike dhe traditës së regjionit ku ndodhet shkolla

## **VLERËSIMI**

- Vlerësimi i zhvillimit trupor bëhet me instrumente antropometrike- dy herë në vit (lartësia e trupit dhe pesha e trupit)
- Vlerësimi i aftësive lëvizore bëhet me sistemin CGS-dy herë në vit (kërcim nga vendi në gjatësi, kërcim nga vendi në lartësi, vrapim 60 metra dhe vrapim 800 metra (vajzat ), 1000 metra (djemtë).
- Niveli i përvetësimit të informative lëvizore bëhet në mënyrë individuale dhe kolektive.
- Vlerësohet respektimi i rregullave të lojës dhe aftësia e bashkëpunimit dhe kooperimit në sportet kolektive.
- Niveli i përvetësimit të informative teorike vlerësohet përmes testeve me shkrim

## **TEKSTET DHE MJETET MËSIMORE**

1. **Hasangjekaj, B., Puka, J.:** *Edukata fizike për klasën V-VI*
2. **Hasangjekaj, B., Puka, J.:** *Edukata fizike për klasën VII-VIII*
3. **Hasangjekaj, B, Gjnolli E, Rakovica H, Puka, J, Nixha M dhe Allajbegu M.:** *Edukata fizike për kl. – I dhe II të AMO (Arsimi i Mesëm i Orientuar).*